

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË

NË 100-VJETORIN E AKADEMIK IDRIZ AJETIT

Materialet e Konferencës jubilarë-shkencore të mbajtur në Prishtinë me rastin e
100-vjetorit të lindjes së Akademik Idriz Ajetit (ASHAK) më 27 janar 2017

Përgatiti: Akademik Rexhep Ismajli

Këshilli organizues i Konferencës: Akademik Hivzi Islami, Akademik Ali Aliu, Akademik Eqrem Basha,
Akademik Ethem Likaj, Akademik Kolec Topalli dhe Akademik Rexhep Ismajli

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SECTION OF LINGUISTICS AND LITERATURE

ACADEMY OF SCIENCES OF ALBANIA

100th ANNIVERSARY OF ACADEMICIAN IDRIZ AJETI

Papers of Anniversary-Scientific Conference held in Prishtina honoring 100th
Birth Anniversary of Academician Idriz Ajeti (KASA) on January 27, 2017

Compiled by: Academician Rexhep Ismajli

Conference Organizing Committee: Academician Hivzi Islami, Academician Ali Aliu, Academician
Eqrem Basha, Academician Ethem Likaj, Academician Kolec Topalli and Academician Rexhep Ismajli

Editor: Academician Eqrem Basha, Secretary of the Section of Linguistics and Literature.



AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË

NË 100-VJETORIN E AKADEMIK IDRIZ AJETIT

Materialet e Konferencës jubilarë-shkencore të mbajtur në Prishtinë me rastin e
100-vjetorit të lindjes së Akademik Idriz Ajetit (ASHAK) më 27 janar 2017

Përgatiti: Akademik Rexhep Ismajli

Këshilli organizues i Konferencës: Akademik Hivzi Islami, Akademik Ali Aliu, Akademik Eqrem Basha,
Akademik Ethem Likaj, Akademik Kolec Topalli dhe Akademik Rexhep Ismajli

Redaktor: Akademik Eqrem Basha, Sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë.



Copyright © ASHAK



Akademik Idriz Ajeti

PËRMBAJTJA

Rexhep ISMAJLI: FJALA E HAPJES	11
Hivzi ISLAMI: AKADEMIK IDRIZ AJETI SIMBOLIZON NJË EPOKË TË ALBANOLOGJISË	12
Muzafer KORKUTI: FJALË PËRSHËNDETËSE	15
Rexhep ISMAJLI: FIGURA DHE VEPRA E IDRIZ AJETIT	17
Kolec TOPALLI: NJË SHEKULL NË SHËRBIM TË KOMBIT	23
Wilfried FIDLIER: IDRIZ AJETI DHE MERITAT E TIJ PËR ALBANOLOGJINË NË BERLININ LINDOR.....	27
Seit MANSAKU: PREJARDHJA E GJUHËS SHQIPE DHE E POPULLIT SHQIPTAR NË VEPRËN E AKADEMIKUT IDRIZ AJETI	33
Victor A. FRIEDMAN: NJË BALLKANIZËM I VJETËR	41
Murat BLAKU: NGA VEPRIMTARIA SHKENCORE E AKADEMIK IDRIZ AJETIT DERI MË 1982.....	45
Bardhyl DEMIRAJ: PËR GJUHËN SHQIPE	53
Skënder GASHI: MENDIME RRETH FORMIMIT DHE PREJARDHJES SË EMRIT HOTI TË FISIT TË SHQIPTARËVE.....	59
Bahri BECI: RRETH PIKËPAMJEVE PËR HISTORINË E STRUKTURËS DIALEKTORE TË SHQIPES	87
Ragip MULAKU: PROF. IDRIZ AJETI PËR ORIGINËN ILIRE TË GJUHËS SHQIPE DHE TË POPULLIT SHQIPTAR.....	93
Ethem LIKAJ: AKADEMIK IDRIZ AJETI: MENDIME DHE RISI PËR RASAT E SHQIPES.....	103
A.S. KARPIKOVA, A.Yu. RUSAKOV: FORMAT E TIPIT "PËR TË + PJESORE" NË SHQIPEN E SOTME (SIPAS TË DHËNAVE TË KORPUSIT ELEKTRONIK)	115
Irena SAWICKA: NGA PROBLEMET E FONETIKËS BALLKANIKE.....	125

Francesco ALTIMARI: ANALISI DI ALCUNI MANOSCRITTI DI PIETRO STANCOVICH SULL'ALBANESE DELL'ISTRIA: SULLE TRACCE DI ALCUNE RICERCHE CONDOTTE PRECEDENTEMENTE DA IDRIZ AJETI SU QUESTA VARIETÀ LINGUISTICA	133
Imri BADALLAJ: RRETH DISA VROJTIMEVE TË PROFESOR IDRIZ AJETIT MBI FONETIKËN HISTORIKE TË GJUHËS SHQIPE	175
Gjovalin SHKURTAJ: HULLI TË MBARA DHE KONTRIBUTE TË AKAD. IDRIZ AJETIT NË FUSHËN E DIALEKTOLOGJISË DHE TË ONOMASTIKËS SHQIPTARE	181
Shaban SINANI: KËRKIMET SHKENCORE SI ETNOGJUHËSI NË STUDIMET E PROF. IDRIZ AJETIT	183
Mimoza PRIKU: HISTORIA E ALBANOLOGJISË NË KËNDVËSHTRIMIN E PROFESOR IDRIZ AJETIT	199
Valter MEMISHA: NDIHMESA SHKENCORE E AKADEMIK IDRIZ AJETI NË FAQET E REVISTËS <i>STUDIME FILOLOGJIKE</i>	209
Mehmet HALIMI: AKADEMIK IDRIZ AJETI MJESHTËR I MADH I PËRDORIMIT TË FJALËS SHQIPE.....	229
Berton SULEJMANI: STUDIMET GJUHËSORE TË AKADEMIK IDRIZ AJETIT TË BOTUARA NË SHKUP	241
Shkumbin MUNISHI: KONTRIBUTI I IDRIZ AJETIT PËR STANDARDIZIMIN E GJUHËS SHQIPE.....	253
Begzad BALIU: RAPORTET E PROFESOR AJETIT ME PROFESOR ÇABEJN	263
Abdullah HAMITI: KONTRIBUTI I IDRIZ AJETIT NË STUDIMIN E TEKSTEVE SHQIPE ME ALFABET ARAB.....	281
Naser PAJAZITI: PROFESOR IDRIZ AJETI PËR GJUHËN E “DIVANIT TË SHEH MALIQIT	291
Fridrik DULAJ: NDIHMESA E IDRIZ AJETIT RRETH TË FOLMES SË RAHOVECIT SIPAS DESHIFRIMIT TË DIVANIT TË SHEH MALIQIT.....	295
INDEKSI	305

SHËNIM

Më 27 janar 2017 u mbushën 100 vjet nga lindja e Akademik Idriz Ajetit. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës dhe Akademia e Shkencave të Shqipërisë, në kuadër të Protokollit vijues dyvjeçar të bashkëpunimit, kishin parashikuar që ky përvjetor i rëndësishëm për shkencën dhe kulturën shqiptare të shënohej me një Konferencë shkencore jubilarë në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Konferenca u mbajt në datën e lindjes së akademik Ajetit në Sallën solemne të Akademisë duke filluar në orën 10:00 me praninë e zyrtarëve shtetërorë dhe institucionalë të Kosovës, të studiuesve e dashamirësve të Ajetit. Konferenca i zhvilloi punimet në dy pjesë: në pjesën e parë jubilarë, folën kryetari i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës – Akademik Hivzi Islami, kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë – Akademik Myzafer Korkuti. Konferencën e përshëndetën Rektori i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” – profesor dr. Marjan Dema, Drejtori i Institutit Albanologjik të Prishtinës – profesor dr. Hysen Matoshi, albanologu i shquar nga Gjermania – profesor dr. Wilfried Fiedler, albanologu i shquar arbëresh profesor dr. Francesco Altimari, ambasadori i Republikës së Shqipërisë z. Qemal Minxhozi, u lexua dhe përshëndetja e albanologut amerikan prof. dr. Victor Friedman, që ishte dërguar në emër të albanologëve amerikanë, dhe në emër të familjes përshëndeti z. Arbër Vllahu.

Këshili organizues i Konferencës vendosi që materialet shkencore të lexuara ose të dërguara për këtë konferencë të botohen në një vëllim të veçantë në kuadër të botimeve të Akademisë. Redaksia ia doli të mblidhte shumicën e materialeve që po paraqiten në këtë vëllim.

Rexhep ISMAJLI, Prishtinë

FJALA E HAPJES

I dashur dhe i nderuar Akademik Idriz Ajeti,
I nderuar Z. Kryeministër i Republikës së Kosovës, akademik Isa Mustafa,
I nderuar Kryetar i ASHAK-ut, akademik Hivzi Islami,
I nderuar Kryetar i ASHSH-së, akademik Myzafer Korkuti,
Të nderuar akademikë, studiues dhe pjesëmarrës të kësaj Konference
jubilare shkencore,
Të nderuar të pranishëm,

Jemi këtu sot për të shënuar 100 vjetorin e lindjes së duajenit të dijes, gjuhëtarit, albanologut profesorit akademik Idriz Ajeti, përfaqësuesit të shquar të brezit të intelektualëve të Kosovës që me veprën shkencore, me punën prej pedagogu, me veprimtarinë në udhëheqje të institucioneve të larta arsimore e shkencore, me prezantimin e studimeve shqiptare në hapësirat kombëtare e ndërkombëtare, i ka mbështjellë me një ndjenjë të ngrohtë për prosperitetin e popullit të vet dhe për miqësinë me fqinjë dhe të tjerët.

Në përvjetorët e mëparmë të Idriz Ajetit kanë qarkulluar disa data të lindjes. Në vendimin që kishte marrë profesori për pensionim është shënuar 4 janari 1917, ndërsa në disa raste të tjera 27 janari apo edhe 26 qershori, siç ishte shënuar në disa përvjetorë më herët. Siç shpjeguan vetë profesori dhe zonja Hajrije para 3 muajsh në zyrën e Kryetarit të Akademisë, data e lindjes së tij është ajo që është shënuar në pasaportën e tij – 27 janar 1917 në Tupallë të Medvegjes. Datat që shënojnë muajin qershor, sipas tyre, kanë qenë vendosur me të treguar. Akademia e ka përligjur këtë shpjegim të profesor Ajetit dhe Z. Hajrije dhe ka vendosur ta shënojë sot.

Konferenca do të zgjasë një ditë dhe është parashikuar që t'i zhvillojë punimet në dy pjesë – në pjesën jubilarë dhe në pjesën shkencore.

Tani do të ftoj me radhë të parashikuarit për të marrë fjalën.

Hivzi ISLAMI, Kryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovë

AKADEMIK IDRIZ AJETI SIMBOLIZON NJË EPOKË TË ALBANOLOGJISË

Shumë i nderuar Akademik Idriz Ajeti, e nderuar zonja Hajrie dhe familja Ajeti,
I nderuar Kryeministër i Republikës së Kosovës, z. Isa MUSTAFA,
I nderuar Kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akademik Muzaffer KORKUTI,
Të nderuar miq, Ambasador i Republikës së Shqipërisë, Rektor i Univesitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”,
Drejtor i Institutit Albanologjik,
Albanologë të huaj dhe studiues të gjuhës dhe të kulturës shqiptare,
Kolegë, Zonja, Zotërinj,
Media të respektuara,

Të gjitha kohët e shkuara për shqiptarët ishin të rënda, ndërsa për intelektualët dhe krijuesit e tyre në gjithë hapësirën gjeoetnike edhe më të ndera. Por dijetarët dhe intelektualët tanë ishin njerëz të tjerë, të veçantë, kontributdhënës, të dinjitetshëm ndaj vetvetes dhe të tjerëve. I donim, i respektonim, mësonim nga veprat e tyre, i konsideronim model të njerëzve të ditur, sepse ishin vërtet të mëdhenj, nder për kulturën dhe kombin tonë. Profesor Idriz Ajeti është njëri ndër ta, me një të veçantë fatlume për të dhe për ne që pati shëndet të plotë dhe jetë të gjatë, duke shkelur pikërisht sot, më 27 janar, në të njëqindtat. Urime Profesor dhe rrofshi sa malet!

Kur përmendet emri profesor, në mjedisin tonë akademik, kulturor e shoqëror të gjithë e dinë se bëhet fjalë për Profesor Idriz Ajetin, sikur në Tiranë që dikur me emrin profesor njihej Profesor Eqrem Çabej. Historia e gjuhësisë, e shkencave albanologjike dhe e kulturës shqiptare nuk mund të

merret me mend pa profesor Idriz Ajetin. Prof. Ajeti, me atë lagje të vogël, por të fortë intelektualësh, dijetarësh dhe patriotësh të Kosovës, çfarë ishin Esad Mekuli, Mark Krasniqi, Ali Hadri, Anton Çeta, Gazmend Zajmi, Dervish Rozhaja, Fehmi Agani e shumë të tjerë, të mbështetur nga faktori politik kosovar i kohës, me punë, mund e sakrifica të mëdha, i ngritën institucionet arsimore e shkencore dhe i mbajtën gjallë veprimtaritë kulturore e shoqërore të Kosovës dhe qenien kombëtare, gjithnjë brenda synimit kolektiv për emancipim dhe përparim të kombit shqiptar. Prof. Idrizi, si doktor i parë i shkencave në Kosovë dhe si intelektual i radhëve të para, kudo që gjendej dhe vepronte, impononte dhe pushtonte me butësinë, qetësinë, shëmbëllesën e mirësisë, optimizmin dhe pamjen prej intelektual.

Profesor Idrizi Ajeti ka një rrugë të ngjeshur jetësore, shkencore dhe intelektuale. Jetoj, veproi dhe krijoi, thënë kushtimisht, në tri regjime, si tri epoka, në të cilat kombi dhe kultura shqiptare përjetuan zhvillime dramatike: ngritje dhe rënie, prosperitet dhe ngulfatje. Ai e përjetoi rrugëtimin e rëndë të Kosovës dhe të shkencave albanologjike në gjithë kompleksitetin e tyre, duke qenë edhe dëshmitar edhe pjesëmarrës, me të gjitha ballafaqimet. I lindur në Tupallë të Medvegjës para një shekulli, ndërsa i shkolluar në Shkup, Zagreb, Pisa, Padova dhe Beograd, i takon gjithë trungut gjeoetnik, gjithë kombit shqiptar dhe tërë kulturës së tij.

Nga fillimet e shkollimit të tij, në vitet '30 e '40 të shekullit XX, nga një gjendje e analfabetizmit kolektiv të shqiptarëve, me ndryshimet politike e shoqërore që do të pasojnë në Kosovë dhe rreth saj, prof. Idrizi do të gjendet në majat e institucioneve shkencore e kulturore të Kosovës. Ishte themeluesi dhe shefi i parë i Katedrës së Albanologjisë, kryeredaktori i parë i revistave prestigjioze "Gjurmime albanologjike" dhe "Studime", drejtor i Institutit Albanologjik, dekan i Fakultetit Filozofik, rektor i UP-së, kryetar i ASHAK-ut, ideator kryesor i Seminarit për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare dhe drejtor i parë i tij, kryetar i parë i Këshillit për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut në Kosovë, kryetar i Parlamentit të Republikës së Kosovës në vitet më të rënda për Kosovën dhe shqiptarët, pjesëmarrës i Konferencës së Rambujesë. Për punën e tij shkencore-hulumtuese dhe publike mori shumë mirënjohje dhe dekorata.

Me trashëgiminë që po na lë, Profesor Idriz Ajeti po lë dhe gjurmë të pashlyeshme në jetën shkencore, kulturore, pedagogjike, kombëtare dhe shoqërore të shqiptarëve të Kosovës dhe të shqiptarëve në përgjithësi në gjysmën e dytë të shekullit XX dhe në fillim të këtij që po e jetojmë. Brezat, pa mëdyshje, do të jenë mirënjohës për trashëgiminë e tij në fushën e dijeve albanologjike dhe në afirmimin e rezultateve të tyre jashtë kufijve kombëtarë e ballkanikë. Vepra e tij shkencore në gjuhësi pa dyshim do të mbetet burim i pashmangshëm reference.

Profesor Idriz Ajeti simbolizon një epokë të albanologjisë, prandaj emri dhe vepra i tij do të rrojnë sa kohë të rrojnë gjuhësia shqiptare dhe shkencat albanologjike.

Ju faleminderit!

Dëshiroj të ju njoftoj se me rastin e 100-vjetorit të Akademik Idriz Ajetit, Kryetari i Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi e ka dekoruar profesorin me medalje për merita të jashtëzakonshme në fushën e shkencës, të arsimit dhe të kulturës. Në pamundësi që të vijë sot në këtë event dhe t'ia dorëzojë dekoratën, ajo do t'i jepet me një rast të veçantë.

Në emër të Akademisë, e falënderoj Presidentin për kujdesin dhe respektin që tregoi për Akad. Ajetin. Është ky dhe një respekt për familjen Ajeti, për shkencën, për Akademinë dhe gjithë shoqërinë e dijes.

Faleminderit!

Muzafer KORKUTI, Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë

FJALË PËRSHËNDETËSE

I dashur e i nderuar Profesor Idriz Ajeti,
Gëzuar, gëzuar 100 vjetorin e lindjes!
I nderuar z. Isa Mustafa, Kryeministër i Kosovës
Të nderuar ministra e deputetë,
I nderuar prof. Hivzi Islami, Kryetar i ASHAK-ut,
Të nderuar Akademikë

Sot është një ditë e shënuar, një ditë e madhe nga vlera që bart, mbasi 100 vjet më parë lindi Idriz Ajeti, dijetari me kontribute origjinale, themelore në gjuhësi dhe personalitetet me ndikim në historinë e mendimit shqiptar; figurë e shquar e shkencës albanologjike. Dy akademitë tona e nderojnë e lartësojnë sot, me mbajtjen e kësaj konference jubilarë – shkencore ndërkombëtare.

Në raste përvjetorësh të mëdha, veç kumtimeve e ligjëratave, ka edhe mënyra të tjera vlerësimesh. ASHSH-ja dhe juria për dhënie të Çmimeve Shkencore Kombëtare e organizuar për herë të parë nga Akademia jonë, *Çmimin e karrierës* (për vitin 2016) ia jep Akademik Idriz Ajetit.

Me motivacionin:

“Dijetar me një veprimtari të gjatë dhe të frytshme akademike e universitare; i pranishëm në mënyrë të pandërprerë e të suksesshme prej shtatë dekadash në shkencat albanologjike; me kontribute origjinale e themelore në gjuhësinë historike e të krahasuar, në marrëdhëniet e shqipes me gjuhët e tjera në arealin ballkanik, në dialektologji e histori shkrimi, në procesin e njësimimit të shqipes letrare.

Personalitet me ndikim të mirënjohur në jetën qytetare të Kosovës dhe në historinë e mendimit shqiptar; që, me modelin e urtësisë dhe ndjeshmëritë e larta ndaj së drejtës, i lartësoi dhe u dha nder përgjegjësive e detyrave të rëndësishme që ka ushtruar”.

Tiranë, më 27 janar 2017

Rexhep ISMAJLI, Prishtinë

FIGURA DHE VEPPRA E IDRIZ AJETIT

(Fjalë me rastin e 100-vjetorit të lindjes)

Akademik Idriz Ajeti është një nga personalitetet e shquara të jetës shkencore, intelektuale e publike ndër shqiptarët e Kosovës dhe të botës shqiptare. Veprimtaria e tij intelektuale, arsimore e organizative u zhvillua në një fazë dinamike të proceseve kulturore e kombëtare të shqiptarëve, në një periudhë kur studiuesi duhej të ishte njëherësh mësues, veprimtar publik, arsimues i popullit, organizues i jetës shkencore, kulturore e shoqërore, bartës i veprimtarive që do ta transformonin mjedisin e vet. Prania e Ajetit në të gjitha zhvillimet shkencore-kulturore e shoqërore në këto 7 dekada në Kosovë dhe në botën shqiptare ka qenë e dukshme. Ai nuk qëndroi anash në fazën e vështirë të rezistencës në vitet '90 të sh. XX, në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut e në veprimtarinë shoqërore si *Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës*, në *Delegacionin e Rambujesë*, etj.

Krijimtaria shkencore e Idriz Ajetit tregon se ai iu qas studimit të shqipes duke e kuptuar gjuhën në frymë të teorisë që shkon në sh. XIX te W. von Humboldt, sipas së cilës gjuha “është emanacion specifik i shpirtit të popullit”. Iu qas, pra, me një dashuri e respekt të tillë. Mund të thuhet se gjuha shqipe e pati Idriz Ajetin një ndër kujdestarët e interesuar për pastërtinë e saj, kërkestarët për theksimin e begatisë së saj. Me këtë ndjenjë janë të lidhura edhe studimet e tij për ndikimet e shqipes në fjalorin e gjuhëve sllave në kontakt, kontributi i tij për krijimin e gjuhës standarde e për përsosjen e saj, si dhe me shkrimet udhëzuese për kulturën e gjuhës etj.

Në tezën e doktoratës “*Zhvillimi historik i së folmes gege të shqiptarëve të Zarës së Dalmacisë*”, të bërë nën drejtimin e Henrik Barić-it, Idriz

Ajeti trajtoi me kompetencë një temë që e kishin shtruar para tij gjuhëtarët Gustav Weigand e Carlo Tagliavini dhe, jo vetëm që saktësoi shumë elemente dhe plotësoi prezantimin e deriatëhershëm të kësaj së folmeje e solli përfundime e sqarime të reja, por, duke i dhënë punimit të tij një strukturim dialektologjik historik krahasues, arriti të përcaktonte elemente të evoluimit të saj nga të folmet e Briskës e të Shestanit të Krajës, prej nga ishte shkëputur më shumë se dy shekuj më parë. Njëherësh, proceset e zhvillimit të brendshëm në mjedis të ndarë, ashtu si kontaktet e përditshme me kroatishen dhe italishten, qenë me rëndësi vendimtare për evoluimin e tërësishëm të kësaj së folmeje. Për t'ia dalë kësaj pune me degëzime të shumëfishta atij iu desh të bënte përshkrime dhe sqarime paralelisht për të dy të folmet në hapësira të ndryshme dhe të përpiquej të rindërtonte zhvillimet që kishin ndodhur midis dy gjendjeve të tyre. Studimi është vlerësuar nga W. Cimochowski si “monografi tepër interesant e me vlerë në dialektologjinë historike, një fushë që zakonisht është paraqitur tepër pak edhe në shumë gjuhë të tjera të hulumtuara më rrënjësisht...”. Ai ka thënë gjithashtu se “gjuhësia dhe dialektologjia i detyrojnë Ajetit mirënjohje të veçantë për të dhënat mbi të folmen e Krajës dhe vendosjen e pozitës së saj në kuadër të të folmeve fqinje të shqipes veriore”. Kjo mënyrë e trajtimit të materies dialektologjike, sado që ndonjëherë me shtrirje ndoshta të tepërta në historinë e përgjithshme të gjuhës, i cakton një vend të veçantë Idriz Ajetit në dialektologjinë shqiptare të deritashme. Këtu përket dhe studimi i tij për një tekst që jep gjurmë për një degëzim të shqipes veriperëndimore drejt veriut - në Istrië: *Djali plangprishës*.

Në punimet e tij për shkrimet shqipe me alfabet arab, siç janë “*Vehbija*” e Tahir Efendi Boshnjakut dhe “*Divani*” i Sheh Hilmi Maliqit, Ajeti u mor me gjuhën e autorëve të tyre, duke përcaktuar ndryshimet që kishin pësuar të folmet përkatëse, e Gjakovës nga viti 1835 dhe e Rahovecit nga fillimi i shek. XX. Në këto studime bie në sy edhe puna filologjike me tekstet me alfabet arab, por ai ndërmori dhe studime të tjera në fushën e studimit të shqipes së shkruar në shekujt XVI-XVII. Të themi po ashtu se ai ka realizuar dhe studime të tjera me interes për dialektologjinë aktuale, si për të folmet e Kosovës, për të folmen e Preshevës dhe Bujanovcit, etj.

Studimet e mëvona të Idriz Ajetit, në fushën e dialektologjisë historike dhe moderne dhe në fushën e historisë së gjuhës, kanë ardhur duke u

degëzuar dhe thelluar njëherësh në aspektet e studimit të krahasuar të shqipes, sidomos me gjuhët fqinje sllave, për çka na ka lënë një ndihmesë me vlerë. Posaçërisht me rëndësi janë studimet e tij për gjurmët gjuhësore e onomastike shqipe në hapësirat e Malit të Zi e të Hercegovinës, ashtu si ndikimet e ndërsjella të shqipes me gjuhët e dialektet sllave jugore. Ka qënë me vlerë theksimi nga ana e tij, e në vijën e Ivan Popoviqit, i dimensionit dhënës të shqipes në raportet me gjuhët sllave të jugut.

Në këtë gamë interesimesh vijnë dhe vështirimet e tij etimologjike, që shquhen për begatinë e refleksive dhe të informacioneve lidhur me materialet e shqyrtuara. Të vlefshme janë etimologjitë që ndërlidhen me botën ballkanike, e në këtë kuadër me gjuhët sllave të jugut.

Në fushën e historisë së brendshme të shqipes Idriz Ajeti ka lënë vepra të tjera: ka hartuar një nga gramatikat e para historike të shqipes nga shqiptarët (para tij këtë e kishte bërë Mahir Domi, veprën e të cilit Ajeti, siç dëshmon tani Fiedler, e kishte konsultuar, por nuk e kishte raportuar), ka shqyrtuar dhe studiuar çështje të ndryshme nga zhvillimet fonetike të para dhe në raport me zhvillimet në kontakt me gjuhët romane ballkanike dhe sllavishtet përkatëse dhe është marrë me paraqitjen e albanologjisë shqiptare dhe të huaj para opinionit tonë shkencor e të përgjithshëm. Idriz Ajeti është një nga njohësit e mirë të historisë së albanologjisë dhe njëherësh një nga njohësit e thelluar të historisë mesjetare e të hershme shqiptare e të Ballkanit ndër gjuhëtarë. Kjo e bënte atë ndër të kualifikuarit të fliste për çështje si prejardhja e gjuhës shqipe, prejardhjen ilire të së cilës e mbronte me ngulm dhe durim e shumë dije e finesa, sidomos në kohën kur merrej me këtë çështje intensivisht (në kohën sa ishte në kontakt të drejtpërdrejtë me Barić-in, në disertacionin e tij ende i jepte përparësi mundësisë që shqipja të kishte prejardhje trakase).

Idriz Ajeti është albanologu që ka marrë pjesë në të gjitha veprimtaritë studimore dhe planifikuese për shqipen letrare që nga viti 1952 në Prishtinë, për të vazhduar me ndihmesat e tij po në Prishtinë më 1957, më 1964 dhe më 1968 në Konsultën Gjuhësore dhe më 1972 në Kongresin e Drejtshkrimit në Tiranë dhe në të gjitha rastet e ka dhënë kontributin e tij. Qëndrimet e tij i kanë ndjekur rrugët e zhvillimeve, duke iu përshtatur proceseve për të vendosur gjuhë të përbashkët letrare për të gjithë shqiptarët.

Veprimtaria shkencore-hulumtuese e Idriz Ajetit është e gjerë dhe e larmishme, përfshin aspektet më të ndryshme të studimeve gjuhësore, gjithnjë të para nga pikëvështrimi i albanologut. Filologjia e teksteve shqipe me alfabet arab gjente tek Ajeti njohësin, ashtu si në tërësi filologjia shqiptare.

Pas largimit të Selman Rizës, që shquhej për qëndrimet e tij kritike, Idriz Ajeti u bë personaliteti që ndikonte në mënyrë efektive në orientimet e studimeve të më të rinjve.

Idriz Ajetin e gjejmë të angazhuar dhe me diskutime e reagime publike në instanca të ndryshme në ish-Jugosllavi gjithnjë në mbrojtje të gjuhës shqipe, të historisë së saj dhe të drejtave të shqiptarëve.

Idriz Ajeti ka mësuar në shkolla të ndryshme të kohës, ndër të cilat shquhet Medreseja e Mbretit në Shkup (1938). Ka studiuar në Zagreb e në Padova, është diplomuar në Beograd në Degën e gjuhëve romane më 1949. Në Beograd i ka vijuar studimet nën drejtimin e albanologut Henrik Barić. Idriz Ajeti është thelluar në studimet e gjuhësisë krahasimtare, në romanistikë e sllavistikë, ka studiuar me themel trashëgiminë albanistike ndërkombëtare, veprat klasike të Gustav Meyer-it, të Holger Pedersen-it, të Norbert Jokl-it, të Henrik Barić-it, të Petar Skok-ut, të Waclaw. Cimochofski-t e Agnia Desnickaja-s dhe më vonë sidomos të Eqrem Çabejtë e të studiuesve të shumtë shqiptarë; me zotërimin e gjuhëve sllave, romane e të gjermanishtes, me dije të sllavistikës, të romanistikës e të gjermanistikës, i ka hapur vetes fushë veprimi të gjerë hulumtuese brenda shqipes në historinë e saj, në degëzimet dialektore, dhe, në një kontekst më të gjerë ballkanistik e indoeuropian, në krahasimet dhe vështirimet etimologjike. Pas viteve '60, kur njohu idetë e Çabejtë, ai u përqendrua në fushën e studimeve për prejardhjen e gjuhës shqipe, të studimeve etimologjike dhe të historisë së gjuhës dhe paralelisht me këtë në fushën e gjuhës letrare.

Profesor i gjuhës dhe i letërsisë shqipe në Gjimnazin e Prishtinës, mësimdhënës në Seminarin e Albanologjisë në Beograd, është doktoruar në shkencat filologjike më 1958 në Beograd; më 1960 e ka nisur karrierën e veprimit universitar dhe shkencor në Kosovë, së pari si profesor i Historisë së gjuhës shqipe dhe i dialektologjisë në Katedrën e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe në Fakultetin e Filozofisë të Prishtinës më 1960, për të vazh-

duar me botimin e revistës *Gjurmime albanologjike* më 1962. Pas vitit 1966 Idriz Ajeti dhe një grup arsimtarësh përbënin bërthamën e ekipit që hapësirën e mësimdhënies në gjuhën shqipe në universitet duhej ta pushtonte me shpejtësi, jo rrallë me gjoks e fljime. Më 1967 në Prishtinë u themelua Instituti Albanologjik me 5 punonjës. Idriz Ajeti ishte një nga kryesorët. Aty u kalua revista *Gjurmime albanologjike*, u nis *Recherches albanologique* më 1984 me Idriz Ajetin kryeredaktor. Në fushën e botimeve Idriz Ajeti ka marë pjesë në revistat e *Buletin i Punimeve të FF*, *Studia humanistica* dhe *Seminari*. Më 1994 Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës vendosi të botonte një revistë shkencore me profil të gjerë të shkencave shoqërore *Studime*; I. Ajeti dhe G. Zajmi ishin ata që më kërkuan t'i hynim kësaj pune dhe ja që edhe në ato kushte, në bashkëpunim me Kryeredaktorin Ajeti, revistën e bëmë.

Idriz Ajeti ishte në krye të shumë projekteve hulumtuese e shkencore me afat më të gjatë në kuadër të veprimtarisë shkencore të Institutit Albanologjik, të ASHAK-ut, të Universitetit të Prishtinës dhe të institucioneve të tjera. Më 1972 në Fakultetin e Filozofisë Idriz Ajeti doli në krye të studimeve të shkallës së tretë në fushat e gjuhësisë dhe të letërsisë. Më 1974 ishte në krye të nismëtarëve për themelimin e Qendrës/ Seminarit Ndërkombëtar të Gjuhës, Letërsisë e Kulturës Shqiptare, ku mbledheshin studiues të njohur e të rinj nga mbarë bota. Seminari u bë qendër me rëndësi për daljen e rezultateve të albanologjisë dhe të kulturës shqiptare jashtë, për afirmim të mëtejme të Kosovës e të botës shqiptare, dhe njëherësh rrugë për të sjellë përvoja, dije, informime e vlera nga bota në mesin tonë. Prishtina ishte bërë një nga qendrat e mëdha albanologjike. Idriz Ajetin e kishim në krye të këtij institucioni gati dy dekada. Rreth dy dekada Idriz Ajeti qe Shef i Katedrës së Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe të Fakultetit të Filozofisë. Në vitet 1971-1973 Idriz Ajeti ishte Dekan i Fakultetit të Filozofisë, ndërsa në vitet 1973-1975 Rektor i Universitetit të Prishtinës. Në vitet 1980-1982 qe drejtor i Institutit Albanologjik të Prishtinës.

Më 1975 u themelua Shoqata e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, që më vonë do të shndërrohet në ASHAK. Idriz Ajeti u zgjodh ndër anëtarët e parë të saj. Ai shquhet në kuadër të veprimtarisë së Akademisë, Kryetar i së cilës ishte në vitet 1979-1981 dhe 1996-1999. Në vitet '90 të sh. XX Idriz Ajetin e gjejmë të angazhuar në Këshillin për të Drejtat dhe Liritë

e Njeriut në Prishtinë. Ndërsa në vitin 1998 u zgjodh Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Idriz Ajeti është nderuar me mirënjohje dhe medalje të shumta, ndër të cilat shënohen edhe: Çmimi i Dhejtorit i KSA të Kosovës, Çmimi i 7 Korrikut i Republikës së Serbisë, Çmimi i AVNOJ-it i Jugosllavisë, Nderi i Kombit i Republikës së Shqipërisë nga presidenti Nishani dhe Medalja për merita të jashtëzakonshme në fushën e shkencës, të arsimit dhe të kulturës nga Presidenti Thaçi.

Kualitetet e trajtesave të tij shkencore kanë bërë që vepra e tij të radhitet ndër veprat e qëndrueshme të gjuhësisë shqiptare, të radhitet krahas veprave të gjuhëtarëve të shquar shqiptarë, krahas veprës së Aleksandër Xhuvanit, Mark La Pianës, Selman Rizës, Shaban Demirajt, Mahir Domit – të prira nga vepra e Eqrem Çabejt.

Kolec TOPALLI, Tiranë

NJË SHEKULL NË SHËRBIM TË KOMBIT

Shpesh jeta tregohet bujare me ata që dinë të jetojnë e të punojnë, me ata që vetën e tyre e vënë në shërbim të shoqërisë, të vendit ku kanë lindur e të kombit të cilit i përkasin. I tillë është rasti që na ka mbledhur sot për akademikun, profesorin e nderuar Idriz Ajeti.

Jeta e tij, një shembull për t'u ndjekur. Puna e tij, një vijë e drejtë gjithnjë në ngritje përgjatë një shekulli. Emri i tij, i skalitur në shumë institucione arsimit, kulture e shkence. Fjala e tij, e gjallë dhe shprehëse, në shumë kongrese, konferenca shkencore e simpoziume.

Lindi në një vit plot tym e krisma, kur njerëzia mes vetes ishte kaçafytë. U rrit, u edukua e u brumos në martiren e Ballkanit, në Kosovën e ndarë padrejtësisht nga trualli amë.

Udhë e gjatë e jetës së tij, ashtu si edhe e shumë intelektualëve të tjerë shqiptarë, nuk ka qenë e sheshtë e pa brenga; por ai ka zgjedhur gjithnjë anën e mbarë të saj, duke kapërcyer shumë pengesa e vështirësi, sepse ka ecur gjithnjë i orientuar nga ylli polar, që i ndriçonte rrugën me moton: *”Kosova është tokë shqiptare”*. Prandaj edhe jeta u tregua bujare me të, dhe s'mund të ishte ndryshe, se ai s'mund të largohej pa e parë Kosovën të lirë, për të cilën kishte vënë gurët e themelit në arsim, në shkencë e në kulturë, si drejtues, edukues e profesor për shumë e shumë breza.

E nisi aktivitetin shkencor që në rini të tij, në moshën studentore, dhe erdhi duke e shtrirë në vitet e mëvonshme duke përfshirë fusha të ndryshme të albanologjisë, ashtu si edhe aktivitete të shumta pedagogjike e arsimore, që ishin aq të nevojshme për Kosovën. Pati interesa dhe qasje shkencore të gjithanshme në fushën e albanologjisë, ku përfshihen: gjuha shqipe në rrafshin sinkronik e diakronik, dialektet e saj, sidomos të folmet e ge-

gërishtes verilindore, historia e gjuhës, shqipja e diasporës, dokumentet e lashta, probleme të fonetikës e morfologjisë historike, toponimia e trevave të banuara nga shqiptarë, vështrime etimologjike në fjalorin e shqipes dhe në toponime të trevave shqiptare, marrëdhëniet e shqipes me gjuhët fqinje, me një përjasje të veçantë me gjuhët sllave, si edhe shumë probleme të tjera me të cilat është përballur shqipja në rrugën e saj të gjatë deri në ditët e sotme.

Koha kur punoi dhe vendi ku jetoi kërkonin angazhime të gjithanshme në fushën e shkencës, arsimit e kulturës e deri në administratën shtetërore, të cilave akademiku ynë i nderuar iu përgjigj me të gjithë fuqinë e tij intelektuale, duke dhënë kontribute me vlerë në krijimin e arsimit në gjuhën amtare, sidomos në ngritjen e institucioneve të arsimit të lartë, në studimet shkencore dhe në përgatitjen e brezave të ardhshëm të mësuesve, pedagogëve, gjuhëtarëve, nëpunësve etj., duke qenë shumëherë i pari që çeli udhë të reja, ku ecën pas tij brezat që ai kishte edukuar. Rruga e tij prej shkencëtari, pedagogu e edukuesi pasqyron udhën e gjatë, të vështirë e të mundimshme të vetë Kosovës dhe të intelektualëve të saj për të mëkëmbur e për të fuqizuar shkollën e arsimit në gjuhën amtare, shkencën albanologjike dhe identitetin e të qenit shqiptar.

Në fillimet e punës së tij, duke iu përgjigjur nevojave të ngutshme të shkollave në gjuhën shqipe, u mor edhe me botime tekstesh shkollore dhe përkthime në gjuhën shqipe. Në periudhat e mëvonshme iu përkushtua tërësisht gjuhësisë, ku, me punën e tij të palodhshme, me studimet shkencore në fushë të albanologjisë, eci në një hap me brezin e gjuhëtarëve shqiptarë të gjysmës së dytë të shekullit të kaluar, profesorët e nderuar Eqrem Çabej, Selman Riza, Martin Camaj, Mahir Domi, Shaban Demiraj e Namik Resuli, që i dhanë frymëmarrje të re studimeve shqiptare, me njohjen e thellë të gjuhës amtare, të dialekteve dhe të folmeve të saj dhe me hulumtimin e dokumenteve më të lashta të shqipes, duke i çuar në një nivel më të lartë studimet albanistike. Nëpërmjet librave dhe artikujve të botuar në revista të ndryshme, akademik Ajeti trajtoi shumë probleme të fonetikës, morfologjisë, sintaksës dhe drejtshkrimit të shqipes, çështje të studimit historik të dialekteve dhe të onomastikës aktuale dhe mesjetare, probleme të kulturës së gjuhës, të zhvillimit të gjuhës letrare shqipe në Kosovë dhe shumë çështje të tjera, që janë ende aktuale në studimet tona albanologjike. Duke

vështruar me një horizont të gjerë shkencor, studimet e tij nuk janë kufizuar vetëm në viset e Kosovës, por shtrihen edhe më përtej, në të gjitha trevat shqiptare, si në Mal të Zi, Maqedoni, Serbi, Bosnje-Hercegovinë e deri në të folmet shqipe të ngulimeve në territore larg trevave shqiptare. Madje, këto të fundit kanë tërhequr vëmendjen e tij që në moshën e rinisë. Ai shquhet gjithashtu edhe për kritikën në fushë të gjuhësisë për botimet albanologjike, çka tregon se ishte në kontakt të vazhdueshëm dhe ndiqte me vëmendje çdo hap të ri në këtë fushë. Ndër figurat e shquara të shkencës e kulturës shqiptare shkroi për Buzukun, Bogdanin, Sami Frashërin, Fan Nolin, Gjeçovin, Gazullin, si edhe për figura albanologësh të brezit të tij. Ndër gjuhëtarët e huaj, shkroi për Bariçin, Tagliavinin, Nahtigalin, Koneskin, Haeblerin, Skokun etj.

Falë punës së këtij dijetari dhe të kontributeve të tij në fushën e shkencës e të arsimit, si edhe të shumë intelektualëve të tjerë, bashkëkohës të tij, sot Kosova është bërë një vatrë e fuqishme e studimeve albanologjike, që me punën e saj rrezaton në të gjitha trevat e banuara nga shqiptarë dhe më përtej në vende të tjera europiane, një qendër e tillë që përpunon mendimin më të përparuar në fushë të albanologjisë duke ngritur gjithnjë e më lart identitetin e kombit shqiptar e të gjuhës shqipe. Botimet e shumta monografike në fushë të albanologjisë, revistat që trajtojnë probleme të gjuhës shqipe, seminarët e përvitshme me një pjesëmarrje ndërkombëtare albanologësh, janë të gjitha kontribute të gjuhëtarëve kosovarë, që kanë në themelet e tyre punën prej nismëtari të akademikut të shquar Idriz Ajeti. Unë nuk mund ta harroj kurrë praninë e profesorit të nderuar në ditët kur zhvilloheshin seminare të tilla në Prishtinë, kur ai zinte vend në rreshtat e para, dëgjonte me vëmendje ata më të rinjtë, studentët e tij, dhe herë pas here jepte mendime e sugjerime për probleme të ndryshme, edhe pse i kishte kaluar të nëntëdhjetat. Është një shembull i rrallë, për t'u ndjekur në të gjitha drejtimet, për vullnetin, këmbënguljen, përkushtimin, orientimin e drejtë dhe përpjekjet për të kapërcyer pengesat e vështirësitë.

Si albanolog, ai ka shkruar e botuar një varg librash, monografish, artikujsh e kumtesash, ku spikat serioziteti i punës prej shkencëtari. Si pedagog, ka mbajtur barrën e rëndë të ligjëruesit të historisë së gjuhës shqipe; si organizator i arsimit të lartë, ka qenë dekan i fakultetit të Filozofisë dhe rektor i Universitetit të Prishtinës; si drejtues shkencor, ka qenë drejtor i

Instituti Albanologjik dhe nënkryetar e kryetar i Akademisë së Shkencave e të Arteve të Kosovës.

Fusha kryesore e studimeve të tij është historia e gjuhës shqipe. Si historian i saj, me studimet në fushën e etimologjisë dhe të gramatikës historike, ka dhënë kontribute që i kapërcejnë fushat e albanologjisë dhe shtrihen në indoeuropianistikë, ballkanologji, romanistikë, helenistikë, turkologji etj. Me studimet për marrëdhëniet e shqipes me gjuhët sllave ka dhënë kontribute që pasurojnë sllavistikën, duke vënë në dukje ç'ka marrë shqipja prej gjuhëve sllave dhe çfarë u ka dhënë ajo atyre gjuhëve. Me vlerë të veçanta janë studimet e tij në fushë të onomastikës, sidomos për toponimet mesjetare në trojet shqiptare. Të gjitha këto, bashkë me studimet e fushave të tjera, i japin akademikut Idriz Ajeti vendin e merituar në albanologji si një përfaqësues i denjë i majave të shkencës shqiptare.

Këtë vit ai mbush 100 vjet. Një shekull jetë ka shpjegimin e vet: trashëgimia familjare, ajri i shëndoshë i Kosovës dhe puna e pareshtur e me pasion që e shoqëroi gjatë gjithë jetës. I urojmë akademikut tonë të nderuar edhe shumë vite të tjera.

Wilfried FIDLER, Meissen

IDRIZ AJETI DHE MERITAT E TIJ PËR ALBANOLOGJINË NË BERLININ LINDOR

Të dashura kolege, të dashur kolegë,

Jubilari ynë shumë i dashur dhe i nderuar shquhet për meritat e shumta në një numër të madh të fushave të shkencës sonë, në lëmin e dialektologjisë dhe të onomastikës, të historisë së gjuhës dhe të lidhjeve midis shqipes dhe gjuhëve sllave të Jugut. Një kontribut të veçantë i dha sidomos zhvillimit të një gjuhe të përbashkët dhe të standardizuar shqipe. Të gjitha këto merita dalin qartë p. sh. nga libri i porsadalë i kolegëve Bahtijar Kryeziu dhe Begzad Baliu me titullin "Rrapi shekullor Akademik Idriz Ajeti". Por, nuk dua të flas këtu, me rastin e jubileut të veçantë dhe të rrallë të akademik Idriz Ajetit për meritat e çmuara që ka fituar jubilar.

Po pati mundësi desha të skicoj me pak fjalë marrëdhëniet e mia personale me profesor Ajetin, takimet dhe letërshtëmbimet midis profesorit dhe meje personalisht dhe kolegëve të mi albanologë në Berlinin Lindor.

Në fillim, pa hyrë në temë, duhet të them se një Orë e bardhë, që më ka ndihmuar edhe disa herë të tjera në jetën time si albanolog, bëri të mundur një udhëtim studimi në Shqipëri gjatë verës së vitit 1959, drejtpërdrejtë para se të binte, në vitet 1960 dhe 1961, një perde tjetër e hekurt midis Shqipërisë dhe vendeve të tjera të bllokut të Lindjes.

Mu në atë kohë kur isha duke mbaruar hartimin e disertacionit tim, në gusht të 1961 u ngrit muri i Berlinit, kështu që për mua ishin ndërprerë njëkohësisht lidhjet edhe me kolegët e Gjermanisë Perëndimore, që vërtet edhe në kohën përpara kishin qenë mjaft të vështira, dhe me kolegët dhe miqt e Tiranës. Kolegët shqiptarë, sidomos profesorët Eqrem Çabej dhe

Ramadan Sokoli, më kishin përkrahur në zgjidhjen e problemeve të shumta gjuhësore dhe folklorike të përpunimi i materialit të ekspeditës sonë folklorike të vitit 1957 si edhe në lidhje me problemet gramatikore. Por tani, më 1959-60, kontaktet u ndërpre në mënyrë të padashur.

Nga ana tjetër gjendja e vështirë politike u bë një sfidë që m'u desh ta pranoja: Në Berlin erdhën nxënësit e Lambercit, i cili kishte dalë në pension, p.sh. Gerda Uhlisch nga Laipcigu, dhe njëkohësisht u kthyen studentët e albanologjisë, ndër tyre Oda Buchholz, Erwin Lewin dhe Peter Schubert, të cilët nuk kishin mundur t'i kryenin studimet në Universitetin e parë të Shqipërisë. Meqenëse isha i vetmi që kishte fituar të paktën titullin e doktorit të albanologjisë, më ngarkuan mua që t'i përcillja drejt provimit shtetëror pranë Universitetit Humboldt dhe më vonë drejt doktoratës. Siç dihet, Oda Buchholz u bë, disa vjet më vonë, bashkëpunëtorja ime më e ngushtë në fushën e albanologjisë.

Por shkenca albanologjike varej, mund të themi, në hava - pa kontakte, pa revista shkencore. Mendoja se mund t'ua dërgoja institucioneve dhe shkencëtarëve më të njohur jashtë vendit disertacionin tim, që të bëhesha pak i njohur dhe të merrja në shkëmbim literaturën e nevojshme për punën e mëtejme. Mirëpo të shtypësh një libër me titullin "Formimi i shumësit në gjuhën shqipe" asokohe ishte e pamundur në RDGj. Keshtu vendosa të shumëfishoja disertacionin tim, vërtet me një mënyrë tepër primitive, e cila printoja dhe lexohej pastaj me zor, dhe t'ua dërgoja albanologëve të huaj, për emrat e të cilëve kisha dijeni. Per fat të mirë plani im mjaft i guximshëm ia mbërriti qëllimit: Pas kësaj u zhvilluan lidhje shumë të mira dhe të frytshme midis nesh dhe albanologëve të huaj, sidomos nga Bashkimi Sovjetik por edhe nga Shtetet e Bashkuara.

Mirëpo si qëndronte në atë kohë puna me vendet e trevës shqipfolëse? Lidhjet me Shqipërinë ishin bërë të pamundura. Jugosllavia, pra edhe Kosova dhe Maqedonia, zyrtarisht konsideroheshin si çerdhe të revizionizmit, edhe pse tani sulmi ideologjik i drejtohej më shumë sidomos Shqipërisë.

Deri atëherë nuk kisha njohur asnjë shqiptar nga Jugosllavia. Bile gjatë qëndrimeve të mia në Shqipëri shumëkush më kishte thënë se Shqiptarët e Kosovës qenkishin shpërngulur në Turqi. Nuk e kujtoj se kush

mund të ma kishte dhënë informacionin për Idriz Ajetin. Sidoqoftë: më 9 prill 1962 dërgova me postë një kopje të disertacionit me adresën e pasaktë: "Prof.Dr. Idriz Ajeti, Priština, Institut für Albanologie." Ishte një gëzim i vërtetë për mua, kur e mora, dy muaj më vonë, shkresën përgjigjeje, ku profesor Ajeti shkruante, ndër të tjera: "mund t'ju thom se rezultatet që në lidhje me të folmet e Kosovë-Metohisë ju kanë dalë, mbas mendimit tonë, nuk do të jenë të sakta, çka përligjet krejt lehtë me mungesën e literaturës përkatëse. Përndryshe keni bërë punë të madhe e të dobishme, që do t'u shërbejë e çfarë të shërbyemi përpjekjeve të Shqiptarëve në punë të njësimit të gjuhës së tyre letrare."

Pastaj prof.Ajeti më informoi për themelimin e revistës "Gjurmime Albanologjike" dhe vazhdoi: "Nga brezi i ri ju jeni n'ato vise të botës i vetmi shkencëtar që aktivisht merret me shqipen, prandaj Redaksia veç çka gëzohet nëqoftë se e nderoni me ndonji kontribut për numrin e dytë të Revistës së saj. "Kështu kam botuar, në numrin e dytë, dy kontribute: për mua ishte hapur rruga e botimeve në Kosovë, e cila do të më çonte shumë më vonë deri në botimin e dy monografive të vëllimshme, të cilat janë botuar, shumë më vonë, në bazë të recensioneve të akademikëve Idriz Ajeti dhe Rexhep Ismajli.

Në të njëjtën letër prof. Ajeti më informoi se kishte pasur dëshirën të takohej edhe me ne në Berlin. Ai thotë: "Kisha vendosë të dilja pak në dy Gjermanitë, gjithandej në Berlin e t'ju vizitoja, mirëpo nuk na doli dot në krye, e jo për fajin tim. Ne Beograd, në Legatën Demokratike Gjermane më kërkuen ftesë zyrtare nga Fakulteti a Instituti i juej, e një dokument i tillë m'u mungonte. Nejse, do të takohemi një herë tjetër."

Kjo tregon më së miri, se realizimi i udhëtimeve midis dy shteteve tona ishte akoma shumë i vështirë, dhe përsa i takonte Kosovës, edhe më i ndërlikuar. E njëjta gjë vlente për lidhjet ndërmjet Jugosllavisë së atëherëshme dhe Shqipërisë. Kështu profesor Ajeti m'u lut në një letër me datën 4. shkurt 1965: "Diku kisha lexue që Mahir Domi paska dhanë një palë skrip-tesh me titull: Morfologjia historike e shqipes, që ma vërtetuet edhe Ju dhe me atë rasë më thatë se e kishit një copë. Ju lutem shumë të m'i çoni për një 10-15 dit t'ua shkoj një sy e të shoh pale si i ka shtjellue disa probleme." Pasi ia pata dërguar mikrofilmin e punës përkatëse.

Në shkresën e përgjigjes profesori thotë: "Pikësëpari Ju falem nderit për mikrofilmimin e dispensës së Morfologjisë së Mahir Domit. E kam zhvillue dhe jam tue shtie në punë në përgatitjen e një teksti të Morfologjisë historike për të cilën kisha lidhë kontratë me Degën e Botimeve të Teksteve të Këtushme. Ja mbaj mendjen të prek në këte tekst edhe parashtesat me mbrapashtesa për të cilat kohën e fundit na kanë dalë punime të reja: Xhuvani-Çabej." Ky dokument tregon se, në atë periudhë, me gjithë vësh-tirësitë rruga për në Berlin ishte me më pak gurë se ajo për në Tiranë.

Duhet përmendur se realizimi i një takimi të parë me profesor Ajetin nuk rezultoi, në radhë të parë, nga punët e mia albanologjike, por varej prej faktit se unë lidhjet me etnografinë e vendeve të Evropës Lindore nuk i kisha ndërprerë dhe bashkëpunoja me kryeredaksinë e revistës referative DEMOS, e cila kishte redaksi kombëtare për çdo vend të Lindjes, dhe synonte të hapte të tilla edhe në çdo republikë e krahinë të Jugosllavisë. Prandaj mora lejen të merrja pjesë në Kongresin e Folkloristëve të Jugosllavisë në Novi Vinodolski (Kroaci) në fund të shtatorit 1964 dhe lidhur me këtë të vizitoja institucionet ballkanologjike në Beograd (ndër të tjera me prof. Dançetoviqin) dhe në Prishtinë. Më 30 shtator të vitit 1964 më priti atje, në mënyrë shumë të përzemërt, profesor Ajeti, tashmë Shef i Katedrës për gjuhën dhe letërsinë shqipe. Përveç diskutimeve të frytshme me kolegët prishtinas, me profesorët Ajeti, Mehdi Bardhi, Anton Çetta, Shefqet Pllana e shumë të tjerë m'u dha rasti të vizitoja disa fshatra të Kosovës për ta plotësuar materialin për shumësin në të folmet, dhe për të mbledhur përralla dhe të dhëna të tjera gjuhësore. Veç kësaj prof. Ajeti më mundësoi një ekskursion të paplanifikuar në Shkup, ku u njoha me profesorët Janura, Vidoeski, Jashar-Nasteva etj.

Tani ishin krijuar lidhje shumë të ngushta me pothuajse të gjitha institucionet albanologjike dhe ballkanologjike në Jugosllavinë e atëher-shme - për mua personalisht si edhe për kolegët e mi të Berlinit.

Mirëpo tensionet midis Lindjes dhe vendeve të tjera keqësoheshin vit pas viti. Pika më e ulët ishte arritur në vitin 1966, kur u bë Kongresi i parë Ndërkombëtar i Studimeve të Evropës Juglindore. Dua të përmend vetëm kontaktin e përealizuar të profesorëve Ajeti dhe Çabej, të cilin e kanë përshtkruar kolegët Kryeziu dhe Baliu në Librin e tyre.

Por invazoni i Paktit të Varshavës në Çekosllovakia, që ndodhi dy vjet më vonë, sigurisht një nga ngjarjet më të rrezikshme gjatë Luftës së ftohtë, kishte si pasojë një rezultat të çuditshëm: disi u normalizuan marrëdhëniet midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë - të dy shtetet kishin frikë mos të ndodhte një gjë e ngjashme edhe në Ballkan. Tani profesorët e Tiranës mund të vinin në Prishtinë dhe të mbanin leksione. Me siguri edhe realizimi i përpjekjeve më të zemrës të Idriz Ajetit, krijimi i gjuhës së përbashkët, të cilin na e ka paraqitur në mënyrë të hollësishme miku ynë Rexhep Ismajli, p.sh. në librin e tij "Në gjuhë" dhe "Për gjuhë", lidhet me këto ngjarje. Kuptohet se - nga ana tjetër - prania e albanologëve të Berlinit Lindor në këto ditë të gëzuara ishte krejt e pamundshme. E konsideroj një mrrekulli të vërtetë q137 neve, Odës dhe mua, na e dhanë lejen të merrnim pjesë në Kongresën e Drejtshkrimit në nëntor 1972.

Në këto vite Oda dhe unë punonim në hartimin e një fjalori shqip-gjermanisht dhe të "Gramatikës së gjuhës shqipe", por njëkohësisht edhe në përgatitjen e albanologëve të rinj. Sidomos studenti ynë më i mirë Dieter Nehring na lidhi, shumë shpejt, me kolegët e Prishtinës dhe, në mënyrë të veçantë, me prof. Ajetin, ligjeratat e të cilit, mbajtur edhe shqip edhe serbokroatisht, Dieteri i kishte ndjekur në fund të viteve 1970.

Siç duket, zbutja e tensionit ndërkombëtar në fillim të viteve 1970 lehtësoi edhe përmbushjen e meritës më të madhe të Idriz Ajetit që ka fituar në fushën e shkencës ndërkombëtare, për albanologjinë e vendeve të huaja, pra edhe për ne: ai mundësoi krijimin e "Sëminarit të kulturës shqiptare për të huaj" në verë të vitit 1974, i cili më vonë u riemërtua "Sëminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare". Idriz Ajeti, jo vetëm se ishte iniciator dhe drejtues i këtij institucioni, por vetë mori pjesë në të si ligjërues. Duhet pasur parasysh se asokohe kolegët e Tiranës nuk do të kishin pasur mundësi të ftonin shkencëtarë, pa folur për studentë dhe fillestarë në fushën e shkencës sonë. Prandaj mund të themi me gojën plot se në këto vite Prishtina ishte bërë vatra e albanologjisë ndërkombëtare, Profesor Ajeti njihej si përfaqësues i shqiptarëve të ish-Jugosllavisë në fushën e shkencës dhe të shkollave të larta në Evropë dhe më gjerë. Historia e institucioneve albanologjike dhe balkanologjike pa të do të kishte marrë një rrugë tjetër. Që të them vetëm dy fjalë për veten time dhe për berlinasit e tjerë: ne u njohëm dhe u miqësuan në Sëminarin e Prishtinës me

albanologët e Gjermanisë dhe të gjithë botës, me arbëreshët dhe arvanitasit, për këtë deshëm ta shprehim dhe njëherë mirënjohjen tonë edhe këtu para jubilarit tonë të nderuar.

Kjo iniciativë e akademik Ajetit pati pasoja shumë frytdhënëse në lulëzimin e shkencës sonë, por mund ta nënvizoj: si për gjithë albanologjinë ndërkombëtare ashtu edhe për jetën time personale.

Seit MANSAKU, Tiranë

PREJARDHJA E GJUHËS SHQIPE DHE E POPULLIT SHQIPTAR NË VEPRËN E AKADEMIKUT IDRIZ AJETI

Është një kënaqësi e veçantë që sot jemi mbledhur këtu në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës për të festuar 100-vjetorin e një studiuesi dhe atdhetari të shquar të kombit shqiptar siç është akademiku Idriz Ajeti. Njëqindvjetori i lindjes është një jubile i madh. Rrallë qëllon që ky jubilar i madh t'i takojë dhe një njeriu të madh dhe një shkencëtari të madh dhe që atë ta përjetojë dhe ta gëzojë vetë jubilari.

Brezit të studiuesve të Idriz Ajetit që e nisën veprimtarinë e tyre pas Luftës së Dytë Botërore koha u ngarkoi të kryenin detyra të shkencëtarit, por edhe të misionarit në fushën e arsimit, të shkencës dhe të kulturës kombëtare. Atyre u takoi barra dhe nderi të krijonin dhe të të hidhnin themelet e institucioneve të larta shkencore e arsimore të vendit dhe ata e kryen me përkushtim të lartë: themeluan institucionet shkencore e të arsimit të lartë, përgatitën punonjësit shkencorë e pedagogët që do të punonin në këto institucione, i udhëhoqën ato me veprimtarinë dhe shembullin e tyre, krijuan dhe vijuan një traditë të pakthyeshme dhe vijnë ballëllart në përvjetorë të rrethuar me nderime nga ndjekës dhe bashkëpunorë të zellshëm që po vazhdojnë më tej veprën e tyre, traditën e krijuar prej tyre.

Për personalitetin dhe veprën e akademik Idriz Ajetit janë bërë vlerësime të merituar në disa raste të tilla, megjithatë për një figure të përmasave të tilla ka gjithmonë vend për të folur dhe për të shkruar. Për një vlerësim të përgjithshëm të figurës dhe të veprës së akademik Idriz Ajetit, unë do të pajtohesha plotësisht me vlerësimin sintezë që i ka bërë akademiku Rexhep Ismajli, njohësi dhe promovuesi më i mirë i personalitetit dhe i veprës së tij me rastin e 90-vjetorit të lindjes. Në referimin e mbajtur

me këtë rast Rexhep Ismajli pohon: “Mendoj se pajtohem, kolegë të nderuar, se figurën e Idriz Ajetit sot mund ta portretizojmë në dy vija themelore: në vijën e veprimtarit të shquar për emancipimin e përgjithshëm të popullit të tij, dhe në vijën e dijetarit të shquar të botës shqiptare, studiuesit të njerës nga shtyllat e mëdha identitare të këtij populli, të gjuhës. Këto vija vijnë e pleksen në rezultatin përfundimtar, që është një figurë madhore e dijes, e kulturës dhe emancipimit të përgjithshëm shqiptar të shekullit 20 dhe të fillimit të shekullit XXI”¹. Sot, 10 vjet më vonë në 100-vjetorin e lindjes figura, vepra dhe personaliteti i Idriz Ajetit vjen edhe më e plotë, më e dashur, më madhore.

Akademiku Idriz Ajeti, i cili e ka rrokur në tërësi problematikën e gjuhës shqipe, të historisë dhe të zhvillimeve të sotme të saj, pothuajse në të gjithë shtrirjen e saj kohore dhe hapësinore, nuk mund të linte jashtë vëmendjes së tij problemet që lidhen me etnogjenezën e shqiptarëve dhe të gjuhës së tyre. Probleme të tilla, siç dihet, paraqesin jo vetëm një rendësi të veçantë shkencore, por edhe kombëtare. Në veçanti për Kosovën ato kanë qenë probleme të mprehta, të ndjeshme, shkencore e shoqërore. Në trajtimin e problemeve të tilla studiuesit i duhet të ruajë një baraspeshë të menduar mirë midis shkencëtarit objektiv dhe shkencëtarit të angazhuar në mbrojtje të vlerave historike kombëtare dhe identitetit gjuhësor e kulturor kombëtar. Unë besoj se akademik Idriz Ajeti ka ditur të bashkojë në një cilësi të shkencëtarit objektiv dhe të atdhetarit të përkushtuar, duke iu përmbajtur asaj devize që E. Çabej e përsëriste shpesh, të jemi objektivë, por jo indiferentë.

Në trajtimin e problemeve të etnogjenezës së popullit shqiptar dhe të gjuhës shqipe, siç ka vërejtur edhe akademik Rexhep Ismajli, Idriz Ajeti mbështetet në parimet, metodat dhe arritjet e gjuhësisë historike krahasuese të gjysmës së dytë të shekullit XIX dhe të drejtimeve të mëvonshme gjuhësore të fillimit të shekullit XX, të përditësuara me arritjet e albanologjisë së gjysmës së dytë të shekullit të shekullit XX në botën shqiptare dhe jashtë saj.

Ai ka ndjekur dhe pasuruar më tej rrugën e studiuesve e dijetarëve më të shquar që janë marrë me këtë fushë studimesh, duke filluar që nga

¹ R. Ismajli, Figura dhe vepra e Idriz Ajetit, ASHAK, Studime 14, Prishtinë 2007. f. 9-16.

fundi i shekullit XVIII me veprën e Johannes Thunmann deri në fund të shekullit XX me veprën E. Çabejt, Mahir Domit e të Shaban Demirajt, E. Hampit. A. Desnickajas etj. Në metodologjinë e tyre shkencore problemet e etnogjenezës së shqipes dhe të shqiptarëve janë shtruar e diskutuar në një kontekst të gjerë historik, arkeologjik, etnografik e gjuhësor. Nga ana tjetër, janë vështuar e studiuar në lidhje të ngushtë me gjendjen antike etniko-gjuhësore të Gadishullit të Ballkanit dhe me gjendjen e sotme të njësisë gjuhësore ballkanike.

Akademik Idriz Ajeti u ka kushtuar problemeve të etnogjenezës disa punime të botuara në organe shkencore, të cilat janë përfshirë edhe në vëllimet e veprave të autorit, të botuara nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës. Po përmendim disa prej tyre: “*Mbi origjinën ilire të gjuhës shqipe*”, botuar në Studime gjuhësore në fushë të shqipes III, Prishtinë 1985, f. 5-11; *Formimi i popullit shqiptar dhe i gjuhës së tij*, botuar në vëllimin IV, f. 7-12, Prishtinë, 2001; *Shqipja e vështuar nga aspekti i studimeve ballkanistike*, botuar në: Idriz Ajeti, Vepra IV, Prishtinë 2001, f.13-21 etj.

Akademik Idriz Ajeti ka mbrojtur me pjekuri dhe maturi shkencore tezën e origjinës ilire të gjuhës shqipe dhe të popullit shqiptar dhe autoktoninë e tyre duke e mbështetur atë me argumentet më të qëndrueshme dhe më të besueshme që kanë mundur t’i qëndrojnë së vërtetës shkencore. Ai i ka përforcuar, plotësuar dhe pasuruar këto argumente me të dhëna nga studimet e tij në fushën e marrëdhënieve të shipes me gjuhët sllave, të gjuhësisë ballkanike dhe të romanistikës. Njohës i mirë i gjuhëve sllave dhe i gjuhëve romane, ai ka shfrytëzuar me dobi vepra të mjeshtërve të këtyre fushave si: Franz Miklosich, K. Jireček, H. Barić, Petar Skok, Radoslav Katičić, A. Desnickaja etj. Ka bërë vlerësimin kritik të tezave të tyre, duke ua nënshtruar një gjykim shkencor objektiv të drejtpeshuar..

Për autoktoninë e shqiptarëve Idriz Ajeti u referohet dëshmime të historianit erudit K. Jireček, njëri nga njohësit më kompetent, siç pohon ai, të historisë dhe të kulturës së popujve të Ballkanit, cili nga kërkimet e tij shumëvjeçare në arkivin e Dubrovnikut, kishte arritur në përfundimin se shqiptarët që në kohën antike gjendeshin gjatë bregdetit Adriatik dhe po në atë kohë, që në shekujt e parë të erës së re, përqaftuan fenë e re të krishterë,

gjithqysh para dyndjeve sllave që vërshuan në zotërimet e Perandorisë Romake e në tokat shqiptare. Sipas K. Jirečekut: “Në burimet mesjetare nuk bëhet fjalë kurkund për krishterimin e shqiptarëve; ata e përqaftuan fenë e re të krishterë në antikën, sepse historia e Ipeshkëvisë së Durrësit dhe e Shkodrës mund të ndiqet pa ndërprerje që nga vitet e para të erës së re deri në ditët e sotme”². Pra autori një nga argumentet që mbështesin tezën e autoktonisë së shsqiptarëve e gjen në krishterimin e hershëm të shqiptarëve dhe në terminologjinë e krishterë me burim latin në gjuhën shqipe.

Për të mbështetur autoktoninë e shqiptarëve dhe prejardhjen ilire të tyre dhe të gjuhës shqipe autori ka trajtuar edhe raportet e iliro-shqiptarëve me romanizimin në Ballkan dhe marrëdhëniet e shqipes me gjuhët klasike, me latinishten dhe me greqishten e vjetër. Në një shkrim të veçantë me titull *Formimi i popullit shqiptar dhe i gjuhës së tij*, Akademik Idriz Ajeti, duke u mbështetur edhe në studimet e E. Çabejt, R. Katičić etj, paraqet në mënyrë sintetike tre argumente themelore për të ndriçuar autoktoninë e shqiptarëve në trojet e tyre dhe prejardhjen ilire të gjuhës shqipe : 1. Mbishtresimi grek dhe ai latin i thesarit leksikor të gjuhës shqipe mund të ndodhte vetëm në territorin e Ballkanit të vjetër. 2. gjuha shqipe flitet vetëm në terrenin e mirëfilltë ilir. 3. Nuk ka kurrfarë lajmesh për imigrimin e shqiptarëve në mesjetën e hershme në atdheun historik të tyre. Në një gjendje të tillë të dijes, - pohon Idriz Ajeti -, del pothuajse vetëvetiu përfundimi se shqipja paraqet një formë moderne të ilirishtes. Duke mbështetur tezën ilire të origjinës së gjuhës shqipe dhe të popullit shqiptar, Idriz Ajeti nuk mendon se kjo tezë është vërtetuar përfundimisht në mënyrë të pakundërshtueshme. Supozimi se shqipja të ketë prejardhje ilire mbetet, për shkak të rrethanave të përshkruara në fillim, alternativa më e mundshme, që, nga ana tjetër, nuk është vërtetuar me siguri. Që prejardhja e shqiptarëve dhe e gjuhës së tyre të mos ketë alternativë-, vijon më tej autori-, duhet të ekzistonte një gjysëm faqe teksti në gjuhën ilire, në ilirishte³.

Një ndihmesë të veçantë për ndriçimin e problemeve të etnogenezës së shqiptarëve e të gjuhës shqipe Akademik Idriz Ajeti ka dhënë në

² Shih për këto Idriz Ajeti, *Formimi i popullit shqiptar dhe i gjuhës së tij*, Vepra 4, Prishtinë 2001, f.7, me literature.

³ Idriz Ajeti. *Vep. cit.* f. 20 me literaturë

fushën e kritikës shkencore ndaj tezave joshkencore dhe shumë herë tendencioze, nacionaliste e jodashmirëse ndaj popullit shqiptar. Ai ka bërë vërejtje e sygjerime herë pas here për metodologjinë e kërkimeve shkencore në këtë fushë studimesh duke nënvizuar domosdoshmërinë e karakterit objektiv të studimeve shkencore, shmangien e shtrëmbërimeve e deformimeve të qëllimshme e të trajtimeve diletante në shkencë.

Në vijim të përpjekjeve për të vërtetuar me sa më shumë argumente problemin e autoktonisë së shqiptarëve dhe origjinën ilire të tyre dhe për të rrëzuar mendimet e kundërta, I. Ajeti i ka kushtuar vëmendje në punimet e tij edhe marrëdhëniet e shqipes me latinishten dhe çeshtjes së romanizimit të Ballkanit, që është e lidhur me mbijetesën e gjuhës shqipe dhe të shqiptarëve përballë këtij procesi të fuqishëm rrafshues, asimilues

Siç dihet, romanizimi i Ilirisë së Jugut është përdorur si argument për të kundërshtuar tezën e autoktonisë së shqiptarëve dhe të prejardhjes ilire të tyre dhe të gjuhës shqipe. Kur trajtohet problemi i autoktonisë së shqiptarëve dhe i origjinës ilire të tyre në lidhje me procesin e romanizimit të Gadishullit të Ballkanit në gjysmën e mijëvjeçarit të parë të erës sonë, dalin një varg problemesh që kërkojnë zgjidhje, por unë do të veçoja dy prej tyre që janë mjaft të diskutueshme : *Së pari*, duhet sqaruar në mënyrë më të thelluar e pa paragjykime se në ç' masë u prekën viset ilire të Ilirisë së Jugut ku është formuar populli shqiptar dhe gjuha shqipe, nga procesi i romanizimit dhe *së dyti*, nëse pranohet se në viset ilire ku sot banojnë shqiptarët nuk ka pasur një romanizim të tillë që të sillte si pasojë ndërrime etnike e gjuhësore të thella, ndërrimin e gjuhës së popullsisë vendase dhe zëvendësimin e saj me një gjuhë romane, siç ndodhi në Daki dhe në Dalmaci, mendoj se duhen sqaruar në mënyrë më të thelluar cilët janë faktorët historikë, gjuhësorë dhe kulturorë që shpjegojnë mbijetesën e gjuhës shqipe, qëndresën e saj përballë romanizimit. Për pyetjen e parë është arritur një përfundim i pranueshëm sipas të cilit: Në Iliri të Jugut pati një ndikim të fuqishëm në leksikun e gjuhës së popullsisë vendase, por procesi i romanizimit nuk arriti ta zëvendësonte atë me një gjuhë romane. Këtë e dëshmon më së miri mbijetesja e gjuhës shqipe si vijim i pandërprerë i ilirishtes, e cila përmban në leksikun e saj një numër jo të vogël huazimesh latine, por ka ruajtur të paprekur strukturën gramatikore dhe një numër jo të vogël fjalësh të trashëguara nga periudha indoeuropiane.

Pë sa i përket çështjes së dytë, para çdo studiuesi që merret me historinë e gjuhës shqipe, duke pasur parasysh sundimin e gjatë roman në Iliri dhe kontaktet shumëshekullore e intensive të ilirishtes e më pas të arbërishtes me latinishten, shtrohet në mënyrë të natyrshme pyetja: Si ka mundur shqipja e vjetër, si vazhduese e pandërmjetme e ilirishtes, t'i shpëtojë romanizimit të plotë dhe të mbijetojë si gjuhë e veçantë, kur në krahina më lindore si Dakia, ku sundimi romak u vendos tre shekuj më vonë ndodhi shndërrimi i trakishtes në një gjuhë romane, në rumanishte? Kësaj pyetjeje i janë dhënë përgjigje të ndryshme. Këtë problem e shtron edhe Idriz Ajeti dhe përpiket t'i japë përgjigje.

Studiuesit që pranojnë romanizimin e Ballkanit perëndimor dhe në të njëjtën kohë mbrojnë tezën e autoktonisë së shqiptarëve dhe të prejardhjes ilire të gjuhës shqipe, përpiqen ta shpjegojnë mbijetesën e shqiptarëve dhe të gjuhës së tyre kryesisht me faktorin gjeografik. Ata mendojnë se stërgjyshërit e shqiptarëve mundën t'i shpëtonin romanizimit duke u tërhequr në zona malore e të izoluara brenda territorit të Ilirëve. Përfaqësuesi kryesor i kësaj teze, siç dihet, është historiani gjerman Georg Stadtmüller.

Për të shpjeguar mbijetesën e gjuhës shqipe dhe të popullit shqiptar në Iliri të Jugut përballë romanizimit, mendoj se faktori gjeografik ka luajtur një rol të rëndësishëm që nuk mund të shpërfillet, por ky shpjegim duhet të zhvishet nga paragjykimet dhe nga konotacionet e komentet negative që e shoqërojnë këtë tezë nga disa studius, të cilët duan t' i paraqesin shqiptarët si popullsi endacake e baritore pa ndonjë qytetërim të zhvilluar.

Në një mënyrë të përgjithësuar, mund të pohohet se gjuha shqipe ka mundur të mbijetojë gjatë sundimit të Perandorisë Romake dhe t'i shpëtojë romanizimit si rezultat i bashkëveprimit të një sërë faktorësh të natyrës historike, gjeografike, etnike dhe gjuhësore:

Faktori gjeografik, i parë jo ngushtë, i plotësuar edhe nga faktori demografik, me lëvizjet dhe kontaktet brendshme të popullsisë vendase, të ndikuara në shkallë të ndryshme nga procesi romanizimit, siç e ka vërejtur albanologja e njorur A. Desnickaja.

Faktori gjuhësor e kulturor, popullsia vendase përfaqësonte një grup etnik e gjuhësor krejt të veçantë e të ndryshëm nga latinët dhe latinishtja,

një popullsi e lashtë që kishte njohur edhe qytetërimin urban dhe një kulturë të lashtë autoktone nuk mund të verbohej nga shkëlqimi i qyteterimit romak dhe të braktiste lehtë gjuhën dhe kulturën e tij.

Faktori social psikologjik. Sundimi romak u ndesh në Iliri me një popullsi që shfaqti një vullnet e qëndresë këmbëngulëse për të mbrojtur gjuhën, kulturën dhe identitetin e saj. Të gjitha këto kanë ndikuar që popullsia vendase të përballojë procesin asimilues të romanizimit dhe të ruaj gjuhën e saj. Gjuhëtari i njohur francez Antoine Meillet, në një artikull për gjuhën shqipe që në fillim të shekullit XX do të theksonte: "Forca e rezistencës së gjuhës shqipe dëshmon tenacitetin e kombit"⁴. Po ky autor disa vite më pas, duke vërejtur ndikimin e gjerë të latinishtes në fjalorin e shqipes, do të pohonte për shqiptarët se "në vendin e tyre ata ruajnë me këmbëngulje gjuhën e tyre, sepse kombi i tyre ka tiparet e veta të veçanta; edhe pse është i vogël, grupi i tyre është rezistent."⁵

Përveç këtyre duhen mbajtur parasysh edhe politikat e ndryshme që ndoqi Roma ndaj provincave të Perandorisë Romake në Ballkan në përputhje me interesat e saj politike dhe ekonomike, të cilat kanë lidhje me numrin e kolonëve romakë që solli në to dhe të ushtarëve që rekrutoi dhe dislokoj në këto provinca për qëllime ushtarake e mbrojtëse.

Duke përfunduar do të pohoja se brezat e sotëm dhe brezat e ardhshëm kanë shumë për të mësuar nga vepra dhe personaliteti i akademik Idriz Ajetit, nga përkushtimi shkencor dhe atëdhetar i tij, nga metodologjia dhe arritjet shkencore të tij. I urojmë autorit shëndet dhe jetë për të gëzuar sa më gjatë frytet e punës së tij dhe për ta pasur sa më gjatë midis nesh.

Tiranë, 20 janar 2017

⁴ A. Meillet, *La langue albanaise*, në "Revue hebdomadaire", 7 gusht 1905

⁵ A. Meillet, *Les langues dans l'Europe nouvelle*, Paris 1928, f.29.

Historia e gjuhës shipe dhe historia e gjuhëve sllave janë ndërthurur për më tepër se një mijë vjet. Ky fakt ka lënë gjurmë të ndryshme në vendet të ndryshme. Idriz Ajeti ka botuar shumë studime të rëndësishme për këto shfaqje në Kosovë dhe Malin e Zi (shih, për shembull, Ajeti 2001a, 2001b, 2001c, 2001d). Këtu unë do të hulumtoj një dukuri të tillë në një rajon tjetër, në kufijtë e shqipes me maqedonishten dhe greqishten, dmth. në Vilayetin e Kosturit (pastaj pjesë e Vilayetit të Manastirit), veçanërisht në jugperëndim të vilajetit. Në këtë pjesë të ish-Perandorisë Otomane shqipja, greqishtja dhe maqedonishtja (si edhe gjuhë të tjera, veçanërisht vllahishtja, por edhe turqishtja, romishtja dhe xhudezmoja) ishin në kontakt të ngushtë shumëshekullor. Ky fakt u bie në sy, për shembull, në fshatrat maqedonase të Janovenit (Janoveni, Pilkati, Slimnica, Omotsko, Kalovish-ta),² kur në këngët popullore kemi strofa dyshe, ku një varg është maqedonisht, tjetri shqip apo greqisht, por edhe strofa shqip-greqisht (Jašar-Nasteva 1987:15-16). Edhe në gramatikën e të folmes maqedonase të Kosturit kemi zhvillime me rezultate shumë afërta me të shqipes. Për shembull, në këtë të folme të maqedonishtes e kryera origjinale sllave me 'jam' dhe pjesorja rezultative me *-l* është zëvendësuar plotësisht me të kryerën e re me 'kam' dhe mbiemrin foljor në asnjë, përveç në përdorimet me kujtimet e habitores së shqipes. Në kontekstet habitore, e kryera e vjetër sllave përdoret mu si habitorja e shqipes. Megjithatë zhvillimet e së kryerës së re të

¹ **Falënderim.** Hulumtimi dhe puna në terren për këtë artikull u realizuan në kohën kur isha vizitues i nderit në Research Center for Linguistic Diversity të La Trobe University. Jam falënderues për këtë mbështetje. Ata nuk mbajnë asnjë përgjegjësi për gabimet.

² Greqisht: Giannohóri, Monópēlon, Trilofos, Livadhotópi, Kalé Vrýsē. Grekët i kanë shkatërruar tërë fshatrat e Janovenit në kohën e luftës civile (Simovski 1998:23-42).

maqedonishtes dhe të habitores së shqipes në kontekstin gjuhësor ballkanik janë mjaft të pleksura (shih Goļab 1984:135 dhe Friedman 2010), mund të themi se bie në sy që maqedonishtja e rajonit të Kosturit tani është shumë e ngjashme me shqipen nga kjo pikëpamje. Këtu dua të hulumtoj një shfaqje tjetër, dhe më të vjetër, ku mund të vështrohej bashkëveprimi i maqedonishtes me shqipen dhe greqishten: pikërisht te refleksët e zanoreve hundore të sllavishtes së përgjithshme në të folmet e Kosturit.

Një tipar i të folmeve të maqedonishtes të Kosturit jugor, jugperëndimor dhe perëndimor është zhvillimi i tipit zanore+*n/m*+bashkëtingullore nga zanoret hundore të sllavishtes së përgjithshme në disa rrethana. Hollësitë e plota janë mjaft të ndërlikuara, por këtu do të mjaftojë shembulli *zqbū/zqbi* 'dhëmb/dhëmbë'. Nga fshtatrat rreth Liqenit të Kosturit deri në Drenovën e Prespës dhe Drenovën e Korçës, duke përfshirë Dëmbenin, Vëmbelin, Kosinecin, Smërdeshin dhe Vërbnikun, kemi refleksët *zāmp/zāmbi*, si edhe *zāp/zāmbi*, në disa fsharta në zonat periferike në lindje nga fshatrat me *zāmp/zāmbi*. Mirëpo, në zonat periferike jugperëndimore dhe jugore kemi *zāmp/zāmbi*, *zāp/zāmbi* apo një zanore të ngjashme të labializuar (Illič-Svityč 1962, Shklifov 1973, 1979, Vidoeski 1999). Refleksët konsekuente janë më periferike në kontekstin e maqedonishtes derisa alternimet ndeshen më afër zonës ku refleksët janë pa gjurmë të nazalizimit. Deri tani, ky fenomen është parë si një arkaizëm sllav periferik. Mirëpo, këtu unë po propozoj shpjegimin që thotë se kjo ka të bëjë me një risi ballkanike në kontekstin e kontakteve gjuhësore që ka mbetur periferike në maqedonishten për shkak të risive të tjera në veri dhe në lindje që pastaj kanë përfshirë jugun dhe perëndimin. Domethënë se nazalizimi në të folmet maqedonase të Kosturit është një ballkanizëm arkaik. Artikujt e Illiç-Svityč-it (1962) si edhe të Timberlake-ut (1978) e vështrojnë vetëm faktin se ka një bashkëtingëllore hundore, por jo cilësitë e zanoreve. Mu këtu, tek zanoret, kemi një dukuri që pasqyron kontaktet gjuhësore. Zanoret kanë një vend të vaçantë në sistemet e të folmevet: edhe *a*-ja apo *ā*-ja ekziston vetëm para një hundoreje me burim nga një zanore hundore dhe para një *r* nga *r*-ja rrokjeformuese në sllavishtjen e përgjithshme.³ Për këtë arsye, mund të supozojmë se ka pasur një fazë me *m* dhe *n* rrokjeformuese dhe në

³ Ngadonjëherë refleksi i *l* rrokjeformuese gjithashtu ka këtë zanore, mirëpo për shaqe fonetike, ka mjaft përjashtime.

këtë fazë ato ishin identifikuar me *r* rrokjeformuese si bashkëtingëllore rrokjeformuese. Pastaj, me zbërthimet në zanore+bashkëtingëllore, që të tria ishin trajtuar njësoj. Për shkak se *r* ka një sonoritet më të madh, ruhet në çdo rrethanë; *n/m* ka një sonoritet më të vogël dhe për këtë arsye ka ndryshime në lidhje me shkallën e sonoritetit (shih Timberlake 1978). Tani të shohim situatat në shqipen dhe në greqishten. Siç dihet, në toskërishten *â*-ja e shqipes së përgjithshme u bë *a* dhe nuk ka bashkëtingëllore rrokjeformuese. Përveç kësaj, në toskërishten ruhet bashkëtingëllorja zanore paraokluzive si edhe ka shurdhim në pozitën në fund të fjalës, krahaso *dhëmp/ dhëmbi* (dhe jo *dhâm/dhâmi* i gegënishtes) si maqedonisht *zëmp/ zëmbi*. Në greqishten, nuk ka as *a* as bashkëtingëllore rrokjeformuese. Në të folmet maqedonase me kontaktet më të ngushta me greqishten zbërthimi i bashkëtingëllores rrokjeformuese ka ndodhur me një zanore e labializuar. Të folmet greke në veri e ruajnë bashkëtingëlloren hundore paraokluzive më tepër se sa në jug. Edhe të folmet vllahe kanë përkime me tipin bashkëtingëllore hundore + okluzive. Dhe që të tri gjuhët (shqip, greqisht, vllahisht) s'kanë zanore hundore.

Kështu, mund të propozojmë shpjegimin që denazalizimi i zanoreve hundore në sllavishten në kontakt më të ngushtë me shqipen dhe greqishten (e vllahishten) është një pjesë e zbërthimeve të bashkëtingëlloreve rrokjeformuese në zanore+bashkëtingëllore. Dhe kjo do të ketë ndodhur me ndikimet nga gjuhët ku kështu do të ketë ndodhur me bashkëtingëlloret rrokjeformuese, pra me tingujt që s'ekzistonin në sistemet zanore të tyre. Dhe nga bërthamat në veriun e kësaj zone, reflekset maqedonase kanë përfshirë zonat në lindje, por atje kanë ndeshur një zhvillim tjetër nga veriu dhe verilindja, dhe ai tjetri kishte më tepër sukses, një sukses që ishte akoma në zhvillim (dmth. duke përfshirë) në shekullin XX.⁴ Duke pasur parasysh të gjithë hollësitë dialektore, mund të themi se nazalizimi i njohur në maqedonishten e rrethinave të Kosturit është një ballkanizëm i vjetër.

⁴ Është me rëndësi se në veri dhe verilindje në dretjim të të folmeve maqedonishte qendrore, *r*-ja rrokjeformuese ruhet dhe zanorja hundore bëhet zanore gojore, dmth. se s'ka kup-tim të mendojmë për një fazë kur do të ketë qenë zanore rrokjeformuese në këtë të folme.

Bibliografi

- Ajeti, Idriz 2001a. "Zhvillime parallel fonetike dhe ndikime të ndërsjella të dialekteve shqiptare dhe serbe të Kosovës" *Vepra* 4, 27-33. Prishtina: ASHAK.
- Ajeti, Idriz 2001b. "Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-sllave" *Vepra* 4, 23-26. Prishtina: ASHAK.
- Ajeti, Idriz 2001c. "Studime të ndërsjella etimologjike albano-sllave" *Vepra* 4, 35-39. Prishtina: ASHAK.
- Ajeti, Idriz 2001d. "Ndikimi i shqipes në të folmet serbe të Kosovës" *Vepra* 4, 91-100. Prishtina: ASHAK.
- Friedman, Victor A. 2010. "The Age of the Albanian Admirative: A Problem in Historical Semantics." *Ex Anatolia Lux: Anatolian and Indo-European Studies in Honor of H. Craig Melchert*, red. R. Kim, N. Oettinger, E. Rieken, M. Weiss, 31-39. Ann Arbor: Beech Stave.
- Gołąb Zbigniew. 1984. The Arumanian dialect of Kruševo in SR Macedonia SFR Yugoslavia. Skopje: MANU. 2 Ngadonjëherë, refleksi i l-eve rrokjezore gjithashtu kanë këtë zanore, mirëpo për shaqet fonetike, ka mjaft përjashtime. 3 Është me rëndësi se në veri dhe verilindje në dretjim të të folmeve maedonishte qendrore, r-ja rrokjezore rruhet dhe zanore hundore u bën zanore gojore, dmth. se s'ka kujtim të mendojmë për një fazë kur paska qenë zanore rrokjezore në kësaj dialekte.
- Illič-Svityč, Vladislav Markovič. 1962. "O studijax utraty rinezma v jugozapadnyx makedonskix govorax," *Voprosy slavyanskogo jazykoznanija* 6:77-88.
- Jašar-Nasteva, Olivera. 1987. *Turski elementi vo jazikot i stilot na makedonskata narodna poezija*. Skopje: MANU.
- Timberlake, Alan. 1978. "Uniform and Alternating Environments in Phonological Change," *Folia Slavica* 2 (1-3): 312-327.
- Shklifov, Blagoj. 1973. *Kostuskijat govor. Trudove po bālgarska dialektologija*, 8. Sofia: BAN.
- Shklifov, Blagoj 1979. *Dolnoprespanskijat govor. Trudove po bālgarska dialektologija*, 11. Sofia: BAN.
- Simovski, Todor Hristov. 1998. *Naselenite mesta vo Egejska Makedoniija*. Skopje: Zdruenie na deca begalci od egejskiot del na Makedonija.
- Vidoeski, Božidar. 1999. *Dijalektite na makedonskiot jazik* 2. Skopje: MANU.

Murat BLAKU, Prishtinë

NGA VEPRIMTARIA SHKENCORE E AKADEMIK IDRIZ AJETIT DERI MË 1982

(Pjesë nga një studim më i gjerë, botohet me rastin e 100 vjetorit të autorit)

Akademiku ynë, që kemi privilegjin ta përmderojmë sot me evari të veçantë, po shkel fatmirazi në shekullin e dytë të jetës së tij, i rrethuar nga kolegë, studiues, ish-studentë të tij sot emra të njohur te studimeve albanistike, miq e dashamirë të shumtë. Që të gjithë këta kanë parasysh portretin e një dijetari të sprovuar të studimeve të thelluara e të rezultateve që gëzojnë gjithandej njohje të përgjithshme dhe që i sigurojnë pa dyshim sot e mot një vend të denjë në Galerinë e të Mëdhenjve të studimeve albanistike.

Nuk premtojnë as koha as vendi që sot e këtu të përthekohet gangull e të parashtrohet e zbërthyer e gjithë puna kërkimore shkencore e një jete të tërë. Megjithëkëtë, përmbledhtas e në vija të trasha diçka edhe mund të përvijohet e të veçohet për segmente të caktuara.

Profesori ynë u formua në rrjedha teorike të avancuara të gjuhësisë krahasuese dhe në praktikën filologjike shkencore të kohës së tij, duke ecur sidomos në gjurmët e albanologëve dhe ballkanologëve të shquar e të mirënjohur Petar Skok, Henrik Bariç, Karlo Taliavini. Studimet e romanistikës, bashkë me zotërimin e mirë të gjuhëve kryesore të kësaj dege e të gjuhëve të tjera, do t'i hapnin perspektiva e horizonte të gjera për t'u njohur drejtpërdrejt me informacionin shkencor linguistik aktual, por edhe për t'u pajisur me një bagazh njohurish profesionale teorike-metodologjike përkatëse të domosdoshme.

Dialektologjia aktuale e historike, historia e gjuhës së shkruar në përgjithësi e sidomos e gjuhës së shkruar me alfabet arab në Kosovë në veçan-

ti, morfologjia historike e shqipes e problemet e diskutueshme të saj, historia e leksikut, me theks të veçantë në interferencat e dyanshme gjuhësore shqiptaro-sllavojugore, kryesisht nga burime të shkruara, onomastika mesjetare dhe e mëvonshme si dhe njësimi i standardit mbarëshqiptar janë fushat kryesore në të cilat lëvroi thellë autori ynë.

Ligjërimet shqiptare që mbetën jashtë kufijve të imponuar të asaj cope Shqipërie londineze, që u quajt shtet shqiptar, me ndonjë përjashtim të vogël, bëhen objekt studimesh ndërmjet dy luftërave botërore nga linguistë të huaj (Jokli, Mladenovi, Skoku, Taliavini, Lamerci etj. në vendet përkatëse). Me gjithë meritat e padiskutueshme, këto studime, siç u pa me kohë, kishin të përbashkët një të metë objektive: mosnjohjen nga brenda të tipareve të shqipes, element i rëndësishëm ky që do të ndreqej vetëm nga gjuhëtarë shqiptarë, ku ka hise patjetër edhe kremtuesi i njëqindvjetorit të moshës së tij sot.

Dy monografi – paradigma të studimeve dialektologjike

Më 1960 Ajeti botoi monografinë e tij **Pamje historike e ligjërimit shqip të Gjakovës në fillim të shekullit XIX**. Dalja në dritë e kësaj vepre përbën një ngjarje të shënuar për historinë e kërkimeve dialektologjike të të folmeve të Kosovës për shumë arsye: **E para**, sepse aty po bëhej për herë të parë objekt trajtimi me një kompetencë të plotë filologjike nga një linguist shqiptar dokumenti deri sot më i moçmi i një ligjërimi shqip të këtyre anëve dhe kështu opinionit dhe qarqeve shkencore po u jepeshin të dhëna burimore të rëndësishme, në radhë të parë fonetiko-fonologjike në tërësinë e tyre; **e dyta** ngase po ashtu për herë të parë një e folme vështrohet jo vetëm në sinkroni, po edhe në **diakroni**, duke ndjekur fillzhvillimin kronologjik të fenomeneve që nga burimet më të vjetra shkrimore të shqipes në përgjithësi dhe të kosovarishteve në veçanti; **e treta** për shkak se duke pasur tashmë një pasqyrë të prerjes së gjendjes zhvillimore të proceseve gjuhësore edhe në këto tërthore, zgjerohen suazat e përdëshmimit të dukurive të caktuara zhvillimore historike, qoftë edhe në fillim të shek.XIX; **e katërta**, se me këtë vepër po hapeshin shtigje për kërkime të tjera në fushën e dokumeteve të vjetra të shqipes së këtyre anëve. Në këtë rrafsh autori ynë

ka merita të veçanta (shih edhe **Mbi gjuhën e "Divanit" të Sheh Maliqit**, botuar së pari te "Gjurmime albanologjike", 3/1966).

Duke iu sjellë gjuhës së **Vehbijes së Tahir Efendi Boshnjakut** (Stamboll, 1835), këtij deri sot "Meshari" të ligjërimeve të Kosovës (më saktësisht të të folmes së Gjakovës), Ajeti, ndër të tjera vërente:

a) Në fushën e vokalizmit, për sa i takon *kuantitetit të zanoreve*, përpos tri gjatësive të rëndomta, ai ndesh dhe konstaton edhe një tjetër-*gjatësinë kompensatore* te rrokja paraprirëse, në ato fjalë ku ë- ja fundore zhduket, si edhe ndër të folme të tjera gege :*ditë>diit>dit; pikë>piik>pik; botë>boot>bot* etj. Më shumë se kjo, janë disa tipare të tjera dialektore karakteristike që përmbahen në vepërzën e Boshnjakut, vërejtur me sy të mprehtë nga autori ynë dhe që pakkush apo askush s'do t' i besonte. Me një akribi të rrallë ai ia doli të konstatonte, pas transkriptimit të **Vehbijes**, praninë asokohe të **nazalitetit** të zanoreve në këtë ligjërime, që përbënte gati një sensacion, po të mbahet parasysh prirja e fuqishme më vonë e **labializimit** sidomos të **a-së** në **o** në këtë të folme dhe në disa ligjërime të tjera të Kosovës. Ishte një "punë Sizifi" kjo, duke ditur karakterin e grafisë së alfabetit arab, me të cilin ishte shkruar e botuar vepërza në fjalë.

Një tjetër element me rëndësi për historinë e vokalizmit të kësaj së folmeje, gjithnjë sipas autorit tonë, është ruajtja e pandryshuar këtu e grupit vokalik **ue**, që sot është zhdukur pa nam e nishan dhe është monoftonguar në **u**, si edhe në një pjesë të madhe të ligjërimeve të Kosovës. Asokohe **ruhej** për mrekulli, me konsekuencë të plotë madje: *Tue kan deka ma e randë se...; Deka asht ma e randë se në vegsh me u përvlue, e me sharrë me u sharrue... Zotyn na ruejt* etj. Ruheshin po ashtu edhe togjet **ie, ye, ae, oe**. Këto dy grupet e fundit nuk ishin rrudhur si sot me gjasë se ende s'ishte fiksuar theksi mbi asnjërën prej tyre, kështu që kontraksion i tyre ishte i pamundur.

a) Në rrafshin e konsonantizmit, fenomeni që tërheq një vëmendje të posaçme për fonetikën historike të të gjitha të folmeve të Kosovës, është pa dyshim e dhëna e konstatuar nga autori ynë për **ruajtjen dhe dallimin e qartë të okluziveve palatale q, gj** nga **afrikatet paragjuhore ç, xh** në vepërzën e Boshnjakut. Dihet mirëfilli se të gjithë linguistët që ishin marrë me studimin e gjendjes aktuale këtyre ligjërimeve pohonin, si një, rrafshi-

min, përkatësisht kalimin në *afrikate* (Lamberci, Mladenovi, Jokli, Taljavini). Jokli, ç'është e vërteta, mbështetur mbi materialet e këngëve popullore të rretheve të Pejës, mbledhur nga Vuka në fillim të shek. XIX e *njih-te* praninë e tyre, ndërsa gjellimin e tyre në fund të shek. XIX dhe në fillimin e shek.XX në këto ligjërime e pohon po Ajeti te studimi mbi gjuhën e **Divanit** të Sheh Maliqit (Gjurmime albanologjike, 3/1965, f.33-34).

Për punë të kronologjisë, se në ç'kohë ndodhi rrafshimi i okluziveve palatale me afrikatat paragjuhore ndër të folmet e gegërishtes veriore në përgjithësi, siç dihet, pikëpamjet e linguistëve janë të ndara.

Dy vjet para se të shihte dritën e botimit kjo monografi e Ajetit dhe para fakteve që i rezultonin atij, prof. Çabej (**Buletini**, 1958/1, f.33) dilte me pikëpamjen se ky shndërrim kishte ngjarë në gjysmën e parë të shek. XVIII, atëherë kur arbëreshët e Zarës i lanë trojet e tyre të vjetra të Briskut e Shestanit. Gjuhëtari i famshëm shqiptar, përveç privacionit të mësipërm, kishte nga ana tjetër parasysh edhe mendimin e autoriteteve si Vajgandi e Taljavini që e pohonin para tij këtë kohë të zhvillimit të dukurisë. Ajeti, ndryshe nga këta linguistë të njohur, pikërisht te studimi mbi gjuhën e **Vehbijes**, pas të dhënave bindëse që sjell, mbron tezën se ky proces kishte ndodhur *aty nga mbarimi i shek.XIX*. Ky konstatim, me sa dihet, nuk është vënë në dyshim deri sot (për këtë në vazhdim, pak më poshtë).

a) Duke dalë nga fusha e fonetikës, ku ka edhe shumëçka për t'u thënë për venarimet me peshë serioze të autorit, po që vendi me këtë rast nuk na lejon dhe duke hyrë në rrafshin e morfologjisë, e vlen të theksohen ndonjë nga karakteristikat dalluese që i nënvizon ai, përjasur me gjendjen e sotme.

Kategoria e emrave të gjinisë mashkullore që sosin me velaret **k, g**, sot, siç dihet, si në të folmen e Gjakovës, ashtu edhe në pjesën më të madhe të ligjërimeve kosovare, kur shquhen marrin mbaresën -i: *plaki, peshki, bregi, shtegi* etj. Me gjithë mungesën e argumentimit, që nuk ia siguron grafia e tekstit, Ajeti mbështetur në gjendjen në përgjithësi arkaike të tij, pohon me bindje të plotë se substantivet e këtij tipi asokohe do të jenë prapanyjësuar me **-u**, e jo me **-i**. Prandaj shembujt si *horllëk, hallk, ahmak* etj. që i ndesh atje, duan marrë si *horllëku, hallku, ahmaku*, pra ndryshe nga forma e sotme e tyre *horllyki, hallki, ahmaki*.

Një tipar tjetër dialektor me rëndësi i parë këtu është ai që, ndryshe nga autorët e vjetër me Buzukun në ballë në veprat e të cilëve ndeshet shumë shpesh përdorimi i **mbiemrave asnjanes të emëruar** (Çabej, Buletini, 1955/II, 44,45), të "Vehbija" hasen dendur **emrat prejfoljorë** : *Rrnimi* i prines, maskarija e t'birrit e s'bijës (11); *Gzimi* i thmis- *rrzimi* i prindes(13); *Rrnimi* i plakut - gërdija e berberit (31).

Ky fakt mund të shërbejë edhe si mbështetje për të saktësuar kohën qëkur zë fill prirja e tendenca e fjalëformimit me **-im** e kësaj kategorie emrash. Prof. Demiraj këtë proces e shihte si më të vonë së paku një gjysmë shekulli (Sh. Demiraj: Historia e gjuhës së shkruar shqipe, Prishtinë, 1970, f.70). Ky element do marrë parasysh gjithqysh në historinë e fjalëformimit të shqipes.

Për sa u takon trajtave foljore dhe përdorimit të kohëve, ashtu si i dalin autorit të monografisë, do thënë që ai i kap dhe i vështrohet nga një këndshikim i trajtimit më të gjerë në kohë dhe hapësirë dhe jo vetëm nga aspekti i një deskripcioni të thjeshtë dialektologjik të kufizuar. Rrjedhimisht, për pika të veçanta, konstatimet e autorit kanë rëndësi edhe për mbarrë morfologjinë historike të shqipes. Në rrafshin dialektor ndërkaq, del me rëndësi e dhëna që forma karakteristike e vetës së tretë njëjës të imperfektit të foljeve të mënyrës dëftore të diatezës veprorë të të folmeve të Kosovës *punojke, vrapojke, luejke* etj., nuk është edhe aq e re, sepse si e tillë ndeshet rregullisht në këtë tekst. Nga ana tjetër, atë nuk e gjejmë te vepra e Kazazit (1743), ndërsa te Bogdani as që ka nevojë të kërkohet. Për pasojë, ky zhvillim kronologjikisht do marrë *si i gjysmës së dytë të shek.XVIII*, kurse si shtrirje gjithandej ku togjet e tingujve **kl, gl** sosin në **k,g**. Është Ajeti i pari dhe i vetmi gjuhëtar deri sot, me sa dimë, që këtë trajtë e shpjegoi të formuar nga *veta e tretë e imperfektit të admirativit*, përkatësisht ajo s'është tjetër pos kjo vetë e së pakryerës së habitores e periudhës kur kjo mënyra e fundit e foljeve ishte shume e gjallë dhe përdorej dendur, që kaloi edhe në imperfektin e dëftores. Çabej (S.F. 1960/IV, 142 mbaresën verbale **-ke** e sheh si imperfekt indikativi, nga **kam**.

Edhe një tjetër veçori, krahas konstatimit për përdorimin e dy formave të futurit në këtë të folme (kam+infinitivi dhe do+prezenti i konjuktivit), që është me interes për dialektologjinë historike të këtyre të

folmeve, është përdorimi i trajtës po ashtu të vetës së tretë njëjës të kohës së tashme të lidhore, tipike për to: Kur *t'vjen* kazaja (13)... mund *t'bjen* posht (22) etj. Këto të dhëna e kanë peshën e vet të padiskutueshme për kërkimet në këtë ravë gjurmimesh.

Për faktet e qëndrueshme të zëna ngojë, sado që shkurtimisht, po edhe për shumë të tjera me një forcë argumentimi shkencor jo më të vogël se këto, që s'i përmendëm këtu, kjo vepër e Ajetit përbën një model referimi, një mbështetje të sigurt informacioni dhe një literaturë të pashmangshme për këdo që ka pretendime serioze të merret me studime dialektologjike në përgjithësi.

Më 1961 doli nga pena e tij, botuar nga Instituti Ballkanologjik i Shoqatës së atëhershme të Shkencave të Bosnjë-Hercegovinës monografia tjetër **Istorijski razvitak gegijskog govora Arbanasa kod Zadra** (Zhvillimi historik i së folmes gege të arbëneshëve të Zarës). Ishte disertacioni për gradën shkencore doktor i shkencave filologjike, mbrojtur para një komisioni autoritativ profesorësh të universiteteve të Lubjanës, Beogradit e Novi Sadit. Mungonte Prof.dr.Henrik Bariç, profesor dhe mentor i tij, albanolog i njohur, që ia kishte sugjeruar këtë tezë, që ishte ndarë nga jeta pak para se të përurohej solemnisht rezultati i një pune solide drejtuar prej tij.

Me gjithë ndonjë pohim a tezë që mund të ndeshet aty-këtu, që zhvillimi i filologjisë shqiptare më vonë edhe mund t'i ketë kapërcyer, kjo vepër e Ajetit paraqet studimin më të thellë e më komplet të këtij ligjërimi deri sot, vështruar në sinkroninë dhe diakroninë e tij. Aty u përrudhën e u fillëzuan mjaft çështje deri atëherë të diskutueshme rreth tipareve karakteristike dialektore të kësaj së folmeje dhe u korrigjuan pikëpamje e teza të shprehura nga studiuesit e saj para tij.

Në kapitullin e parë, mbasi sjell një pasqyrë të hollësishme e shterruese të historisë së zhvillimit të dialektologjisë shqiptare që nga fillet e saj e deri në atë kohë, ai vë në peshojë kritike gjithë pikëpamjet e linguistëve para tij rreth këtij ishulli gjuhësor të shqipes, duke filluar nga shënimet e para për të e deri studiuesit seriozë (S. Buzoliç, F.Mikloshiç, T. Erber, G. Vajgand, K. Taljavini etj.).Ajeti konstaton:

a) Nuk qëndron teza e shprehur nga Buzoliç, Mikloshiç e Vajgand se e folmja e arbëreshëve të Zarës nuk kishte *l* palatale, po vetëm *ll* labiale dhe *l'* të ndërmjetme a evropiane, siç është quajtur shpesh. Mikloshiç në shembujt si *nalt, kandil, ksula, floku, plumbi* etj. thotë se *l*-ja është e ndërmjetme. Autori ynë shpreh me të drejtë rezervat e veta rreth kësaj pikëpamjeje, njëherë për shkak se të folmet e tjera të shqipes e kanë *l*-në palatale, ndërsa nga ana tjetër ai pohon po këtu se kjo *l'* e ndërmjetme nga fundi i shek .XIX në këtë të folme vinte edhe nga depalatalizimi i *l*-së dhe nga devalarizimi i *ll*-së dhe zëvendësonte edhe çdo spirant tjetër të zëshëm.

Zaten është interesant se në studimet albanistike në përgjithësi ishte diskutuar gjerësisht për problemin se a thua shqipja ka tre apo dy tipa të ketij tingulli. Dozoni (*Manual...*, Paris,1879) thotë se shqipja ka vetëm dy tipa: *l* e *ll*, nuk ka të ndërmjetme; Pedersen (L-*Laute...* Kuhn's Zeitschrift, XXXIII, 335-351) dhe te monografia për të folmen e Çamërisë (*Albanesische Texte...* f.80 flet vetëm për dy tipa të *l*-së. Është Gustav Majer (*Albanesische Studien*, V, f.3), i cili thoshte se shqipja ka tre tipa të *l*-së dhe evropianja apo e ndërmjetmja del vetëm ndër fjalë me prejardhje të huaj. Gjergj Pekmezi (*Archiv ...*, XXI, f.219) shkon edhe më larg : një *l* e ndërmjetme në toskërishte ndeshet jo vetëm ndër fjalë të huaja.

S'premtori vendi këtu për pririme të mëtejme të kësaj çështjeje, prandaj po mjaftohemi me konstatimin se atë e sqaroj njëherë e mirë Ajeti edhe diku tjetër (*Glas I u arbanaskim govorima Crnogorske Krajine, "Godisnjak" I Balkanologskog instituta*, Sarajevo, 1957; *Tipat e l-së në dialektet shqiptare të Brisk-Shestanit të Krajës, Kërkime gjuhësore*, Prishtinë, 1978, f.234-246).

b) Për sa u takon tingujve okluzivë palatalë *q, gj* e çifteve të tyre, afrikateve prepalatale *ç, xh*, që i kishim prekur diku më lart, s'ka dyshim se në gjendjen e tyre të sotmen në këtë të folme, ato janë rrafshuar, ndryshe nga ligjërimet e Brisk-Shestanit, ku, sipas Ajetit, dallohen fare mirë. Ky fakti i fundit rrëzon pikëpamjen e shprehur nga disa gjuhëtarë të theksuar më sipër se ato kishin përfunduar në *ç, xh* qysh para shpërnguljes në Zarë. Nga ana tjetër, ruajtja e *q, gj* në këto tërthore e kundërshton tezën se prania e okluziveve palatale në sistemin konsonantik të shqipes i dedikohet ndikimit të greqishtes (I. Popviç, *Istorija srpskohrvatskog jezika*, Novi Sad,

1955, f.137). Dhe, meqë e solli rasti, do theksuar edhe kjo që Ajeti e bëri edhe të veten pikëpamjen e H. Aganit që ky zhvillim do konsideruar si *proces i brenshëm dialektor i shqipes* (H.Agani, *Cila është treva gjuhësore... f.182,183; Fjalori i L.Kujunxhiçit*, f.126,127).

Monografitë si këto të dyja, model i rrallë i akribisë shkencore dhe i punës së përkushtuar, i bëjnë nder jo vetëm autorit, po edhe studimeve albanistike në përgjithësi.

Bardhyl DEMIRAJ, LMU München

PËR GJUHËN SHQIPE

(Homazh për Profesor Idriz Ajetin)

“Një komb - një gjuhë”

Në tubime të kësaj natyre kumtuesit i jepen dy mundësi për të zgjedhur: ose a) t’i përkushtojë një kumtesë jubilarit, duke vënë në pah e vlerësuar ato prurje që ai ka përcjellë deri sot në debatin albanologjik, të paktën në njërën prej fushave ku ka qenë dhe mbetet aktiv – e këto në rastin jubilarit tonë, profesor Idriz Ajetit, sigurisht që nuk janë pak (!!!); ose b) t’i përkushtojë atij një temë qoftë edhe anësore, të cilën jubilari ynë e ka fokusuar dikur sado shkarazi në analizat e tij, domethënë pa mundur ta nisë e stolisë ashtu siç dinte dhe di vetëm ai.

Ndërsa alternativa e parë – siç mësojmë edhe prej programit të këtij tubimi – duket të jetë e ezauruar mirëfilli prej kolegëve biografë dhe njohës sqimatarë të prurjeve të profesor Ajetit në albanologji, alternativa e dytë sigurisht që kërkon një punë paraprake aspak të lehtë. Arsyeja është e thjeshtë, thujse triviale: jubilari ynë ka mbushur ndërkohë një moshë biblike dhe penda e tij nuk ka reshtur së shkruari mbi letër të bardhë dekada me radhë. Por jo vetëm kaq: profesor Ajetin e kemi edhe sot e gjithë ditën mes nesh e sekush ushqen dhe ushqehet me shpresën dhe dëshirën e mirë me përjetuar në vazhdimësi – qoftë edhe në formën e kumtit gojor e të bashkëbisedimit – përsiatjet e tij për çështje nga më të ndryshmet që kanë të bëjnë me shqipen.

Një opsion i tretë do të ishte në fakt edhe të përmbledhja në një kumtesë të veçantë kujtimet e tim eti për profesor Ajetin, por një temë e tillë

nuk ezaurohet dot në 10 min që kam në dispozicion. Të dy i ka lidhur një kolegialitet dhe miqësi e sinqertë dhe e lashtë, andaj nuk është aspak çudi, përse emri i profesor Ajetit lakohej aq shpesh në familjen tonë, sidomos në vitet 70-të, kur im atë filloi të vizitonte rregullisht Kosovën e unë si adoleshent mezi e prisja të kthehej me ndonjë top basketbolli apo me ndonjë çimçakiz apo karamеле e më pas, kur u"burrërova" – d.m.th. aty nga moshë 14 vjeç – edhe me cigare"Kent", që ia merrja vjedhurazi nga çanta.

Por le të kthehem në temë: Vështirësitë që kisha në përzgjedhjen e njërit apo tjetrit opion më detyrojnë tash të ndalem thukët në dy dhunti të karakterit human dhe profesional të profesor Ajetit, të cilat i kam fiksuar dikur qysh fëmijë prej kumteve të tim eti, ndërsa sot më mbetet vetëm t'i përditësoj drejtpërdrejt ose tërthorazi qoftë me aktivitetin e tij shkencor, ashtu edhe me angazhimin e tij social në mbarështimin largvajtës të albanologjisë e të kulturës shqiptare në përgjithësi.

Ndër këto dy dhunti, e para nuk është aspak e vështirë sot për t'u diktuar, e për këtë mjafton të shfletojmë me lexim diagonal prurjet e derisotme të profesor Ajetit, të përmbledhura qoftë edhe pjesërisht në opusin e tij pesëvëllimësh si botim i veçantë i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës (Prishtinë 1997/8). Ky opus, sikurse shumë e shumë botime të tjera, të organizuara këso rastesh jubilarë dëshmojnë qartë që në personin e profesor Ajetit gjëllin si dhunti e lindur etja për njohje të gjithanshme të shqipes. Rinia, shkolla, studimet universitare, sikurse e gjithë jeta e tij jeta shkencore-akademike konfigurojnë së bashku atë sjellje thujse instinktive në aktivitetin e tij intelektual që feks e tingëllon sot në sytë e veshët tanë pikërisht si etje e amshuar për njohje të thelluar të shqipes në të gjitha perspektivat e mundshme, ndër to:

- a) shqipja si gjuhë e gjallë e me larmi varietetesh bashkëkohore (: të folmet e Zarës dhe të Istries, të Krajës dhe të Shestanit, të zonës së Preshevës etj.);
- b) shqipja në fazat e ndryshme të evolucionit të saj historik;
- c) shqipja në marrëdhëniet e saj me gjuhët fqinjë;
- d) b) kultura e shkrimit shqip në kohë e hapësirë (: shqipja e Kosovës në shek. XVIII-XIX etj.); e *last but not least*.

- e) shqipja bashkëkohore në fokusin e planifikimit gjuhësor për gjithë hapësirën kompakte shqipfolëse në Ballkan dhe diasporë.

Mjaftojnë këto prurje në gjithë këto fusha me përsiatur mirëfilli atë ndërlidhni përmasash të pazakonshme me gjuhën shqipe që përjeton profesor Ajeti në këtë qindvjeçar të parë të jetës së tij. Nuk gabojmë aspak, po të mëtojmë tash se Shqipja, e personifikuar në Zonjën Shqipe, është pas gjase Ora e tij personale, që i rri gjithherë pranë, e shoqëron, e mbron dhe e orienton në jetën e tij intelektuale. Kështu i përcillja dikur si adoleshent fjalët e tim eti, që gjithmonë ngazëllehej, kur binte fjala për profesor Ajetin me Çetën e tij të Profetëve gjuhëtarë të Kosovës, e thosh: "Or' po, ata do na lënë prapa shpejt neve këtej. Jo për gjë, por ...; se jo vetëm i kanë mundësitë, xhanëm (!), për literaturë ..., por sikur, ata sikur kanë lindur për gjuhëtarë." E unë si fëmijë fantazoja, se si profesor Ajeti, kur kishte lindur dikur aty nga viti i largët 1917, kishte pranë si vejtore të fatit Orën Shqipe. Ora Shqipe i kishte diktuar orientimin në jetë, deri si të ecë e të vallëzojë virtualisht me të, kur dhe si të kombinojë hapat para e mbrapa e kur të kthehej djathtas, apo të rrotullohej majtas.

Pikërisht në këtë qerthull marrëdhëniesh virtuale me Orën Shqipe diktojmë edhe atë dhunti të dytë, në personin e profesor Ajetit. Ani, është kjo një dhunti, pas gjase po e lindur, por që arrijmë ta deduktojmë mirëfilli si të tillë, sidomos kur përqendrohemi në angazhimin e tij social, bash kur ngjerojmë ashtu mes rreshtash në shkrimet, qëndrimet dhe intervistat e tij ndaj planifikimit gjuhësor, përkatësisht njësimi të normës gjuhësore për shqipen e shkruar në gjithë hapësirën kompakte shqipfolëse në Ballkan, të cilën e njohim dhe e mirënjohim sot më fort të ripagëzuar nën emërtimin *Shqipe Standarde*.

Lejohem të kumtoj me këtë rast thjesht përvojën time personale, pikërisht mënyrën se si e kam përjetuar – ndonëse me shumë vonesë (!) – atë angazhim social të profesor Ajetit në shkrimet e tij përgjatë rrjedhës së procesit të normëzimit të variantit të shkruar të Zonjës Shqipe. S'kam përse e fsheh atë mbresë të thellë që më ka lënë njëri ndër artikujt e hershëm, në mos më i hershmi i botuar i profesor Ajetit në këtë fushë: "A ka gjâ mâ punë n'ortografinë e shqipes?" (Përparimi, Prishtinë 1958, nr. 7-8, f. 471-476). E përcjellim rishtas këtë shkrim në opusin pesëvëllimësh të profesor

Ajetit, duke e shoqëruar njëherësh me buzëqeshje të rastit si edhe me seriozitetin e duhur: a) me buzëqeshje të rastit, sa i përket formës aktuale, meqë shkrimi original është përshtatur i tëri në variantin normativ letrar të Zonjës Shqipe, madje qysh në titull: “A ka më punë në ortografinë e shqipes” (“Vepra”, bl. 2, f. 203-7); sikurse b) me seriozitetin e duhur, sa i përket mesazhit të natyrës universale që emeton ky titull, sidomos në kohën tonë dhe në hapësirën tonë shqipfolëse, bash kur ish-nxënës të tij e shtrojnë sot rishtas këtë pyetje si imperativ i kohës.

Prashtu pa dashur të zgjatem, lejohej të shtoj pa drojë, se ngjërimit i këtij shkrimi të parë sikurse i çdo shkrimi, qëndrimi e interviste të mëvonshme që ka botuar e dhënë profesor Ajeti këta 6 dhjetëvjeçarë në vazhdim për çështje të normës gjuhësore, më sjell ndërmend kumtin e dikurshëm ngazëllyes të tim eti, të cilin ma përsëriste shpesh: “Që sot kemi një shqipe të njësuar, këtë duhet t’ia dimë [për nder] Kosovës, e cila u sakrifikua përsëri për ne” dhe i shkëlqenin gjithnjë sytë kur përmendte me këtë rast emrin e profesor Ajetit.

Unë i kisha as i kisha aty te 14-at atëherë, kur u mbajt Kongresi i Drejtshkrimit në Tiranë, dhe im atë ishte për mua si gjithnjë i vetmi person kontakti me botën, thënë më saktë qiellin e largët e të paarrtshëm të Kosovës. Se kush ishte profesor Ajeti e çfarë rëndësie jetike kishte për ne kjo Gjuha me katër mbiemra: “Letrare Kombëtare e Njësuar Shqipe”, në fakt nuk arrija ta përtypja dot, por meqë i besoja tim eti në çdo fjalë që thosh, fillova ta dua edhe unë si i marrë profesorin tonë të nderuar, anipse nuk e kisha parë kurrëherë, as në fotografi. Ja që kjo rrethanë më ndihmoi shumë, se fillova ta përfytyroja profesor Ajetin tamam si Prometheun mitik, duke i sjellë *zjarrin*, që vjen me thënë *gjuhën e njësuar* vëllërzërve tanë në Kosovë, e ashtu me bark të çjerrë e me mushkëri të përgjakura gjëmonte sa tundej dheu: “S’ka më Shqypni, as Dhe t’ Arbnit, as më Gegni; ka vetëm Shqipëri, Arbëri e Gegëri!” Më vonë, filloi të më vinte vërtet shumë keq ta shihja profesor Ajetin ashtu të sakatuar, si mos o Zot! Prandaj ndërrova mendje shpejt dhe e këmbeva Prometheun me Odinin, babazotin e mitologjisë nordike. Edhe ky zot babaxhan ishte, e po aq i etur për dije, mençuri e sakrifica sa profesor Ajeti; andaj la peng fillimisht një sy, vetëm e vetëm që të pinte një kupë prej Burimit të Dijes që e ruante Zonja Mirmir, ndërsa më vonë, kur donte të mësonte edhe zanafillën e shkrimit runik, nuk e bëri më

të gjatë, por u vetëvar për nëntë ditë e nëntë net me radhë në Pemën e (nëntë) Botëve (*Yggdrasil*). Ja që pas nëntë ditëve e mësoi edhe misterin e gjuhës Runa e sipas mitologjisë nordike jes e gjëllin edhe sot e kësaj dite shëndoshë e mirë në qiellin e nëntë.

Për fatin tonë të madh, edhe profesor Ajeti, jo vetëm që e njeh dhe zotëron shqipen letrare, apo *standardin*, siç jemi mësuar t'i themi sot, por gëzon edhe shëndet të plotë, duke festuar me këmbë në tokë e mes nesh përvjetorin e tij biblik. Veçse nuk është thjesht dhe vetëm etja për dije ajo dhunti e lindur që e nxiti profesor Ajetin të sakrifikohej për Runa-n shqipe. Vijnë kështu tek ajo dhunti e dytë, e lindur ashtu natyrshëm te shqiptari i thjeshtë i Medvegjës, i Kosovës dhe i Shqipërisë mbarë: *dëshira me qenë gjithmonë bashkë*, bash sipas motos "një komb - një gjuhë".

Skënder GASHI, Vjenë

MENDIME RRETH FORMIMIT DHE PREJARDHJES SË EMRIT HOTI TË FISIT TË SHQIPTARËVE¹

Tradita gojore për lindjen e fisit të Hotit

Hoti është zonë bjeshkore e Malësisë së Madhe në pjesën veriore të trojeve shqiptare që tani ndodhet nën administrimin e Malit të Zi. Kjo zonë banohet nga shqiptarë të fisit të Hotëve, i cili qenka jo vetëm më i vjetri, porse edhe ndër më të rëndësishmit e kësaj treve. Në gojën e popullit² dëgjohen edhe nëndarjet *Hoti i vendit* ose *Hoti i Malit* që lidhet drejtpërdrejt me Plavën sipri Gucisë mbi lumin Lim përkatësisht me bjeshkën-kullotat e hotjanëve origjinarë të quajtura në vitin 1330 *Hotina Gora* “Mali i Hotit; bjeshka e Hotit” për të cilin (mal, bjeshkë, përkatësisht për Plavën e Gucinë) M. Šufflay kujtonte me të drejtë se edhe është djepi i formimit të fisit të Hotit. Jo pa arsye, tradita e quan këtë pjesë të territorit të Hotëve “*Hoti i Vendi*”. Ka porse edhe dy nocione gjeografike, nëndarje të tjera: *Hoti i Rrafshit* dhe *Hoti i Detit*, përreth Podgoricës së Malit të Zi. Hoti, gjithnjë sipas R. Lushajt³ “shtrihet në komunën e sotme të Plavë-Gucisë dhe ka mbetë tokë rrudhun në një fshat të vogël me disa lagje: Haxhaj, Mehaj, Muja, Hysenaj, Sinanaj, duke iu mbijetue vështirësive të shekujve, duke lidhnue lëvizjen e trungut të vet në “korridorin” nga malet në bregdet, nga liqeni i Plavës tek Liqeni i Shkodrës, ku në shekujt pas skënderbegianë u themeltue “Hoti i Rrafshit” si Kapedani e tevona me dy bajrakë.”

Gojëdhana përkitazi me fiset kishte shënuar në gjysmën e parë të shek. XIX edhe Johann Georg von Hahn,⁴ askohe konsull i Austro-Hunga-

¹ Kushtuar Prof. Idriz Ajetit, me rastin e 100-vjetorit të lindjes.

² Sipas Ramiz Lushaj, *Rruga e Hotit: Shembull, Model, Simbolikë*, në *Voice of Albanians - Zëri i Shqiptarëve*.

³ Po ai, po aty.

⁴ sh. *Albanesische Studien*, Jena, 1853, f. 185-188.

risë në Shkodër. Sipas këtij, një arbanas (shqiptar) i quajtur *Keq-i* (emrin e të cilit ky e interpreton si të sajuar nga mbiemri shqip *i keq*) qenka arratisur nga turqit (!) dhe paska ardhur në regjionin që më vonë do të quhet Piper. Aty e paska ngritur plangun e vet dhe i paskan lindur gjashtë djem: Lazari, Bani, Mërkoti, Kasteri, Vasi e Piperi. Kur iu rritën të bijtë, njëri nga ata e vrau fqinjin e tij. Keqi dhe i biri më i vogël i tij Piper-i u pajtuan me familjen e të vrarit. Nga Piperi, në rrjedhë të kohës, do të krijohet vëllaznia e Pipërve. Duke pasur frikë nga hakmarrja, pesë vëllezërit e tij ikën nga kanti dhe u strehuan në Trie(p)sh (krahina e sotme e Kuçit). Me kohë, në hapësirën e rrjedhës së majtë të lumit të Cemit, nga Lazari [S. G. ndoshta Lazri] do të linden *Hotët*, ndërsa nga Bani *Bankeqët* e Trie(p)shit. Diç më vonë, në vendlindje do të kthehet edhe Mërkot-i dhe nga ai do të linden vëllazëritë e Mërkotëve e të Piperëve - sot sllavishtfolës.

Sipas gojëdhanës që e kishte shënuar Johann Georg von Hahn, djali i quajtur Vasë i arbanasit (shqiptarit) *Keq,-i* ishte martuar me një vajzë nga Reçica (hapësira që më vonë do të njihet si territor i Vasojeviqëve malazezë), i biri tjetër *Kastri* do të ikte më larg, në Rrafsh të Dukagjinit. Atje do të martohej dhe do të jetonte në shtëpi të prindërve të gruas dhe nga ky do të lindej vëllaznia/fisi i *Kastratëve*. Po në këtë formë, këtë gojëdhanë e paska shënuar edhe Spiridon Gopčević, kah fundi i shek. XIX.

Një variant i gojëdhanës për *Keqin* dhe të gjashtë bijt e tij është gjetur e shënuar edhe në dorëshkrimet e Mark Milanit. Këtu, porse, disa nga bijt e Keqit kanë emra të tjerë. Bij të Keqë Pontit ishin, sipas këtij versioni: *Ozra, Pipa, Krasa, Vasa, Ota* dhe *Bona* (S. G. ndoshta *Bani*). Katër të parët ishin bijë të Keqit nga martesë e parë, ndërsa dy të tjerët nga martesë e dytë e tij. Nga shënimet në dorëshkrim të Mark Milanit mësohet se ky farë Keqi paska ardhur prej dikah nga veriu i shtratit të rrjedhës së lumit Cem.⁵ Mbase pikërisht këtë Lazër Keqin si të parin e fisit të Hotit e kishite “konfirmuar”⁶ edhe studiuesi Fulvio Cordignano, porse edhe ky paskësh gabuar, sakohë që shkruante se Lazër Keqi po rridhka nga një baba sllav, i cili, për shkak të persekutimit nga ana e turqve, qenka arratisur nga Piperi e për pasojë nuk na qenka (khs. më lart) i ardhur nga Bosna.

⁵ khs. M. Barjaktarević, Predanja o zajedničnom poreklu nekih crnogorskih i nekih arbanaških plemena, në Projekat Rastko Skadar: Stanovništvo slovenskog porijekla u Albaniji.

⁶ sipas *Ndue Bacaj* Etnogjeneza e Hotit, të publikuar më 20 dhjetor 2016 tek Albdreams.

Mua më duket shumë i arsyeshëm relativizimi i besueshmërisë kundrejt traditës gojore, që psh. përkitazi me prejardhjen e fiseve të Hotit e të Krasniqes, e shfaqte studiuesi Mirko Barjaktarević. Ky vërente se: “Siç po shihet, janë shënuar disa variante të ndryshme për ekzistimin e tre, katër, pesë e madje edhe të gjashtë vëllazërve, nga të cilët me kohë qenkan lindur disa bashkësi fisnore tonat [S. G. të malazezëve] e të shqiptarëve. Këso gojëdhanaash kanë dalë edhe më vonë pale a mos atyre fiseve do t’u ndajmbathet edhe ndonjë fis edhe pale a mos edhe ai mund të zërë vend në grupin e “farefisit”. Duket sikur “kujtesa” dhe trillimet popullore në këtë rrafsh nuk kanë të sosur.”⁷

Një verison gojëdhane përkitazi me prejardhjen e fisit të Hotit e kishte shënuar edhe Edi Durham në traditën gojore të malazezëve.

Nga një version tjetër i traditës gojore mësohet se, (saktësisht !) në vitin 1520 në Hot paska pasur dy familje në hapësirën e të cilave qenka vendosur njëfarë Geg Lazri, i bir i Lazër Keqit, i ardhur nga Bosnja. “Familja e Geg Lazrit u shtua aq shumë, sa shumica e popullsisë së Hotit e kanë për trung Gegë Lazrin. Ndërsa autoktonët, dy banorët që u gjetën në vitin 1520, gjenden (edhe sot) në Locnikaj (Locaj) e Koje, të cilët në vitin 1911 numëronin 12 shtëpi, që martoheshin me Hotin Tjetër, ndërsa Hoti në mes vete jo.”⁸ Tradita gojore kallxon më tej se ky Lazër Keqi paska pasur edhe tre djem të tjerë, *Piper* Lazrin, *Vaso* Lazrin e *Krasni* Lazrin, prej nga po e hiqkan prejardhjen fiset e malazezëve - dikur shqiptare - të Piperëve e të Vasojeviqëve, tani të sllavizuar dhe fisi Krasniq/Krasniqe (i islamizuar) i shqiptarëve që për pararendës e paska *Krasni* Lazrin.⁹ Sipas këtij shpjegimi, bërthama e fisit Hot dhe e hapësirës së banuar nga ai paska lidhje me katunin shqiptar të Lesh Tuzit, i përmendur që në vitin 1330 në Krisobulat e Deçanit.¹⁰ Në dritën e rrethanës se Lesh Tuzi regjistrohet i pari nga banorët e katunit, lë të besohet që vërtet ky ishte kryepar i këtij katuni.

As nga shkrimi i Hahn-it e aqë më pak nga variantet e kallximeve popullore, nuk mund të merret vesh nëse ai arbanasi i quajtur *Keq* ka gjë të përbashkët me një *Ban Keqin*, emri i të cilit është ruajtur deri në v. 1330

⁷ Po ai, po aty.

⁸ sipas Ndue Bacaj, poaty.

⁹ sipas Hoti, në Wikipedia.

¹⁰ *katounь arbanasъъ*, “katuni i arbanasëve”, të. Dečanske hrisovulje, f. 55.

tek mikrotoponimi *Банькекјеve glade* “Tbanet e Ban Keqit”. Ky vend ishte pikë kufiri i bjeshkës së Vërmoshit : “dhe ja kufijt e Gërçarevo-s me Gusinë [...] teposhtë Vërmoshit [...]; dhe ja kufinjt e Vërmoshit [...] tek Kryqi i Gjakonit [...] tek Tbanet e Ban Keqit” [...].¹¹

Në këtë kontekst bën të shënohet që pikërisht mikrotoponimi *ѡakonov крѡстѣ* “Kryqi i Gjakonit” e tregon jo vetëm përkatësinë etnike shqiptare, porse edhe përkatësinë konfesionale në krishterimin e variantit roman të Hotëve dhe pjesës tjetër të popullisë shqiptare të këtij regjioni. Sikur kjo popullatë të ishte sllave dhe e ritit ortodoks të krishterimit, titulli *gjakon*, në trajtën sllave të tij, do të ishte *dijak/ѡak*.

Së këndejmi, kështu kujtoj, arbanasi Keq i traditës gojore mund të jetë vetë Ban Keqi i v. 1330 ose një pasardhës i tij vetëm pas një brezi e jo një individ i quajtur Keqi që do të ishte, gjykuar sipas gojëdhanave, disa shekuj më i vonë se pararendësi i tij i shek. XIV.

Në rrafshin gjuhësor, këtu bën të vihet në spikamë edhe rrethana se, që nga Johann Georg von Hahn e deri më sot, ky emër sqarohet si trajtë e konglutinuar [e bashkëshkrirë] shqipe e antroponimit *Ban* dhe e ofiqit familiar *Keqi* të ndonjërit pararendës fillimisht të katunit e më vonë edhe të katundit Bankeqi; ky sqarim më duket i pranueshëm, sepse ka mjaft deshmi që emrin *Ban* e mbanin, përveç vllahve, edhe shqiptarët.

Me emrin e katunit *Bankeq* lidhen legjendat e formimit të fiseve Hoti, Kuçi dhe Bushati. Më tej shpjegohet se pas shpërbërjes së katunit “vendbanim veror i barinjve, tban” të madh të Lesh Tuzit u kufizua (u rinda) edhe zona e kullotave verore që ka lidhje me territorializimin dhe me shpërbërjen e fiseve. Procesi i shpërbërjes dhe i territorializimit të fiseve paska përfunduar në shek. XV, gjë që dëshmoreshka nga të dhënat e përmbajtura në defterin osman-turk të regjistrimit të kryefamiliarëve të sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485. Nga ky burim rezulton se nga komuna, përkatësisht nga vëllazëritë e fisit të Hotit, ishin sajuar 8 katunde që numëronin 134 shtëpi dhe, të gjitha këto katunde sajnin një njësi territoriale - të quajtur edhe asokohe *Malet e Hotit* përkatësisht *Nahija e Maleve të Hotit*,

¹¹ khs. origj. [...] “a se megje гънѡаревѡу [megja z gousinomy] [...] нѡзъ вѡмоѡѡу [...] a se megje вѡмоѡѡи [...] ou ѡakonov крѡстѣ [...] ou *Банькекјеve glade* ...” tek Dečanske . Hrisovulje..., f. 116-117.

që ta kujton nocionin gjeografik venecian *montane Ottorum*, “Bjeshkët/ Malet e Hotit” në Shqipëri “...*in partibus Albanie* ...” të v. 1439 (khs. më poshtë). Kjo nahije përbëhej nga 10 katunde, përkatësisht nga: katundi **Geg** (Gjegi) me 20 shtëpi; katundi *Tihomir* me 20 shtëpi; katundi *Mihalina* me 20 shtëpi; katundi *Pobrezhan* me 20 shtëpi; katundi *Bozhan* me 21 shtëpi; katundi *Oblana* me 8 shtëpi; katundi *Ibthosh* me 1 shtëpi; katundi *Vidagi* me 4 shtëpi; katundi *Lubice* me 15 shtëpi dhe katundi *Ishbisha* i pabanuar.¹² Vlen të konstatohet se asnjëri nga kryefamiliarët e këtyre katundeve nuk e mbante emrin Hot as si antroponim e as si patronim, gjë që do ta shpjegonte kujtesën për pararendësin prej gjaku të tyre.

Po u gjykua sipas kallximeve të traditës, do të rezultonte sikur bërthamë e pothuaj të gjitha fiseve të shqiptarëve dhe e disa vëllaznive të malazezëve na qenka kryepari Ban Keqi i katunit të paemër të vetin, i dëshmuar më 1330 si *katounъ arbanasъъ* “katuni, tbanat e arbanasëve”. Ky katun na del të jetë vend nga i cili shqiptarët paskan qenë shtrirë “si push-tues”, në kuadrin e kërimit të kullotave, të tokave të bukës, të ikjes nga gjakmarrja e nga ndonjë motiv tjetër, edhe në hapësirat e sotme të Kosovës. Paçka se deri në asgjë nga këto gojëdhana përputhet me realitetin historik.

Sakohë që është dëshmuar se në v. 1485 nahija e Hotit kishte 134 kryefamiliarë/ shtëpi dhe në gjysmën e dytë të shek. XIX, përkatësisht që, sipas një gojëdhane “të besueshme” që rrjedh nga famullitari disavjeçar në famullitë e Malësisë së Madhe - veçanarisht në atë të katundit të Kastratit që ka qenë edhe prefekturë apostolike, Don Gavriili, Hoti paska pasur rreth katëqind e pesëdhjetë familje, që sajnin një popullsi prej mbi katërmijë frymësh të ndara në tri katunde: Hot, Rapshë dhe Traboin, nuk mund të besohet të jenë shpërndarë - sikundër propagohet nga “shkenca” serbe e etnografisë- gjatë shek. XVII edhe nëpër Kosovë.

Për të kështjellë e mbaj edhe versionin kosovar të traditës gojore, sipas të cilit fisi Hot, si i ardhur nga Malësia e Madhe, në krye të herës paska zënë vend në katundin Plluzhinë, ndërsa më vonë qenka degëzuar në gjashtë vëllazëri të tjera që paskan zënë vend në katundet e sotme Likovc, Ticë, Tushilë e Morinë të krahinës së Drenicës dhe në katundin Bradash të Lla-

¹² sh. S. Pulaha, Defteri ... f. 126.

pit.¹³ Vëllazni që e mbajnë veten për të fisit të Hotit ka edhe në katundet Poklek të Gllgovcit; Rogovë të rrethinave të Gjakovës dhe në vetë qytetin e Gjakovës; në katundet Jashanicë e Binxhë të Klinës; në katundin Ribar i Madh të Lypianit; në Carrallukë e Guncat/Ngucat të Malishevës; në Dejn dhe në Radostë të Rahovecit e tjetërkah nëpër Kosovë.

Vetëm sa për ilustrim se fiset e shqiptarëve që mbajnë emra personash mund të jenë pasardhës kryeparësh të ndryshëm të vëllaznive të cilët (kryeparë) rastësisht e mbanin një antroponim që, pa marrë parasysh prejardhjen gjuhësore, në periudha gjegjëse të historisë ishte pjesë e korpusit onomastik të tyre. Kështu mund të shpjegohet mbase edhe arsyeja e një tregimi që kam shënuar gjatë viteve '70 të shekullit që shkoi në katundin Drajkovc/ Drekovci të komunës së Shtërpçës, të banuar pjesërisht nga popullata serbe. Informatori serb nga i cili po shënoja mikrotoponiminë e këtij katundi më tregonte se vëllaznia, së cilës i përkiste edhe ai, ishte e fisit të Hotëve dhe se shi për këtë arsye edhe po u përbuzkan nga sivëllezër të tyre në Serbi duke i quajtur *arbanasë*. Me këtë rast vlen të sillet ndërmend rrethana që një vëllazni e këtij katundi, e quajtur *Drećovići*, mban një emër me prejardhje romane-ballkanike përkatësisht vllahe në trajtën shqipe, përkatësisht të përkthyer në shqip të tij. Ky emër është i një teme antroponimike prej nga rrjedhin emrat vllah *Drecun* e *Drekal* të malazezëve e ndoshta edhe me ofiqin *Dracul* të rumunëve dhe me antroponimin *Dreq* të shqiptarëve i cili në hapësira të Kosovës së sotme është dëshmuar vetëm një herë në v. 1485: khs. Ilia, i bir i *Dreqit*, në katundin e zhdukur *Kraçor* që asokohe varej nga Peja.¹⁴ Së paku 5 nga 14 kryefamiliarët - sa kishte atëherë ky katund - mbanin antroponim ose partonim me prejardhje shqipe.

Përkatësinë etnike vllahe të pararendësit të vëllaznisë së *Drećović*-ëve përkatësisht të atyre që dinë për përkatësinë e tyre në fisin Hot do ta tregonin, fundja, edhe mikrotoponimet aktuale *Kapisor* e *Kapikur* të këtij katundi të cilat mund të jenë mbetje onomastike vllahe, prejardhjen e të cilave, porse, unë nuk di ta zbërthej.¹⁵

¹³ sipas <http://www.forumishqiptar.com>.

¹⁴ Selami Pulaha, Defteri i regjistrimit të popullsisë së Sanxhakut të Shkodrës, i vitit 1485, Tiranë, 1974, f. 311.

¹⁵ Këto mikrotoponime i ka shënuar në terren Dr. Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës 9, Ferizaj, Shtimja dhe Shtërpca, Prishtinë, 2004, f. 231.

Dëshmi të emrit Hot në burime të shkruara:

a) Në funksion toponimi

Para se të paraqiten e të trajtohen të dhënat për emrin Hoti në toponimi le të shtohet paravendimi fort i besueshëm se dëshmia më e mocme e antroponimit *Hot* nga i cili, në hapësirën etnolinguistike të shqiptarëve, do të jenë sajuar oikonime homonime rrjedh nga një shkresë më e mocme se viti 1190 kur janë dëshmuar dy katunde të ndryshme të quajtura Hoçë,¹⁶ përkatësisht *Hoča i druga Hoča* “Hoča dhe Hoča tjetër”.¹⁷ Në një dokument tjetër të kishës serbe, i cili datohet si i viteve 1198-1199 është evidentuar vetëm një katund i quajtur *Hotča/ Hotbča*¹⁸ (lexo Hotça). Po në këtë trajtë dëshmohen edhe në një shkresë të sundimtarit serb Stefan Uroš të v. 1293-1302, përmes së cilës Malit të Shenjtë në Athos i falte kisha, katunde e njerëz. Edhe asokohe, këto dy katunde janë evidentuar të quheshin *Hotča*.¹⁹ e Poshtnja dhe e Epërmja. Në një burim që mbahet i viteve 1282-1298 emrat e këtyre dy katundeve ishin shënuar si *Hodbča/ Hodča*, përkatësisht si *obě Hodče* “të dy Hodçat”.²⁰ Në burime kishtare serbe të shek. XIV, deri në v. 1348, emri i këtij katundi është shënuar herë si *Hodča* e herë si *Hotča dhe/apo Hoča*. Që nga Dj. Daničić,²¹ emri i këtyre vendbanimeve zbërthehet si formim sllav nga emri personal Hot, që ndër sllavë del në trajta të ndryshme (sh. më poshtë).

Tradita gojore nuk ka ruajtur, pra, ndonjë “të dhënë” për ndonjë pararendës përkatësisht individ, [me përjashtim të rastit të dyshimt *Ota* nga

¹⁶ Kemi të bëjmë me katundet e sotme Hoça e Qytetit (serb. Hoča Zagradaska) 3 km. në perëndim të Prizrenit dhe me katundin Hoça e Madhe (serb. Velika Hoča) në rrethina të Raovecit. I pari është i banuar nga shqiptarë ndërsa i dyti nga popullata serbe. Në këtë të dytin paska disa kisha, ndonjëra nga të cilat qenka ngritur qysh në shek. XII.

¹⁷ F. Miklosich, *Monumenta spectantia historiam Serbiae, Bosnae, Ragusii, Viennae*, 1871, f. 6.

¹⁸ sipas Dr. Ludovikus de Thalóczy, - Constantinus Jireček - Aemilianus de Šufflay, *Acta et diplomata res Media aetatis illustrantia I*, Vindobonae, 1913-1918; f. 113.

¹⁹ Franz Miklosich, *Monumenta spectantia historiam Serbiae, Bosnae, Ragusii, Viennae*, 1871, f. 59. : “[...] obě Hotbči, dolnja i gornja.”

²⁰ St. Novakovi ć, *Zakonski spomenici* f. 389.

²¹ khs. Rječnik iz književnih starina srpskih III, Biograd, 1864, f. 420-422

tradita malazeze - khs. më lart] familje apo vëllazni që do të jetë quajtur *Hot* e që në bazë të tij të jetë quajtur katuni apo fisi i parardhësve të tij.

E dhëna që nuk mund të haset kthjelltazi në traditën gojore, dëshmohej porse në vitin 1330 tek Krisobulat e Deçanit, prej nga mësohet se mbase pikërisht emri i përveçëm *Hot* [që mund të ketë qenë edhe kryepar i vëllaznisë/ katunit], përmbahet në emrin e një mali (bjeshke), të quajtur *hotina gora*²² “Bjeshka e Hotit” [që mund të interpretohet edhe si “Tbanat e Hotit”], në regjionin e Plavës.

Ky emër i bjeshkës, që mund të ketë qenë në pronësi të individit apo të vëllaznisë së quajtur Hot-i ka të bëjë me njërin ndër malet/bjeshët apo me vetë krahinën Hoti dëshmohej pra, siç na mëson M. Šufflay, në një zonë në të cilën, edhe në një burim venedikas të vitit 1414 përmendet vëllaznia ose fisi i Hotëve, emri i të cilit është shënuar në trajtat *Otti*, *Oc-ti*, *Chioti* dhe *Coti*²³ [dhe në një tjetër, të dt. 12. 07. 1439,²⁴ edhe si *Hoti*- (S. G. ndoshta *Oti* ?).

Vetë trajta sllave e gjinore *Hotina* “i, e Hotit” e vitit 1330 flet në të mirë të paravendimit se këtu kemi të bëjmë me antroponimin *Hot*. Këtij mendimi i del krah mbase edhe rrethana që në këtë zonë, përveç Maleve të Hotit, më 1438 përmendet, krahas *capitaneus montane Ottorum*, “Kryeparit të maleve të Hotëve” edhe një banor i quajtur *Junch Hoth iam dominus in partibus Albanie*²⁵ në vitin 1434, i cili përmendej edhe në Kadastrin e Shkodrës të v. 1417-1418 (khs. më lart).

Dhe, emri i kryeparit *Junch* i bjeshkëve të Hotit, i dëshmuar në vitin 1438, jeton edhe sot e gjithë ditën tek emri *Junkaj* i një vëllaznie pikërisht të krahinës së Hotit. Në këtë mes bën të përmendet edhe rrethana që si tek vëllaznitë shqiptare, ashtu edhe tek Piperët e Kuçët e sllavizuar, ekziston gojëdhana (të cilën e kam shënuar edhe vetë në terren), sipas së cilës njëri ndër pararendësit e këtyre vëllaznive paska qenë një burrë i quajtur

²² sh. Miloš S. Milojević, Dečanske hrisovulje, in: Glasnik Srpskog Učenog Društva, 12, Beograd, 1880, f. 56.

²³ sh. Serbët e Shqiptarët ..., f. 63.

²⁴ sipas Spisak katuna Gornje Zete, iz 1455 godine, në Wikipedia.

²⁵ sipas M. Šufflay, Serbët dhe Shqiptarët, Prishtinë, 1968, f. 63., ose [sipas Oliver Jens Schmitt, Arberia Venedike 1392-1479, f. 496-497, Tiranë, 2007, f. 499.

Hoto ose (në versionin venecian ose/dhe sllav) *Oto*. Në të mirë të vazhdimësisë shqiptare të këtij emri flet mbase edhe emri i shkëmbit *Guri i Ohot's* që në vitet '70 të shekullit të kaluar e kam shënuar vetë në regjionin e Trieshit, i cili, pas gjithë gjasësh, e ruan njërën nga forma të emrit personal ose të vëllaznisë *Hot,-i*.

Sipas N. Baca,²⁶ në vitin 1474, një i quajtur *Ban Hoti* [...] "gëzonte në Male respektin më të madh e për këtë arsye ishte personaliteti vendimtar që mundësoi kalimin e Fiseve (Malsisë së Madhe të kohës, N. B.) në anën e Venedikut. Në këtë menyre shpëtoi Shkodra nga pushtimi gati i sigurt prej Osmanëve."

Përveç në Veriun e Shqipërisë dhe në regjionin e Hotit në rrethina të Plavës, antroponimi *Hot* dëshmohet disa herë gjatë shek. XIII-XIV edhe në qytete bregdetare të Adriatikut, vetëm si antroponim femëror. Kështu, në v.1348, në Dubrovnik dëshmohet si emër femre khs. *Chote uxor de Nichola Dresse*; në Trogir dëshmohet në v. 1390 *Chota* abbatisa S. Nicolai, soror archipresbyteri Dese Luce dhe në Zarë ishte dëshmuar qysh në v. 1289 një *Chota* Cerni de Carlaco. Në këtë kuadër, Jireček e shtie emrin *Coten*, khs. Petrus Coten comes ynsularum, i dëshmuar në Dubrovnik në v. 1331. Të gjithë këta emra, Jireček i sheh për me prejardhje sllave, përkatësisht të kenë dalë si pasojë e femërorizimit të emrit mashkullor sllav *Hotimir*.²⁷

Hotët për si vëllazëri më vete përmenden edhe në një marrëveshje midis Republikës së Venedikut dhe vojvodës Stefan Crnoje të Zetës, të lidhur në vitin 1455, përkitazi me famulltarë kishash dhe ipeshkvë katolikë e ortodoksë në regjionin e të Zetës, përkatësisht të Krajës.²⁸ Këtu është fja-

²⁶ Po aty

²⁷ khs. Konstantin Jireček, *Romani u gradovima Dalmacije tokom srednjega veka*, Zbornik Konstantina Jirečeka II, Srpska Akademija Nauka i Umetnosti, Beograd, 1962, f. 226. Më gjerësisht për mendimet përkitazi me prejardhjen e këtij emri sh. më poshtë.

²⁸ khs. tekstin: " Item dixi, che non sia alcun prete over vescovo over arcivescovo Latin sorra le nostre chiezie, ma che li siano de la nostra fede superior de le nostre chiezie: et volemo de guele non poder esser arcivescovo Latin in Craina, nomea desse messo bitropoliti de la fede sciava: perche guello bitropoliti de Craina el se chiama bitropoliti de Xenta: et lui mete li nostri zagi et preti, e senza celo non podemo esser." tek Dr. Janko Šafarik, *Srbski Istorijski Spomenici Mljetačkog Arhiva*, Glasnik Društva Srbske Slovesnosti 14, Beograd 1862, f. 175-177.

la për popullatën e vëllazërive *Marguxi* (= Mataguzhi),²⁹ *Hoteni* (= Hotenët, përkatësisht *Hotët*), *Gruda*, *Cuzi* (lexo: Kuçi), *Piperi*, *Bielopaulichi* (lexo: Bielopavliqi), *Cruessi* (lexo: Kryethi), *Chacharichij* (lexo: Kakariqi), *Busati* (: lexo Bushati), *Arbenexi* (lexo: Arbëneshi) në rrethina të Podgoricës përkatësisht të Ulqinit dhe *Fichsta* (lexo: Fishta), *Rogame* (Rogam), *Ivani* (Ivanaj) në Shqipërinë e Veriut përkatësisht në rrethina të Shkodrës. Me këtë ka të bëjë edhe dëshmia e vitit 1474, kur *Hoti* është evidentuar sërish si mal më vete me një kryetar, i emëruar pastaj vojvodë, i cili ishte në aleancë me Republikën e Venedikut. Pak më vonë, në kohën e pushtimit osman të kësaj treve, (mbase për t'u shpëtuar reprezaljeve) paska pasur një emigrim të hotianëve deri në Sicili, prandaj³⁰ mbiemri Hoti po u ndeshka atje, sado rrallë, edhe sot.

b) Në funksion horonimi, patronimi e antroponimi

Njëra nga dëshmitë për funksionin prej horonimi (= emrit të fisit/ vëllaznisë), të emrit *Hot* në burime të shkruara është ajo e vitit 1414 kur në një burim venedikas përmenden *certi Hocti* (“disa hoktë”). Dy vite më vonë, në një burim tjetër venedikas është shënuar se një *Andrea Otto* (“Andrea i tetë”)³¹ ishte emëruar për kapiten i vetëm i maleve, (S. G. të Hotit, khs. më lart) dhe se e gjithë kjo hapësirë malesh i dhurohej Venedikut, meqëse hotjanët ishin prishur përfundimisht me Balshajt. Në burime të vitit 1417 këto male cilësohen edhe si *Otto* (S. G. “Hot”?) ose të *de Hottis* “të Hotëve.”

Në funksion të patronimit (mbiemrit sipas prindit a atij të vëllaznisë), antroponimi *Hot* është dëshmuar edhe në Kadastrin venecian të Shkodrës të vitit 1416-1417, kur është evidentuar se disa kryefamiliarë – proniarë, njëkohësisht edhe kryparë katundesh, e mbanin patronimin, përkatësisht mbiemrin Hoti. Kështu psh. në katundin Bishttrjolla ishte proniari Rardogart *Hoti*; në katundin Potgora ishin proniarët *Andrea Hoti* me të vëllezërit

²⁹ E sajuar ndoshta nga pasardhës të Mata Guzh-it të katunit të arbanasëve të v. 1330 sh. Dečanske Hrisovulje ..., f. 55.

³⁰ sipas Wikipedia, HOTI.

³¹ Që unë e mbaj për interpretim jo të bindshëm sepse as në antroponiminë historike e as në atë bashkëkohore të shqiptarëve nuk ka antroponim apo ofiç që do të ishte sajuar nga numërori *tetë*.

Radas *Hoti* e Mazrek *Hoti*; në katundin Ljushta ishin evidentuar krerët Junch e Vlatik *Hoti* me vëllezër dhe në katundin me gjithsejt 5 kryefamilia-rë, *Villa clamada Pesiugla cauo* ishte dhe kryepari i quajtur Nicola *Otto*.³²

Në kësi funksioni, emrin *Hot-i* e gjejmë të dëshmuar edhe në vitin 1485, kur në katundin Egjirish të zonës së Shkodrës ishte evidentuar edhe kryefamilia-ri i quajtur Pepa *Hot-i* dhe banori i Nikshiqit *Hoti*, i bir i Kurës (mund të lexohet edhe Korës).³³

Në nomenklaturën aktuale topike, emri i Hotëve është ruajtur edhe tek emri *Balta e Hotit*. Kështu, kur po i trajtonte paralelet e mundshme onomastike të emrave të stacioneve rrugore romake në udhën romake kon-tinentale nëpërmes Malit të Zi, M. Pešikan³⁴ tek fliste për mundësinë e lokalizimit të kështjellës romake *Sinna/Kinna* që do të ketë qenë buzë Li-qenit të Shkodrës në pjesën shqiptare të tij, përmend dhe një si ujdhesë të vogël *Liqeni i Hotit* ose serb. *Humsko Blato* e krijuar më vonë si pasojë e zgjerimit të natyrshëm të Liqenit të Shkodrës. Ky na mëson se afër ven-dit *Balta e Hotit* (në afërsi të Vuksan Lekić, përkatësisht Tuzit) paska qenë ndoshta edhe kështjella Birziminium/ Bersumnum e periudhës romake.

Mendime rreth prejardhjes së emrit

Në hyrje të këtij nënkapitulli po sjell dy interpretime që unë i shoh si shembuj jo se si duhet, por se si nuk duhet shtruar çështja e prejardhjes së një emri, në rastin konkret përkitazi me çështjen e zbërthimit të emrit Hoti të fisit të shqiptarëve. Kjo vlen sidomos për pjesën më të madhe të studi-uesve shqiptarë që s'kanë shkollim për disiplinat e indoeuropeistikës, ball-kanistikës antike e asaj moderne, helenistikës, romanistikës e sllavistikës. Studiuesit e këtyllë materialin onomastik të lashtësisë së hapësirës etnolin-guistike moderne të shqiptarëve, që këta me shumë andje e quajnë mbetje

³² sh. gjithë lëndën onomastike tek Šime Ljubić, Skadarski zemljišnik od godine 1416, Priobćio u sjednici fiologičko-historičkoga razreda jugoslavenske akademije znanosti i umjetnosti dne 10. studenoga 1881, Pravi član Šime Ljubić, në: Starine, JAZU, XIV, Zagreb, 1882, f. 36.

³³ sh. S. Pulaha, Deferi ..., f. 364, 373.

³⁴ sh. Moguće onomastičke paralele imena putnih stanica na rimskom kontinentalnom putu kroz Cnu Goru, Onomastica Jugoslavica 9, Zagreb, 1982, f. 92.

pellasgo-iliro-dardano-arbënore -shqipe, e zbërthejnë me matierial leksikor të shqipes moderne thua se kjo nuk ka pësuar zhvillime të brendshme fonetike që nga kohët e mugëta dhe që nuk është vërsuar nga huazime nga më të ndryshmet. Për t'i arsyetur etimologjitë e tyre që shumë shpesh janë “patriotike” përkatësisht diletanteske, etimologji banale popullore, studiues të kësaj kategorie, përveç që paravendojnë zhvillime fonetike të padëshmuara në fonetikën historike të shqipes, nuk u durohet pa pas harruar periudha të tëra historike gjatë të cilave brumi leksikor i shqipes u ndikua thellë nga greqishtja e vjetër, latinishtja e më vonë edhe nga gjuhë të tjera.

I këtillë më duket, i lidhur me rastin tonë, edhe interpretimi i preardhjes së emrit Hot-i nga studiuesi shqiptar Ndue Bacaj.³⁵ Ky shpjegon se emri i fisit të Hotit do të ketë dalë nga emri i një hyjnie pagane të quajtur *Hestia*. Autori ynë thotë: “Duke mos pretenduar për një të vertetë absolute se emri Hot i ka rrënjët në emrin e Hyjnisë Pagane *HESTIA*, unë nuk heq dorë së menduari se emri apo toponimi **Hot** është trashigimi e emrit të kësaj hyjnie pagane të malit, krahinës apo këtij fisi i ka lënë si trashigimi të gjitha ato virtyte dhe vlera të mira që kultivohen fisnikërisht edhe sot në kohën e besimit Kristian të hotjanet. Mendoj se gjatë shekujve u zevendësuan *e*-ja dhe *s*-ja me shkronjen *o*, dhe e “humbi” vendin shkronja e fundit *a*-ja, duke bërë kështu të “mundur” që emri *Hestia* në vendin ku adhurohej e besohej kjo hyjni të “transformohej” deri në toponimin *Hot*.”³⁶

Studiuesi tjetër shqiptar, Ramiz Lushaj³⁷ tregon se “Hoti etno-historik me palcë kombëtare iliro-arbnore [...] përkatësisht se fisi i Hotit është (S. G. një herë) “Pasardhës i Autariatëve ilir në gene të gjakut e në truallin e tyre etnik ...” dhe/ose (herën tjetër)/ për ta lejuar më tej edhe një mundësi më shumë se krejt hipotetike sipas së cilës tek varianti *BRIGJE T'HOTIT* që po shenjuaka “anët e Hotit në lindje të Liqenit të Shkodrës” po u ruajtka emri *FRIGJI-FRIGËT*, *BRIGJI-BRIGËT* të një fisi/populli të njohur ilir” të përmendur në kohën e Luftës së Trojës, pasardhës të të cilit qenka fisi i

³⁵ sh. *punimin e tij* Etnogjeneza e Hotit, të publikuar më 20 dhjetor 2016 tek Albdreams.

³⁶ sipas Wikipedia, virgjëresha Hestia ishte, pas mitologjisë greke, hyjneshë e vatrës së familjes e të shtetit, e vatrës dhe e zjarrit flijues dhe një ndër të 12 perënditë e Olimp. Bile, vetë emri i saj qenka me prejardhje greke (khs. gr. Ἑστία, në jonishten Ἰοστίνη me kuptimin “vatër”). Tek romakët e njëjta hyjneshë, me të njëjtat attribute, quahet Vesta.

³⁷ sh. Rrugë e Hotit: Shembull, Model, Simbolikë, në Voice of Albanians - Zëri i Shqiptarëve.

Hotit, “që në mesjetën e hershme shtriheshin deri në malin e Komovit (1.850 m. mbi nivelin e detit), nga kryerrjedha e lumit Lim deri në kryerrjedhë të lumit Tara.”³⁸

Duhet theksuar me këtë rast se populli i frigasve me gjuhë indoeuropiane, i cili më së voni në shek. VIII para erës sonë kishte formuar një perandori të madhe (greq. Φρυγία) në pjesën qendrore të Azisë së Vogël me kryeqytet Gordion-in - rreth 80 km. në perëndim të Ankarasë së sotme, është një popull, një etni ilire me dy variante të emrit të tyre, përkatësisht vetë etnia ilire e Brygasve.

Hartë e fiseve të pavarura dhe e fiseve luftarake të Shqipërisë së Epërme [Veriore], përkatësisht e *kuçëve*, *palabardhajve*, *piperëve*, *hotëve*, *krasniqëve* dhe *vasojeviqëve*, e hartuar në vitin 1839 nga kryepari i Vasojević-ëve, e publikuar së fundi nga portali *konica.al*, më 20 mars 2017.

Në këtë mes unë, me sa kam mësuar nga burimet, shtoj se Brygasit ishin, në të vërtetë, një fis i ilirëve që³⁹ do të ketë jetuar midis të dy anëve të liqenit Lychnidos-it (Ohrit) e deri në rrjedhën e poshtme të lumit Axios (Vardar) dhe Epidamnosit (Durrësit), duke e pasur të vetin edhe këtë qytet i cili më vonë u quajt Dyrrachion (Durrësin), të cilin e kishin sulmuar jo vetëm një herë. Një pjesë e këtij fisi u shpërngul në Azinë e Vogël dhe hapësira e banuar atje nga gekët u quajt Φρυγία. Ky variant, sqaron A. Mayer [khs. më poshtë] është rezultat i kalimit të greq. υ në ι, sikundër dëshmohet në glosën βρύγλα të lidishtes aziatike.

Në dritën e këtyre të dhënave do të rezultonte që Brigasit ilirë (Bρύγες, Bρύγοι) janë i njëjti entitet që jetonte në hapësirat e Makedonisë pararomake, i cili, pas shpërnguljes së tij të plotë apo të pjesërishtme në Azi të Vogël, nga grekët u quajt Frigas, përkatësisht greq. Φρυγες/Φρύγοι. Varianti i mirëfilltë Bρύγοι i emrit të këtij fisi është⁴⁰ emër me prejardhje indoeuropiane dhe rrjedh nga ieur. *bhreu-g përkatësisht *brug- me kuptimin “i lirë” dhe i afërt edhe me emrin e një fisi tjetër të ilirëve, *Breu -ci* që jetonte në hapësirat e Panonisë. Fisi ilir i Brigëve/Frigëve jetonte pra në ha-

³⁸ sipas Ramiz Lushaj, *Rruga e Hotit: Shembull, Model, Simbolikë*, në *Voice of Albanians - Zëri i Shqiptarëve*.

³⁹ sipas Anton Mayer, *Die Sprache der alten Illyrier*, I, Wien, 1957, f. 98.

⁴⁰ sipas Anton Mayer, *Die Sprache der alten Illyrier*, II, Wien, 1959, f. 20.

pësira të veta fort larg nga territoret e labeatëve e të autariatëve, përkatësisht larg hapësirës së banuar nga fisi Hot mesjetar e i sotëm i shqiptarëve.

Për rrjedhojë, as emri *Brigjet* (*Brigjet e Hotit*) nuk ka të bëjë asgjë me Brigët e Makedonisë e të Anatólisë, sepse ky toponim është në të vërtetë një emër shqip i vendit, i sajuar nga shumësi *brigje* i fjalës *breg* të shqipes, të cilin [emër] edhe ndonjë sllavist⁴¹ e mban për toponim me prejardhje shqipe në Malin e Zi të sotmin.

a) Emri Hoti i fisit nuk mund të jetë mbetje onomastike e Gotëve.

Përkundër rrethanës së njohur për praninë fizike të ndonjërit nga fiset germane në hapësirat etno-linguistike të shqiptarëve dhe mbetjeve leksikore e onomastike germane-gote në gjuhën shqipe, të cilat i kishte trajtuar N. Jokl⁴² dhe vogëlsia ime,⁴³ kujtoj që emri *Hot,-i* i fisit të shqiptarëve vështirë se mund të jetë me prejardhje germane, përkatësisht gote.

Megjithëse rrjedh nga një dijetar i shquar i indoeuropeistikës dhe i ballkanistikës, i këtitllë (khs. më lart tezat e dy autorëve shqiptarë) ka mundësi të jetë edhe mendimi i linguitit të shquar Henrik Barić. Këtë e mësova nga Jahja Drançolli. Mësova se, përkitazi me Gotët e Lindjes në rrethina të Shkodrës, përkatësisht në hapësirat e Ilirikut, të Dardanisë e të Epirit, në librin *Historia e Malit të Zi*⁴⁴ është shkruar se “Shfaqja e parë e Gotëve të Lindjes në kufinjtë e Praevalis-it⁴⁵ ndodhi në vitin 459. Perandori Leoni I ua refuzoi Gotëve të Lindjes *subsidentin*, (S. G. nga lat. *Subsidiarius* “që i takon rezervës, që shërben si ndihmë”) dhe, për pasojë, Gotët e

⁴¹ khs. psh. M. Pešikan, Moguće onomastičke paralele imena putnih stanica na rimskom kontinentalnom putu kroz Crnu Goru, *Onomastica Jugoslavica* 9, 1982 Zagreb., f. 95.

⁴² khs. punimin e tij *Balkangermanisches und Germanisches im Albanischen*, separat nga “Festschrift der 57. Versammlung deutscher Philologen und Schulmänner in Salzburg”, 1929, f. 118-120, 107, 116, 119, 121-123, 134, 135-137.

⁴³ sh. trajtesën time Bashkëjetesa sase-shqiptare në shekujt 14-16 dhe disa gjurmë onomastike e leksikore sase në Kosovë, në *Kërkime Onomastike-Historiuke për Minoritete të shuara dhe ekzistuese të Kosobës*, botim i ASHAK, Prishtinë, 2015, f. 11-114.

⁴⁴ khs. *Istoriija Crne Gore*, vëll. I, Titograd 1967, f. 252.

⁴⁵ Pas reformës administrative të perandorit Diokletian (284 - 305), hapësira e Shqipërisë së sotme u takonte provincave të sapoformuara Praevalis, Epiros Novae Epiros Vetus. Kryeqendër e provincës Praevalis, e cila shtrihej, në jugdi deri te Lezha e sotme, ishte Shkodra.

Lindjes shkretëruan Ilirikun, pushtuan disa qytete dhe depërtuan në Epirin e Ri dhe plaçkitën Durrësin, por shumë shpejt u morën vesh me qeverinë e Perandorisë dhe u tërhoqën në Panoni. Regjioni i Durrësit dhe pjesa më e madhe e Epirit të Ri qenë hapësirë e kolonizimit të Gotëve të Lindjes, ku do të ketë pasur edhe gjurmë të Gotëve të Perëndimit. Meqë kishin bërë plang në Mizinë e Poshtme⁴⁶ në vendin Novae (sot, Svištovo) Gotët e Lindjes, me në krye prijsin e tyre Teodorih-un, në luftë kundër perandorit Zenon në vitin 478 depërtuan përsëri në Epir, ku u vendosën përreth Durrësit. Në Epir, afër Janinës, gjurmë e këtyre Gotëve qenka toponimi Γότισσα.⁴⁷

Gotët e Lindjes depërtuan në Praevalis, pas gjithë gjasësh, nga Epiri, e ndoshta do të jenë ngulitur edhe në rrethina të Shkodrës, prej nga [nga një lokalitet i panjohur] rrjedh një përthekojse e pasuruar dy herë me gurë gjysmë të çmueshëm dhe me koka të shpendit mitik të Gotëve) (*gipaete, zool. Gypaetus barbatus*) e cila [përthekojse], sipas sistemit të dekorimit, i përgjigjet sistemit dekorues të stolive të Gotëve të Lindjes.” Në vazhdim është sjellë edhe mendimi sipas të cilit “Dëshmi e banimit të Gotëve në rrethina të Shkodrës është, ndoshta, etimologjia e emrit *Hoti* të fisit të shqiptarëve në anët verilindore të Liqenit të Shkodrës (regjioni Hoti, burimet në Liqenin e Shkodrës, *Liqeni i Shkodrës*) të cilin disa filologë e nxjerrin nga emri *Goth*”⁴⁸ duke cituar në këtë mes qëndrimin e dijetarit Henrik Barić.⁴⁹

Duke kaluar në rrafshin e interpretimeve “n’tokë t’bukës”, mua më rezulton se përkitazi me prejardhjen gjuhësore të antroponimit *Hot-i*, nga i cili do të jetë lindur vëllaznia e pastaj fisi i Hotëve, ka dy mundësi.

⁴⁶ Provincë e perandorisë romake. Shtrihej në pjesën lindore të gadishullit të Ballkanit. dhe arrinte për disa qindra kilometra në drejtim të rrjedhës së poshtme të Danubit. Emrin e mori sipas fisit trakas të Mizëve/Mezëve.

⁴⁷ sipas J. Kovačević, Arheologjia i istorija varvarske kolonizacije južnoslovenskih oblasti, od IV do početka VII veka, Novi Sad 1960, f. 23-24. Sa për sqarim po shtoj se këtë mendim e kishte shfaqur Max Vasmer në punimin e tij Beiträge zur slavischen Altertumskunde, XVII Balkangermanisches und Verwandtes, Zeitschrift für slawische Philologie XVIII, Heft 1, Leipzig 1941, f. 58.

⁴⁸ sipas J. Kovačević, Arheologjia i istorija varvarske kolonizacije ... južnoslovenskih oblasti, od IV do početka VII veka, Novi Sad 1960, f. 23-24.

⁴⁹ khs. punimin e tij O germanskim tragovima u jezicima preslovenskih stanovnika Balkana, në Lingvističke studije, I, Sarajevo, 1954, f. 79.

b) emri *Hot*, -i mund të jetë me prejardhje vllahe

I pari që e shprehu mendimin për prejardhjen vllahe të emrit të këtij fisi të shqiptarëve është dijetari kroat Petar Skok. Kur, në aspektin etimologjik, po e shkollonte emrin e fisit shqiptar të *Hot* -it (sipas të cilit e ka marrë emrin edhe krahina e banuar nga ky fis), P. Skok⁵⁰ ia mveshi këtij emri atributin *vllah*, përkatësisht e shihte këtë për emër me prejardhje vllahe. Këtë emër ky dijetar i madh, romanist, sllavist e ballkanolog e shihte të ketë dalë nga fjala vllahe, përkatësisht rumune *hotul* (nga rum. *hot* + suf. *-ul*) “hajn, cub, plaçkitës”, khs. rum. Moderne *hoț*. „hajn”, fem. *Hoție* “haj-neshë” dhe dial. *hojështe* “i, e hajnisë”.

Në të mirë të kësaj etimologjie do të fliste ndoshta edhe dëshmimi në vitin 1348 i oikonimit *hotulb*, përkatësisht (në lokativin sllav) *vyše hotoulja* khs. tekstin: „dhe mbretëria ime ia fali kishës [...] në Vran(j)ë sipri *Hotulës*”⁵¹ që ka të bëjë me katundin e sotëm shq. *Hotël*, serb. *Hotlja* përkatësisht Donja, Gornja Otulja, në rrethina të qytetit të Vranjës - një zonë kjo në të cilën prania e vllahëve në mesjetën e vonë nuk mund të vihet në dyshim), në të cilin përmbahet pra edhe prapashtesa romane ballkanike e shquarësisë *-ul*.

Me rëndësi për këtë çështje është edhe rrathana që, për hapësirën e sotme të Kosovës, ky emër dëshmohet po më 1330 edhe si antroponim i vllahve. Kështu, në vendbanimin e *vlas*i *tudoričevci* “Vlleht Tudoričevci” (= katundi i sotëm Turičevci i komunës së Skënderajt) ishte evidentuar edhe kryefamiliar i *toudoric a sin mou hotilo* “Tudoric-i dhe i biri Hotilo”. Përkatësinë etnike vllahe të banorëve të këtij katundi, përveç cilësimit shprehimisht për “i vllahve” e tregon edhe vetë trajta karakteristike vllahe Tudor, e pajisur këtu me prapashtesën sllave *-ic*, e antroponimit me prejardhje nga greq. e mesme Theodoros, edhe rrethana që dy banorë të këtij vendbanimi e kishin ruajtur deri atëherë edhe antroponimin roman-ballkanik *Bun*, pat-

⁵⁰ khs. Toponomastički prilozi, Časopis za slovenski jezik, književnost in zgodovino VII (1 - 4), 1928, f. 166.

⁵¹ khs. origj. „i priloži carstvonі crkvъ preobraženije ou vranі vyše hotoulja.” tek J. Šafarik, Hrisovulja cara Stefana Dušana, kojomь osniva monastirь sv. Arhangela Mihaila i Gavrilja u Prizrenu godine 1348 ?, Glasnik Društva Srbske Slovesnosti, 15, Beograd, 1862, f. 303; Đ. Daničić, Rječnik iz književnih starina srpskih II, Beograd 1864, f. 420.

ronimin *Bunovik*, antroponimin Dush në trajtën romane-ballkanike *Dushul* të tij dhe antroponimin *Baç*.⁵² të së njëjtës prejardhje si fjala *bac*. “bariu më i moçëm përkah mosha i një tban; vëllau i madh” e shqipes që e kanë edhe gjuhë të tjera që fliten në gadishullin e Ballkanit.

Në të mirë të mundësisë që emri Hoti i fisit të shqiptarëve të jetë me prejardhje vllahe do të shkonte edhe rrethana që në kufi të qytetit të Plavës (vendit të formimit të kësaj vëllaznie) dhe atij të Gucisë ishte dhe bjeshka me emrin roman-ballkanik vllah *Visitor*. Khs. tekstin “[...] katundi në qytetin e Plavës [...] dhe ja megjiet e qytetit [...] dhe përmes Visitorit.”⁵³

Përtkitazi me emrin e kësaj bjeshke që mbase do të jetë shfrytëzuar nga vllah e nga shqiptarë, P. Skok⁵⁴ sqaronte se emri *Visitor* është një emërtim rumun [S. G. nënkupto roman-ballkanik, përkatësisht vllah, nga lat. *videre*] që rrjedh nga mbiemri foljor *a visa* “fle, ëndërroj, dremitem”. Përveç kësaj, pikërisht në këtë zonë janë edhe bjeshkët si *Durmitor* (që rrjedh nga mbiemri rumun përkatësisht vllah *a dormi* me prejardhje nga lat. *dormire* që tek vlleht në shek XVI u ndryshua në *durmi*) për të cilin Skok thoshte: “Ky emër mali është një emër foljor thjesht rumun, kuptimi i të cilit si vend gjumi i blegtorëve nomadë i përgjigjet shkëlqyeshëm”.⁵⁵ Në këtë zonë, me prejardhje vllahe janë edhe emrat e maleve *Pirlitor* (nga rum., përkatësisht vllah. *a pirlu* “djeg, shkrumboj”), *Palator*, një va në lumin Drina (nga rum., përkatësisht vllah. *a [s] spāla* “laj”), *Cipitor* (nga rum., përkatësisht vllah. *Aṭipi* “kotem, dremis”, emri *Murgule* i një rrafshine nën bjeshkën *Durmitor* si edhe bjeshka Stari Vlah e ndonjë tjetër.

Mundësia e prejardhjes vllahe të emrit *Hot* -i të vëllaznisë/fisit të shqiptarëve do ta gjente mbështetjen edhe tek konstatimi i sllavistit holandez N. van Wijk,⁵⁶ sipas të cilit, në mos i gjithë, së pakut një pjesë e popullit të rumunëve ishte etni autoktone edhe në hapësirën e Ballkanit jugor. Këtë e tregon rrethana që në mesjetën e herëshme bullgarët e serbët ishin të ndarë gjeografikisht nga një popullatë josllave. Dhe, kjo popullatë josllave,

⁵² khs. Dečanske hrisovulje ..., f. 51-52.

⁵³ khs. origj. *selo ou plavě gradъ [...] a m e g j e g r a d o u* [...], f. 39] *i přezb visitorъ ...*” në Dečanske Hrisovulje ..., f. 40, 42.

⁵⁴ sipas Al. Rosetti, *Istoria limbii române de la origini pină în secolul al XVII-lea*, București 1968, f. 213.

⁵⁵ cit. sipas Al. Rosetti ..., poaty.

⁵⁶ sh. librin e tij *Les langues slaves (de l'unité à pluralité)*, Hage, 1956, f. 103.

sidomos në Dardani e në Praevalis, ishte popullatë romane (S. G. Ballkani-ke), sepse në këtë hapësirë nuk gjendet asnjë gjurmë e lashtë e fiseve bullgare ose të atyre serbe/kroate. N. van Wijk përfundon se “një provë e mbështetur mbi nomenklaturën gjeografike tregoi se emrat e vjetër të qyteteve të romanëve u ruajtën para se gjithash në provincat Dacia *Mediterranea*, *Dardania* dhe *Praevalis*, thënë ndryshe në zonën që ndan Danubin, në veri e në verilindje të Sofjes, në Adriatik dhe që formon një regjion të ndërmjetëm që u përmend sipri, në të cilin nuk gjendet asnjë gjurmë e vjetër e fiseve bullgare e serbe/kroate. Të gjitha të dhënat bashkë pajtohen nëse paravendojmë që dy grupet e sllavëve të Ballkanit ishin të ndarë nga një zonë romane nga Rasi pas gjithë gjasësh deri në vitin 1200 apo ndoshta edhe më heret se ky hark kohor.”⁵⁷

Kësaj mundësie i del krah dhe rrethana, e pastudiuar deri tani as nga romanistë e as nga albanologë, se në gjithë këtë hapësirë kishte një bashkëjetesë vllahe-shqiptare, çështje kjo që nuk do të preket në këtë shkrim.⁵⁸

Mendimi i vagullt se varianti *Oto* i emrit *Hot*-i mund të sqarohet me numërorin *otto* “tetë” të romanishtes do ta gjente mbështetjen e tërthortë të rrethana që në lagjen *Preki Lug* [sot Prekollukë] të katundit Hrastovik [sot Rostovicë] të rrethinave të Deçanit, përmendet në v. 1330⁵⁹ edhe banori *Voislav Šaptejević* i cili, pas gjithë gjasësh, e ka për mbiemër emrin Shaptej të katundit të rrethinave të Deçanit nga i cili do të ketë ardhur në Rostovicën e sotme. E, vetë emri Shaptej është me prejardhje vllahe-rumune dhe rrjedh nga numërori *šapte* “shtatë” i rumanishtes/ vllahishtes.

Fonematikisht të ngjashëm me emrin tonë janë mbiemrat rumunë: *Şapte -fraţi*, *Şapte ochi*, *Şaptezeni*, *Şaptireş*, *Şaptelea*, *Şapticeni*, *Şeptesani*,

⁵⁷ khs. tekstin origjinal : “Un examen approfondi de la nomenclature géographique a montré que les anciens noms des villes romains furent conservés surtout dans les provinces Dacia Mediterranea, Dardania et Praevalis, autrement dit dans la zone qui relie la Danube, au Nord et au Nord-Ouest de Sofia, à l’ Adriatique, et qui forme la région intermédiaire mentionnée plus haut, où l’ on ne trouve aucune trace d’ anciennes tribus bulgares et serb-croates. Toutes les données concordent donc ensemble, si nous admettons que les deux groupes de Slaves Ballkaniques étaient séparés par une zone romane de Ras probablement jusqu’ en 1200, ou même au delà cette époque”.

⁵⁸ Këtë temë e kam trajtuar më gjerësisht në punimin tim Albansko-vlaška simbioza u svjetlu onomastike, në *Onomastica Jugoslavica* 1/1982 (Zagreb) sidomos në librin tim ende në dorëshkrim Vlacho-Albanica.

⁵⁹ khs. *Dečanske hrisovulje* ..., f. 13.

Seaptes, *Septes* e ndonjë tjetër, në të cilët A. Constantinescu⁶⁰ e gjen të përmbajtur një antroponim kuptimisht të barasvlershëm me atë të lat. *Septimus*, i cili e ka, poashtu, kuptimin “i shtati”. Në grupin e tipit të emrave të sajuar nga numërorë (si edhe toponimet e përmendura) të sjellë më lart bien edhe emrat e mbiemrat *Pîrva*, *Pîrvan*, *Pîrvu* nga rum. *pîrvu* “i pari” dhe *Cincul*, *Cincea* që rrjedhin nga rum. *cinci* “pesë, i pesti” etj. të vllahëve e të rumunëve si edhe emri sllav *Prvoje*, i dëshmuar po më 1330 në katundin *Babe*, [sot Babaj t’Bok’s e Babaj t’Slloqit të rrethinave të Deçanit] ku jetonin edhe kryefamiliarët *prvoje* dhe i vëllai *živalb* e *raiko* dhe gjyshti i tyre me emrin, pas gjithë gjasësh vllah, *mr̃morb*.⁶¹

Të këtij formanti janë edhe emri i banorit *Primus Blasii de Menze* më 1322 - pasardhës i familjes *de Primo* (*Primojević*) në Dubrovnik dhe pak emra të tjerë të dëshmuar në shek. XV po në këtë hapësirë. Ky emër dëshmohet⁶² edhe në CIL (= Corpus Inscriptorum Latinorum) në altartin e S. Primi-t në Kotor në v. 1166. Emri personal Primo që, mbase si relik i romanëve mesjetarë, gjallon edhe sot në qytetin e Shkodrës.

c) Emri *Hot*,-i mund të jetë me prejardhje sllave

Etimologjia vllahe e këtij emri vihet në dyshim në dritën e rrethanës që në hapësirat etnolinguistike të sllavëve ka shumë emra vendesh e lumenjsh që përmbajnë temën emërore *Hot*-. Të këtillë janë psh. Emrat *Hotinac*, *Hotinovci*, *Hotkovci*, *Hotkovica*, *Hotmal* e të tjerë (në Bosne); *Hotnja*, *Hotuča* (në Kroaci),⁶³ këtu bien edhe emrat e lumenjve *Otnja*, *Otina*, *Chotina* (një degë e lumit të Bregallnicës afër qytetit të Shtipit në Maqedoni), pastaj emrat e vendeve *Chotynia*, *Chotyniec* (në Poloni) dhe *Chotina ves*, *Chot*, *Chota*, *Choteh* (në Çeki) etj. Në një punim tjetër të tijin⁶⁴ B. Simeonov shtonte se toponime të sajua nga *hotb* e sllavishtes

⁶⁰ khs. Diçionar onomastic romînesc, Bucureşti, 1963, f. 380.

⁶¹ khs. Dečanske hrisovulje ..., f. 82.

⁶² sipas K. Jireček, Romani ..., f. 194.

⁶³ khs. Rječnik JAZU III, f. 673. Hotel, Hotelić etj. (në Bullgari), khs. edhe N. Kovačev, Ošte nešto za mestopoloženieto i imeto na srednovekovnoto selište „Hotel”, Bălgarski ezik 5-6 (1961), f. 518.

⁶⁴ khs. Imini albanski mestni nazvanija, Bălgarski ezik 4-5, Sofia, 1959, f. 520.

(khs. bullg e vj. *Hotъ* “ljubovnik, dashnor, *želanie*”; çek. *chot* “godenik, ṣrug “bashkëshort”; pol. e vj. *hotial* “iskal”) ka, përveç në Bullgari (*Hotnica, Hotanica, Hotanec*) edhe në Poloni (*Chocil, Chotla, Chodel, Chocielewo*) dhe në Shqipëri (*Hotishtë, Hotovë, Hoticë*) dhe se të gjithë këta, bashkë me emrat *Hotel/Hotelec* të Bullgarisë, duhet të lidhen me sllav. e vj. (përkatësisht me bullg. e vjetër). Fundja, edhe dijetari i zellshëm Đuro Daničić sqaronte në vëllimin III të fjalorit të tij⁶⁵ se emrat e vendeve *Hotina Gora* e *Hotiš* të regjionit të Plavës dhe *Hotulъ* të Vranjës, bashkë me emrin në variantet grafike *Hotъča/ Hodъča/Hoča* të rrethinave të Prizrenit përkatësisht të Rahovecit, po rridhkan nga folja sllave/ serbe *hotъnъ* “dua, dëshiroj” (lat. *libens* “i kënaqun, që vepron me gjithë qejf” dhe “i gëzueshëm”) dhe *hotënije*; lat. *voluntas*. “vullnet, dëshirë” etj⁶⁶.

Kundër prejardhjes vllahe të antroponimit *Hot* do të fliste dëshmimi shpesh ndër sllavë i kësaj teme emërore në funksion antroponimi të zgjeruar me prapashtesat *-ko, -in, -el*, përkatësisht *Hotko, Hotin, Hotel* dhe në antroponimet dypjesëshe të tipit *Hotimir, Hotislav* etj. që bukur bindshëm mund të zbërthehen si të dala nga folja sllave *hoteti* “dua, dëshiroj”.⁶⁷

Sado që nuk fliste drejtpërdrejt përkitazi me emrat e përveçëm të tipit *Hot-*, B. Simeonov⁶⁸ thoshte që emri *Godeč* i qytetit dhe emra të tjerë të këtij tipi është semantikisht i motivuar si emrat e tipit *Hot-*. Sipas tij, emrat *Hot-* që ndeshen nëpër hapësirat e banuara sllavët e kanë për rrënjë foljen sllave *hoteti* “dua, dëshiroj”. Të kësaj prejardhjeje janë emrat personale *Hotemir, Hotebor, Hoteh, Hoten, Hotena, Hoteslav, Hoteš, Hotibor, Hotiš*,⁶⁹ *Hotivoi, Hotimir* në Bohemi e në Moravi; *Hotan, Hotimir* në Lausitz (Gjermani); *Hotin* në Kiev (Ukrainë); *Hotъjan* i dëshmuar në shek. XVII në dokumente ruse; *Hotъnъ* i dëshmuar në shek. XVI në burime polake, *Hotun* etj. Këtë temë emërore autori ynë e gjen edhe në emrat e vendeve *Hotelъ, Htětovo Htětovo > Tetovo, Hotnica, Hotanica* (në Bullgari), *Ho-*

⁶⁵ Rječnik iz književnih starina srpskih III, Biograd, 1864, f. 420-422.

⁶⁶ khs. Për këtë H. Lacaj e F. Fishta, Fjalor Latinisht-Shqip, Tiranë 1966, f. 281, 561.

⁶⁷ khs. Jordan Zaimov, Bulgarische Gewässernamen, II, Zeitschrift für Slawistik, Bd. VI, 1961, Akademie-Verlag, Berlin, f. 234-235, 248.

⁶⁸ khs. punimin e tij Nazvaniето nga grad Godeč, Български Език Nr. 4/1962, Sofia, f. 433.

⁶⁹ për të cilin A. Loma, khs. Toponimija Banjske Hrisovulje, SANU, Beograd, 2013, f. 224 kujton se rrjedh nga antrop. sllav *Hotišъ ose nga deminutivi i antrop. *Hotislavъ.

tište e *Hoštenje* në Shqipëri; *Chociel*, *Chotla*, *Chodel*, *Chocielevo* bashkë me emrat e lumenjve *Chotel* e *Chodel* - degë të lumit Viša në Poloni. Dijetari tjetër bullgar J. Zaimov⁷⁰ konsideron se nga antroponimi i zhdukur **(H)oto* rrjedh edhe emri *Otóvica* i një lumi në malin Rila të Bullgarisë dhe se antroponimi **(H)oto* qenka trajtë e shkurtër e antroponimit **Hotibta*. Të afërt me këtë janë edhe emrat *Otowice*, *Otówka*, *Ottóvko*, *Ottowo*; emrat çekë të tipit *Otovice* etj. Të gjithë këta emra J. Zaimov i sheh të jenë të dalë nga antroponimi **Hoten*. Të kësaj prejardhjeje autori ynë e sheh edhe emrin e vendbanimit e të lumit *Hotnica* (Chotnica) në Bullgari etj. dhe i sjell për krahasim emrat *Hotovo*, *Otoštica*, *Otošnica* etj. Më tej autori ynë thotë se emri *Hotina* i një dege të lumit Bregalnica rrjedh nga antroponimi mbase mashkullor **Hota* dhe i sjell për krahasim emrat *Hotansko dere* të lumit dhe toponimin *Hotnica* nga një **Hotenica* (nga antroponimi **Hoten* i zgjeruar me prapashtesën *-ica*), që i sheh të formuar si edhe emri polak *Chotina* i lumit dhe si emri çek *Chotoun* dhe ai *Cottendorf* në Saksoni të Gjermanisë. Prejardhjen sllave të këtij emri e bën më të besueshme edhe rrethana që ky emër dëshmohet edhe në hapësirat e regjionit Lausitz të sorbëve të Saksonisë e në Brandenburg, pjesa sllave e banorëve të të cilave mbahen për sllavë të Perëndimit e, mbase nën ndikimin e etimologjisë popullore, edhe me emrin e vjetëruar *Serbja*, *Serby* (për *serbë*) dhe për *Wenden* (*vendë*) “sllovenë” me kuptimin e përgjithshëm *sllav*, -ë. Mbizotëron mendimi që këta sllavë janë vendosur në këto hapësira në shek. VI.

Kësaj i del krah edhe rrethana që, përveç tek shqiptarët [vetëm tek emri Hoti i fisit], antroponimi *Hot* ndeshet fort shpesh edhe sot tek rumunët. Sipas N. A. Constantinescu,⁷¹ ky emër mund të zbërthehet përmes substantivit dialektor *hot* “bucium”; “instrument muzikor” të rumanishtes ose nga slav. *hotъ* rum. *voiniță* “dëshirë, vullnet” i cili i sjell me këtë rast për krahasim e dëshmi shembujt që i kishte dhënë K. Jireček për në Dalmaci e të cilët i solla edhe unë (khs. më lart). Për dokumentim se këtë emër e mbanin edhe vlleht autori ynë e sjell shembullin *Hot*, *-ilo*, mbase nga krisobulat e Deçanit ndërsa për dëshmi të këtij emri në funksion patronimi tek rumunët, autori i sjell shembujt *Hotu*, *Hota*, *Hotan/Hotanul*, *Hote*, *Ho-*

⁷⁰ sh. punimin e tij *Bulgarische Gewässernamen*, ..., f. 234, 248

⁷¹ Dicționar onomastic romînesc, București 1963, f. 297-298.

tea, Hoten, Hotean/Hoteancea, Hotian, Hoteni/Hotësti, Hotman, Hotcol/Hotësti. Në hapësirën aktuale etnolinguistike të rumunëve, emri *Hot* është ruajtur edhe në disa mikrotoponime. Të kësaj prejardhjeje janë, sipas autorit tonë, emrat e vendeve *Hotin, Hotinësti* e ndonjë tjetër. Mikrotoponime me prejardhje nga substantivi me prejardhje vllahe/rumune ose sllave [sh. më poshtë] është edhe emri *Hotonog* në territorin e Hungarisë aktuale. Ndër rumunë, në shek. XVII emri *Hot* dëshmohet edhe në trajtat *Hotopel, Hodopeni, Hotopeanul*, ndësa në gjysmën e parë të shek. XVIII edhe në trajtat *Hoțul, Hoțea* e *Hoția*.

Në këtë mes do të duhej të shihej edhe çështja nëse edhe varianti *Hoda* me zgjerime të ndryshme prapashtesore, të dala si rezultat i ndryshimit të dëshmuar jo rrallë të kalimit të *t* në *d*, mund të jenë të së njëjtës prejardhjeje. Khs. për këtë psh. dëshmitë *Hodo* e *Hodivoj*⁷² të dëshmua në v. 1455 e të ruajtura nga shqiptarët në trajtat *Hoda* e *Hodaj* dhe tek emri *Hodonovc* i katundit në regjionin e Kamenicës.

Venerime përmbledhëse

Prej nga sa u tha më lart, rezulton pra që emrin me prejardhje sllave *Hot-* e paskan marrë romanë të sllavizuar të qyteteve jugore të brigjeve të Adriatikut, përkatësisht të Raguzës, Trogirit e të Zarës; shqiptarë të hapësirës midis Ulqinit e Shkodrës [në të cilat kishte porse edhe qytetarë romanë, sepse kjo hapësirë ishte pushtuar e administruar, edhe herë pas here, për kohë të gjatë nga Republika e Venedikut] dhe vllah të Kosovës e të rrethit të Vranjës.

Rrethana që emri i fisit (vëllaznisë) shqiptar *Hoti* në funksion të toponimit posesiv (khs. *hotina gora* më 1330 dhe *Otti, Octi, Chioti, Coti*, që nga viti 1414) dëshmohet pa prapashtesa sllave përkatësisht pa trajta të derivuara, do ta tregonte lashtësinë e qenies në përdorim të këtij emri tek shqiptarët përkatësisht do të dëshmonte, pa e marrë parasysh prejardhjen e vetë emrit, se shqiptarët e ruajtën në emrin e tyre të fisit/vëllaznisë trajtën më të vjetër sllave, të cilën sllavët në hapësirën e sotme të Malit të Zi e rimorën nga goja e shqipfolësve.

⁷² Hamid Hadžibegić, Adem Handžić dhe Ešref Kovačević, Oblast Brankovića, Opširni katastarski popis iz 1455. godine, Orijentalni Institut u Sarajevu, Sarajevo 1972.

Në të mirë të kësaj që u tha më sipër, sidomos në dritën e konkludimit të pranuar gjithandej se përkatësia gjuhësore e emrit/antroponimit nuk e nënkupton edhe përkatësinë etnike të bartësit të atij antroponimi, sidomos tek etnitë [shqiptarët, vlleht dhe romanët e brigjeve të Adriatikut] që u pushtuan nga sllavët ardhës kisha e pushteti i të cilëve u imponoi edhe antroponimë sllave. Thënë ndryshe, edhe nëse emri Hot është me prejardhje sllave, kjo nuk do të thotë se edhe bartësit e këtij emri ishin sllavë. Ndryshe nga van Wijk, gjuhëtari rumun E. Petrovici⁷³ ishte i bindur se [në kuadër të tezës për autoktoninë e rumunëve në hapësirën e sotme etnike-gjuhësore të tyre] popullata josllave që gjeografikisht i ndante serbët e bullgarët nuk ishte romane porse shqiptare. E përkufizuar thjesht gjeografikisht, kësaj teze do t'i dilte krah rrethana që vetë emri *Lim* i lumit të madh të këtij regjioni është me prejardhje shqipe. Mendimin e kësaj lloji kishte shfaqur i pari qysh sllavaisti zulmëm madh Fr. Miklosich dhe e kishin tumirë edhe indoeuropeistë, sllavistë⁷⁴ e albanologë. Të gjithë janë pajtuar se emri *Lim* i lumit rrjedh nga fjala *lymë* ose *lumë* i shqipes.

Nga emërtime të sajura nga magjja e leksikut të shqipes këtu mund bjerë gjithsesi edhe emri i lumit të vogël, degë e Moraçës, të cilin shqipfolësit e shqiptojnë si *Cem*,-i, ndërsa sllavishtfolësit si *Cijevna*. Dëshmia më e vjetër e emrit të këtij lumi rrjedh nga viti 1278 kur në zonë të këtij lumi të vogël *Cêmvî* ose (shq.) *Cem*, përmenden kopetë e bagëtive të shqiptarëve, për të cilët M. Šufflay⁷⁵ shkruante “Sikundër mund të shihet nga turmat kompakte të shqiptarëve në afërsinë e Raguzës dhe Kotorit në shek. XIII, këtu kishte kudo edhe mbeturina ilire autoktone, të shkëputuna nga bërthama shqiptare”.

Ka jo pak arsye të paravendohet që e shqipes do të jetë edhe trajta *Cemva* e emrit të këtij lumi, e shënuar në v. 1313-1318 në Krisobulën e

⁷³ sh. Istoria poporului român aglindită în toponimie, Studi de dialectologie și toponimie, București, 1970, f. 242.

⁷⁴ khs. psh. Ivan Popović, Bemerkungen über die vorslavischen Ortsnamen in Serbien, në Zeitschrift für slavische Philologie Bd. XXVIII, Heidelberg 1960, f. 113, për të cilin ky dijetar thotë se është një huazim që në sllavishten ka hyrë pas ngulitjes së sllavëve në hapësirën etnolinguistike të shqipes dhe se [prandaj] në këtë rast s’kemi të bëjmë me ndonjë hidronim të periudhës parasllave.

⁷⁵ Serbët dhe Shqiptarët, Prishtinë, 1968, f. 61.

Banjskës. [khs. "dhe ja megjet e Dinoshës nga Cemva ..." dhe më 1330 në Krisobulat e Deçanit khs "katundi në Zetë Kushevë dhe kufiri ... dhe në maje të Gunicës dhe në maje të Bukovikut dhe Tum(b)ën e Çermenikës dhe përtej në Cemvë".⁷⁶ Si në këto, ashtu edhe në tjajtën e sotme *Cem*, -i të shqipes, përmbahet fjala shqipe *cem*, -i "përrua malor me ujë shumë të ftohtë e të kulluar" khs. edhe shprehjen *cema e kroje* dhe⁷⁷ mbiemrin shqip (i, e) *cemtë* "shumë i ftohtë e i kthjellët".

Se emrat shqip të dy lumenjve më të njohur të kësaj zone të banuar nga shqiptarë, e pra, edhe nga pjesëtarë që e mbajnë veten të fisit të Hotit, nuk janë emërtime të vendosura nga shqiptarë ardhës, porse nga shqiptarë vendës që në këto hapësira ishin edhe në kohën e kontakteve të shqipes me latinishten ballkanike e tregon edhe toponimi *Fundëna* i dalë me ndërmjetësimin e shqipes nga lat. *fontānus*, a, um "burim, gurrë; i, e burimit, gurres" (për prejardhjen latine khs. emrin e vendbanimit *Funtana* në rrethina të Poreçit në Istri) e të tjerëve në hapësirën e Malit të Zi të sotmit.⁷⁸

Autoktonia e shqiptarëve [pa e pas mohuar edhe elementin etnik roman-ballkanik, përkatësisht vllah] bëhet më e kuptueshme edhe nga trajtesa përkitazi me institucionin e fisit. Dihet se, deri më tani, tek sllavët ardhës në Jug të Ballkanit, nuk është shënuar as edhe një rast që në mesin e tyre të ketë pasur ndonjë fis apo vëllazëri që do të quhej Hot. Kjo, ndoshta, sepse sllavët, përkatësisht serbët ishin organizuar kryesisht në bazë territoriale e jo në bazë të përkatësisë me gjak ndonjë vëllaznie apo me diç të ngjashme me institucionin e shqiptarëve e, pjesërisht, edhe të malazezëve të fisit. Kjo shihet mbase fort mirë në bazë të studimit të historianit të mirënjohur serb St. Novaković. Nga trajtesa e tij e gjatë përkitazi me titujt e me gradat bizantine tek sllavët/serbët, ai vërente se institucioni i katunit, përkatësisht i vëllaznisë nuk ka të bëjë asgjë me organizimin e kryer-shëm social të sllavëve ardhës. Nga trajtesa e tij rezulton se emrat e institu-

⁷⁶ khs. origj. "A se megje dinoši ot cem've" tek Lj. Kovačević, Svetostefanska hrisovulja, f. 5 dhe : "Selo u zetë kuševo ... a megja ... i na vr̃hъ gunica i na vr̃hъ bukovika. i na gomilu čemer'nika. i p̃reko u cēm'vu ...", tek Dečanske hrisovulje ... f. 120.

⁷⁷ sipas Fjalor i shqipes së sotme, Tiranë, 1984, f. 134.

⁷⁸ khs. për këtë tek Idriz Ajeti, Contribution à l'étude de l'origine de quelques toponymes du Montenegro, Akten des internationalen Kolloquiums (Zum Gedächtnis an Norbert Jokl), Innsbruck, 1972, f. 677-687.

cioneve të popullatës indigjene, përkatësisht të shqiptarëve e të vllahve, sllavët i njohën vetëm në variantet e tyre bizantine, pas pushtimit të hapësirës së sotme të Kosovës e viseve të tjera të banuara me shqiptarë përbrenda Gadishullit të Ballkanit dhe nënshtrimit të katuneve, pasi që vendësve ua kishin marrë me dhunë bjeshkët, e rrallë ndonjëherë i kishin blerë - siç është rasti me bjeshkën e Ujeznës, të cilën sundimtari e kishte blerë për 100 dele me gjithë qingja. Khs. për këtë tekstin “Dhe mbretëria ime ia dha kishës së Pandokratit (S. G. Manastirit të Deçanit) bjeshkët që janë sipri Deçanit, gjithë atë që ka mbetur sipas krisobulës së Malit të Shenjtë dhe atyre të qytetit (S. G. = të Deçanit?) gjithashtu e bleva Ujeznën për 100 dele (bashkë) me qingja dhe gjithashtu i vendosa (S. G. i bëra bashkë) me bjeshkët e Altinit dhe ua caktova kufinjt të gjitha atyre bjeshkëve të Malit të Shenjtë e të qytetit dhe në ato bjeshkë të mos ketë metoh as bujari as vllahu e as arbanasi”⁷⁹ dhe këto dy popullata ishin bërë pronë e kishave e manastireve serbe dhe e sundimtarëve lokalë. Novaković konstatonte se “Në kohën e vendosjes në Gadishullin e Ballkanit, fiset sllave e serbe ishin të pacivilizuara, gati-gati të egra. Edhe sa u bie nevojave dhe pozitës së tyre i gjithë strofulli zjapila midis tyre dhe botës greke-romake me të cilat binin në kontakt që nga vendosja e tyre në Gadishullin e Ballkanit. Ardhësve të rinj nuk u duhej asgjë nga ajo masë pikëpamjesh e institucionesh [S. G. të Bizantit] dhe e gjithë kjo rridhte nga doket atje ku ata ishin më të fuqishëm.” Nga kultura greke-romake - thotë autori ynë - “U ruajt ajo që këtyre [S. G. sllavëve] u duhej, sipas ligjeve psikologjike të ndikimit të civilizimeve më të përsosura mbi këta gjysmë të egjër. Zbutja e tyre përmes kishës dhe mjeteve të tjera ecte ngadalë. Deri atëherë kur ndër ardhësit sllavë e serbë u lind rendi deri dikund më i zhvilluar shoqëror e shtetëror, këtyre as që iu deshtën asnjëri nga institucionet përmes të cilave ai rend u ruajt dhe vazhdoi të aplikohet në Perandorinë e Bizantit. Ato baza të rregullimit shoqëror e shtetëror që u duheshin kolonëve të rinj në župa [S. G. “bashkitë e katundeve”] dhe në katunde u ruajtën për kohë të gjatë sipas dokeve po-

⁷⁹ origj. “I da kralje v’stvo mi pan’dokratorou planine koje sou nadъ dëčanou. v’së što je ostalo za hrisovouljemъ svetogor’skimъ i gradъč’kimъ. toungjere koupihъ oujezdnou za r (S. G. = 100) ov’cъ sъ jagnъci i takogjere smëstihъ s al’tin’skimi planinami. i oumeždihi tezi v’së planine s’mëgjami svetogor’skimi i gradъč’kimi i ou tēh’zi planinahъ da ne meteha ni vlastelinъ ni vlahъ ni ar’banasinъ” [tek Decanske Hrisovulje, f. 55-56.

pullore të vjetra. Kuadri suprem shtetëror ishte në duarë të Konstantinopojës, ky porse nuk u shtri më larg se në qytetet e Bregdetit [S. G. që banoreshin nga autoktonë të romanizuar e romanë të mirëfilltë] dhe qendrave të mëdha e rrugëve të pushtetit ushtarak e shtetëror të Konstantinopojës. Në treva të gjera malore përbrenda kufijve që, në gjithë Gadishullin e Ballkanit “barbarët” jetonin me vetveten, pakherë duke e dëgjuar (sidomos kur ishin të mundur e të ndjekur) dhe më shumë duke mos e dëgjuar pushtetin superior të Konstantinopojës.”⁸⁰

Me këtë ka lidhje edhe rrethana që antroponimi *Hot* [me përjashtim të tri qyteteve të Dalmacisë] në brendinë e Gadishullit të Ballkanit, përka-tësisht në hapësirën etnolinguistike të shqiptarëve [në të cilën deri në të nisur të shek. XV kishte dhe katune të vllahve], ndeshet vetëm në katune, vendbanime të përkohshme, të barinjve shqiptarë. E, për institucionin e katunit “bjeshkë” e një vëllaznie, St. Novaković thoshte se “përveç katundit, si bërthamë e organizimeve sociale e fisnore të sllavëve, fiset e sllavëve të Gadishullit të Ballkanit dinin edhe për *župa*-n, bashkinë e më shumë katundeve, të lidhura për ndonjë luginë ose trevë gjegjëse, të rrethuar me kodrina. Vetë plastika e tokës, një luginë lumi me shumë rrjedha më të vogla të lidhura ngusht me atë të parën sajonte *župa*-n dhe e ndante atë me lartësira përreth nga *župa*-t e tjera”. Sipas këtij dijetari rezulton se sllavët e ardhur nuk dinin për katunin, sepse, siç na mëson ky, “viset malore me kullota në të cilat jetohej vetëm gjatë verës në kasolle - çfare kishte nëpër të gjitha bjeshkët e Gadishullit të Ballkanit -, *nuk kishin emra sllavë porse, në të gjitha gjuhët e Ballkanit, quheshin thjesht katune*. [nënv. im]”.⁸¹ Prej këndeje lejohet të nxirret përfundimi që sllavët ardhës nuk e sollën me vete as blegtorinë transhumane e pra as vetë termin *katun* porse këto i gjetën tek popullata vendëse [pasardhëse e ilirëve dhe e trakasve të romanizuar] apo fjalën *katun* e huazuan me ndërmjetësimin e greq. së mesme, dëshmia më e mocme e së cilës, në bizantinishten, rrjedh nga shek. XI kur në veprën Strategikon të Kekaumenit përmendet disa herë nocioni *κατοῦνα, κατοῦν-εύειν* me kuptimin “*tbanë ushtarake dhe tbanë banimi*”.

⁸⁰ sipas, St. Novaković, Vizantijski Činovi i Titule u Srpskim Zemljama XI-XV Veka, Glas Srpske Kraljevske Akademije 78, drugi razred 47, Beograd, 1908, f. 179-180.

⁸¹ Vizantijski Činovi i Titule u Srpskim Zemljama XI-XV Veka, Glas Srpske Kraljevske Akademije 78, drugi razred 47, Beograd, 1908, f. 183-184.

Shtirirja gjeografike përkatësisht kufizimi pikërisht pothuaj se vetëm në atë region i antroponimit Hot-i në të cilin kjo vëllazni u zgjerua me pasardhës sikur flet, megjithatë, se vëllaznitë shqiptare që e mbajnë veten për të fisit Hot mund të jenë rezultat i lëvizjes së tyre përbrenda territorit të vet etnolinguistik të katuneve e të katundeve të vllshve e të shqiptarëve. Kështu mund të shpjegohet në rend të parë dëshmimi (vetëm) një herë në hapësirat e Kosovës së sotme [khs. *Tudoric-i dhe i biri Hotilo* ndër *vllsh Tudoričevci* = sot Turiçevc në komunën e Skënderajt në v. 1330] në një ambient vllshsh. Këtij fakti i del krah edhe rrethana që emri *Hot-i* dëshmohej vetëm një herë në regjistrimin osman-turk të kryefamiliarëve në vitin 1485 dhe asnjëherë në atë të v. 1455 - regjistrime këto që e mbulojnë pothuaj gjithë hapësirën etnolinguistike të shqiptarëve të shek. XV. Ata që këtë punë mund ta dinë më mirë bën ta shkoklojnë mundësinë nëse emrat *Hoco*, ardhacak dhe *Stepan Hoce* - kryefamiliarë në kat. Nerodime të Ferizajt që janë evidentuar në v. 1455,⁸² mund të jenë variante të emrit Hot?

Kujtoj se mbetet detyrë e albanologëve dhe e balkanologëve të kallxojnë përse në gjuhën shqipe fjala *katun* nuk është ruajtur për ta shenjuar tbanin, vendbanimin e barinjve - siç e kanë [gjithandej për fjalë të huaj] të gjithë sllavët e Ballkanit dhe ata të Europës Qendrore e madje edhe rusët si edhe në bizantinishten e shek. X - porse është sinonim me fjalën *fshat*, të huazuar nga lat. *fossatum*.

Me këtë rast shprehi padurimin tim që sa më parë të dalë në dritë studimi *Miti i Hotit* të cilin (siç njofton Pantheon Info e 27 shkurtit 2017), autori shqiptar Kolec P. Traboini e paska ofruar për botim.

⁸² sh. Oblast Brankovića ..., f. 122.

Bahri BECI, Paris

RRETH PIKËPAMJEVE PËR HISTORINË E STRUKTURËS DIALEKTORE TË SHQIPES

Historia e formimit të strukturës dialektore të shqipes është një nga fushat më pak të studiuara të gjuhësisë shqiptare. Kjo për arsye të mungesës deri vonë të studimeve sistematike për të folmet e shqipes, për shkak të dokumentimit të vonë të shqipes, po edhe për shkak të vështirësive që paraqet në vetvete studimi i historisë së strukturës dialektore të shqipes.

Në etapën e parë të studimeve dialektologjike, po edhe më vonë, vemendja e studiuarve ka qenë përqendruar në përcaktimin e vjetërsisë së formimit të dy krahinave dialektore të shqipes, të krahinës dialektore të Shqipërisë së Veriut ose gegërishtes dhe të krahinës dialektore të Shqipërisë së Jugut ose toskërishtes.

Lidhur me vjetërsinë e formimit të dy krahinave dialektore të shqipes, në studimet e derisotme janë vënë re dy qëndrime.

Autorë si J. G. Hahn, G. Meyer (me rezervë), B. Beci dhe Sh. Demiraj e kanë pranuar vjetërsinë e formimit të dy dialekteve të shqipes, kurse autorë të tjerë si N. Jokl, K. Taliavini, E. Çabej, V. Polak, A. V. Desnickaja, I. Ajeti, J. Gjinari etj., nuk e kanë pranuar vjetërsinë e formimit të tyre. Ata, edhe pse pranonin vjetërsinë e disa dukurive kryesore dialektore të dy dialekteve të shqipes, kanë mbrojtur pikëpamjen se degëzimi dialektor i shqipes në gegërisht e toskërisht është *relativisht i ri*.

“Mendimin se degëzimi dialektor i shqipes në gegërisht e toskërisht është relativisht i ri, shkruante E. Çabej, mendim që i ka burimet te Gustav Meyeri e te N. Jokli besoj ta kem përforcuar dhe në pika të veçanta, ta kem çuar më tej e pjesërisht ta kem dhe modifikuar”.

A. V. Desnickaja, duke ju referuar Rr. Zojzit, ka shkruar se "shekullit XVII i përket formimi i të dy grupeve të mëdha që kanë marrë emrin *Gegëri* dhe *Toskëri*. Procesin e përgëndrimit të tokavet Rr. Zojzi e lidh krijimin në shekullin XVIII të *dy shteteve feudale* - pashallëkut të dinastisë së Bashatëvet në veri të Shqipërisë dhe i Ali-Pashë Tepelenës - në jug".

Po kështu edhe J. Gjinari ka shkruar se aty nga fundi i shekullit XVIII dhe fillimi i shekullit XIX erdhën e u dalluan dy ndarje të mëdha krahinore, *Toskëria* në Jug dhe *Gegëria* në Veri, që përbëheshin nga njësi të tjera krahinore më të vogla.

Në dallim prej studiuesve të mësipërm J.G. Hahni e shpinte formimin e dy dialekteve të shqipes në rrethanat e kohës antike duke e lidhur me ilirishten dhe epirotishten. G. Meyer në lidhje me këtë pikëpamje të J.G. Hahnit, ndër të tjera ka shkruar se "kjo është e mundshme, madje do të thoja që ka gjasë të jetë, por nuk është aspak e provuar".

Për vjetërsinë e formimit të dy dialekteve të shqipes, edhe ne, ndër të tjera, më 1974 kemi shkruar që tiparet e pranuara prej nesh si veçori dalluese të dy dialekteve të shqipes janë të vjetra, të periudhës para sllave, "gjë që do të thotë që edhe ndarja e shqipes në dy dialekte është e kësaj periudhe".

Më 1979 kemi shtuar se "kalimi i n -së në r në toskërishte, si edhe tiparet e tjera dalluese të dy dialekteve të shqipes, i përkasin fundit të periudhës antike ose Mesjetës së hershme, kështu që edhe ndarja e shqipes në dy dialekte është e kësaj periudhe".

Edhe Sh. Demiraj, duke folur për dallimet dialektore të shqipes të pranuara prej tij, më 1999, ndër të tjera ka shkruar se "stërgjyshërit e folësve të dialektit verior dhe jugor të shqipes kanë qenë të pranishëm në trevat e tyre të sotme në periudhën *pasromake* dhe *parasllave*", kohë në të cilën, sipas tij u formuan dy dialektet e shqipes.

Po më shumë se pikëpamjet për historinë e formimit të dy dialekteve ne këtu na interson të dimë se cilat janë pikëpamjet e studiuesve të dërsotëm për historinë e formimit të strukture dialektore të shqipes në përgjithësi.

I vetmi që është marre me shpjegimin e historisë së formimit të strukturës dialektore të shqipes në përgjithësi është J. Gjinari.

Sipas tij në shek. V-VII-VIII dy dialektet e shqipes *po merrnin formë* (pra, nuk ishin formuar, po po merrnin formë)

"Proceset ekonomiko-shoqërore që zhvillohen sidomos në *pesë shekujt e fundit* në grupet e ndryshme të bashkësisë shqiptare etnike, shkruante J. Gjinari, *thellojnë mëtej ndarjen e dy dialekteve* dhe u japin dalëngadalë formën *degëzimeve më të voga dialektore* që arritën deri në ditët tona.

Disa dukuri dialektore, që zhvillohen në këtë periudhë, shtrihen duke mbuluar *gjithë territorin e një dialekti*, disa të tjera vijnë e bëhen *tipare të nëndialekteve*, disa të *grupeve të të folmeve* e disa të tjera *tipare të veçanta të të folmeve*.

Me lindjen e këtyre tipareve brenda gegërishtes marrin formë dy variante që ndahen gjeografikisht te lumi Mat: *gegërishtja veriore* dhe *gegërishtja jugore*, kurse brenda toskërishtes kristalizohen më tej *toskërishtja jugore e toskërishtja veriore*».

Sipas Gjinarit "Relativisht të reja, të këtyre dy-tre shekujve të fundit, janë edhe disa veçori dalluese dialektore që ndajnë sot grupet e të folmeve, grupin e gegërishtes veriperëndimore, grupin e gegërishtes verilindore, grupin e gegërishtes qendrore dhe labërishten e çamërishten".

Përfundimi në të cilin arrinte është "Kjo ndarje dialektore e gjuhës shqipe dhe kjo ndarje krahinore e popullit tonë morën formën që kanë sot aty nga fundi i shekullit XVIII dhe fillimi i shekullit XIX para Lëvizjes sonë Kombëtare. Në këtë kohë erdhën e u dalluan *dy ndarje të mëdha krahinore*, Toskëria në Jug dhe Gegëria në Veri, që përbëheshin nga njësi të tjera krahinore më të vogla. Nga pikëpamja gjuhësore në këto dy zona dalloheshin dy ndarje të mëdha dialektore: *gegërishtja në Veri dhe toskërishtja në Jug me nëndarjet e tyre*".

Pra, sipas Gjinarit, njësitë dialektore të shqipes, dialektet, nëndialektet dhe grupet e të folmeve janë krijuar njera pas tjetrës në hapësirë, dialektet mbrenda hapësirës ballkanike të shqipes, nëndialektet brenda hapësirës së dialekteve dhe grupet e të folmeve brenda hapësirës së nëndialekteve, pa dalë jashtë kufijve të tyre. Kjo për ne do të thotë se J. Gjinari, në thelb, pranonte që historia e formimit të strukturës dialektore të shqipes është rezultat i një ndarjeje suksesive a të njëpasnjëshme të shqipes dialek-

tore në hapësirë, fillimisht në dialekte, pastaj të secilit prej tyre në nëndialekte dhe e secilit nëndialekt në grupe të folmesh.

Një qëndrim i tillë na duket se e ka futur në impasse a bllokim shpjegimin e historisë së formimit të strukturës dialektore të shqipes sepse paraqipton një ndarje suksesive a të njëpasnjëshme të strukturës dialektore të shqipes jo vetëm në hapësirë, po edhe në kohë, çka do të thotë, se fillimisht a në një kohë të parë, janë formuar dy dialektet e shqipes, pastaj, në një kohë të dytë secili dialekt është ndarë në nëndialekte dhe pas tyre, në një kohë të tretë, secili nëndialekt është ndarë në grupe të folmesh.

Mirëpo, a është e mundur të përligjet një ndarje e njëpasnjëshme a suksesive në hapësirës dhe në kohë e shqipes dialektore, fillimisht në dialekte dhe pastaj, e secilit dialekt në nëndialekte dhe e secilit nëndialekt në grupe të folmesh, kur dihet se shkaku themelor i formimit çdo njësie dialektore dhe i shfaqjes së karakteristikave gjuhësore specifike tek secila prej tyre është prania për një kohë pak a shumë të gjatë, brenda territorit të secilës prej tyre, e lidhjeve politike, ekonomike e kulturore që kanë favorizuar komunikimin e popullsisë së atij territori?

Pra, a ka mundësi që lidhjet politike, ekonomike e kulturore që kanë favorizuar formimin e njësisë dialektore të shqipes në terriore të caktuara të jenë shfaqur ose realizuar në mënyrë të njëpasnjëshme (suksesive) në kohë, pra, fillimisht në terrioret e dy dialekteve të shqipes, pastaj në terrioret e nëndialekteve të tyre dhe së fundi në terrioret e grupeve të të folmeve?

Për mendimin tonë është e pamundur të kenë ekzistuar zhvillime ekonomike, shoqërore e politike të njëpasnjëshme (suksesive) të tilla që ta kenë ndarë hapësirën ballkanike të shqipes fillimisht në dy hapësira të mëdha që mbulojnë dy dialektet dhe pastaj secilën prej tyre në hapësira më të vogla që mbulojnë nëndialektet e shqipes dhe së fundi në hapësira akoma më të vogla a nënhapësira që mbulojnë grupet e të folmeve.

Besoj se edhe kaq mjafton për të pohuar se problemi i "gjenezës" dhe i "moshës" së këtyre dialekteve, si edhe i bazave historike të ndarjes e degëzimit të tyre më tej mbetet i hapur dhe pret zgjidhje në të ardhmen.

Bibliografi

- A. V. Desnickaja, *Gjuha shqipe dhe dialektet e saj*, Prishtinë, 1972 (originali rusisht: *Albanskij jazyk i ego dialekty*, Leningrad, 1968).
- Beci, *Mbi katër inovacione fonetike të të folmeve të Gegënisë së Mesme*, "Konferenca e parë e studimeve albanologjike", Tiranë, 1965.
- B. Beci, *Diskutim rreth kumtesave të G. Bonfantës dhe R. Ismajlit*, "Kuvendi i studimeve ilire" II, Tiranë, 1974.
- B. Beci, *Dialektet e gjuhës shqipe dhe lashtësia e tyre*, Shkenca dhe jeta, 5, Tiranë, 1979.
- B. Beci, *Lashtësia e dialekteve të shqipes - dëshmi e vendbanimit të hershëm të shqiptarëve*, "Studime filologjike", 3, Tiranë 1982.
- B. Beci, *Vendbanimi i hershëm i shqiptarëve në dritën e të dhënave të dialektologjisë sonë historike*, "Ilyria", 1, Tiranë 1986.
- B. Beci, *Dialektologjia historike shqiptare për kohën dhe vendin e formimit të gjuhës shqipe dhe të popullit shqiptar*, "Gjurmime albanologjike", 22, Prishtinë, 1993.
- Beci, B. *Rreth historisë së formimit të strukturës dialektore të gjuhës shqipe*. Në "Seminar i XVIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare", Tiranë, 1996.
- B. Beci, *Dialektet e shqipes dhe historia e formimit të tyre*, Tiranë, 2002.
- C. Tagliavini, *La lingua Albanese*, "Studi albanesi", V-VI, 1935-1936.
- E. Çabej, *Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe*, "Buletin i Universitetit shtetëror të Tiranës", SSHSh, Tiranë 1963, 3. Shih edhe "Studime Gjuhësore", IV, Prishtinë, 1977.
- E. Çabej, *Disa faza të moçme të shqipes në dritën e gjuhëve fginje*, "Revistë shkencore e Institutit Pedagogjik të Shkodrës", I, Shkodër 1964.
- G. Meyer, *Della lingua e della letteratura albanese*, "Nouvo Antologia", 50 1885.
- I. Ajeti, *Rreth disa tipareve gjuhësore të ligjërimeve shqiptare të Kosovës*, "Gjurmimi Albanologjike", 1? Prishtinë, 1969. Shih edhe "Kërkime gjuhësore", Prishtinë, 1978.
- J. Gjinari, *Dialektologjia shqiptare (dispensë)*, Tiranë 1963.
- J. Gjinari, *Për historinë e dialekteve të gjuhës shqipe*, "Studime filologjike", 4, Tiranë 1968.
- J. Gjinari, *Struktura dialektore e shqipes e parë në lidhje me historinë e popullit*, "Konferenca kombëtare e studimeve etnografike", Tiranë 1977 (botuar më parë në "Studime filologjike", 3, Tiranë 1976).
- J. Gjinari, *Dëshmi të historisë së gjuhës shqipe për kohën dhe vendin e formimit të popullit shqiptar*, "Studime filologjike", 3, Tiranë 1982.
- J. Gjinari, *Dialektologjia shqiptare*, Tiranë 1988.
- J. Gjinari, *Dialektet e gjuhës shqipe*, Tiranë 1989.
- J. Gjinari, Gj. Shkurtaç, *Dialektologjia*, Tiranë, 1997.
- J. Gjinari, Gj. Shkurtaç, *Dialektologjia*, Tiranë, 2013.

N. Jokl, *Albanisch*, "Geschichte der indogermanischen Sprachwissenschaft seit ihrer Begründung durch Franz Bopp", II, III, Strasburg 1917.

Sh. Demiraj *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë 1988.

Sh. Demiraj, *Prejardhja e shqiptarëve nën dritën e dëshmime të gjuhës shqipe*, Tiranë, 1999(ribotuar më 2015 me titullin *Prejardhja e shqiptarëve përmes dëshmime të gjuhës shqipe*).

Ragip MULAKU, Prishtinë

PROF. IDRIZ AJETI PËR ORIGJINËN ILIRE TË GJUHËS SHQIPE DHE TË POPULLIT SHQIPTAR

Në qendër të historisë së popujve të Ballkanit e të gjuhëve të tyre tash e dy shekuj e gjysmë mbizotëron problemi i origjinës së popullit shqiptar e bashkë me të edhe i gjuhës shqipe”i vendit të lashtë të formimit të saj dhe i atdheut të kryehershëm të etnisë shqiptare”. Kjo çështje me peshë të madhe me të drejtë është objekt studimi i shkencave multidisiplinare ballkanike e sidomos i atyre albanistike, sepse është e ndërthurur ngushtë me prejardhjen e popullit shqiptar dhe të gjuhës shqipe. Si e tillë, ajo ka tërhequr vëmendjen e dijetarëve (gjuhëtarëve, historianëve e etnologëve), të cilët brenda saj përpiqen të ndriçojnë edhe çështjen se a jemi ne shqiptarët e sotëm autokton në trojet tona që nga perioda antike (greko-romake) dhe po ashtu, a jemi ne stërnipër të ilirëve të vjetër, pra a ka vazhdimësi mes ilirëve dhe shqiptarëve dhe, në këtë kontekst, a është gjuha shqipe pasardhëse e ilirishtes apo e një gjuhe tjetër?! Si një çështje që ka të bëjë, në njërin anë, me historinë e vjetër të popullit tonë e, në anën tjetër, me historinë e lashtë të gjuhës shqipe, gjë kjo që lidhet pashmangshëm edhe me trojet tona në gjerësinë gjeografike të Ballkanit, prandaj me ndriçimin e saj janë marrë një varg shkencëtarësh, të huaj e shqiptarë, ndër ta edhe prof. I. Ajeti, i cili me maturi dhe me akribi të rreptë shkencore, të mbështetur kudoherë në të prova e argumente, që bazohen në rregullat e fonetikës së gjuhës shqipe. Prof. I. Ajeti me një punë sistematike, ka përforcuar tezën e etnogjenezës sonë prej ilirëve e të gjuhës shqipe prej ilirishtes dhe kështu u është kundërvënë me fakte të reja e të qëndrueshme mendimeve destruktive e tendencioze të disa pseudoshkencëtarëve serbë të dekadave të fundit, të cilët në rrethana specifike, duke harruar qëndrimet e mëhershme të stu-

diuesve sllavë, tani ngrihen kundër autoktonisë sonë në Gadishullin Ballkanik dhe kundër çfarëdo lidhjeje tonën me popullin e lashtë ilir.

Pikëpamjet e prof. I. Ajetit për etnogjenezën e popullit shqiptar dhe për origjinën e gjuhës shqipes i ka shfaqur kaherë në vështrimet e tij gjuhësore, siç janë: *“Për të vërtetën shkencore”, “Mbi origjinën ilire të gjuhës shqipe”, “Autoktonia e shqiptarëve nga pikëpamja linguistiko-historike”, “Autoktonia e shqiptarëve të Kosovës në dritën e të dhënave gjuhësore”, “Shqiptarët e gjuha e tyre”, “Vrojtime mbi formimin e popullit shqiptar dhe të gjuhës së tij”, “Vështrim i shkurtër i punës në studimet etimologjike të gjuhës shqipe”, “Arritjet kryesore të studimeve etimologjike të shqipes”* etj. të përmbledhura dhe të publikuara në veprën “Për të vërtetën shkencore” më 2006. Bashkë me to prof. Ajeti ka botuar aty edhe disa shkrime nëpërmjet së cilave ka polemizuar me guxim me disa autorë serbë, për arsye se shkrimet e tyre, jo vetëm që nuk kanë mbështetje shkencore, po për më tepër, ato përshkohen me mllef e urrejtje të paparë deri atëherë ndaj etninë shqiptare e ndaj gjuhës shqipe. Ndër shkrimet polemizuese të prof. I. Ajetit, shquhen ato që kanë për bazë dëshmitë e gjuhësisë e të onomastikës historike, sipas së cilave toponimet, hidronimet dhe oronimet e viseve ku sot jetojnë shqiptarët përkojnë plotësisht me zhvillimet e fonetikës historike të gjuhës shqipe dhe vetëm me anë të shqipes gjejnë shpjegim evoluimi i trajtave të hershme antike të emrave: *Naissus, Scupi, Drivastum, Lissus, Dyrrachion, Issamnus, Scampinus, Aulon, Scardus mons, Ragusium, Astibos, Drinus, Mathis, Barbanna, Pirustae/ Perustae* etj. në të sotmet: *Nish, Shkup, Drisht, Lesh > Lezhë, Durrës, Ishëm, Shkumbin, Vlorë/Vlonë, Sharr, Rrush, Shtip, Dri/Drin, Mat, Buenë/ Bunë, Prush > Qafa e Prushit* etj. Ligjësitë fonetike të shqipes dhe kronologjia e tyre i kanë ndihmuar shkencës së gjuhësisë krahasimtare që të shpjegojë, si krijimin e këtyre toponimeve të lashta, ashtu edhe evoluimin e tyre në trajtat e sotme. “Pjesëmarrja e gjuhës shqipe në tërësinë e vlerave të mëdha kulturore të popujve ballkanikë, si trashëgimtare e drejtpërdrejtë e kulturës së lashtë gjuhësore të ilirishtes në arealin gjeografik të Ballkanit, thekson prof. Ajeti, është kudo e hetueshme. Në këtë pikëpamje, gjurmët gjuhësore të shqipes kanë depërtuar në gjuhët e popujve ballkanikë, siç është vërtetuar ndikimi i shqipes në disa të folme fqinjësore të shpërfaqura nga gjuhëtarët sllovenë J. Kopitari dhe Franc Mikloshiçi. Studiuesi Mikloshiçi,

duke u marrë me fonetikën historike të gjuhës shqipe ka përcaktuar edhe aso ligjësish, vlerën e të cilave e kanë vërtetuar edhe krerët e mëvonshëm të albanistikës si rregull dominuese”¹. Në këtë mënyrë, një numër i konsiderueshëm i leksikut blegtoral të gjuhës shqipe, si *katun*, *balgë*, *shllirë*, *bardhoka*, *larëza* etj., kanë depërtuar, thotë Mikloshiçi, në të folmet serbe e malazeze: *katun*, *balega*, *barla*, *bardhka*, *baleshka*, *baloshka*, *balota* etj. Në këtë mënyrë janë shpjeguar edhe disa ngjashmëri leksikore të shqipes e të rumanishtes, të cilat i ka shtjelluar Eqrem Çabej me një metodologji krejtësisht objektive shkencore dhe i ka shpjeguar me të drejtë të hyra nga shqipja në rumanishten dhe të gjitha këto elemente gjuhësore janë në përputhje me rregullat e fonetikës historike të shqipes, shton prof. Ajeti. Linguistët serbë po t’i vështronin këto fakte gjuhësore të shqipes me objektivitetin më të vogël të mundshëm shkencor, të zhveshur sado pak nga nacionalizmi i skajshëm e nga urrejtja që ushqejnë ndaj fqinjëve të tyre, e sidomos ndaj shqiptarëve, ata fare lehtë do të vinin në përfundim se shqiptarët këtu që nga antikiteti janë banues të këtyre trevave dhe kështu edhe pasardhës të pandërmjetshëm të ilirëve. Mirëpo, lakmia e tyre për të pushuar toka të huaja, që ka zënë fill që nga koha e dyndjes së tyre nga ana veriore drejt jugut, drejt tokave të buta e pjellore, ende nuk është shuar, edhe pse askush prej fqinjëve nuk kërkon kthimin e tyre nga kanë ardhur, po si duket ata vetë druhen nga e kaluara e hidhur e popujve ballnikë ç’ prej ardhjes së elementit serb në këto hapësira.

Së këndejmi, në shkrimet e tyre pseudoshkencëtarët serbë, duke harruar se ç’ kishin thënë më parë disa nga dijetarët serbë në lidhje me prejardhjen e popullit tonë dhe të gjuhës shqipe, tani jo vetëm që kontestojnë çfarëdo lidhjeje të popullit tonë me ilirët e moçëm e të gjuhës sonë me ilirishten, po njëkohësisht përpiqen që me çdo kusht ta vënë në dyshim edhe autoktoninë tonë në trojet e ngushta që na kanë ngelur, si pasojë e tkurrjes së vazhdueshme shekullore nga dyndjet e sllavëve nga veriu në trevat ilire. Një fushatë të tillë kundër nesh, pseudoshkencëtarët serbë (historianë e gjuhëtarë) me shkrimet e tyre e kishin ndërmarrë sidomos në periudhën brenda viteve 1981 e deri në luftën tonë çlirimtare 98/99, pra në kohën kur u ushtrua dhunë e egër dhe masakruan civilë shqiptarë në shumë fshatra të Kosovës me qëllim të pastrimit etnik të trojeve tona stërgjyshore.

¹ Idriz Ajeti, *Për të vërtetën shkencore*, Prishtinë, 2006, f. 29-30.

Shovinizmit të paparë të tyre të shfaqur në ato rrethana kundër gjithçkaje që kishte të bënte me etninë shqiptare e me gjuhën shqipe, i kundërvihet me argumente shkencore e me guxim të pashoq, prof. Ajeti. Me reagimet shkencore e plotësisht objektive, prof. I. Ajeti u kundërvihet shkrimeve me prapavijë politike të disa studiuesve serbë, të cilët, pa kurrfarë provash e pa as farë njohurish shkencore mohojnë çfarëdo lidhjesh tona me ilirët e të shqipes me ilirishten në përpjekje për t'i shtrembëruar argumentet shkencore të një vargu dijetarësh të huaj, mbi të cilat ata kishin ngritur doktrinën e tyre mbi origjinën ilire të popullit tonë dhe të shqipes prej ilirishtes. Kështu, në lidhje me fenomenin fonetik të lëvizjes së theksit dhe fiksimit mekanik të tij në rrokjen parafundore në gjuhën shqipe, si në fjalët burimore të shqipes, si në huazimet nga gjuhët e tjera, që është një ndër pesë karakteret konstitutive të shqipes, në një paraqitje të tij historiani Hrabak pyet i habitur: “Si është e mundur të flitet për gjuhën shqipe e për ligjësitë e saj që në kohën romake, kur gjuha është shenjim etnik i popullit, e kurrfarë shqiptarësh nuk mund të ishin formësuar si etnos”popull” në kohën romake, e shembujt krahasues për ilirishten janë nga koha romake”. Dijetarit sllav, Hrabak, të cilit i mungon formimi gjuhësor, sikurse edhe përkrahësve të rrymës së tij, kështu që studiuesi ynë i kundërvihet kështu me kundërpjetje: Po, pyesim ne, si do të quhet gjuha, me siguri e gjallë në kohën romake, në të cilën kalon pikërisht gjithë ai fond leksikor i latinitetit lindor-latin, shtojmë ne: *os ossis - asht, est – është, seculum – shekull, signum – shenjë* etj., nëse nuk emërtohet disi. Si do të studiohet, pra, elementi i tij indoevropian, përkatësisht antik grek, shtojmë ne: *lakhanon – lakër, makhane – mokër/mokën, prason – preshe, kerasia – qershi, pepenon – pjepën* etj., në atë gjuhë”të paqenë”? Duke ndjekur këtë logjikë, shton prof. Ajeti, vijmë tek absurdi se, në qoftë se burimet historike greke, përkatësisht latine, nuk përmenden, atëherë as ka ekzistuar grupi etnik që i ka përdorur këto! Historianit sllav, Hrabak, me shumë shembuj, si: *Scodra – Shkodër, Scupi – Shkup, scarfion – shkarpë, scamnum – shkëmb, scalme – shkallmë* (lloj shpate) etj., prof. Ajeti ia sqaron se grupi konsonantik *sc* i latinishten ka dhënë në shqipen *shk*. Dijetari ynë, po ashtu, e bën me dije Hrabakun se në qoftë se ai si historian nuk kupton lidhjen e toponimeve antike *Malotum* me apelativin shqip *mal* dhe lidhjen *Dimalum* (toponim afër Dubrovnikut) me shprehjen shqipe *Dy male*, linguistët e kanë krejtësisht të qartë këtë afri. “Caktimi i ligjeve fonetike dhe kronologjia e tyre, shton prof. I. Ajeti, na jep dorë t’u vëmë gisht toponimeve të lashta, vendbanime-

ve tona, oronimeve, emrave të maleve dhe të qyteteve të moçme, që i përmendëm më parë. Është konstatuar, thotë prof. I. Ajeti, se shumica e këtyre toponimeve të sapopërmendura janë ilire e zhvillimi i formave të sotme të tyre nga ato të moçmet ka qenë i mundshëm vetëm me ndërmjetësimin e fonetikës historike të shqipes. Gjuhët sllave, me të drejtë, shton prof. Ajeti, janë përjashtuar, sepse në khën e kryerjes së këtij procesi gjuhësor, bartësit sllavofolës të tyre në ato kohë po gjëllinin përtej maleve Karpate”².

Për praninë etnike shqiptare në këto troje, prof. Ajeti në veprën në fjalë shprehet kështu:” Po, është po aq e vërtetë se etnia shqiptare ose parashqiptare që nga koha antike gjëllin në këto troje sot e gjithë ditën. Do të thuhet edhe diçka: këto vise do të quhen vende skajore të formimit të gjuhës shqipe, meqë Kosova që binte në Dardaninë antike edhe ajo ishte pjesë e gjethit të formimit të popullit shqiptar dhe të gjuhës së tij”³ Në këtë vijë kërkimesh qëndron edhe historiani çek Jireçeku, i cili pasi kaloi vite të tëra duke hulumtuar e duke gjurmuar në arkivin e Dubrovnikut, i gjeti shqiptarët që në kohën antike edhe përgjatë bregdetit Adriatik, të cilët, po në atë kohë, në vitet e para të erës sonë përqaftuan fenë e re të krishterë, gjithqysh para dyndjeve sllave që vërshuan në zotërimet e Perandorisë Romake në tokat shqiptare⁴.

Por krejt ndryshe e sheh problemin e popullit shqiptar studiuesi i sotëm serb, Vl. Popoviç, për të cilin prof. Ajeti shkruan kështu: “Njeriu nuk mund të mos tmerrohet, thotë I. Ajeti, përpara ndjenjës së urrejtjes që një shkencëtar me parime e sjellje”demokratike”, njerëzore, ndryn në vete, sikurse provohet te Vl. Popoviç ndaj trashëgimisë kulturore dhe ndaj qenies së popullit shqiptar, vetëm se nuk mund ta shohë të drejtë çështjen e formimit të popullit tonë në trojet etnike të tij, vazhdimësinë iliro-shqiptare, vazhdimësinë e emrit etnik Albanon që nga shek. II i erës së re, për zgjidhjen e të cilave shkenca aktuale shqiptare dha prova të patundshme”⁵

Vështrimet e prof. Ajetit, të publikuara në veprën në fjalë, kanë për temë trajtimi vetëm të vërtetën shkencore në lidhje me etnogjenezën tonë prej ilirëve të moçëm dhe origjinën e gjuhës shqipe prej ilirishtes. Në vështrimet gjuhësore të tij kushtuar çështjes së burimit të gjuhës shqipe e

² I. Ajeti, *vep. cit.*, f. 38.

³ I. Ajeti, *vep. cit.*, f. 38.

⁴ I. Ajeti, *vep. cit.*, f. 38.

⁵ I. Ajeti, *vep. cit.*, f. 39.

historisë së popullit tonë, prof. Ajeti i mbahet me të drejtë tezës ilire që është e një moshe relativisht të madhe, për arsye se ishte ngritur kaherë nga dijetarët më të shquar gjatë më shumë se dy shekujsh, të cilët me prova, fakte e argumente të qëndrueshme i ishin kundërvënë tezës trake, pra një teze relativisht të re e, pa prova të sigurta. Këtu është vendi të sjellim mendimet e dijetarëve më të njohur (të huaj e shqiptarë) të më shumë se dy shekujve të kaluar, të cilët shohin te shqiptarët pasardhësit e ilirëve e te gjuha shqipe bijën e ilirishtes, e të cilat natyrisht i mbështet dhe i plotëson me prova të reja prof. I. Ajeti.

Dijetari që pa i pari origjinën ilire të popullit shqiptar ka qenë Johann Thunmanni, i cili në veprën e tij të vitit 1774 ka shkruar për shqiptarët kështu: "Në historinë e tyre nuk kam gjetur ndonjë gjurmë të emigrimit të mëpastajmë: gjuha e tyre na ka dhënë të tilla dëshmi për fatin e popullit, që unë nuk mund mos njoh te ky fqinjët e Grekëve dhe nënshtetasit e Romës së vjetër. Po të dyja këto më kallëzojnë ilirët". Po kështu është shprehur edhe Hahni, kur thotë: "Meqë burimet megjithëse të vobekta; përveç ardhjes së Sllavëve nuk përmendin ndonjë tjetër, që do të ishte mjaft e rëndësishme për të formuar një popull të madh, mund të pranohet që Shqiptarët e sotëm janë stërnipërit e banorëve anas të vendit".

Në këtë mënyrë edhe Kreqmeri duke marrë për bazë anën gjuhësore shprehet kështu: "Mendimi që gjuha shqipe paraqet fazën më të re të ilirishtes së vjetër, ose si shprehet më matur Gustav Majeri – të një dialekti ilir, është në bazë të të gjitha rrethanave aq afër menç, sa duhej njeriu të sillte arsye shumë të mëdha për ta hedhur poshtë, sepse shqiptarët banojnë atje ku në kohë të vjetra rronin popuj ilirë, dhe i mbajnë këtë vise të paktën që nga shekulli X pas erës së re. E më një tjetër vend ai shfaqte mendimin se jo ata që pranojnë burimin ilir të shqiptarëve duhet ta vërtetonin atë, po ata që e mohojnë".

Sipas këtyre argumenteve historike që i ka parasysht edhe prof. Ajeti në lidhje me këtë problematikë, shihet se shqiptarët nuk dëshmohej se kanë ardhur më vonë në vendbanimet e sotme, më anën tjetër, këtu në kohën e vjetër kanë qenë Ilirët. Këto dy rrethana flasin për një kontinuitet etnik e gjuhësor iliro-shqiptar. Kjo çështje lidhet me autoktoninë e popullit

shqiptar, që mundohen pa fakte ta kontestojnë pseudoshkencëtarët serbë sidomos në tri dekadat e fundit.

Teoria e burimit Ilir të Shqiptarëve, përveç dëshmimeve gjuhësore, ka më vete, siç shihet, edhe arsye të forta historike, nga që Shqiptarët kanë të përbashkët me Ilirët e moçëm truallin e banimit. Prandaj që e natyrshme që kjo teori u shfaq së pari ndër historianë, si Thunmanni, Hahni, Fallmerayeri, e pastaj u vërtetua edhe nga lagjja e gjuhëtarëve.

Në lidhje me origjinën e shqiptarëve e të gjuhës shqipe, në librin e tij, prof. Ajeti sjell edhe qëndrimet e Aleksandër Stipčevićit, sipas të cilit: “Studimi i së kaluarës ilire, ... nuk është siç ka mundur të mendohej ndonjëherë, vetëm e një rrethi të ngushtë ekspertësh, ilirologësh: e kaluara dhe kultura e ilirëve është pjesë përbërëse e historive kombëtare të kroatëve, të malazezëve, të sllovenëve, e pjesërisht edhe të serbëve, dhe, kuptohet, mbi të gjitha e shqiptarëve, për të cilët sot mund të thuhet se edhe shkencërisht është vërtetuar prejardhja e tyre e drejtpërdrejtë nga ilirët e lashtë” – në librin e tij **Ilirët**, të botuar në vitin 1974, në Zagreb, tani të përkthyer edhe në shqip.

Po aty prof. I. Ajeti thekson edhe qëndrimet e Radosllav Katiçiqit, i cili, për problematikën në fjalë thotë si vijon” Në saje të kontributit të gjuhësisë bashkëkohëse krahasimtare, përkatësisht të ballkanistikës, në radhë të parë, shohim se në lidhje me prejardhjen e gjuhës shqipe edhe te gjuhëtarët e shquar shpesh ka pasur përfundime të nxituara. Kjo shkencë, siç dihet, ka dëshmuar se argumentimi kundër prejardhjes ilire të gjuhës shqipe përmes të cilit mendohej se mund të vihej në dyshim mundësia e interpretimit të marrëdhënieve gjuhësore, nuk mund t’i qëndrojë shqyrtimit sado pak kritik që do të bëhej në dritën e të dhënave përkatëse. Nuk ka arsye të bindshme gjuhësore që do të na bënin ta hedhim poshtë prejardhjen ilire të gjuhës shqipe. Kjo, natyrisht nuk do të thotë – shton Katiçiqi – se të gjitha argumentet kundër kësaj prejardhjeje janë të parëndësishme dhe se kjo çështje nuk nxjerr probleme të tjera. Madje edhe vetë hedhja poshtë e këtyre argumenteve ka qenë e dobishme për historinë e gjuhës shqipe dhe për gjithë linguistikën ballkanike. Por, meqë as alternativa tjetër, domethënë prejardhja trakase nuk mund të dëshmohet me kritere gjuhësore, ajo atëherë ka shumë më pak gjasë sa kohë që alternativa ilire të

mos hidhet poshtë me argumente të forta, sepse i gjithë territori gjuhësor i shqipes është pjesë e territorit të dikurshëm të Ilirisë, së paku në bazë të asaj që ka arritur të njohë shkenca deri sot. Kjo gjë në linguistikën bashkëkohëse ballkanike ka marrë vend shumë të rëndësishëm, me të u vunë bazat e mira metodologjike për çdo shqyrtim të prejardhjes së gjuhës shqipe për arsye të pozitës gjeografike dhe pakohë që të mos ketë dëshmi të kundërta, prejardhja ilire e gjuhës shqipe mbetet më e bindshmja”⁶.

Përkundrazi, teoria e burimit trak mbështetet më shumë në kritere gjuhësore sesa historike për arsye se Trakasit gjeografikisht e historikisht kanë banuar kryesisht në Rumani e në Bullgari të sotme, kështu që kësaj teorie i mungon baza gjeografike e historike dhe është më e re sesa teoria ilire.

Me problemin e djepit ballkanik të popullit shqiptar janë marrë përgjithësisht dijetarët rumunë, në krye me Gustav Vajgandin, të cilët mendojnë autoktoninë e shqiptarëve në viset perëndimore të Gadishullit Ballkanik, duke u përpjekur t’i shtojnë në anën lindore, pra më në brendi të Ballkanit. Në hovin e tyre ata janë përpjekur për të zbardhur edhe djepin ballkanik të popullit rumun. Shumica e dijetarëve rumunë të Shqiptarët shohin stërnipërit e Trakasve dhe në gjuhën shqipe bijën e trakishtes, e jo të ilirishtes. Vajgandi mbronte mendimin se në gjeografinë e Shqipërisë ka një prani emrash topikë të huaj të fshatrave. Mendimeve të tilla të Vajgandit, thotë prof. Ajetit, u mungon baza shkencore, sepse vështirimi i toponimeve duhet parë sipas një kronologjie historike, sipas së cilës emrat e fshatrave përgjithësisht kudo në Ballkan janë të një periudhe të re, të vonshme, prandaj nuk mund të merren si dëshmi për të sqaruar gjendjen e vjetër etnike e gjuhësore të kësaj treve. Përkundrazi, për të dëshmuar lashtësinë e një etnie a të një gjuhe, me këtë rast lashtësinë e popullit shqiptar e të gjuhës shqipe, duhet të merren parasysh emrat e qyteteve, të maleve, të lumenjve e të luginave etj., të Shqipërisë së vjetër, siç na i kanë lënë autorët e vjetër grekë e romakë dhe ata të krahasohen me trajtat e tyre të sotme dhe ashtu të shqyrtohen nëse këta janë vazhdimësi e atyre të kahmotshmëve në pajtim me fonetikën historike të shqipes, apo jo. Në mungesë të dokumenteve të moçme të shqipes, dijetarët, si prof. I. Ajeti, Çabej dhe ballkano-

⁶ I. Ajeti, *vep. cit.*, f. 18-19

logët e tjerë u janë drejtuar lidhjeve e kontakteve që ka pasur shqipja në kohën antike e në atë mesjetare me gjuhët fqinje të Gadishullit Ballkanik e të Italisë, pra me greqishten e me latinishten në radhë të parë, e më pastaj edhe me sllavishten e me gjuhët e tjera. Kështu, pra, kur është shtrua problemi i vendit të formimit të shqipes së lashtë, studiuesit kanë gjurmuar huazimet latine në shqipen, veçanërisht ato të sferës kishtarë, si: **Iter, klishë, prift, mëkat, djall, ipeshkv, shpirt, mreku, bekoj** etj., të cilat kanë depërtuar në gjuhën tonë nëpërmjet përhapjes së krishterimit në popullatën bregdetare ilire, veçanërisht në vendbanimet urbane. Huazimet latine të shqipes, duke qenë të një periudhe shumë të lashtë, pra të epokës parahkrimore, si të tilla, dëshmojnë për praninë e etnosit shqiptar qysh moti në viset e sotme të Adriatikut, thekson prof. Ajeti, për arsye se kanë hyrë nga faza e hershme e latinishtes. Ato, vështruar kështu gjuhësisht rezulton se janë në përputhje me rregullat fonetike të shqipes dhe dëshmojnë për praninë e elementit shqiptar qëmoti në viset e sotme bregdetare, që në vijimësi gjëllin edhe sot, kështu që përpjekjet e atyre që djepin tonë të lashtë e shtynë sa më në thellësi të Ballkanit, karakterizohen tendencioze e pa mbështetje shkencore. Fatmirësisht, shqiptarët në vijimësi epokash kanë jetuar dhe gjëllin edhe sot në viset bregdetare të Adriatikut e të Jonit, pra aty ku kanë jetuar fiset ilire, e kjo flet mjaft për autoktoninë tonë në trojet e të parëve tanë – ilirëve, kështu që ka rëndësi të madhe faktori historik, që është në anën tonë, në të cilin duhet të mbështetemi përherë.

Po ritheksojmë se po të vështrohet në këtë mënyrë problematika në fjalë, pra duke i krahasuar trajtat e emrave topikë të lashtë si: *Naissus, Scardus mons, Scupi, Scodra, Lissus, Drivastum, Dyrrachium, Candavia, Astibos, Drinus, Barbana, Mathis, Isamnus* etj., me ndryshimet që paraqesin ata në trajtat e tyre të sotme: *Nish, Sharr, Shkup, Shkodër, Lesh> Lezhë, Drisht, Durrës, Kunavë, Shtip, Dri Drin, Buenë, Mat, Ishm*, si për prof. Ajetin, si për cilindo studiues tjetër, që i mbahet të vërtetës shkencore, është e qartë se këto trajta të fundit janë vazhdim i atyre të parave, për arsye se janë zhvilluar në pajtim me fonetikën historike të shqipes, pra duke kaluar nëpër gojën e folësve të gjuhës shqipe, për faktin se një *s*, përkatësisht një *sk* indoevropiane në shqipen ka dhënë më të shumtën e rasteve *sh*, si në fjalët e fondit burimor të shqipes, ashtu edhe në huazimet greke e latine në shqipen: *sagita: shëgjete, signum : shenjë,*

osten (greq.) e *os ossis* (lat.) shq. *asht-i, est* (lat.) *është* (shq.), *septem* (lat.) *shtatë* (shq.), *prason* (greq.), *presh* (shq.), *kerasia* (greq.) *qersh* (shq.), *seculum* (lat.) *shekull* (shq.), *scamnum* : *shkamb/ shkëmb*, *scala* : *shkallë* dhe si rrjedhojë ato janë të një periudhe më të moçme dhe, si të tillë, paraqesin një shtresë më të lashtë të toponimisë.

Përfundim

Mendimi i prof. Ajetit për prejardhjen e gjuhës shqipe dhe të popullit shqiptar qëndron në këmbë të shëndosha për arsye se përkon me gjykimet e arsyeshme, veç tjerash, edhe të një lagjeje studiuesish ballkanologë: F. Mikloshiç, N. Jokl, P. Skok, H. Bariç, H. Krahe, A. Meje, M. Budimir, V. Georgiev, E. Çabej. A. Desnickaja, I. Popoviç, R. Katiqiç etj. Prandaj, në punën shkencore të tij në lidhje me këtë problematikë të ndjeshme, prof. I. Ajeti është prirë kurdoherë me të vërtetën shkencore, të mbathur me fakte e prova, të përshkuara me punë sistematike që ka bërë gjatë kohë në studimet e tij gjuhësore në fushë të shqipes.

Ethem LIKAJ, Tiranë

AKADEMIK IDRIZ AJETI: MENDIME DHE RISI PËR RASAT E SHQIPES

Në historinë e gjuhës shqipe vepra e akademikut Idriz Ajeti është dhe do të jetë pjesë e plotvlerë e jetës dhe pasjetës së tij. Në këtë fushë studimesh ai në formim, kërkim dhe krijim del si model i gjuhëtarit të kompletuar falë shkollave ku ka studiuar, falë personaliteteve elitare që ka ndjekur; por edhe falë pasionit, dëshirave, vullnetit dhe aftësive të admirueshme të tij. Prandaj ai njihet nga gjithkush si fonetikan, si etimolog, si dialektolog dhe si morfolog, gjithmonë prodhues, i historisë së shqipes. Nga koha dhe vepra akademik Idriz Ajeti shquhet edhe si pasardhës, edhe si paraardhës brezash albanologësh të shquar vendës dhe të huaj.

Kushdo gjen në këtë vepër një burim të gjerë faktesh gjuhësore, mendimesh e zgjidhjesh për problem të ndërlikuara të historisë së gjuhës shqipe. Për më shumë se një shysmë shekulli vepra e akad. Idriz Ajeti u bë një shkollë e gjerë mëkimi dhe studimi për nxënës, studentë dhe studiues.

Probleme të veçanta të fonetikës historike, të etimologjisë dhe të morfologjisë historike të shqipes ishin kapur dhe trajtuar nga indoevropianistë të shquar, por vetëm në kuadrin e projekteve të mëdha ndërgjuhësore, apo të zgjidhjeve të problemeve të veçanta të gjuhës së tyre. Kurse akad. Idriz Ajeti qysh në fillimet e shkrimeve të tij u përpoq t'i parashtronte sistematikisht kategoritë historike gjuhësore të strukturës së shqipes. Mëtimet e tij nuk nuk janë vetëm njohëse, por kërkuese, sepse problemet e morfologjisë historike të shqipes, siç thekson autori, "... kishin mbetë me gjithë gjasë, mbas dore..."¹

Në këtë vështrim, kontributi i parë i autorit në këtë fushë studimesh është synimi i tij që "...në mbështetje të punës së kryeme... krahas me atë

çka mbetet për t'u gjurmue, nuk mund të quhet e pavend përpjekja a rrahja që të bahet një sintezë rezultatesh të përkorta në fushën e morfologjisë historike të shqipes.”²

Në punimet e tij ai ka ndjekur metodën e kalimit nga sistemi morfologjik i shqipes si i tërë, në pjesë të veçanta të tij. Sistemin e ka parashtruar, por nga ky sistem edhe ka veçuar probleme dhe problematika.

Në këto pjesë të veçanta vend me peshë zënë trajtimet mbi sistemin rasor emëror të shqipes. Edhe këtu, si në mjaft punime të tij, theksojmë ecurinë e përvijuar në tri rrafshë: njohje e gjendjes, parashtrim i vështirësive dhe përpjekje për zgjidhje.

Dhe në këto trajtime të veçanta fati i eptimit rasor në tërësi, i burimit dhe zhvillimit të tij, e ka tërhequr vazhdimisht. Qëndrimi fillestar ka qenë pak evaziv. Drejtpërdrejt është bashkuar me mendimin e shumicës së gjuhëtarëve shqiptarë dhe të huaj se shqipja pjesërisht trashëgon eptimin indoevropian, por tërthorë del edhe te ndonjë mendim i kundërt. Ky përfundim del nga thënia: ”Mbaresat nominale kanë lidhje të ngushtë me sistemin e nyjeve të gjuhës shqipe: njëherë sistemi nominal i gjuhës sonë pikënisjen e vet e ka te sistemi i nyjeve që në këtë gjuhë zu të gjinikohet si rezultat i dobësimit dhe i *zhdukjes së plotë të sistemit rasor të periodës indoeuropiane në këtë gjuhë*.”³

Nga kjo thënie dëshirojmë të veçojmë dhe të theksojmë dy ide me shumë interes: lidhjen e ngushtë të nyjave të shqipes me eptimin e pashquar emëror dhe ”zhdukjen e plotë të sistemit rasor të periodës indoeuropiane në këtë gjuhë”, ide, të cilat, për të qenë të vërtetë, njëra më pak e tjetra më shumë, kanë pasur autorë dhe mbështetës edhe më parë. Këto ide intriguese na shtojnë të mundohemi t'i përforcojmë dhe argumentojmë, por edhe t'i zhvillojmë më tej dhe t'i pasurojmë ato me një trajtim të ri.

Për gjuhën shqipe kufizimi i eptimit të mirëfilltë rasor në të gjitha njësitë gjuhësore, që paraprihen prej parafjalëve, i cili duhej të zhvillohej paralel me të, është thuajse i pandieshëm. Edhe më i padukshëm është faktori sintaksor i renditjes së gjymtyrëve. Mjetet e mirëfillta gramatikore, që sendërtojnë kuptimet rasore brenda tipave të lakimit, ose janë reduktuar tërësisht, ose janë kufizuar tejskajshëm.

Për shqipen, por edhe për gjuhët që gjatë historisë kanë zhvilluar kategorinë e shquarsisë dhe të pashquarsisë, një fakt është i njohur edhe i përgjithësuar: kategoria e shquarsisë - pashquarsisë është kategori suksesi-ve; në kuptimin që shquarsia ka ndjekur format pararendëse rasore herë të plota, herë të reduktuara, herë të mënjanuara. Kjo duket qartë te gjuhët, që ruajnë forma analitike për shprehjen e shquarsisë. Mjetet e shquarsisë në këto gjuhë, meqë kanë qenë të veçuara, janë zhvilluar edhe në bashkëlidhje me emrat përkatës, edhe në vetvete. Kurse në gjuhën shqipe, për shkak të pozicionit të tyre të pasvendosur, zhvillimet formale të nyjave kanë ndodhur gjithmonë në bashkëvajtje me emrat. Prandaj ka rëndësi të madhe edhe gjendja e sistemit paradigmatic rasor, që gjeti sistemi paradigmatic nyjor, edhe zhvillimi i tyre i përbashkët, kur u kalua nga gjendja analitike në gjendjen sintetike, d. m. th. kur nyjat iu prapangjitën emrave.

Në tërë paradigmen e lakimit të pashquar dalin vetëm tri mbaresa: *-i*, *-e* dhe *-u*. Por historikisht është provuar se mbaresat *-i* dhe *-u* janë alomorfë. Dhe, në qoftë se nisemi nga mendimi që mbaresat rasore të indoevropianishtes kanë pasur të njëjtin burim, sepse kryenin edhe të njëjtin funksion, atëherë të gjitha mbaresat rasore të sistemit të dokumentuar të shqipes përbëjnë një sistem alomorfesh. Kështu që sistemi rasor i shqipes me katër lakime është pasojë e procesit të alomorfisë.

Fakti gjuhësor që format rasore të emrit janë reduktuar, sidomos në shumësin e shquar dhe në njëjësin e pashquar, ndërsa morfet e së njëjtës morfemë janë shtuar, të shpie në përfundimin se në strukturën paradigmaticke emërore faktorët fonologjikë po marrin përparësi në krahasim me faktorët morfologjikë. Janë pikërisht faktorët fonologjikë që në rrjedhë të kohës kanë vepruar kaq fuqishëm, saqë kanë ndryshuar edhe tipin e lakimit. Lëvizshmëria e strukturave paradigmaticke dhe përgjithësimi i tyre i largon ato nga lidhja me një kuptim gramatikor rasor të qëndrueshëm. Dhe në këto raste vepron parimi i përgjithshëm gjuhësor se: “Në qoftë se gjuha nuk ka nevojë për një formë të caktuar gjuhësore, ajo ose e braktis atë, ose i ndryshon asaj vlerën”.⁴ Për gjuhën shqipe nuk ka nevojë të theksohet se, në qoftë se nuk do të ishin përfutur nyjat shquese, të cilat jo vetëm zgjeruan strukturën ekzistuese të paradigmes, por në mjaft raste u bënë shkak edhe për zhvillime të tjera të njohura fonologjike, paradigma rasore emërore e saj do të ishte më e thjeshtë nga ç’është sot.

Ndryshimet fonologjiko-analogjike, të cilat përgjithësisht kanë njësuar forma rasore brenda një serie paradigmatiche, tërthorë tregojnë se lidhjet sintaksore të emrit nuk po i nënshtrohen formës, por më shumë po bëhen barrë e reksionit foljor. Shembulli i procesit të njësimi të përfunduar plotësisht shihet te asnjansit *të ecurit, të shkruarit* etj. Pyetjes nëse një kuptim rasor i qartë dhe i dallueshëm kushtëzon - detyrimisht dhe gjithmonë - edhe një formë të caktuar rasore, vështirë t'i përgjigjesh me bindje të plotë. Historikisht dihet se kuptime të qarta të rasave të caktuara kanë gjetur shprehje te forma të tjera rasore, megjithëse ato kanë qenë larg njëra-tjetrës.

Karakteristikë tjetër e zhvillimit të sistemit lakimor të shqipes është rënia thuajse e të gjitha mbaresave të hershme të sistemit rasor indoevropian. E vetmja mbaresë e interpretuar nga mjaft gjuhëtarë si vazhdim i një mbarese indoevropiane është ajo e dhanores *-i* dhe *-e*. Megjithatë edhe këtu mendimet ndahen edhe për rrugën e zhvillimeve fonetike, edhe për burimin fillestar të kësaj mbarese. Një gjurmë e tërthorë e një mbarese të indoevropianishtes shihet edhe te mbaresa e kallëzores së shquar *-n(ë)*, e cila, siç është përmendur nga shumë gjuhëtarë, përmban një mbaresë të hershme indoevropiane të kallëzores *-n* (nga *-m*) dhe një shquese të kallëzores *të*, të cilat së bashku kanë evoluar në *-n(ë)*.

Nga ana tjetër, për shkak të përfutimit të lakimit të shquar, mbaresat rasore të sistemit emëror u zhvilluan edhe në vetvete, si mbaresa të së pashquarës, edhe në bashkëndeshje me nyjat shquese, të cilat iu prapangjitën formave rasore paraprirëse.

Mendohet se dukuria e rënies së mbaresave nuk duhet t'i ketë përfshirë të gjitha rasat njëherësh. Mbaresat rasore të emërores, të gjinore dhe të rrjedhores kanë rënë para shfaqjes së nyjave të prapme, sepse, duke iu prapangjitur emrave sipas rasave, do të kishin luajtur një rol mbrojtës. Kurse mbaresat e rasës kallëzore për të trija gjinitë - për gjininë asnjansë edhe mbaresa e emërores - mendohet se kanë rënë pas shfaqjes së nyjës shquese përkatëse.⁵

Veç prirjes së përgjithshme të të gjitha gjuhëve indoevropiane drejt reduktimit të sistemit rasor, do theksuar se në gjuhën shqipe, së paku në dukje, në lakimin e pashquar, nuk është vetëm emërorja dhe kallëzorja e

numrit njëjës që janë barazuar; në të vërtetë, njësimi i mjeteve ka kapur edhe rasat e tjera: gjinoren, dhanoren dhe rrjedhoren e të gjitha lakimeve. Edhe po ta pranojmë si të vërtetë që mjeti i vetëm i rasës dhanore është i trashëguar nga një dhanore apo vendore indoevropiane, para shtrirjes së këtij mjeti edhe në rasën gjinore apo rrjedhore, këto rasa, për një periudhë sado të shkurtër, do të kenë dalë pa mbaresë. E në këtë rast shtrohet pyetja: Në qoftë se rasat përkatëse e kanë humbur mbaresën e dikurshme, përse lindi nevoja që të përvetësonin një mbaresë tjetër të një rase, që ndryshonte mjaft prej tyre edhe kuptimisht, edhe nga ana sintaksore, duke e shtuar barazinë formale me një rrugë të kundërt nga zhvillimet e zakonshme, jo me reduktimin e formave rasore, por me zgjerimin e tyre me mbaresën e dhanores –*i* dhe duke kaluar kështu nga një barazi formale dyshe në një barazi formale treshe: *dhanore* = *gjinore* = *rrjedhore*. Njësimet formale rasore e kanë shoqëruar prej kohësh sistemin morfologjik të gjuhës shqipe, pa u kushtëzuar thuajse asfare nga kuptimet rasore përkatëse. Janë njësuar formalisht madje edhe rasa që kuptimisht janë dalluar dhe dallohen qartë nga njëra-tjetra. Sot dalin njëlloj, por pa mbaresë, emërorja dhe kallëzorja për të gjitha lakimet; por në sistemin përemëror ky njësim ka përfshirë dhanoren dhe kallëzoren (krah. format rasore të theksuar dhe të pathek-suara të përemrave vetorë në dhanore – kallëzore: *mua/ më ~ ty/ të*). Këto lëvizje strukturore në sistemin morfologjik të gjuhës shqipe kanë përfshirë jo vetëm sistemet më të vjetra, por edhe ato më të rejat, në dy lakimet.

Zhvillimet e formave rasore të emrave nuk kushtëzohen vetëm nga lëvizjet e brendshme të fjalëformës, që kanë të bëjnë, siç e kemi theksuar, me natyrën e theksit, me pozicionin e mbaresave brenda fjalëformës dhe me natyrën fonetike të bashkëndeshjeve. Një rol me rëndësi ka luajtur dhe luan edhe reksioni i foljeve; folje të caktuara karakterizohen edhe nga aftësi përcaktuese rasore. Ky kushtëzim mund të vihet re veçanërisht te rasa kallëzore dhe dhanore, formësimi i të cilave varet nga natyra foljore. Ndikimi i kësaj vetie foljore te përemrat vetorë, siç dihet, ka qenë mjaft largvajtës. Për gjuhën shqipe rol vendimtar në zhvillimet rasore ka luajtur përftimi i lakimit binar: lakim i pashquar ~ lakim i shquar. Prapavendosja e nyjës sipas trajtave rasore përkatëse, krijoi një gjendje të re në fundoret e emrave. Prandaj, për të shpjeguar gjendjen e sistemit rasor të sotëm të emrave, duhet vërejtur kronologjikisht dhe krahasimisht edhe gjendja e

sistemit rasor të lakimit të pashquar, edhe gjendja e sistemit të ri paradigmatic të përfutur nga mjeti i ri gramatikor, nga nyja shquese, e cila, për shkak të natyrës formale burimore, del me trajta të ndryshme.


Shqipja e dokumentuar del vetëm me një mjet gramatikor rasor, i cili edhe kështu nuk është gjithmonë i vetëmjaftueshëm, sepse në gjinore dhe dhanore emri mund të përdoret vetëm i paraprirë nga nyja joshquese *një*. Duhet shtuar edhe një fakt tjetër gjuhësor: që në dialekte a në shkrime të tjera format e së shquarës të disa emrave të vjetër të lakimit të parë në gjinore dhe dhanore dalin pa mbaresën e së pashquarës *-i*.⁶ Nga ana tjetër, nuk është shpjeguar askund pse mbaresa rasore e hershme e kallëzores *-n* (*<-m*) u ruajt deri në kohën e prapangjijtjes së nyjës së prapme të kallëzores *-të* (*<-tan*), kurse në rasat emërore, gjinore dhe rrjedhore ato kishin rënë. Madje pohohet pa u vërtetuar se kishte rënë edhe mbaresa e kallëzores së emrave asnjansës, kur kushtet fonetike ishin thuajse të njëjta me kallëzoret e dy rasave të tjera. Nuk janë shpjeguar as arsyet e shtrirjes së mbaresës *-i* të dhanores në gjinore dhe në rrjedhore.

Pas këtij parashtrimi, po mundohemi të shtrojmë dhe të japim ndonjë gjykim mbështetës ose të ri për zgjidhje të mëtejshme të evolucionit që kanë ndjekur mbaresat rasore të emrave.

Për shtrirjen e mbaresës *-i* edhe në rasat e tjera, vështirë të gjesësh një arsye gjuhësore bindëse. Shtimi i kësaj mbarese nuk mund të shpjegohet me arsye morfologjike, sepse formalisht nuk krijon opozicion gramatikor, përkundrazi rrafshon ndryshime morfologjike. Në kushtet e lakimit të pashquar, shtimi apo përgjithësimi i saj nuk ka as arsye fonetike, sepse është një shtesë që bëhet në fund të fjalës. Nga kjo pikëpamje ajo (mbaresa) vetëm mund të marrë zhvillime të mëtejshme të kushtëzuara nga bashkëndeshja me fundoret e emrave përkatës, siç ka ndodhur kur kjo është ndeshur me zanore të theksuara ose me bashkëtingëllore të caktuara. Prandaj shtrirja e kësaj *-i*-je duhet të ketë ndodhur në rrethana të tjera gjuhësore. Shtrirja e saj në gjinore dhe rrjedhore duhet të ketë ndodhur ose në struktura emërore të reja, ose për arsye të tjera, ndofta analogjike.

Strukturat e reja morfologjike duhet të jenë krijuar në kohën kur formave paraprirëse rasore iu shtuan format përkatëse nyjore. Nyja shquese i gjeti këto struktura ose pa mbaresën e hershme të tyre, ose me


mbaresën e re të dhanores. Por më e mundshme është që nyja t'u jetë prapangjitur formave pa mbaresë, sepse, siç e përmendëm më lart, shtrirja e mbaresës së dhanores *-i* nuk përligjet nga ana morfologjike. Në këto kushte, nyja shquese, së paku për këtë lakim, do t'i jetë prapangjitur drejtpërdrejt temës së emrit përkatës. Duke qenë se këta emra mbaronin kryesisht me bashkëtingëllore, prapavendosja e nyjës, e cila në këto rasa (gjinore, dhanore dhe rrjedhore) ishte gjithashtu një bashkëtingëllore, paraqiste vështirësi përdorimi, prandaj këtu është ndërfutur në *-i*, ashtu siç është ndërfutur *-i*-ja e kallëzores (*lis-i-n*) në shqipen e dokumentuar po në të njëjtat kushte. Pra nga format *list*, *malt* u kalua në *lis-i-t*, *mal-i-t*. Ky proces fonetik i sendërtuar në këto rasa të zhdrejta duhet t'i ketë paraprirë dhe t'i ketë shërbyer mandej edhe si gjedhe procesit të ndërtimit të mëvonshëm të kallëzores. Por nuk është e pamundur që këtu të ketë ngjarë dukuria gjuhësore e njohur dhe e përsëritur e tematizimit të formave të veçanta gramatikore, që vërehet jo rrallë në sistemin foljor, mbiemëror dhe emëror të shqipes. Sipas arsyetimit tonë, ka mundësi që - ndryshe nga ç'mendon Çabej - ⁷ vetë forma e emërores së shquar (*mal-i*, *lis-i*) të jetë tematizuar, të jetë përfytyruar si temë. Kësaj teme mandej duhet t'i jenë prapangjitur format nyjore sipas rasave, duke kaluar nga struktura paradigmatiche 1) në strukturën paradigmatiche 2):



Ky kalim nuk e përjashton mundësinë që si model përgjithësimi të jetë edhe forma e dhanores së pashquar, në qoftë se mbarsa përkatëse e saj *-i* është refleks i mbarsës së hershme indoevropiane. Edhe një gjë duhet theksuar që shtrirja e modelit tematik nuk do të ketë ndodhur në të njëjtën kohë në të gjitha rasat. Për këtë dëshmon forma e kallëzores së shquar, ku shfaqja e *-i*-së del së pari te Buzuku te një kategori emrash, kurse përgjithësimi i takon shqipes së re.

Në mbështetje të njërës prej ideve të akademikut Idriz Ajeti, po theksoj dhe shtoj se *është një e vërtetë gjuhësore që, veç prirjes për thjeshtim të përgjithshëm të sistemit rasor të shqipes, edhe ndikimet dhe përgjithësimet nga lakimi i shquar në të pashquarin dhe ndërsjelltas kanë ndodhur dhe ndodhin edhe para syve tanë*. Nga ana tjetër, në krijimin e strukturave të reja formëformuese ndodhin më tej ndryshime në përputhje me nevojat gjuhësore. Kështu, p. sh. brenda lakimit të shquar mjetet gramatikore të së pashquarës nuk vazhdojnë të kryejnë funksionet morfologjike të mëparshme, prandaj edhe shtrihen në gjithë paradigmen duke u ndier më shumë si pjesë të përfaqësimit fonologjik të një teme të re, e cila mund të shërbejë edhe si model e të ndihet si bazë për ndërtimin e formave të tjera gramatikore. Ndodhin pak a shumë dukuri të ngjashme me formimet e ngushta dialektore të emrave dikur asnjans si, p. sh. *ujë ~ ujë-t ~ ujt-i*.

Për lakimin e tretë, në parim, mund të bëhet i njëjti interpretim, por në sens të kundërt: Në lakimin e shquar si temë për formëformim mund të ketë shërbyer tema e emrit,⁸ së cilës i janë shtuar format nyjore përkatëse të gjinisë femërore, sipas skemës vijuese:



Në paradigma që ndjekin njëra-tjetrën, zhvillimet e brendshme të mëtejshme formale kushtëzohen përgjithësisht nga treguesi i fundit gramatikor, pra nga mbaresa e së shquarës, e cila, për shkak të formave të veçanta që bart nga përemri dëftor, prej të cilit rrjedh, shpreh njëherësh, krahas shquarsisë, edhe rasën. Prandaj forma e mbaresës paraprirëse të së pashquarës, brenda paradigmes të së shquarës i humbet vlerat morfologjike dhe shndërrohet herë në përbërës i temës, herë i mbaresës së re.

Pa mohuar mendimet e mëparshme për burimin e mbaresës *-e* të gjinore, dhanores dhe rrjedhores së pashquar, duhet pranuar se në një periudhë të caktuar emrat e kësaj gjinie kuptimin e emërores së shquar e

kanë shprehur me nyjën shquese përkatëse *-e* (e cila do të jetë dukur më qartë tek emrat femërorë që dilnin me temë në bashkëtingëllore). Në këto kushte nuk do të ketë qenë e pamundur që kjo formë e emërore së shquar (p. sh. *flutur-e*) të jetë përdorur pastaj si formë për tri rasat përkatëse të së pashquarës, ku *-e*-ja brenda paradigmes së plotë të së pashquarës ndihet si një mbarese e këtij lakimi.

Domosdoshmëria e përdorimit të nyjës joshquese *një* para rasës gjinore-dhanore të pashquar, që mendohet se është e njëjta formë e emërores së shquar, mund të lidhet me këto rrethana shndërrimesh e përgjithësimesh morfologjike. Përmes nyjës *një* bëhet ridallimi nga emërorja e shquar. Një dukuri e përafërt ka ndodhur edhe në gjinore-dhanoren e numrit shumë, ku dallimi midis trajtës së shquar dhe të pashquar nuk bëhet me mjete morfologjike, por me mjete leksikore.

Jashtë kriterëve të këtyre zhvillimeve duket se del formanti *-n(ë)* i kallëzores së shquar. Në këtë trajtë pritej që forma e së pashquarës të pasohet nga forma përkatëse nyjore *të*. Dy kanë qenë mendimet zotëruese për këtë zhvillim:

- Mbaresa e së shquarës *-n(ë)* është një zhvillim fonetik i bashkimit të mbaresës së kallëzores së shquar *-n* (nga i.e. *-m*) dhe i formës së nyjës së prapme të kallëzores *të* (nga forma e kallëzores së dëftorit *tan*). ⁹Mbaresa e sotme *-në* përbën një gjurmë jo të drejtpërdrejtë, por të tërthortë të së dikurshmes kallëzores së shquar”. ¹⁰

Pavarësisht nga interpretimet, të dyja mendimet përputhen në një pikë: që në bazë të kësaj mbarese qëndron bërthama e një mbarese të kallëzores indoevropiane. Për kriterin e ndjekur në shpjegimin e ndërtimit të formave rasore të së shquarës nga tematizimi i një forme rasore, do të ishte më e pranueshme pikëpamja e dytë, që kjo mbarese të jetë vazhduese e drejtpërdrejtë e mbaresës së kallëzores së shquar, e cila, për shkak të zhvillimeve të veçanta morfonologjike, ka marrë vlerën e një mbarese shquarësie.

Është pranuar thajse nga të gjithë se mbaresat rasore të lakimit të shquar nuk kanë rënë të gjitha njëherësh. Mbaresa e kallëzores *-n(ë)* është ruajtur për një kohë më të gjatë se mbaresat e pjesës më të madhe të


rasave. Siç e theksuam më lart, në një periudhë të caktuar të shqipes emërorja, gjinorja dhe rrjedhorja kanë dalë pa mbaresë; por dyshime ka edhe për dhanoren. Kur këto rasa u pajisën me nyja shquese, në strukturën e paradigmës ajo u dallua së pari si i vetmi mjet gramatikor që shprehte shquarsinë. Në rrjedhë të kohës asaj iu përshtat mandej edhe kuptimi gramatikor i rasës, i gjinisë dhe i numrit. U krijua kështu një paradigmë, ku nga një anë qëndronte tema, nga ana tjetër forma rasore përkatëse vetëm me një mbaresë (vetëm me nyjën). Kurse kallëzorja, si rasë që e ruante ende mbaresën e së pashquarës, doli me dy mbaresa: edhe me mbaresën e së pashquarës **-n(ë)**, edhe me nyjën përkatëse të kallëzores **-të**. Pra, në përballje me rasën gjinore, p. sh. kallëzorja dilte me dy morfema, me morfemën rasore **-n-** dhe me morfemën e shquarsisë **-të**.

Gjinore Kallëzore

(i) $\longleftrightarrow$ të bir **-t** $\longleftrightarrow$ të bir **-n -të** $\longleftrightarrow$

Por kjo gjendje nuk mund të vazhdonte gjatë kështu, që vetëm kallëzorja të dilte me dy morfema, prandaj, për të ndjekur sistemin paradigmatic, duhej mënjeluar njëra morfemë. Dhe nga dy morfemat, **-n a -të**, me sa duket, është mënjeluar morfema **-të**, sepse ruajtja e saj dhe mënjanimi i morfemës **-n-**, do ta kishte reduktuar edhe më tej eptimin rasor edhe në të shquarën. Rënia e kësaj mbarese, në të shquarën do t'i kishte njësuar prej kohësh të gjitha rasat me përjashtim të rasës emërore. Këto rasa do të dilnin gati të gjitha me mbaresën e së shquarës **-të**. Prandaj në kallëzoren e shquar u ruajt ajo morfemë, që e ruajtiti dhe e ruan ende paradigmën rasore të emrave në shqipe.

Natyrisht po flasim për atë periudhë të shqipes kur nyja shquese rasat e tjera i gjeti thujse pa mbaresë. Ky zhvillim në këtë periudhë mund të ketë ndjekur këtë rrugë:



Me këtë parashtrësë në këtë Jubile të madh lindjeje u munduam që të mbështetim dhe të çojmë sado pak më tej vetëm disa nga mendimet e ak. Idrizit Ajeti.

Në tërësi vepra e tij është një mozaik, një enciklopedi brendagjuhësore, e cila jep nga çdo fushë, parashtron dhe ngre probleme në çdo fushë, zgjidh edhe probleme në çdo fushë.

Vepra e akademik Idriz Ajetit është një pasuri kombëtare, që i kapërcen 100 vjetët e jetës së tij.

Urimet më të mira për jetë dhe shëndet!

Bibliografi

I. Ajeti, *Historia e gjuhës shqipe*, 3

I. Ajeti, *po aty*, 3

I. Ajeti, *po aty*, 18

E. Sapir, *Gjuha- Hyrje në studimin e ligjëritimit*, 190

Sh. Demiraj, *Gramatikë...*, 289

Shih për këto përdorime: J. Gjinari, *BUSHSH*, 1, 1957, 118, ku për të folmen e qytetit të Beratit jep: ... për nusen **e të birt**; **e të kushurirt** etj.; i njëjti autor përdorime të tilla ka gjetur edhe te Buzuku: ...en **së dalët së diellët**, i d **naliët**, **Jezut**; tha **d birt** etj.

E. Çabej, *BUSHT*, *SSHSH*, 2, 1969, 79

M. Domi, në dispensën 'Morfologjia historike e gjuhës shqipe', 22

H. Pedersen, ¹¹ H. Pedersen, *Bidrag*, 249, *KZ* 36, 310; *La Piana*, *St. Ling. Alb. I*, 159; E. Çabej, *BUSHT*, *SSHSH* 3, 1963, 79; M. Domi, *Morf. Hist.*, 19; I. Ajeti, *Historia...*, 32; Sh. Demiraj, *Morfologjia historike I*, 19

S. Riza, *BUSHT*, *SSHSH*, 4, 1958, 14

I. Ajeti, *Vepra* 3, *Akademia e Shkencave dhe Arteve Kosovës*, *Botime të veçanta XXXII*, *Seksioni i Gjuhës dhe i Letërsisë*, *Libri* 16, f.235

Po aty, 231

A.S. KARPIKOVA, A.Yu. RUSAKOV, Shën Peterburg

FORMAT E TIPIT "PËR TË + PJESORE" NË SHQIPEN E SOTME (SIPAS TË DHËNAVE TË KORPUSIT ELEKTRONIK)

Hyrje

Siç dihet shumë mirë shqipja standarde ka formën e së ardhmes së tipit “ballkanik” të formuar me pjesëze të pandryshuar të (te prejardhur nga folja me kuptimin volitive) dhe me formën analitike të mënyrës lidhore: *do të shkruajë*. Nga ana semantike kjo e ardhme e gjuhës shqipe nuk dallon nga format futurale të atyre gjuhëve të “standardit evropian”, që gjithashtu kanë të vetmen formë të së ardhmes. Nga ana e marrëdhënieve paradigmatiske forma e së ardhmes ndodhet në qendrën e “familjes” së formave gramatikore me kuptimet si temporale ashtu dhe modale: *do të shkruante* (e ardhmja e së shkruarës, koha e tashme e mënyrës kushtore); *do të ketë shkruar* (e ardhmja e përparme); *do të kishte shkruar* (e ardhmja e përparme në të shkuarën, koha e kryer e mënyrës kushtore).¹

Por në gjuhën shqipe standarde (ashtu si në shumicën e të folmeve) ekziston edhe një formë e interpretuar tradicionalisht si e përkritur sferës futurale dhe e formuar nga folja ndihmese *kam* dhe forma e pashtjelluar me kuptimin qëllimor *për të + pjesore*: *ka për të shkruar* (*për të shkruar* – supini, *të shkruar* – emri prejfoljor të gjinisë asnjansë, *shkruar* – pjesorja).

Ka edhe forma të tjera me “*për + të +Part*” me *kam* në imperfekt, aorist, mënyrën lidhore etj.

¹ Në dialektet gegë (si dhe në formën gegë të shqipes standarde) përveç këtyre formave përdoret edhe e ashtuquajtura forma geqe e së ardhmes: **kam me punue** (*kam + paskajore geqe*) me disa forma derivative.

Qëllimi i këtij artikulli është të shqyrtojë funksionimin e formës “kam (koha e tashme) + për + të + pjesore” sipas të dhënave të korpusit elektronik të shqipes.²

Forma e tipit “kam për të + pjesore” në gramatikat e gjuhës shqipe

Kuptimi i formës përshkruhet në gramatikat shqiptare shumë shkurt. Karakteristikën më të hollësishme kemi në (Buchholtz / Fiedler 1987: 151), ku thuhet se forma ka kuptimin temporal të së ardhmes (me komponentin e sigurisë – “eine Komponente der Sicherheit, Bestimmtheit, Versicherung”, Buchholtz / Fiedler 1987: 151) dhe kuptimin modal të detyrimit. Autoret e emërojnë këtë formë “Nezessitativ” (Buchholtz / Fiedler 1987: 151-152). Përshkrimin shumë të ngjashëm në shohim në Gramatikën akademike: “Me të njëjtin kuptim (të së ardhmes – AR), ndonëse më rrallë, përdoret edhe e ardhmja e tipit kam për të bërë, por kjo në disa raste e ruan në një farë mase ngjyrimin e detyrimit të togfjalëshit të lirë, nga është formuar” (Agalliu et al. 1995: 290, sh. edhe Newmark et al. 1982: 50).


Format e tipit “kam për të + pjesore”: vendi e koha

Në monumentet e para të shkrimit shqip ne shohim një asortiment mjaft të gjerë të formave që shprehin kuptimin e së ardhmes: a) koha e tashme e dëftores; б) koha e tashme e lidhores; в) forma geqe e se ardhmes (e tipit ka me shkrue) (Fiedler 2004; Schumacher / Matzinger 2012).

Për sa i përket formës “kam për të + pjesore”, dëshmitë e para (dhe mjaftë të rralla) të përdorimit të saj ne kemi tek P. Bogdani (1685), Gj Kazazi (1743), Anonimi i Elbasanit (1761). Ne tekstet e Gj. Buzukut (1555), P. Budit (1618, 1621), Fr. Bardhit (1635) ashtu si në arbërishte dhe arvanitike s’ka format e tilla. Ashtu, mund të supozojmë se kjo formë s’u formua më herët sesa në gjysmën e dytë të shekullit XVI (Demiraj 1986: 838, shih edhe Bokshi 2012).

Duke shqyrtuar shpërndarjen dialektore moderne mund të vërejmë se sipas të dhënave të ADGjSh (2007) forma e tipit “për + të +Part” është më i përhapur në arealin toskë:

² http://web-corpora.net/AlbanianCorpus/search/?interface_language=sq.
Për korpusin shih Arkhangelskij et al. 2012.



Shpërndarja dialektore e formave të kohës së ardhme (ADGjSh 2007: 390)³.

³ Shih edhe shënimin e S. Mansakut për përdorimin më të gjerë të kësaj forme “në të folmet e Shqipërisë së Mesme ku trajta kam me shkue përdoret më pak” (Mansaku 2012: 83, shih edhe Mansaku 2010; Altimari 2014/)

Format e tipit “kam për të + pjesore” në Korpusin elektronik

Sipas situatës në maj 2016 korpusi kishte një 19 mln. fjalë teksti. Në përgjithësi në korpus ka 788 shembuj të kësaj forme analitike me *kam* në të tashmen (për 19 mln. fjalë teksti). Forma është shumë e rrallë (për krahasim në korpus ka më së 96000 përdorime të së ardhmes «volitive»).

Tabela 1. *Format e tipit “kam për të + pjesore” sipas zhanreve*

Terë korpusi (19431249)		Tekstet artistike (3840565)		Gazetat (12230215)		Tekstet fetare (744989)		Tekstet jo-artistike (3840565)	
sasia	iipm ⁴	sasia	Iipm	sasia	Iipm	sasia	iipm	Sasia	iipm
788	440,55	276	666,40	160	113,8	303	4406,71	47	220,61

Interes ka shpërndarja e formave sipas zhanrit.

Materialet e tabelës tregojnë ngritjen e fortë e dendurisë relative (ipm) të përdorimit të formës në tekstet fetare (para se gjithash në tekstet e Dhiatës së Vjetër dhe të Dhiatës së Re), do të kthehemi tek ky fakt më poshtë. Përkundrazi në tekstet jo-artistike (mësimore dhe shkencore) vihet re një zbritje e dendurisë së përdorimit, kjo është lidhur, mundet, më përdorimin e këtyre formave relativisht të shpeshtë në ligjërimin e drejtë.

Shumica dërmuese e teksteve të përfshirë në korpus janë shkruar në gjuhën letrare dhe ne nuk mund të studjojmë në bazën e korpusit përhapjen dialektore të kësaj forme. Megjithatë, mund të supozojmë se tekstet të shkruara në Kosovë mund të kenë ndikimin e substratit dialektor gegë. Kështu kemi krahasuar përdorimet e formave të shqyrtuara në tekstet e dy gazetave: “Gazeta Shqiptare” (del në Shqipëri) dhe “Zëri” (del në Kosovë), shih Tabelë 2.

Materialet tregojnë se forma jone ndeshet shumë me shpesh në Gazetën Shqiptare (ipm 41), ndërsa në Zerin ne kemi ipm 9. Kjo nuk i

⁴ Ipm është sasia e formave për një milion të fjalëve teksti.

kundërshton, të paktën, supozimit se forma “*kam për të + pjesore*” është më e përhapur në rajonet e Shqipërisë jugore.

Tabela 2. Shpërndarja e formave të tipit “*për + të +Part*” në gazetat

Gazeta Shqiptare (Shqipëria)		Zëri (Kosova)	
sasia	ipm	sasia	ipm
76	40,76	56	8,98

Format e tipit “*kam për të + pjesore*”: kuptimi

Analiza paraprake na lejoji të bëjmë disa konkluzione për kuptimin e formës.

1. Shumica dërmuese (më se 70%) i rasteve të përdorimit të kësaj forme karakterizohet me kuptimin *destinativ*, kuptimin e parapërcaktimit ose të parashikimit (sh. “format e destinativit karakterizojnë situatën, realizimi i së cilës konceptohet nga folësi si i pashmangshëm në rrethanat e dhëna”, Плунгян 200: 117):⁵

(1) *Janë kotësi, punë mashtrimi; në kohën e ndëshkimit të tyre kanë për të vdekur* (Dhjata e vjetër, Jeremia 10:15, përkthimi i Shoqërisë Biblike të Shqipërisë, 1994)

Është interesant se denduria e kësaj forme në përkthimet biblike (ipm 406,7) është dhjetë herë me e madhe sa ajo në Korpus në përgjithësi (ipm 40,6). Megjithatë, në kemi këtë kuptim si më i dendur edhe në forma jashtë teksteve biblike:

(2) *Me siguri (конечно) kemi për të gjetur vetëm disa qindra ushtarë dhe më të shumtët nuk kemi për t’i njohur dot.* (Ismail Kadare, Gjenerali i ushtrisë së vdekur (1980)

2. Në korpus ka shembujt me kuptimin e *detyrimit* (nja 15%), në shumicën e rasteve kemi detyrimin e tipit të jashtëm (ose deontik):

(3) *Mua më vjen turp t’i them që nesër kam për t’i dhënë shokut Q. diskutimin.* Dritëro Agolli, Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo, 1972)

⁵ Shih termin *providencialis* të propozuar për kuptimin e tillë nga E.Maslova (2004).

Ka dhe disa raste edhe me ngjyrimin e fort të modalitetit epistemik:

(4) *Për vetë Ramën, Kuvendi ka për të qenë një tokë e pazbuluar* (Zëri, 2013.09.08, 2013)

3. Në rastet të pakta forma *kam për të + npuvacmue* ka kuptimin e *synimit (intencës)*:

(5) *Më nevojitet një pallto, një pallto e madhe, me jakë të ngritur, me astar.*

— **Keni për të bërë** ndonjë udhëtim? — e pyeti ai.

— Jo! (Gustave Flaubert, Zonja Bovari, përkthyer nga Viktor Kalemi, 2009)

4. Me në fund kemi në korpus shembujt ku kjo formë ka kuptimin thjeshtë *futural* (nganjëherë me nuancat semantike modale):

(6) *Le të shpresojmë, se edhe ti, ke për të na dhënë shembull të mirë!* (Gustave Flaubert, Zonja Bovari (përkthyer nga Viktor Kalemi), fiction prose novel, 2000–2009)

Duhet të them se nganjëherë është vështirë të shënoj kufirin midis këtyre kuptimeve. Kuptimet e *destinativit* (parapërcaktimit) dhe të intencës gjithmonë dhe kuptimi i detyrimit në shumicën e rasteve realizohen në kontekstin *futural* dhe shumë shpesh është e pamundshme të dallojë në një shembull konkret formën me kuptimin e *futurit* (me ngjyrimin e lehtë të *destinativit*) nga forma me kuptimin kryesor të *destinativit*.

Veç kësaj duhet të mbajmë mend se forma *“kam për të + pjesore”* është shumë e rrallë dhe bile në kontekstet e *parapërcaktimit* e ardhmja volitive përdoret shumë më shpesh. Ka raste ku në një fjali kombinohen format të ndryshme të sferës së ardhmes pa ndonjë dallim semantik:

(7) *Në disa pjesë të atdheut tonë të stërmadh, ende flitet se qysh atëherë kanë ekzistuar profecitë se do të vijë një kohë kur ata që nuk punojnë kanë për të jetuar më mirë, e ata që janë tradhtarë kanë për të qenë objekt adhurimi.* (Zëri, 2013.07.31)

Format e tipit “kam për të + pjesore”: vijat e zhvillimit semantik

Forma e pashtjelluar “*për të + pjesore*” ka kuptimin qëllimor dhe mund të përdorur në fjali si një përcaktor. Në korpus ka shembujt ku ne kemi bashkimin e lirë të foljes *kam* dhe të togfjalëshit qëllimor të përdorur si një përcaktor, ky bashkim është omonimik me formën tonë. (8) – (10)

(8) *Do të marrë shërbëtorët, shërbëtoret, të rinjtë tuaj më të mirë dhe gomarët që **keni për t’i përdorur** në punimet e tij.* (Dhjata e vjetër, 1 i Mbretërve (1 i Samuelit), 8, 16, përkthimi i Shoqërisë Biblike e Shqipërisë (Albanian Bible Society)1994)

(9) ***S’ka asgjë për të treguar*** (Kronikë në gur, Ismail Kadare 1963)

(10) *Shumë gjëra **kam për të folur e për të gjykuar** për ju.* (Dhjata e re, Gjoni, 8, 26, përkthimi i Vladimir Dervishit 2000)

Duket se shembulli (10) mund të ketë dy trajtime semantike: “kam shumë gjëra për të folur” dhe “do të flasë shumë gjëra”. Është interesant se zhvillimi semantik nga forma qëllimore përcaktore te kuptimi i detyrimit / destinativit i ngjan zhvillimit kuptimor të perfektit posesiv (nga “kam diçka të bërë” te “kam bërë diçka”), me tej ne kemi (në të dy rastet) zgjerimi i përdorimit të konstruksioneve tek foljet jokallimtare.

Nga ana semantike shembujt të tipit (10) mund të zhvillojnë kuptimin e *detyrimit* dhe shembujt e tipit (9) (më foljen *kam* në vetën e tretë njëjës) kuptimin e *destinativit* (shih edhe (11):


(11) *Le të deklarojnë cilat ishin gjërat e kaluara, në mënyrë që të mund t’i shqyrtojmë dhe të njohim kryerjen e tyre; ose na njoftoni ç’**ka për të ndodhur*** (Dhjata e vjetër, Isaia, 41, 22, përkthimi i Shoqërisë Biblike e Shqipërisë (Albanian Bible Society)1994)

Zhvillimi semantik i mëtejshëm mund të çonte te kuptimet e *synimit* dhe pastaj të *futurit*.

Zhvillimi i përshkruar është shumë i afërt vijës së gramatikalizimit të propozuar nga Joan Bajbi ([Bybee et al. 1994: 263, shih edhe van der Auwera & Plungian 1998):.

'be', 'become', 'have'/POSSESSION > OBLIGATION

'be', become', 'have'/POSSESSION > PREDESTINATION



Përfundime

1) Forma e analizuar është shumë e rrallë në shqipen moderne: në korpus ka 788 shembuj të kësaj forme (krahas më së 96000 përdorime të së ardhmes «volitive»).

2) Kuptimi më i përhapur i formës është ai i *destinativit* (termi i V. A. Plungjanit) ose i parapërcaktimit, forma përdoret edhe në kuptimet e *detyrimit*, të *synimit* (intencës), në kuptimin thjeshtë *futural*. Forma “*kam për të + pjesore*” ka në gjuhën standarde moderne karakterin jo-obligator: për shumicën e kuptimeve të analizuara në artikull format e së ardhmes të tipit “*do + lidhore*” janë shumë më të përhapura (për kuptimin e detyrimit më të përhapura janë format të tjera modale).

3) Mund të përfytyrojmë hipotetikusht vijën e tillë gramatikalizimit të formës “*kam për të + pjesore*”: kuptimi *pronor* > *destinativ*; kuptimi *pronor* > *detyrimi*; *destinativ*, *detyrimi* > *synimi* > *futuri*. Zhvillimi i tillë pajtohet shumë mirë me skemën e gramatikalizimit të së ardhmes të propozuar nga Joan Bybee.

Bibliografi

- Маслова Е. С. 2004. К типологии проспектива: категория провиденциализма в юкагирских языках // Ю. А. Ландер и др. (ред.). *Исследования по теории грамматики, вып. 3: Ирреалис и ирреальность*. М.: Гнозис, 212–225.
- Плунгян В. А. 2006. О категории «темпоральной подвижности в армянском языке» // *Проблемы типологии и общей лингвистики* / Ред. В. С. Храковский, С. Ю. Дмитренко, Н. М. Заика. СПб.: Изд-во ИЛИ РАН, 115–124.
- ADGjSh 2007 = Gjinari, Jorgji, Bahri Beci, Gjovalin Shkurtaj i Xheladin Gosturani. *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe*. 1. Napoli.
- Agalliu F., Demiraj Sh., Hysa E. 1995. *Gramatika e gjuhës shqipe*. Vëll. I / red. Sh. Demiraj. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
- Altimari F. 2014. E ashtuquajtura e ardhme arbëreshe *kam + lidhore*: romanizëm italian apo arkaizëm ballkanik. In: F. Altimari. *Studia linguistica italo-albanica. Arbërishtja në kontekstin gjuhësor ballkanik dhe italian*. Prishtinë: ASHAK. F.41-54.
- Arkhangelskij T., Daniel M., Morozova M., Rusakov A. Korpusi i gjuhës shqipe: drejtimet kryesore të punës. Në: R. Ismajli (red.). *Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit. Konferencë shkencore mbajtur më 10-11 nëntor 2011 në Prishtinë*. Prishtinë: ASHAK. F.635-643.
- Bokshi B. 2012. Format e futurit të shqipes në raport me ato të gjuhëve ballkanike. Në: R. Ismajli (red.). *Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit. Konferencë shkencore mbajtur më 10-11 nëntor 2011 në Prishtinë*. Prishtinë: ASHAK. F.29-36.
- Buchholz O., Fiedler W. 1987. *Albanische Grammatik*. Leipzig: Verlag Enzyklopädie.
- Bybee J., Perkins R., Pagliuca W. 1994. *The Evolution of Grammar Tense, Aspect, and Modality in the Languages of the World*. Chicago: The University of Chicago Press.
- Demiraj Sh. 1986. *Gramatikë historike e gjuhes shqipe*. Tiranë: 8 Nëntori.
- Fiedler, Wilfried. 2004. *Das albanische Verbalsystem in der sprache des Gjon Buzuku (1555)*. Prishtinë: ASHAK.
- Mansaku S. 2010. Sur la typology et la chronologie des forms du futur en albanais. In: *Wir sind die Deinen. Studien zur albanischen Sprache, Literatur und Kulturgeschichte, dem Gedenken an Martin Camaj (1925 – 1992) gewidmet* (Albanische Forschungen B.29). Wiesbaden: Harrassowitz Verlag. S. 330-356.
- Mansaku S. 2012. Tipologji romane dhe ballkanike në strukturën gramatikore të shqipes. Në: R. Ismajli (red.). *Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit. Konferencë shkencore mbajtur më 10-11 nëntor 2011 në Prishtinë*. Prishtinë: ASHAK. F.71-89.
- Newmark L., Hubbard Ph., Prifti P. 1982. *Standard Albanian*. Stanford, California: Stanford University Press.
- Schumacher, Stefan, and Joachim Matzinger. 2013. *Die Verben des Altalbanischen. Belegwörterbuch, Wortgeschichte und Etymologie*. Wiesbaden: Harrassowitz.
- van der Auwera, J. & Plungian, V. A. 1998. Modality's semantic map. *Linguistic typology*, 2.1, 79–124.

Irena SAWICKA, Varshavë

NGA PROBLEMET E FONETIKËS BALLKANIKE

Në artikullin tim dëshiroj t'i referohem interesimit shkencor të profesor Idriz Ajetit, i cili ka të bëjë me ndikimin reciprok të gjuhëve në kuadër të Ligës Gjuhësore Ballkanike.

Në punimet mbi Ligën Gjuhësore Ballkanike shumë rrallë gjejmë informacione për problemet fonetike. Zakonisht këto janë shënime të shkurtra mbi dy tipare, të cilat konsiderohen si tipare ballkanike. E para është paraqitja e grupeve konsonantike *mb*, *mp*, *nd*, *nt*, *ng*, *ɲk* në fillim të fjalëve, dhe e dyta është prania e një zanoreje të mesme, qendrore, e ashtu quajtura “shva” si fonemë e pavarur. Këto shënime modeste natyrisht nuk mjaftojnë si përshkrim i fonetikës së Ballkanit. Së pari, ato kërkojnë zgjerim dhe verifikim, së dyti, këto nuk janë të vetmet tipare fonetike që i karakterizojnë gjuhët ballkanike dhe, se treti, zona e shpërndarjes së ballkanizmeve fonetike është pak më ndryshe se zona e shpërndarjes së ballkanizmeve morfo-sintaktike. Përveç dy karakteristikave të përmendura duhet të marrim parasysh gjithashtu, së paku, tipin e theksit, tipin e sandhit midis fjalëve, grupet vokaliqe, disa karakteristika të intonacionit të fjalisë, dhe një lloj citacizmi. Këto karakteristika përqendrohen në zonën ku takohen shqipja, greqishtja dhe maqedonishja. Kjo është gjithashtu zona ku proceset e konvergjencës janë intensive edhe sot, ndërsa në rajonin bullgaro-rumun, si rezultat i krijimit të shteteve kombëtare, minoritetet janë reduktuar në mënyrë të konsiderueshme, prandaj plurilingualizmi është kufizuar, ndërsa konvergjenca gjuhësore praktikisht ka vdekur.

Këtu do të them disa fjalë për fonemën vokaliqe të mesme, qendrore, të ashtuquajtur shva, e cila paraqitet në Ballkan në variante të ndryshme

fonetike, më të ulëta, ose më të larta, më të përparme ose më të prapme¹, dhe e cila konsiderohet gjerësisht si një tipar ballkanik. Sipas mendimit tim, ky nuk është ballkanizëm. Një tingull mund të identifikohet si tipar karakteristik i një lige gjuhësore kur shfaqet në territorin gjuhësor kompakt të kësaj lige dhe u zhvillua ose është ruajtur si rezultat i kontaktit gjuhësor. Por kjo nuk është e mjaftueshme. E rëndësishme është gjithashtu, se ky tingull nuk është i pranishëm në territorin fqinjë, rreth territorit të ligës. Shva fonologjike nuk e plotëson këtë kusht.

Në të vërtetë, në shumicën e dialekteve të Ballkanit paraqitet shva fonologjike. Një fonemë e tillë shfaqet në bullgarisht, në dialektet shqipe dhe në dialektet jugore serbe. Në rumanisht kemi dy zanore të këtij lloji. Shva nuk shfaqet në greqisht, në pjesën perëndimore-qendrore të dialekteve maqedonase, si dhe në shumicën e dialekteve gege, në të cilat shva interpretohet si një segment jo-fonologjik, i kushtëzuar nga pozita, fragment kombinatorik i artikullimit të sonantit. Për shembull, forma *letrën* interpretohet fonologjikisht si /letrn/ - fonema /n/ në këtë pozicion shqiptohet si [ən] - ky është rezultat i kufizimeve që vijnë nga struktura e rrokjes. Në shumicën e dialekteve gege ë-ja gjithmonë shoqërohet me sonant, në pozita ku sonanti dëmton vijën e sonoritetit të rrokjes. Futja e [ə]-së e eliminon këtë problem. Në pozicione të tjera shva paraqitet shumë rrallë.

Pra shva fonologjike nuk shfaqet në zonë absolutisht kompakte. Në Ligën Ballkanike ka vende pa këtë fonemë dhe këto janë vende, ku përqendrohen të tjera ballkanizime fonetike dhe ku fenomene të konvergjencës janë aktive. Por kjo nuk është pengesa më e rëndësishme që të konsiderojmë shva fonologjike si një tipar ballkanik. Tinguj të tipit të shvas takohen shpesh në gjuhët e botës, veçanërisht në Evropë dhe në Azi. Zona e Ballkanit lidhet direkt me një zonë të madhe të Azisë, ku ky tingull shfaqet rregullisht. Ballkani përbën periferinë jugo-perëndimore të shfaqjes së shvas. Zanorja e mesme, qendrore, ekziston në shumicën e gjuhëve altaike, në gjuhët turkike: në turqisht, në çuvashisht, uzbekisht, në gjuhën tatarë,

¹ Këto janë të ashtuquajturat zanore të reduktuara apo të centralizuara, pra zanore të tilla, të cilat në një figurë gjeometrike, që simbolizon vendin e artikullimit (zakonisht trekëndësh ose katërkëndësh), i vendosim në mesin e figurës dhe jo në skajet e saj.

azere, në kazakisht, bashkirisht, karaim, burjat, etj., si dhe në mongolisht dhe në familjen e gjuhëve tunguso-manxhuriane. Përveç kësaj, gjithashtu zanore e lartë e tipit shva shfaqet edhe në gjuhët sllave në veri të maleve Karpate – në polonisht, në rusisht, në ukrainisht, në bjellorusisht. Shva-ja veriore sllave, veçanërisht polake, në dëgjim është identike me zanoren e lartë të reduktuar rumune. Në gjuhët ballkanike ky segment është relativisht i ulët. Gjuhët altaike kanë zanore të reduktuara të ndryshme, më të larta (si në turqisht) ose më të ulëta. Në gjuhën azere shfaqet një zanore, e cila në alfabetin IPA shënohet me [u] ([m] e përmbysur), një lloj i [u]-së jo-labiale. Në të vërtetë kjo nuk është zanore e mesme, e reduktuar, por duhet të mbajmë në mend që zanorja sllave e reduktuar [i] është zhvilluar nga një zanore e ngjashme, si rezultat i delabializimit të [u]-së së gjatë.

Prandaj zona ku paraqitet shva është mjaft kompakte. Rreth kësaj zone prania e zanores së reduktuar nuk është e rregullt. Për shembull në ligën centralo-aziatike, e cila përfshin gjuhët lindore dhe perëndimore të Iranit, gjuhën dumaki, gjuhët indo-ariene, burushakishten dhe gjuhë darde (sipas Tonopob 1965), shva në të vërtetë takohet, por duket më pak e rregullt, midis të tjerash ajo mungon në taxhikisht dhe në Kashmir. Ajo gjithashtu nuk shfaqet në shumicën e gjuhëve të Kaukazit - mungon në gjuhën avare, në abhazisht, në gjeorgjisht. Edhe nga ana tjetër e këtij territori me shva – në gjuhët fino-ugrike – shva-ja nuk shfaqet.

Unë nuk mund ta përcaktoj vlerën fonologjike të kësaj zanoreje në të gjitha gjuhët altaike. Sigurisht ajo është një fonemë e pavarur në shumicën e këtyre gjuhëve. /ɯ/-ja është fonematike në gjuhën turke. Në gjuhët sllave [i] (shva e lartë) për disa shekuj ka pasur shpërndarje komplementare me [i], prandaj ajo ishte variant kombinatorik i /i/-së. Në gjuhët sllavo-jugore [i]-ja u zhduk - u transformua në [i], ndërsa në gjuhët sllavo-veriore [i]-ja shfaq një tendencë për t'u transformuar në fonemë të pavarur. Në gramatikën polake ajo sigurisht përbën fonemë të pavarur. Në bullgarisht si në të tjera gjuhët sllave jugore [i]-ja u zhduk, por ekziston një tjetër zanore e reduktuar, më e ulët, me tjetër etimologji - ajo vjen nga shva-ja e prapme e sllavishtes së vjetër, dhe ky tingull vjen nga [u]-ja e shkurtër. Përveç kësaj, zanorja e njëjtë vijon nga zanorja sekondare.

Në vitin 1931 Roman Jakobson prezantoi idenë e Ligës Fonetike Euroaziatike, e cila përfshin veçanërisht gjuhët altaike dhe gjuhët sllave (Jakobson 1931, Якобсон 1962). Ajo bazohet në vetëm dy karakteristika fonetiko-fonologjike: praninë e korrelacionit të palatalitetit dhe mungesën e politonisë. Siç mund të shikoni, ne mund të shtojmë këtu edhe praninë e një zanoreje të tipit të shvas, si dhe bashkëtingëllore laterale me ngjyrim velar.

Nga ana tjetër, sa i përket shvas, një lloj i zanores së reduktuar hundore sigurisht ekzistonte në historinë e gjuhëve kryesore ballkanike – në bullgarisht, shqip, në gjuhën rumune dhe në dialektet maqedonase, dhe ky fakt mund të konsiderohet si një ballkanizëm historik. Shva-ja toske ka të njëjtën origjinë si zanorja hundore geqe. Zanorja bullgare e reduktuar (ъ) – ”jer” bullgare - vjen nga zanorja e njëjtë e sllavishtes së vjetër, por edhe nga zanorja hundore e prapme. Zanorja e lartë e reduktuar rumune vjen nga [a] hundore ([ã]) (dmth. [a] në kontekst para [n], si dhe para grupit [m] plus bashkëtingëllore). Në gjuhën maqedonase zanorja hundore ka refleks të njëjtë si zanorja e reduktuar sekondare. Në disa dialekte maqedonase nazaliteti ruhet deri sot. Gjuhët sllave kishin kushtet e tyre për përzjerje të reduktimit me hundoresinë, por fakti që një tingull i tillë, i rrallë, u zhvillua në gjuhët sllave të Ballkanit mund të shpjegohet me ndikimin e dialekteve lokale shqipe dhe rumune. Në historinë e gjuhëve sllave jo-ballkanike një tingull i tillë nuk është shfaqur (për më shumë shih, midis të tjera Sawicka 2001).

Bibliografi

- Jakobson R., 1931, *Über die phonologische Sprachbünde*, Travaux de cercle linguistique de Prague, 4.
- Sawicka I., 2001, *Lidhje midis hundoresisë dhe reduktimit në gjuhëve ballkanike*, Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare XIX, Prishtinë, 283-286.
- Топоров В. Н., 1965, *Несколько замечаний о фонологической характеристике центрально-азиатского языкового союза*, [në:] *Symbolae linguisticae in honorem Georgii Kurylowicz*, Wrocław, 322-328.
- Трубецкой Н.С., 1923, *Вавилонская башня и смешение языков*, Евразийский временник III, Берлин, 1923, 107--123.
- Якобсон Р., 1962, *К характеристике евразийского языкового союза*, [në:] R. Jakobson, *Selected writings I. Phonological studies*, 's-Gravenhague.

Irena SAWICKA, Varshavë

Z ZAGADNIEN FONETYKI BAŁKAŃSKIEJ

Przedotyczące Bałkańskiej Ligi Językowej bardzo rzadko poruszają zagadnienia fonetyczne. Zazwyczaj informacje fonetyczne ograniczają się do wymienienia dwóch cech uważanych za bałkańskie. Jest to występowanie grup spółgłoskowych *mb*, *mp*, *nd*, *nt*, *ŋg*, *ŋk* w pozycji inicjalnej w wyrazie, a druga cecha to występowanie średniej, środkowej samogłoski, tzw. szwy jako samodzielnego fonemu. Te skromne uwagi nie wyczerpują zagadnienia. Po pierwsze informacje na temat tych cech wymagają rozwinięcia i weryfikacji, po drugie, nie są to jedyne cechy fonetyczne, jakie zasługują na miano bałkańskich, po trzecie, zakres bałkanizmów fonetycznych jest nieco inny niż cech morfoskładniowych. Pozostałe, na które warto zwrócić uwagę to, co najmniej, rodzaj akcentu, rodzaj sandhi międzywyrazowego, pewien rodzaj cytacyzmu, frekwencja grup samogłoskowych. Cechy te koncentrują się na styku macedońsko-albańsko-greckim. Jest to też teren współcześnie zachodzących konwergencji także na innych poziomach języka, podczas gdy na obszarze bułgarsko-rumuńskim, gdzie na skutek powstania państw narodowych grupy mniejszościowe uległy znacznemu ograniczeniu, a zatem też multilingwizm, procesy konwergencyjne praktycznie ustały.

Tutaj chcielibyśmy powiedzieć parę słów na temat środkowej samogłoski, która na Bałkanach występuje w różnych odmianach fonetycznych, niższych i wyższych, mniej lub bardziej przednich czy tylnych, a której fonologiczność powszechnie traktowana jest jako cecha bałkańska. Moim zdaniem nie jest to słuszne. Aby jakiś segment został uznany za cechę charakteryzującą ligę językową, nie wystarczy, że rozwinął się, albo zachował pod wpływem kontaktu językowego, ale także musi on występować na zwartym terytorium, wokół którego segment ten nie występuje. Szwa fonologiczna nie spełnia tego warunku. Istotnie w większości dialektów bałkańskich występuje fonologiczna szwa: taki fonem występuje w albańskim i bułgarskim, w skrajnych dialektach serbskich, a w rumuńskim mamy nawet dwie samogłoski tego typu. Szwa nie występuje natomiast w greckim, w zachodnio-centralnej części obszaru macedońskojęzycznego, a także w większości dialektów geگیjskich, w których szwę interpretujemy jako segment niefonologiczny, uwarunkowany pozycyjnie, fragment kombinatorycznej realizacji sonantu. Na przykład formę *letrën* zinterpretujemy fonologicznie jako /letrn/ - fonem /n/ ma w tej pozycji realizację [ən] – jest to rezultat ograniczeń wynikających ze struktury sylaby. [ə] w dialektach geگیjskich występuje zawsze przy sonancie, który stoi w pozycji zakłócającej linię sonomości sylaby. Wstawienie [ə] likwiduje ten problem. W innych pozycjach szwa pojawia się zupełnie wyjątkowo. Tak więc fonologiczna szwa występuje na absolutnie zwartym obszarze, są na terenie Bałkańskiej Ligi Językowej miejsca bez szwy i to są właśnie te miejsca, na których występują pozostałe bałkanizmy fonetyczne i zjawiska konwergencyjne są aktywne. Ale nie to stanowi najważniejszą przeszkodę w uznaniu fonologicznej szwy jako cechy bałkańskiej. Dźwięki typu szwy są bardzo częste w

1. Bashkëtingllorja /l/ në ballë të fjalës është ruajtur e pa ndryshuar, p.sh.: *lidh* nga lat. *ligare*, *lafshë* nga lat. *laxa*, *larg* nga lat. *largus* etj. Nga kjo rregull, sipas Pedersenit, duke u mbështetur edhe në fjalët ,të cilat dalin me /ll/ nistore nuk e kanë pasur këtë fonemë që në krye të herës, por para saj ka qëndruar një zanore që me kohë ka rënë, sepse ishte e pakteksuar. Kështu emri *llanë* /llërë/ lidhet me rrënjën ie. *elei*”përkul” (**elena*) etj.
2. Bashkëtingëllorja /l/ është alternuar në /ll/ kur ndodhej ndërmjet dy zanoreve: *engjëll* nga lat. *angelus*, *kapruall* nga lat. *capreolus* etj.
3. /L/-ja është ruajtur kur ndodhej në grupe të bashkëtingëlloreve: *plep* nga lat. *plopus*. Nga kjo rregull fjalët që përbëjnë grupe bashkëtingëlloresh me prapaqiellzoren /ll/ nuk janë burimore, por janë huazuar nga gjuhët me të cilat shqipja kishte kontakte nëpër mote të ndryshme: *vllah* nga greq. *vllahes*, *flad* nga sll. *hlad* etj.
4. Nga /ll/ ka dalë bashktingllorja /l/: *gjel* nga lat. *gallus*, *kalë* nga lat. *caballus* etj.

Në huazimet italiane përkundër kësaj rregulle, /ll/ ka përfunduar në /ll/, d.m.th. është ruajtur: *kaptjell* nga ital. *capitello* etj.

5. Tipi i tretë i /l/ është qiellzorja /lj/, që brenda shqipes ka evoluar në /j/, por në disa të folme periferike të shqipes, si në labërishte e çamërishte ka përfunduar në /l/: *golë* nga *golja*, *fëmilë* nga *fëmilj* (lat. *familia*), *val* (nga lat. *olium*). Ndërsa në të folmet italo-arbëreshe dhe në ato të arbërorëve të Greqisë realizohet dendur palatalja /lj/: *ljumë*, *djalj*, *kljarë*, *kuelj*, *kljumësht*, *kljiç*, *mjaljtë*, *ljulje*, *ljepur*, *kopilje* etj.

Edhe profesor Ajeti e vë në shqyrtim /l-në në të gjitha pozicionet: në ballë të fjalës, në mes të fjalës, në pozicion fundor, në fjalët e huazuara, duke mos lënë anash edhe ndikimin e këtij konsonanti mbi tingujt e tjerë, kur ai ndodhet në bashkëvjajtje në leksemat e fondit leksikor të mbarë shqipes. Mirëpo, mospërfillja e tipit të tretë të kësaj sonante palatale tregon qartë se profesori kishte mangësi në njohjen e të folmeve arbëreshe, ku kjo fonemë, sipas shembujve të përmendur më sipër, na del dëndur me vlerë fonologjike.

Në fillim të këtij shekulli më saktësisht më 2001 studiuesi Kolec Topalli, pos botimeve të disa vëllimeve të tjera, që kapin cep më cep gjithë problematikën e fushës së fonetikës historike të gjuhës shqipe, botoi edhe monografinë me titull: *Sonantet e gjuhës shqipe (2001)*, që në kreun VIII të njësisë me titull *Sonantet e lëngëta anësore*, hiç më pak se 30 faqe ia kush-ton tingullit /l/, që pa dyshim, saktësimet, që sjell ky studim janë të plota, të sakta dhe të mbështetura shkencërisht. Sa i përket shpjegimit të tipave të sonantes /l/ shkon edhe më tutje se pararendësit e tij, ngase derisa Peder-sen-i në shpjegimet, që i bëri, kryesisht u mbështet në fjalët e fondit auto-kton dhe të huazimeve latine e greke, Kolec Topalli, jo vetëm në monogra-finë, të cilën e përmendëm më sipër, por edhe në veprën madhore *Fonetika historike e gjuhës shqipe, Tiranë, 2007*, këtë fonemë e shpjegon edhe në huazimet e tjera, si: latine, sllave, romane, greke, turke, të cilat gjithsesi kanë hyrë më vonë në gjuhën shqipe”...atëherë kur shndërrimet e këtyre bashkëtingëlloreve kishin marrë fund”³

Pra, krejt në fund të kësaj kumtese lirshëm mund të themi, se profe-sor Ajeti me seriozitetin dhe objektivitetin e një studiuesi dhe shkencëtari të devotshëm me një kulturë të gjerë gjuhësore, me një mendje të kthjellët, edhe në fushën e fonetikës historike shënon gjykime e konkluzione, që, pa u trembur fare, do t’i qëndrojnë dhëmbit të kohës edhe për shumë mote.

³ Kolec TOPALLI, *Fonetika historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 265.

Gjovalin SHKURTAJ, Tiranë

HULLI TË MBARA DHE KONTRIBUTE TË AKAD. IDRIZ AJETIT NË FUSHËN E DIALEKTOLOGJISË DHE TË ONOMASTIKËS SHQIPTARE

(Kumtesë për 100-vjetorin e Idriz Ajetit, Prishtinë, 27 Janar 2017)

Abstrakt

Akad. Idriz Ajeti është një nga studiuesit më jetëgjatë dhe me veprimtari të shumënduershme studimore në lëmin e albanologjisë. Në rrethin e gjerë të studimeve të tij shumëvjeçare ai është marrë edhe me dialektologji, duke bërë aty punë prej pionieri; u mor me hetimin dhe paraqitjen e tipareve gjuhësore më kryesore të disa prej të folmeve shqipe, sidomos të Ljarjes dhe të Shestanit, të së folmes së Istries, si dhe të arealit të vendlindjes së tij Preshevës e Bujanovcit.

Qysh në hulumtimet e tij më të hershme, të kryera kur ishte ende i ri, Idriz Ajeti lakmoi t'u jepte përparësi ndjekjes, përqasjeve dhe shqyrtimeve të holla dialektologjike rreth disa tipareve të moçme që ndejnë hapësirat ruajtëse të diasporave historike shqiptare dhe të folmet anësore të shqipes, me bindjen e patundur se fjalët, kuptimet dhe onomastika e trevave anësore të shqipes do t'i sillnin fryte të shumta në përqasjen e kundrimet krahasuese të atyre dukurive me dokumentet sado të pakta të shqipes së shkruar. Me atë ideim të mbarë ai do të ndërmernte një punë përqasëse e krahasimtare frymëgjatë, duke kërkuar e gjetur aty prurje të reja me vlerë që mbështetnin e përforconin pohimet e tij rreth hershmërisë së shqipes dhe të shqiptarëve në trojet e veta të hapësirës ballkanike. Në të folmet dhe dialektet anësore të shqipes, prof. Ajeti shikonte lëndë shumë të vyer për përthekimin e shqyrtimeve të tij të hapëta e të shumënduershme rreth vlerave të mëdha të gjuhës së "Mesharit" të Gjon Bdek Buzukut, prandaj qysh herët, hulumtoi enkas e me ngulm të pashoq në atë areal, u pykëzua në të folmet shqipe të Ljarjes dhe të Shestanit, si dialektolog dhe si gjurmues i onomastikës historike dhe si etimolog nga më dorëmbarët.

Pastë jetë e shëndet edhe më tej profesori ynë i nderuar që t'i gëzojë vlerësimet dhe fjalët e miradijes për ndihmesat e tij të vyera jo vetëm në lëmin e dialektologjisë dhe të onomastikës, po edhe në fusha të tjera me rëndësi themelore për gjuhësinë shqiptare.

Shaban SINANI, Tiranë

KËRKIMET SHKENCORE SI ETNOGJUHËSI NË STUDIMET E PROF. IDRIZ AJETIT

Studimet gjuhësore të prof. Idriz Ajetit, në mënyrë të veçantë ato në fushë të etimologjisë, të marrëdhënieve të ndërsjella të shqipes me gjuhët e popujve sllavë të Ballkanit dhe të dialektologjisë, përveç qëllimit parësor për të cilin janë shkruar, kanë shumë interes dhe rëndësi edhe për *studime etnogjuhësore* e *antropogjuhësore*. Ato mund të shërbejnë si pikënisje dhe nxitje për shqyrtime të reja në fushën e *gjuhësisë etnotekstore* dhe në *arkeogjuhësi*, dy nëndisiplina ku studimet shqiptare kanë hyrë vonë.

Këtu nuk është fjala thjesht për ato studime të prof. Idriz Ajetit, që kanë interesim parësor të shpallur dhe lidhje të drejtpërdrejtë me etnosin dhe etnologjinë e shqiptarëve, si *Prejardhja e disa emërtimeve të miteve dhe të demonëve në gjuhën shqipe*¹ dhe *Emërtime popullore shqiptare të gjellëve e të ushqimit në vështrim gjuhësor*²; apo për vëmendjen e vijueshme që u kushtohet në studimet e tij trashëgimive joshkrimore e shkri-more të ngulimeve shqiptare jashtë kufirit të vet gjuhësor, si arbëneshët e Zarës apo shqiptarët e Istrias, Sremit dhe të ngulimeve të tjera të tyre në Europën Qendrore dhe Lindore, në të cilat, krahas të dhënave dialektologjike e gramatikore, jepen dhe dëshmi të drejtpërdrejta të karakterit etnografik (etnonimet që morën me vete, endonimet, ekzonimet, historia e ndarjes prej bashkësisë etnike). Me këtë trajtesë priremi të dritësojmë rëndësinë etnotekstore të atyre studimeve të prof. Idriz Ajetit, që e kanë

¹ U botua fillimisht në gjuhën serbokroate në *Godišnjak*, vëll. III, izd. *Centar za balkanološka ispitivanja*, lib. 1, Sarajevo 1965, f. 111-118, me titullin *Poreklo nekih mitskihi demonskih naziva u šiptarskom*.

² Këtë artikull kemi pasur mundësi ta këshillojmë në botimin në Idriz Ajeti, *Vepra*, vëll. 3, bot. i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Prishtinë 1998, f. 185-192.

këtë përbërëse gati të padukshme, disi *përanash*, dhe që kërkojnë vëmendje të thelluar për të tejshkuar përmes fjalës deri në frymën dhe shpirtin e gjuhës shqipe dhe në origjinalitetin e saj.

Si një prej njohësve autoritarë të marrëdhënieve historike ndërdhënëse të shqipes me gjuhët në kufi, sidomos me serbokroatishten, dialektet dhe të folmet lokale të saj, prof. Idriz Ajeti u ka krijuar studiuesve të rinj lehtësinë e madhe për të fytyrëzuar disa *dëshmi e vlera etnogjuhësore dhe arkeogjuhësore të shqipes*. Larg çdo romantizmi të vjetër dhe neoromantizmi gjuhësor të sotëm, që shpesh shkon deri në vullnetarizëm shkencor e aventurizëm, si dhe përtej përlllogaritjeve të karakterit thjesht sasior për të vërtetuar praninë e shqipes në gjuhët që e kanë rrethuar historikisht, prof. Idriz Ajeti ka arritur të përveçojë disa marrëdhënie gjuhësore tejet të ndërlikuara, të cilat kanë të bëjnë jo thjesht me *huazimet prej saj*, por bashkë me to edhe me *shtegtimin e brendësisë së fshehtë të shqipes* dhe të figurshmërisë së saj si bartëse kulture në *gjuhën tjetër*.

Pikërisht *gjuha e tjetrit*, fjala a dukuria gjuhësore e shqipes në një *mjedis aloglot*, janë ato që lehtësojnë njohjen me disa të dhëna sa të kriptuara aq dhe të rëndësishme për *antropogjuhësinë, etnogjuhësinë, psikogjuhësinë dhe etnotekstet*. Ndoshta këtë ka pasur parasysh përkujdesësi i botimit *Pararendësi*, prof. Rexhep Ismajli, i cili ka përzgjedhur dhe pranëvendosur me një fqinjësi tematologjike shumë evidente një koleksion studimesh të botuar ndër dekada nga autori, me një mëtim të dukshëm për të pahësuar kontributet e Idriz Ajetit për shqipen brenda sllavishtes, sidomos brenda asaj në ish-Jugosllavi³. Këtu ne përqendrohemi vetëm në

³ Idriz Ajeti, *Pararendësi - përzgjedhje punimesh nga akademik Idriz Ajeti* (nën përkujdesjen e akademik Rexhep Ismajlit, bot. Koha, Prishtinë 2011. Në këtë përzgjedhje, disa nga studimet më të rëndësishme të prof. Idriz Ajetit, që janë me rëndësi antropogjuhësore për studimet shqiptare, jo rastësisht janë grupuar si një nënpjesë: *Arritjet kryesore të studimeve etimologjike të shqipes; Mbi disa fjalë e shprehje shqipe në dialektet e sllavëve të Jugut; Për gjallërimin e studimeve gjuhësore ballkanike dhe për disa huazime shqiptare në të folmet serbokroate; Kontribut për studimin e onomastikës mesjetare në territorin e Malit të Zi, Bosnjë-Hercegovinës dhe të Kosovës; Zhvillime paralele fonetike dhe ndikime të ndërsjella të dialekteve shqiptare dhe serbe të Kosovës; Emërtime gjeografike në shqipen dhe serbokroatishten janë vetëm disa prej këtyre studimeve. Nuk është e rastit që këto studime gjenden thuajse me të njëjtën renditje në vijim të njëri-tjetrit edhe në vëllimin me studime *Studime për gjuhën shqipe**

disa prej rasteve më tipologjike, kur studimet etimologjike, dialektologjike e ato historiko-krahasuese të prof. Idriz Ajetit mundësojnë *interpretime etnotekstore* dhe thellimin e kërkimeve për mbijetesën e shqipes nën *zhguallin e gjuhës së tjetrit*, në të folmet kufitare me të të serbëve e malazezëve.

1. Kjo mbijetesë e shqipes jashtë kufirit të saj, atje ku shfaqet në përdorim në kontekste aloglote, prej folësish që nuk e kanë atë gjuhë amtare, duke përfshirë dhe ligjërimet më konservative, si këngët heroike legjendare (*srrpske junačke pjesme*), provohet deri në shkallën e *diskriminimit të rendit të eptimit të gjuhës ku ka hyrë*, siç është rasti i formave emërore në *trajtë të shquar me nyje të prapavendosur*, tipike për natyrën e shqipes, të antroponimeve të këngëve të ciklit të Krajleviq Markut të folmet e serbëve të Kosovës:

*Lov loviše tri srpske vojvode
Jedno beše Marko Kraljević
Drugi beše Miloš Kopilić
Trećo beše Relja Krilatić
... ..
Čuješ li me Marko Kraljević
Kad to začu Kraljević Marko⁴.*

*Gjojë po gjuenin tre serbët
vojvodë,
Bash në krye Marko Krajleviqi,
Mbas po i vjen njaj Milosh
Kopiliqi
Qyr dhe i treti, Relja Krilatiqi
... ..
A po m'ngion ti Marko
Krajleviqi,
Kur të m'ngiosh ti Marko
Krajleviqi*.*

Në këto vargje guslari serb i Kosovës ia ka nënshtruar formën e eptimit të emrave të kreshnikëve që u këndon *rendit të dukurisë së shquarësisë së shqipes*, me prapavendosje të nyjes, si në këngët heroike legjendare që këndon rapsodi shqiptar. Duke qenë se këto këngë janë më së shumti dygjuhëshe, krahasimi na e bën më të dukshme vetë shkallën e pranisë së

(*Vepra të zgjedhura*), f. 581-665, botuar *in honorem* në 100-vjetorin e lindjes së autorit, zgjedhi e përgatiti akademik Rexhep Ismajli, bot. i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Prishtinë 2017.

⁴ Idriz Ajeti, *Ndikimi i shqipes në të folmet serbe të Kosovës*, në *Vepra*, vëll. 4, bot. Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Prishtinë 2001, f. 93.

* Përshtatja në gjuhën shqipe është jona.

shqipes në gjuhën në kufi. Në këtë rast kemi të bëjmë me *pranim dukurie*, me pranim rendi gjuhësor, dhe jo thjesht me prani të shqipes në gjuhën tjetër, çka do të thotë dhe me një hierarki më të lartë pranimi⁵.

2. Në fillim veçojmë kategorinë e huazimit të kalkuar të *njësisë shprehëse të shqipes me përbërje fjalie*, përfundim i një procesi të gjatë përngjitjeje, deri në atë shkallë sa edhe vetë përdoruesi i zakonshëm i shqipes nuk ka kompetencë të rindërtojë në mënyrë prapavajtëse procesin që ka ndodhur. Studiuesi Idriz Ajeti me të drejtë e sheh thirrmen *kojunak - kojunaci* të disa të folmeve të malazezve si përkthim të fjalës shqipe *kushtrim*, në krye të herës *kush është trim*, *kush a trim*, që ka hyrë edhe pa kalkim në këto të folme, në formën *uçini kuštrim*, *jepni alarmin*⁶.

Në gjuhën shqipe përngjitjet e atyre që mund të quhen *fjalë-thirrma* janë burimore. Përveç që ruhen në *kontekste etnojuridike kanunore*, në të cilat edhe infinitivi ruan disa vlera aspektive-modale me karakter urdhërues), ato kanë *një gjedhe të hershme së paku mesjetare*, siç dëshmohet edhe prej njëfjalësimit të *e-mbë-tha*, *mbi ta*, që sot shihet më shumë si një *pasthirrme* se si *fjalë-thirrme*⁷. Ka shumë të ngjarë që edhe në të folmet malazeze në krye kalkimi të ketë qenë analitik: *ko je junak*, *kush është trim*,

⁵ Idriz Ajeti dyshon në tri mundësitë e interpretimit të kësaj dukurie në serbishte, propozuar në studimet e Murat Blakajt: **1.** Si një rrokje e shtuar thjesht për nevoja metrike; **2.** Si mbaresë shumësi (devijante); **3.** Si mbaresë e thirrores (devijante). Por nuk shprehet për mundësinë që ndikimi të jetë prej shquarësisë së shqipes dhe prapavendosjes së nyjes në shqip e në disa gjuhë ballkanike. Shih Idriz Ajeti, *Ndikimi i shqipes në të folmet serbe të Kosovës*, në vep. cit., f. 396-397. Pikëpamjen e Murat Blakut për këtë çështje e kemi gjetur në artikullin e tij *Ndikimi i shqipes mbi të folmet serbe të Kosovës*, botuar në *Gjurmime albanologjike*, seria e shkencave filologjike, nr. 24/1994, bot. i Institutit Albanologjik, Prishtinë 1995, f. 29-38 dhe në monografinë me të njëjtin titull *Ndikimi i shqipes mbi të folmet serbe të Kosovës*, që përmban edhe lëndë leksikore të përzgjedhur, bot. Instituti Albanologjik, Prishtinë 2010.

⁶ Shih I. Ajeti, *Studime të ndërsjella etimologjike albano-sllave*, në *Studime dialektore dhe etimologjike*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë 2005, f. 353-354. Shih dhe *Mbi disa fjalë e shprehje shqipe në dialektet e sllavëve të Jugut*, në *Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*, Prishtinë 1980, f. 127-135.

⁷ Sipas disa studiuesve, kjo fjalë, në formë të ngurtësuar e të inkuorporuar, del në shekujt mesjetarë në një kontekst gjuhësor latin. Ndërsa I. Kadare lashtësinë e saj e ka shprehur me vargjet: *Nga kaosi i gërmadhëve / Që koha pas e la / U ngrit e na erdhi / Kjo fjalë: "Embëtha!"*.

kush është kreshnik, dhe shumësi *kojunaci* të jetë formuar pas një përngjitjeje të shkallës së parë. Këtu është me vend të përmendet se në epikën heroike legjendare fjala *trim*, që i përgjigjet serbokroatishte *junak*, përdoret dendurisht, madje në të folmet arbërishte *trim* përdoret dhe për djalin e dashuruar (*trimi* dhe *vasha*). Kurse fjala *kreshnik* është më shumë një preferim i studimeve mbi eposin, se sa i lahutarit të eposit vetë⁸.

Më të vona duhet të jenë ato idioma që gjenden edhe sot në të folme jugore të serbokroatishtes dhe që ende ruajnë *formën e shprehjes së cituar* duke qenë të rrethëqarkuara prej lëndës së gjuhës tjetër, domethënë në mjedis joshqip. Rasti më domethënës do të ishte ai i fjalës së urtë që gjen në këto të folme prof. Idriz Ajeti: *Ako nekoga hoćeš da uklješ, rekni mu "tu rit mendja"* - *Nëse don të mallkosh dikënd, thuaji "t'u rritë mendja"*, që është tipike për ligjërimet veriperëndimore të gegnishtes⁹. Është me shumë interes të studiohet më në thellësi shtresëzimi i lëndës së shqipes në të folmet e sllavëve të Jugut sipas shkallës së tretjes, gjegjësisht vetëruajtjes në mjedisin e ri.

3. Prania e idiomatikës shqipe në të folmet e sllavëve të Jugut, që në thelbin e vet është *prani e figurshmërisë* së saj (figuracionit gjuhësor), çështje së cilës prof. Idriz Ajeti i ka kushtuar disa studime¹⁰, bën të mundur

⁸ Çështjen e mbisundimit të formës *trim* në vend të *kreshnik* në eposin heroik legjendar shqiptar dhe të imponimit të papërligjur të termit *kreshnik* në botime prej mbledhësve e studiuesve e kemi trajtuar më gjerësisht në *Këngë trimash apo këngë kreshnikësh*, në *Etnos në epos*, Tiranë 2011, f. 75-120.

⁹ Idriz Ajeti, *Studime të ndërsjella etimologjike albano-sllave*, në vep. cit., f. 356.

¹⁰ Përveç studimeve të cituara, kemi parasysh dhe: *Raportet e shqipes me gjuhët ballkanike*, në *Vepra*, vëll. 3, bot. i Akademisë së Shkencave dhe Arteve, Prishtinë 1998, f. 207-216; *Rreth disa emrave topikë me prejardhje shqiptare në Mal të Zi në vështrim gjuhësor*, po aty, f. 291-298; *Shqipja e vështruar nga aspekti i studimeve ballkanistike*, në *Vepra*, vëll. 4, Prishtinë 2001, f. 13-22; *Marrëdhëniet gjuhësore sllavo-shqiptare*, po aty, f. 23-26; *Zhvillime paralele fonetike dhe ndikime të ndërsjella të dialekteve shqiptare dhe serbe të Kosovës*, po aty, f. 27-34; *Studime të ndërsjella etimologjike albano-sllave*, po aty, f. 35-50; *Emërtime gjeografike në shqipen dhe në serbokroatishten*, po aty, f. 101-110; *Kontribut për studimin e onomastikës mesjetare në territorin e Malit të Zi, Bosnës e Hercegovinës dhe të Kosovës*, po aty, f. 111-124; *Rreth disa abanizmave në "Fjalorin" e Vuk Karaxhiqit*, në *Vepra*, vëll. 5, f. 25-32; *Albanistika jugosllave dhe disa probleme të saj*, po aty, f. 51-62; *Raportet e shqipes me gjuhët ballkanike*, në *Studime dialektore dhe etimologjike*, vep. cit., f. 425-434.

që të provohet mbijetesa e fjalës shqipe në një proces riformimi me mjete të gjuhës tjetër, që ka mbetur i pambaruar, i pambyllur. Këtu është fjala për atë kategori huazimesh frazeologjike për të cilat kalkimi rezulton proces i pakryer dhe ndoshta nuk do të kryhet ndonjëherë, si idiomat *nijesam ngušt za, to nije ngušt za to - s'jam në hall për atë punë, s'është në zor për atë gjë, nuk jam ngushtë për këtë çështje*. Në këtë kalkim fjalës *ngushtë*, me burim latinishten *angustus* (it. *angoscio*), por gjithsesi protoshqiptare, për shkak të humbjes së zanores nistore, folësi malazez nuk i ka gjetur një gje-gjëse dhe e ka pranuar si në shqip, për hir të tërësisë kuptimore të mendimit. E tillë mbetet gjithashtu fjala *shyt - shytë*, me kuptim *pa brirë*, që përdoret pa përkthim në shprehjet idiomatike të këtyre të folmeve: *šuto je bez njega, što mi je šuto bez nega*¹¹. Sigurisht, malazezi e përdor fjalën e shqipes *shyt-ë* jo në kuptimin e supozuar *jam pa brirë pa të, më duket vetja pa brirë për të*, por në kuptimin figurativ që ka marrë fjala: *jam mangut pa të, si më duket vetja mangut pa të*.

4. Janë jo pak rastet e pranimit të fjalës shqipe pa kushte, pa përkthim a kalkim, madje dhe pa nënshtrim ndaj rendit gramatikor të serbokroatishtes, që kanë të bëjnë me një prej ligjërimeve më konservativë të shqipes, me ligjërimin kanunor-etnojuridik, të cilin edhe vetë shqiptarët e përdorin si një mënyrë gjysmë të gatshme komunikimi. Kështu ka hyrë në serbokroatishte fjala *gurapesh*, si shenjues i *gurit të bē-së* dhe të përmbarrimit të së drejtës¹², që Idriz Ajeti e gjen edhe në "Fjalorin" e Gl. Elezović-it, në formën *gurapesh*, të shpjeguar prej tij si huazim nga shqipja, me përdorim etnografik: *u arnautski jeziku toga kraja znači bacanje kamena, ali ne s ramena, nego iz medju nogu i s mesta*¹³. Ky është rasti i depërtimit të fjalës shqipe bashkë me kategorinë etnojuridike tradicionale që mund të quhen përjashtimisht shqiptare, i *albanizmave të dyfishtë*: gjuhësorë dhe antropogjuhësorë. Mbetet objekt me shumë interes për studiuesit veçimi i

¹¹ Idriz Ajeti, *Studime të ndërsjella etimologjike albano-sllave*, në vep. cit., f. 358.

¹² Në *Kanunin e Lekë Dukagjinit* (mbledhë e kodifikue prej At Shjefën Gjeçovit, Shkodër 1933), për fjalën *gurapesh* jepet ky shpjegim: *Kufini i fituem me "gurapesh" a me rrasë të ngarkueme. Heret-heret, kur s'kë kë në pushka ndoshta, në të dām të kufive qitej në punë gurapeshi për kufije t'afërta, e për të largtat bâhej gadi një rrasë a gūr sâ bindi me një "kush i del!", d.m.th. me u ngarkue me të*.

¹³ Idriz Ajeti, *Fjala shqipe në "Fjalorin" e Gl. Elezović-it*, në *Vepra*, vëll. 4, f. 68.

këtyre albanizmave të dyfishtë nga rreth 300 fjalë shqipe që prof. Idriz Ajeti gjen në *Fjalorin* e Gliša Elezović-it¹⁴.

Në të folmet e gjalla këtij regjistri ligjërimit të sllavëve të Jugut, që, ashtu si ligjërimi në rapsodinë heroike legjendare, sipas përcaktimit të Albert B. Lord, *janë një gjuhë më vete*, rast më vete është ai i pranimit të fjalës *besë*, me kuptimin *časna reč, vera, kletva (fjalë nderi, betim)*, që, si-kurse dihet, është një fjalë e ballkanizuar¹⁵. Por rasti i hyrjes së saj në serbokroatishite është edhe më specifik, sepse fjala *besë* gjendet në këtë gjuhë *bashkë me çerdhen fjalëformuese dhe frazeologjinë që këtë fjalë e ka në bazën e vet*. Idriz Ajeti, bashkë me fjalën *besë*, identifikon edhe formimin mbiemëror *besnik, besenik* (edhe *besali, bisali*, me prapashitesim të një formanti të turqishtes); shprehjen e ngurtësuar si formulë betimi *besa-bes*; si dhe idiomat: *besa je sadjena iskwarena (besa është punë e mbaruar)*; *pod besu je (je në besën time)*; *besa-bes (besëlidhje)*; *besa platiću ti (për besë do të të paguaj)*; *besenik, besnik, kaže se za čoveka koji tvrdio drži zadatu reč (thuhet për njeriun që e mban fjalën e dhënë)*¹⁶.

5. Një tipologji më vete të rasteve të shumtë të pranisë së albanizmave gjuhësorë e antropogjuhësorë në gjuhët e sllavëve të Jugut është ajo e *fjalëve që kanë domethënien e kategorive etnodalluese të shqiptarëve*, të kodeve morale, që kanë shërbyer si rregullatorë të rendit tradicional të jetës së tyre. Në këtë trajtesë do të veçonim dy prej tyre: *burnija*

¹⁴ Termin *albanizma*, për fjalën shqipe në gjuhët sllave që ka zënë vend në fjalorë (jo për çdo fjalë shqipe me përdorim rastësor në të folme të sllavëve të Jugut), Idriz Ajeti e përdor edhe në titullin e parë të art. të cit., *Albanizmat në "Fjalorin e të folmeve serbe të Kosovë-Metohisë"* të Glisha Elezovićit, botuar në *Studime gjuhësore në fushë të shqipes*, vëll. I, bot. Rilindja, Prishtinë 1982, si dhe studimin *Rreth disa albanizmave në "Fjalorin"* e Vuk Karadžić-it, në Idriz Ajeti, *Vepra*, vëll. 5, f. 25-32. Krhs Gliša Elezović, *Rečnik kosovsko-metohijskog dijalekta*, Beograd 1932.

¹⁵ Sa u takon dukurive gjuhësore të ballkanizuara me pikënisje lëndën e gjuhës shqipe ose së paku me faktor veprues shqipen, shih më gjerësisht Rexhep Ismajli, *Studime për historinë e shqipes në kontekst ballkanik*, bot. i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Prishtinë 2016; më herët nga i njëjti autor: *Mbi disa toponime në Serbi të Jugut dhe në Maqedoni të Veriut*, botuar në *Gjurmime albanologjike*, nr. 1-2, bot. i Institutit Albanologjik, Prishtinë 1970.

¹⁶ Po aty, f. 56. Shih gjithashtu dhe Anila Omari, *Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe*, bot. i Qendrës së Studimeve Albanologjike, Tiranë 2012.

dhe *nerzija*, që zëvendësojnë njëra-tjetrën sipas nesh si sinonime të fjalës *nder* të shqipes: *nikakvu nerziju ima (s'ka kurrfarë burrnje, nderi); ti da imaš nerziju, tako ne bi učinijo (po të kishe nder nuk do të bëje ashtu)*¹⁷. Priremi të besojmë se në këtë rast të dyja fjalët duhet të referohen kuptimisht tek kuptimi referencial i fjalës *nder* të shqipes, sepse për *njerëzi* serbokroatishja ka fjalën *čovečnost*. Me këtë kategori bashkojmë dhe formulat e ngjushëllimit të të folmeve malazeze, që janë tretur në mënyrë analitike brenda saj, por duke ruajtur strukturën e gjuhës së burimit, shqipës, si në rastet *jesi (jeste) li tvrdji, nek vam je beričet u ostatak (a jeni të fortë, Zoti ju dhashtë fuqi të gjallëve)*¹⁸. Edhe këtë rast e konsiderojmë si *albanizëm të dyfishtë*, gjuhësor dhe antropogjuhësor, sepse bashkë me idiomën ka shtegtuar edhe fytyra e ritit shqiptar që njihet me fjalën *kryeshnosh*, *kryetshnosh*: *kryeshnosh për atë qi ju la, presin për kryeshnosh, shkoj për kryeshnosh*¹⁹.

6. Më vete mund të bashkojmë disa shprehje me kuptim të mbyllur, ku fjala shqipe është *e pranishme me një shmangie*, duke kuptuar me këtë thjesht devijancën morfonetike, *jo një formë të tronkuar* për shkak të ndërhyrjes së eptimit të gjuhës tjetër. Të tilla janë idiomat e të folmeve malazeze ku njëra njësi kuptimdhënëse është fjala *kret*, për *krejt*: *kret se dobravila (e ka marrë veten tamam, është përmirësuar tërësisht); bili smo blizu kret (ishim fare afër)*²⁰. Duhet thënë se dhe në shqip fjala *krejt* paraqitet me shmangie formale prej burimit të kuptuar të saj, *krejet*, si te *kryekrejet* apo *fund e krye*. Të ngjashme me to janë dhe ato idioma ku fjala shqipe ruhet, por me eptimin e gjuhës ku ka hyrë, si fjala *krenohem*, *krenohet*, që dalin në të folmet malazeze në formën *kreniše*: *kreniše se ona s tijem što je učinjela (mbahej me të madh për atë që kishte bërë)*²¹, edhe kjo

¹⁷ Idriz Ajeti, *Studime të ndërsjella etimologjike albano-sllave*, në vep. cit., f. 349.

¹⁸ Po aty, f. 351.

¹⁹ Dukuria e shtegtitimit të formulave të gatshme të urimit, ngjushëllimit, falënderjes dhe mallkimit është e njohur edhe në shqip. Në këngët heroike legjendare është ngulitur, për shembull, mirëseardhja e mikpritja urohen me idiomën e turqishtes *hoshgielden* (turq. *hoşgeldin, hoşgeldiniz*): *Kur n'Kotorr djali ka dalë / Motra e vet larg e ka pa / Para motra m'i ka dalë: / - Ti hoshgielden, ago, i ka thanë*. Shih tek Zymer U. Neziri (përg.), *Këngë të kreshnikëve*, antologji, Prishtinë, 2009, f. 180.

²⁰ Idriz Ajeti, *Studime të ndërsjella etimologjike albano-sllave*, në vep. cit., f. 353.

²¹ Po aty, f. 352.

prej së njëjtës rrënjë, *krye*, *kren*, ambicja për të qenë në krye, sot *krenari*²². Fakti që fjala-rrënjë ruan një formë tashmë të vjetëruar të fjalës dhe një kuptim që gjendet vetëm në disa ligjërime konservative do të thotë se hyrja e saj në sllavishtet duhet menduar mjaft e hershme²³.

Edhe frazeologjizmi *nijesu mi ruke sungulate*, fj. për fj. *nuk jam dorëcung*, *nuk më janë prerë duart*, që në shqip përdoret më gjerësisht në formën *nuk më janë tharë duart*, bashkohet më të njëjtin rast. Në shqip kemi edhe mbiemrin *krahëthatë*, për një njeri të padobishëm, që *s'i vlen puna*; si dhe formulën e mallkimit *t'u thafshin krahët*.

7. Përmes gjurmimeve të fjalës shqipe në të folmet sllave, prof. Idriz Ajëti përveçse ofron një lëndë të rëndësishme për studime *etnogjuhësore* e *arkeogjuhësore*, identifikon mikrotekste frazeologjikë që mund të marrin rëndësi për të rindërtuar *rende gramatikore të supozuar*, siç është rasti i shfaqjes së refleksivit dikur më aktiv *vetë* në idiomat e të folmeve serbe *sam drugi*, *sam treći* (*vetë i dytë*, *vetë i tretë*)²⁴. Gjurmë të këtij përemri mund të shohim dhe tek emri vetëvetori *vetë* (për të tria vetat: *unë vetë*, *ti vetë*, *ai vetë*), *vetë-a* për *njeri* / *njerëz* (*sa vetë ishin*); tek fjala (*i*) *vetëm*, me sa duket një përngjitje e shprehjes *vetë me*, më tej *vetë me vete*, *ai vetë*; tek emri abstrakt *vetmi* etj. Në poezinë e Josif Bagerit, dibran nga Reka e Epërme, ky përemër përdoret rregullisht si refleksiv për të tria vetat, siç duhet të ketë qenë në krye të herës, ashtu si në titullin e poezisë *Mësoni gjuhën e vet*, botuar në *Besa* (Konstantinopojë 1909). Tek poezia e Josif Bagerit mund të shihet rasti i fundmë i përdorimit me paradigmë të plotë të këtij përemri, që, siç dëshmojnë kërkimet e prof. Idriz Ajëtit, në të folmet e sllavëve të Jugut duhet të jetë përfutur përmes kalkimit të shprehjes:

²² Në ligjërimin ungjillor *krenia* dhe *përvujtnia* janë dy prej të përkundërtave të mëdha: *vesit* dhe *virtutit*. Në ligjërimin etnojuridik gjithashtu *krenia* është kategori etike e rendit parësor: *Po pat besë shpija e dorërasit, të rrijn me mend e me nierzi në punë të vet, të ruhen si burrnimi si edhe granija e mos t'i shkaktojn dâme as trazime, për në kioshin ngiatas me shpi të të vramit e mos të shesin kreni*. Shih At Shtjefën Gjeçovi (mbledhë e kodifikue), *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, nyje 886.

²³ Krhs veçanërisht Petar Skok, *Iz toponomostike južne Srbije*, izd. Glasnik skopskog naučnog društva, nr. XV-XVI, Skopje 1936.

²⁴ Idriz Ajëti, *Studime të ndërsjella etimologjike albano-sllave*, në vep. cit., f. 352.

Vetë, refleksiv si ka qenë

Hapni **t'vetat**, o t'mallkuet!

Fmia juej shqyp me msuet,

Se keq ju jini marruet!

Dhe gjuhën **e vet** harruet!

Vetë, në formën e rrudhur

Dhe kan shku një vise t'huaja,

Atje t'rrojn t'përvujt si grua!

Sikur s'kan vendin **e vet**,

Ah, të cilën kan lon shkret!²⁵

Këtu është vendi për të sjellë në vëmendje faktin që tek emri *vete-vetja* gjejmë edhe një kuptim të kryehershëm eufemistik sot fare pak i njohur, sidomos në të folmet geqe: leksemat *vete-vetja*, por edhe *nënvete-nënvetja*, për të shmangur përmendjen e organeve gjenitaleve, më shumë të mashkullit, por në disa raste për të dyja gjinitë²⁶. Gruaja, kur do të thotë se i biri a një djalë kushdo qoftë duke luajtur është vrarë në organet gjenitale, shenjojnë studiuesit, e shmang dhe nuk përmend fjalën emërtuese, por gjen ndonjë shprehje perifrastike eufemistike, si p.sh. *u vra në vehte* (Jug), *u vra n'vetin*, *u vra në vedi* (Veri). Shumësia e sinonimeve është e larmishme sipas krahinave dhe sipas gjinisë së folësit në situatat e ligjëritimit. Eufemizmat me përdorim më të shpeshtë ndër folësit e brezit të vjetër kanë qenë: *vete-vetja*, *n'vetin*, *n'vedin* (në *veten*): *po m'dhemp n'vetin*; *i ka ra shtjelp en vetin* etj.²⁷

Vlen të përmendet se në të folmet e sllavëve të Jugut fjala shqipe është huajtur edhe për këtë funksion, për përdorim eufemistik, siç është rasti i fjalës *šurek*: *bazdi na šurek* (*bie erë shurrë*), *uh što je ova voda vruć kao šurek* (*uh, ky ujë valë si shurrë*)²⁸.

8. Me kriptim informacioni etnoghjuhësor e antropoghjuhësor janë edhe idiomat që sot nuk kanë ndonjë shenjë të dukshme të shqipes, por janë përfitimet figurative, besëtytnitë dhe zakonet e njeriut shqiptar, disa

²⁵ Të dyja strofat janë të së njëjtës poezi të Josif Bagerit, me titull *Vajtim e mallkim*, botuar në gazetën *Shqipëria*, Bukuresht 16 prill 1899.

²⁶ Në vijim mund të përmendim gjithatë eufemizma që ndeshim në trevat tona për të zëvendësuar emërtimet përkatëse të organeve gjenitale: ... ai sendi, ai miku, **vete-vetja** (**vedi**, **në vetit**, **n'vedi**). Shih Gjovalin Shkurtaj, *Sociolinguistikë e shqipes: nga dialektologjia te etnografia e të folurit*, bot. Morava, citohet si në botimin e dytë, Tiranë 2009, f. 374.

²⁷ Arnisa Kushi, *Tabu dhe eufemizma të shqipes në përqasje me gjermanishten*, tezë doktorate, Universiteti i Tiranës, Tiranë 2014, f. 14 dhe f. 89.

²⁸ Idriz Ajeti, *Studime të ndërsjella etimologjike albano-sllave*, në vep. cit., f. 357.

cilësi e raporte etnotipike që lidhen me të, siç mund të mendojmë në shprehjet *obidem jelo* (kërkoj, ngjëroj gjellën, provoj gjellën); *uzela ga na oči* (e mori mësysh); *ne čini ga sas plačom* (mos e bëj me vaj, mos e bëj të qajë); *uzeti nekoga ljepotom* (marr më të mirë dikënd). Me këto frazeologjizma prof. Idriz Ajeti bashkon dhe *udara kiša, udara snijeg*²⁹, me përhapje në të gjitha arealet e të folmeve të serbokroatishtes, me kuptimin si në shqip *bie shi, bie borë*, që e gjejmë të ruajtur edhe në poezitë-lodra të fëmijëve tek arbëreshët sot: *Bie shi, bie bore / finarella me një dorë / Bie bore, bie shi / finarella me një si*.

9. Rasti më i rëndësishëm i pranisë së kuptimeve të ngurtësuara të fjalëve shqipe në gjuhët e sllavëve të jugut është ai i leksemave *cung*, i fjalëve që edhe për folësin e zakonshëm të shqipes janë pa çerdhe, i disa arkaizmave leksikorë, si fjala *lum*, që sot del në përdorim gati si një fjalë shërbyese. Pakkujt i shkon ndërmend për ta lidhur kuptimisht atë me *i lumi*, si eufemizëm për *Zot, Hyj* (ndoshta në shenjë respekti për njërin prej dhjetë ndalimeve: *mos e zër në gojë emrin e Zotit tënd*); më tej dhe me foljen me eptim tejet të reduktuar: *i lumtë, të lumtë, ia lumsha*; dhe me formimet emërore *lumni e lumnim, lumturi e i lumtur*. Studiuesi Idriz Ajeti e gjen këtë fjalë në idiomën e serbokroatishtes: *ljum ti sokaku, vaj ti konaku* (*lum mëhalla, vaj shtëpia*)³⁰. Të së njëjtës rrugë historike përftimi ngjajnë dhe *hip na konja, ždrip na konja* (gjithnjë në punë, *hip në kalë, zbrit nga kali*); *takam paša, hal madjupi* (*veshën pashë, vaktin përderës*); ku prania e fjalës shqipe njofton dhe burimin e formulës.

10. Si kategori të rëndësishme huazimesh me interes për studime etnoghjuhësore veçojmë edhe rastet kur gjuha tjetër ka pranuar formën e gabuar së në gjuhën shqipe, duke iu bindur një *kuptimi-shumë* që në të vërtetë nuk ekziston, si rasti i kalkut *konjski kamen*, për *gurkali*, duke e ditur që në shqip fjala *gurkali* është një formë e shtrembëruar e përngjitjes *gur i kaltër*, për shkak të një përfytyrimi të gabuar për lidhjen formale të dy përbërësve të saj. Kjo fjalë në shqip u përngjit duke mos e pasur asnjëherë në strukturën e vet fjalën *kalë*. Por, nga mjegullimi formal i përbërësve leksikorë, shprehja *gur i kaltër* përfundoi në *gurkali*, dhe më vonë

²⁹ Idem, vep. cit., f. 358-361.

³⁰ Idem, ibidem.

shqipja”gabo” edhe serbokroatishten. Me sa duket, kjo ndodhi fillimisht në të folmet gege, ku mbiemri *i kaltër* shkallë-shkallë doli jashtë gjuhës së folur dhe rasti më i mundshëm për përafrim formal për folësin e saj tashmë mbetej fjala *kalë*, *i kalit*, *gurkali*.

11. Së fundmi, pak fjalë edhe për të debatueshmen leksemë *ubla*, *umbla*, për burimin e së cilës gjuhëtarët Idriz Ajeti dhe Eqrem Çabej kanë mbajtur dy qendrimë mospajtuëse, i pari duke e shpjeguar me një rrënjë sllave *ubla*, *rrjedhë*, *burim*; kurse i dyti duke e lidhur me *ambël*, më tej me sa duket edhe me *t’ambël* (për *qumësht*)³¹. Nga të dhënat që kemi pasur rastin të mbledhim prej bartësve vendës në Krajë e Shestan, gjatë dy ekspeditave antropologjike të viteve të fundme, kemi mundur të vërejmë se *ublat* e këtyre anëve lidhen me *sakralizimin e ujit*, që ka një përhapje në gjithë hapësirën shqiptare (*ujërat shërimtarë*, *krojet e shenja*, krojet që mbajnë emrin *e Tinzot*). Sipas një gojëdhëne që kemi mbledhur prej një subjekti të moshuar dhe me arsim vetëm fillor, një udhëtar kërkoi ujë pranë një shtëpie në Krajë dhe i zoti i shtëpisë i nxori qumësht, sepse ujë nuk kishte. Udhëtari nuk ia bekoj qumështin të zotit të shtëpisë. Krajani, i prekur në sedër, ia ktheu: *Tamël, për ma mirë se ujë*. Dhe udhëtari ia ktheu: *Ujë, për ma mirë se tamël*. Kështu nis, sipas gojëdhënës, historia e krajanëve dhe shestanasve me *ublat*, pusët karakteristike për ujë të pijshëm, për ujë për tufat e bagëtive, për ujë për larje e pastërti e për ujë për barinjte, një histori që thuhet se nis para njëmijë vjetësh, kur Shën Gjon Vladimiri e Kosara ndërtuan të parën dhe më të madhen *ubël* të atyre anëve. Të dhënat etnografike nxisin për ta bashkuar këtë leksemë me shtegtimet e fjalëve shqipe në gjuhë të tjera në kuptimet e tyre eufemistike, natyrisht me shmangie fonetike që shpjegohen me të dhënat dialektore dhe mundësitë shprehëse të gjuhës tjetër. Dihet mirë përdorimet eufemistike janë pjesë shoqëruese e pandashme e dukurisë së sakralizimit. Idriz Ajeti qendroi në mendimin e vet për burimin e kësaj fjale deri kohët e fundme³².

³¹ Shih Idriz Ajeti, *Emërtime gjeografike në shqipen dhe serbokroatishten*, në vep. cit., f. 409. Idem, *Shqipja dhe gjuhët fqinje*, botuar në *Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit - Albanian and Balkan Languages* (red. Rexhep Ismajli), bot. i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Prishtinë 2012, f. 26-27. Krhs gjithashtu: Eqrem Çabej, *Ältere Stufen des albanesischen im Lichte der Nachbarsprachen*, botuar në *Zeitschrift für Balkanologie*, vol. II, 1964.

³² Njëherë unë kisha një mendim tjetër rreth etimologjisë së toponimit “Ombla”, dhe këtë e

12. Në përfundim pohojmë se etimologjitë e fjalës shqip të prof. Idriz Ajetit, kuptimet historike të tyre, ruajtja e tyre në shprehje të ngurtësuar, pranimi i tyre në gjuhët kufitare me kuptime eufemike, figurative dhe emocionale, kryesisht si formula shtegtuese, me ngjyresa të kriptuara, janë bazë e rëndësishme jo vetëm për arkeogjuhësinë, por dhe për etnogjuhësinë dhe studimet etnotekstore, ku fjala mban fshehur ritin, mendësinë, kategoritë etike shqiptare, ato vlera që quhen *albanizma*. Ky term, i përdorur nga vetë autori, qendron më saktë si përkufizim se termi i rëndomtë *huazim*, sepse nuk është fjala për një shtegtim fjale, por edhe për shtegtimin e mënyrës së të menduarit dhe të jetuarit të njeriut shqiptar.

Fakti që pjesa më e madhe e fjalëve shqip në gjuhët e sllavëve të Jugut vijnë prej ligjërimesh konservative, si ligjërimi biblik-ungjillor dhe ai etnojuridik; fakti që shumica e tyre kanë shtegtuar në këto gjuhë bashkë me cilësi, rite dhe tradita etnotipike shqiptare; si dhe fakti që përgjithësisht kalimi i kufirit për në gjuhën e tjetrit ka ndodhur kryesisht në kuptime të figurshme, në frazeologji, në ngërthim të pragmatikës me sintagmatikën, na bën të mendojmë se kemi të bëjmë me një dukuri që ka ndodhur relativisht herët. Kjo mundëson që shqipja të kërkojnë në gjuhën tjetër kuptime të humbura dhe forma arkaike të fondit të saj dhe njëherësh të identifikojë rolin e vet dhënës përmes shqyrtimesh etnogjuhësore dhe antropogjuhësore.

*shfaqja publikisht në fjalën time, pasi që ai tashmë e kishte botuar mendimin e tij. Kolegët më thanë se profesor Çabej do të inatoset, por, përkundrazi, ai ishte një burrë i madh, që i pranonte mendimet shkencore të tjetrit. Sigurisht, unë isha i bindur në mendimin tim, por me vinte keq t'i kundërvihesha profesor Çabejt, sepse ai më parë kishte shkruar mirë për mua. Kur u takuam, ai ma rrahu krahun dhe më tha: "Ke të drejtë!". Kështu është shprehur prof. Idriz Ajeti në lidhje me këtë debat shumë vite më pas, sipas Bahtjar Kryeziut dhe Begzad Baliut, në *Me profesor Eqrem Çabejn ishim dhe mbetëm miq*, intervistë e datës 20 shkurt 2016, botuar në *Rrapi shekullor - akademik Idriz Ajeti*, bot. Era, Prishtinë 2017, f. 258.*

Bibliografi

- Ajeti, Idriz, *Albanistika jugosllave dhe disa probleme të saj*, në *Vepra*, vëll. 4, bot. i Akademisë së Shkencave dhe Arteve, Prishtinë 2001.
- Ajeti, Idriz, *Albanizmat në "Fjalorin e të folmeve serbe të Kosovë-Metohisë" të Glisha Elezoviçit*, në *Studime gjuhësore në fushë të shqipes*, vëll. I, bot. Rilindja, Prishtinë 1982.
- Ajeti, Idriz, *Emërtime gjeografike në shqipen dhe në serbokroatishten*, në *Vepra*, vëll. 4, bot. i Akademisë së Shkencave dhe Arteve, Prishtinë 2001.
- Ajeti, Idriz, *Fjala shqipe në "Fjalorin" e Gl. Elezoviç-it*, në *Vepra*, vëll. 4, bot. i Akademisë së Shkencave dhe Arteve, Prishtinë 2001.
- Ajeti, Idriz, *Kontribut për studimin e onomastikës mesjetare në territorin e Malit të Zi, Bosnës e Hercegovinës dhe të Kosovës*, në *Vepra*, vëll. 4, bot. i Akademisë së Shkencave dhe Arteve, Prishtinë 2001.
- Ajeti, Idriz, *Marrëdhëniet gjuhësore sllavo-shqiptare*, në *Vepra*, vëll. 4, bot. i Akademisë së Shkencave dhe Arteve, Prishtinë 2001.
- Ajeti, Idriz, *Mbi disa fjalë e shprehje shqipe në dialektet e sllavëve të Jugut*, në aktet e Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë 1980.
- Ajeti, Idriz, *Poreklo nekih mitskihi demonskih naziva u šiptarskom*, në *Godišnjak*, vëll. III, izd. Centar za balkanološka ispitivanja, lib. 1, Sarajevo 1965.
- Ajeti, Idriz, *Raportet e shqipes me gjuhët ballkanike*, në *Studime dialektore dhe etimologjike*, bot. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë 2005.
- Ajeti, Idriz, *Rreth disa abanizmave në "Fjalorin" e Vuk Karaxhiqit*, në *Vepra*, vëll. 5, bot. i Akademisë së Shkencave dhe Arteve, Prishtinë 2002.
- Ajeti, Idriz, *Rreth disa emrave topikë me prejardhje shqiptare në Mal të Zi në vështrim gjuhësor*, në *Vepra*, vëll. 3, bot. i Akademisë së Shkencave dhe Arteve, Prishtinë 1998.
- Ajeti, Idriz, *Shqipja dhe gjuhët fqinje*, në *Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit - Albanian and Balkan Languages* (red. Rexhep Ismajli), bot. i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Prishtinë 2012.
- Ajeti, Idriz, *Shqipja e vështruar nga aspekti i studimeve ballkanistike*, në *Vepra*, vëll. 4, Prishtinë 2001.
- Ajeti, Idriz, *Zhvillime paralele fonetike dhe ndikime të ndërsjella të dialekteve shqiptare dhe serbe të Kosovës*, në *Vepra*, vëll. 4, bot. i Akademisë së Shkencave dhe Arteve, Prishtinë 2001.
- Bageri, Josif, *Vajtim e mallkim*, poezi, në gazetën *Shqipëria*, Bukuresht 16 prill 1899.
- Blaku, Murat, *Ndikimi i shqipes mbi të folmet serbe të Kosovës*, në *Gjurmime albanologjike*, seria e shkencave filologjike, nr. 24/1994, bot. i Institutit Albanologjik, Prishtinë 1995.

- Blaku, Murat, *Ndikimi i shqipes mbi të folmet serbe të Kosovës*, bot. i Institutit Albanologjik, Prishtinë 2010.
- Çabej, Eqrem, *Ältere Stufen des albanesischen im Lichte der Nachbarsprachen*, në *Zeitschrift für Balkanologie*, vol. II, 1964.
- Elezović, Gliša, *Rečnik kosovsko-metohijskog dijalekta*, Beograd 1932.
- GJEÇOVI, Àt Shtjefën (mbledhë e kodifikue prej), *Kamunin e Lekë Dukagjinit*, Shkodër 1933.
- Ismajli, Rexhep, *Mbi disa toponime në Serbi të Jugut dhe në Maqedoni të Veriut*, në *Gjurmime albanologjike*, nr. 1-2, bot. i Institutit Albanologjik, Prishtinë 1970.
- Ismajli, Rexhep (nën përkujdesjen e), *Pararendësi* (përzgjedhje punimesh nga akademik Idriz Ajeti), bot. *Koha*, Prishtinë 2011.
- Ismajli, Rexhep, *Studime për historinë e shqipes në kontekst ballkanik*, bot. i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Prishtinë 2016.
- Ismajli, Rexhep (zgjedhje e përgatiti për botim), *Idriz Ajeti, Studime për gjuhën shqipe (Vepra të zgjedhura)*, in honorem në 100-vjetorin e lindjes së autorit, bot. Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Prishtinë 2017.
- Kryeziu, Bahtjar dhe BALIU, Begzad, *Me profesor Eqrem Çabejn ishim dhe mbetëm miq*, intervistë e regjistruar nga autorët më datën 20 shkurt 2016 (tejskrim), në *Rrapi shekullor - akademik Idriz Ajeti*, bot. *Era*, Prishtinë 2017.
- Kushi, Arnisa, *Tabu dhe eufemizma të shqipes në përjasje me gjermanishten*, tezë doktrate, Universiteti i Tiranës, Tiranë 2014.
- Neziri, Zymer U. Neziri (përg.), *Këngë të kreshnikëve*, antologji, Prishtinë 2009.
- Omari, Anila, *Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe*, bot. i Qendrës së Studimeve Albanologjike, Tiranë 2012.
- Sinani, Shaban, *Këngë trimash apo këngë kreshnikësh*, në *Etnos në epos*, Tiranë 2011, f. 75-120.
- Skok, Petar, *Iz toponomostike južne Srbije*, izd. *Glasnik skopskog naučnog društva*, nr. XV-XVI, Skopje 1936.
- Shkurtaj, Gjovalin, *Sociolinguistikë e shqipes: nga dialektologjia te etnografia e të folurit*, bot. *Morava*, botim i dytë, Tiranë 2009.

Mimoza PRIKU, Shkodër

HISTORIA E ALBANOLOGJISË NË KËNDVËSHTRIMIN E PROFESOR IDRIZ AJETIT

Bota shqiptare e shqipja, karakteri por gjithashtu historia e saj, kanë ngjallur kërshërinë e albanologëve të cilët lanë gjurmë të vyera me studimet e tyre dhe ndër vite u bënë pjesë e historiografisë së albanologjisë. “*Qyshë prej kohësh shqipja,- vërente J. Rrota,- këjo gjuhë e çuditëshme dhe krykëput e dallueme nga të folmet e popujvet t’Europës, nisi të shquejë interesin dhe vemenden e etnografëve, filologëve dhe të glotologëve.*”¹ Këto studime u bënë më të dendura gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX dhe sidomos gjatë shek. XX duke krijuar një vijimësi të këtyre kërkimeve dhe duke na lënë pas një trashëgimi mjaft të pasur dhe me vlera. Kontributi i filologëve për shqipen, parë me një perspektivë historike dhe me sy kritik, ka qenë objekt i një plejade dijetarësh të njohur, mes të cilëve një vend nderi zë padyshim edhe prof. Idriz Ajeti.

Profili shkencor i akademikut Ajeti lidhet me një sërë botimesh e veprimtarish të shquara në mbarë botën albanologjike duke nisur me ndihmesat e pandërprera të tij për institucionalizimin e albanologjisë në Kosovë. Në vitin 1962 themeloi revistën “Gjurmime albanologjike” e cila u bë tribunë kuptimplotë e dijes.”*Pas hapjes së Fakultetit Filologjik të Prishtinës (1960),- kujton prof. Ajeti,- tok me kolegët-bashkëpunëtorë, zumë t’i përveshemi punës me të gjithë kolegët forcat, për të nxjerrë Revistën shkencore që e pagëzuam”Gjurmime albanologjike*”.² Në vitin 1974 u bë promotori i një prej ngjarjeve më të rëndësishme albanologjike, themelimit

¹ J. Rrota, *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*, (bot. I), Shkodër, Botime Françeskane, 2006, f. 563.

² I. Ajeti, “Tridhjetë vjet”Gjurmime albanologjike”, *Vepra* 5, Prishtinë, 2002, f. 241.

të Seminarit ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, i cili hapi dyert për studiues nga mbarë bota. Ajeti do të bëhej shtylla kryesore edhe për revistën "Studime" e cila mori jetë në vitin 1984.

Ndihmesat e Ajetit, këtij mjeshtri të gjuhës, janë pjesë integrale e historisë së albanologjisë, por akademiku ynë dallohet njëkohësisht edhe si historiograf i saj. Padyshim, që në këtë rrugëtim Ajetin e ndihmoi formimi i tij filologjik fillimisht si romanist e pastaj edhe si ballkanolog, formuar në universite të njohura në këto fusha të dijes, si Zagrebi, Padova, Piza etj. Filli drejtues i punës së tij u bë hetimi me imtësi i punës së albanistëve dhe njohja e prezantimi i këtyre kontributeve.

Në spektrin e gjerë të studime të prof. Ajetit një vend të zgjedhur zënë punimet nga historia e albanologjisë. Që në vitet e para të Seminarit Ajeti zgjodhi rrugën për shkrimin e një historiografisë të albanologjisë. Me ligjëratat e tij ai njohu albanistët e ardhshëm me arritjet e dijes albanologjike, ngjalli vëmendjen e tyre për t'u thelluar në këtë lëmi. Ai arriti ta kthente Seminarin në një vend dijeje e debati, në një *bashkëtakim shkencor albanologësh*.

Qëmtimi i vazhdueshëm i figurës, veprave të albanologëve është një qasje e vazhdueshme në punën e profesorit pasi "...çështjet kardinale të historikë së albanistikës, si madhore që ishin, përfatuan një lagje klasikësh të kësaj dijeje. Janë quajtur klasikë në kuptimin më të mirë të kësaj fjale, sepse zgjidhën problemet parësore të albanistikës që u dhanë atyre epitetin e merituar: "klasikë"..."³ Kjo fushë kërkimesh nuk ka qenë asnjëherë e pjesshme, por është riparë e plotësuar vazhdimisht me përkushtim të pandërprerë nga akademiku Ajeti. Në ngritjen e ndërtesës së historisë së shkencave albanologjike, siç shprehet prof. Ajeti, ndihmuan emra të njohur, si: Miklošić, G. Meyer, H. Pedersen, C. Tagliavini, H. Bariç, E. Çabej,⁴ M. Camaj⁵ etj., puna e të cilëve u bë objekt i analizave të gjuhëtarit

³ "Pesë pyetje Akademik Idriz Ajetit", në *Gjuha shqipe*, 2004, nr.2, Prishtinë, f. 5.

⁴ I. Ajeti: E. Çabej, *Über einige mit z analytische Wörter der Albanischen*, Zeitschrift für Phonetik und allgemeine Sprachwissenschaft, 9/3, Berlin 1956, p. 203-229, *Gjurmime Albanologjike*, Prishtinë 1962, nr. 1, f. 283-286.

I. Ajeti: E. Çabej, "Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe", Tiranë 1967, f. 216, *Gjurmime albanologjike*, Prishtinë 1968, nr. 2, f. 259-262.

tonë. Punimet e prof. Ajetit në këtë fushë patën në fokus zhvillimin e albanologjisë në vende, si: Italia, ish-Jugosllavia, traditën e albanologjisë sllovene, ashtu edhe punën e albanologëve të veçantë. Kësaj fushe i përkasin punimet: "Zhvillimi i gjuhësisë shqiptare në Jugosllavi", "Për kontributin e linguistikës italiane në studimet e gjuhësisë shqiptare – Carlo Tagliavini", "Kontributi i studiuesve sllovenë për historinë e gjuhës shqipe dhe krijimin e letrarishtes së saj", "Henrik Bariqi për gjuhën shqipe", "Kontributi i Holger Pedersenit në studimin e historisë së gjuhës shqipe", "Kontribut i Carlo Tagliavinit në studimet historike të gjuhës shqipe". "Në njëqindvjetorin e vdekjes së Fran Miklošičit" etj..

Meritë e Ajetit është metodologjia e punës prej linguisti të mirfilltë, i cili gjatë punës së tij, megjithëse ka në fokus një albanist, kur trajton çështjet gjuhësore, nuk mbetet tek ai, por analizon edhe ndihmesat e albanologëve të tjerë, të huaj dhe shqiptarë që lidhen me diskutimin. Gjurmimet e tij si historiograf u pasuruan edhe me recensionet e veprave kryesore të botuara për gjuhën shqipe që zunë vend sidomos në faqet të revistës "Gjurmime albanologjike" e "Studime". Në hulumtimet e tij Ajeti qendëron problemet që lidhen me origjinën e shqipes, vendin e formimit të saj, leksikun etj., jo vetëm duke ravijëzuar mendimet e albanologëve, por duke dhënë edhe mendimet e tij, shpeshherë kritike. Ai e di se një varg studimesh sistematike në fushë të shqipes zënë fill me punën e albanologëve të huaj, ndaj dhe i qëmton me kujdes këto kontribute me karakter albanologjik. Ajeti është i vetëdijshëm që këto studiues nuk erdhën drejtpërsëdrejti në truallin e shqipes, por mbërritën përmes kërkimeve mbi gjuhët e tjera, kryesisht përmes indoeuropianistikës e ballkanistikës. Këtë prirje ai e vë në dukje për gjuhëtarët: N. Jokl, M. Bartoli, Tagliavini etj. Ai pohon: "*Si linguistët tjerë italianë, edhe Matteo Bartoli studimeve shqiptare iu*

I. Ajeti: "Veprimtaria shkencore e prof. Çabejt", *Gjurmime albanologjike*. Seria e shkencave filologjike V, 1975, Prishtinë 1976, f. 7-25.

I. Ajeti: "Dy fjalë për opusin e E. Çabejt", *Studime gjuhësore I* (Studime etimologjike në fushë të shqipes A-O), Prishtinë 1976, f. VII-XXII.

⁵ I. Ajeti: Martin Camaj, Albanische Wortbildung – die Bildungsweise der älteren Nomina, Albanische Forschungen, vëll. 6, Wiesbaden 1966, *Gjurmime albanologjike*, Prishtinë 1968, nr. 1, f. 241-243.

afrua duke u nisur nga kërkimet e gjuhëve romane”,⁶ edhe Tagliavini, sipas Ajetit, nisi të kalojë “nga trualli i studimeve ballkanike të përfshijë edhe çështjet e kërkimeve gjuhësore shqiptare duke kaluar në terrenin studimor të kësaj gjuhe”,⁷ ndërsa “Norbet Jokli, duke qenë vetëm nis e sos puro albanist”.⁸

Në qerthurin e hulumtimeve të bëra nga prof. Ajeti një zë i veçantë është leksiku i shqipes, ku ai çmon punën e Miklosiçit, G. Meyer-it, H. Pedersenit, N. Joklit. Në disa punime ai ndalet në të parin fjalor etimologjik për shqipen të hartuar nga G. Meyer-i (1891)⁹ që “mbetet një përmendore e dorës së parë,- sipas Ajetit,- në fushën e studimeve shqiptare”.¹⁰ Ndërsa në lidhje me metodën e punës së këtij albanisti Ajeti shkruan: “Në shoshitjen e visarit leksikor të gjuhës shqipe vetëm me Meyerin nisët në një rrugë të re. Ai në njëfarë dore, është figura qendrore në punë të organizimit të studimeve etimologjike të gjuhës shqipe”.¹¹ Por ashtu edhe si profesori i tij C. Tagliavin-i, Ajeti e kritikon Meyer-in se “në shoshitjen e visarit te saj leksikor mbiçmoi ndikimin e huaj”. Të njëjtin qëndrim ai mban edhe vite me vonë, por sigurisht duke cilësuar vlerat e Meyer-it në gjuhësinë historike. “Për sa i përket faktit që Gustav Mayeri kundër të cilit kemi ditur të hedhi, gurë shpeshherë, -shprehet Ajeti,- sepse pat mbiçmuar rëndësinë e elementit latin të gjuhës shqipe, si dhe në përgjithësi për huazimet nga gjuhët e tjera, mund të thuhet se ndërtimi i gjuhësisë historike shqiptare është merita e tij”.¹²

Një meritë të veçantë për këto përfundime thelbësore të Ajetit që lidhen sidomos me fondin e fjalëve të shqipes ka linguisti italian Carlo Tagliavini, i cili u prit mjaft mirë nga dijetarët që merreshin me albano-

⁶ I. Ajeti, “Kontributi i Carlo Tagliavinit në studimet e historisë së gjuhës shqipe”, *Vepra* 5, Prishtinë, 2002, f. 65.

⁷ *Po ai, po aty*.

⁸ “Pesë pyetje Akademik Idriz Ajetit”, në *Gjuha shqipe*, 2004, nr.2, Prishtinë, f. 5.

⁹ *Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache*.

¹⁰ I. Ajeti, “Zhvillimi i gjuhësisë shqiptare në Jugosllavi”, Seminari II ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Prishtinë 1976, f. 25.

¹¹ I. Ajeti, “Henrik Bariqi për gjuhën shqipe”, Seminari XIV ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Prishtinë 1989, f. 111-119.

¹² “Pesë pyetje Akademik Idriz Ajetit”, në *Gjuha shqipe*, 2004, nr.2, Prishtinë, f. 5.

logji, sidomos për vërejtjet, të cilat ai i bëri Fjalorit etimologjik të G. Meyer-it. Tagliavini ka vënë në dukje se nga 730 fjalë të cilat ishin lënë pa etimologji, pjesa më e madhe e tyre i përkisnin fondit të vjetër *i.e.*¹³ Një tjetër albanolog i vlerësuar nga Ajeti sidomos për problemet që lidhen me leksikun e shqipes është edhe gjuhëtari kroat H. Barić. Puna e këtij ballkanologu është çmuar sidomos për kritikën e tij për fjalorin e G. Meyer-it dhe rikthimin e disa leksemave gjuhës shqipe, fillimisht në veprën “Albanorum-mänische Studien” (Sarajevë, 1919).

Ajeti arrin të përcaktojë vendin që zënë në albanologji shumë dije-tarë të huaj, duke i çmuar për meritat e kritikuar shpesh edhe për metodologjinë e punës. Kështu, sipas gjuhëtarit kosovar “Linguisti sloven Miklošičit u dallua në shoshitjen etimologjike të thesarit leksikor të shqipes”¹⁴, por “studimet etimologjike të kohës së Miklošičit si dhe vetë punimet e tij të gjuhës sonë, vuanin nga metoda që karakterizohej nga zbërthimi i leksikut të gjuhës shqipe duke kërkuar gurrën e fjalëve të saj të huazimet gjegjëse të gjuhëve të tjera.”¹⁵

Sllavisti dhe ballkanologu i njohur F. Miklosiç, shpesh është cilësuar nga studiuesit si *pionier i albanologjisë*. Në lidhje me këtë figurë Ajeti shkruan: “Historinë e gjuhës shqipe e njëjtte mirë duke zotëruar dhe përve-tësuar çdo gjë që deri atëherë ishte botuar për albanistikën”.¹⁶ Ajeti veçon të vështuarit e lidhjes ballkanike në dritën e substratit trako-ilir dhe vlerë-son mendimet e Miklosiçit nga fonetika historike mbi disa zhvillime të zanoreve në huazimet latine; etimologjia, në fushë të leksikut. “*Është merita e Mikloshičit që i studion shtjellueshëm lidhjet e gjuhëve të Ballka-nit në dritën e teorisë së substratit trako-ilir, duke theksuar rendësinë e posaçme të shqipes si e vetmja gjuhë që trashëgon drejtpërsëdrejti struk-turën e asaj gjuhe të lashtë, elementet e së cilës pasqyrohen në disa gjuhë ballkanike*,-shkruan Ajeti”.¹⁷

¹³ M. Priku, *Carlo Tagliavini dhe studimet albanologjike rreth shqipes*, Camaj-Pipa, Shkodër, 2011, f. 105.

¹⁴ I. Ajeti, “Në njëqindvjetorin e vdekjes së Fran Miklošičit”, *Vepra* 5, Prishtinë, 2002, f. 20.

¹⁵ *Po ai, po aty*.

¹⁶ I. Ajeti, “Zhvillimi i gjuhësisë shqiptare në Jugosllavi”, Seminari II ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Prishtinë 1976, f. 23.

¹⁷ I. Ajeti, “Albanistika jugosllave dhe disa probleme të saj”, *Vepra* 5, Prishtinë, 2002, 52.

Në punën kërkimore-shkencore në albanistikë të profesor Ajetit një rol të dalluar kanë edhe disa qendra në të cilat mori hov dija albanologjike e shpesh edhe u institucionalizua. Ajeti identifikon vatra të njohura, si: Vjena, San Petersburgu, Beogradi ku nisën e vazhdojnë ende kërkimet albanologjike me studiues të shquar.”Në Vjenën, [...] me tradita të pasura e të forta shkencore-linguistike, studimet albanologjike kishin marrë hov në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar e sidomos në fillim të këtij tonit (Kopitar, Mikloshic, G. Meyer, M. Lamberg, Kreçmer, Jokl, etj.).¹⁸ Në Rusi meritën për themelimin e një qendre albanologjike e më pas një shkolle albanistësh, Ajeti ia njeh albanologes e studiuses Agnia Desnickaja, me përkujdesjen e së cilës, “në Universitetin e Leningradit u hap dega e gjuhës dhe letërsisë shqipe..”¹⁹ dhe padyshim “është merita e saj që në qytetin e carëve të Rusisë vepron sot Shkolla albanologjike e Desnickajes”. Sigurisht me rëndësi është edhe areali universitar ku do të formoheshin filologët e albanologët e ardhshëm, si: Graci, Beogradi, Padova, Zagrebi etj.

Në gjysmën e parë të shek. XX në Beograd H. Bariç themeloi *Seminarin e Gjuhës shqipe* (1923). Falë përkushtimit të tij, arriti të botohej e të qarkullojë edhe revista shkencore “Arhiv za arbanasku starinu, jezik i etnologiju” (knjiga I, sv. 1-2./ Urednik H. Barić.- Beograd, 1923.) e cila “afroi rreth kësaj tribune të studimeve albanologjike punonjësit më të mëdhenj në fushën e kërkimeve të gjuhësisë shqiptare të Evropës: N. Jokl, K. Treimer, Meyer-Lübke (Vjenë), Alfredo Trompetti, Carlo Tagliavini (Itali), P. Skok (Zagreb), R. Nahtigal, K. Oshtir (Lubjanë), M. Budimir (Beograd), Gl. Elezović (Shkup).²⁰

Një prej figurave të shquara të albanologjisë që është bërë objekt studimi është edhe ish- profesori i tij, Carlo Tagliavini. Ajeti i vlerëson të gjitha ndihmesat e Tagliavinit në albanologji, por në veçanti çmon monografinë “L’Albanese di Dalmazia (Contributi alla conoscenza del dialetto ghego di Borgo Erizzo presso Zara”.²¹ Duke qenë se prof. Ajeti

¹⁸ I. Ajeti, “Mendime të studiuesve jugoslavë për shqiptarët dhe gjuhën e tyre”. Seminari XVIII ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Tiranë, 1996, f. 127.

¹⁹ I. Ajeti, “Agnia Desnickaja” (1912-1992), *Vepra* 5, Prishtinë, 2002, f. 257.

²⁰ I. Ajeti, “Zhvillimi i gjuhësisë shqiptare në Jugosllavi”, Seminari II ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Prishtinë 1976, f. 25.

²¹ Firenze, 1937, L. Olschi, 132f.

punoj vetë më pas për këtë të folme²² gjykon si pjesën më të rëndësishme leksikun etimologjik dhe vlerëson punën e Tagliavinit në gjetjen e zbulimin e mjaft etimonëve. Në lidhje me këtë monografi Ajeti shkruan: “Ky studim i hapët e i gjithanshëm i Tagliavinit, rrok në mënyrë të shtjelluar problemet gjuhësore të ishullit të vogël të arbëneshëve të Zarës”.²³ Në etimologji Tagliavini i përmbahet shpesh zgjidhjeve që kishin bërë emra të njohur në këtë fushë.

Sipas I. Ajetit²⁴ Taliavini ishte punëtor i virtytshëm shkencor, çdo punim i tij shquhet me të dhëna të gjera, por edhe asosh të imëta, gjë që mundëson shqyrtim të sigurtë të temës në tërësinë e saj dhe zgjedhje të çështjes në vështrim. Në albanistikë Taljavini la gjurmë të shënueshme me vlerë të pakrahasueshme dhe të përherëshme; një numër jo i vogël i etimologjive të tij të trajtuara kanë gjetur zgjedhje,....kjo vlen sidomos për venecianizmat e pranishme në gjuhën shqipe”.²⁴

Në shumë çështje që lidhen me karakterin e shqipes, sidomos në aspektin e gjuhësisë krahasimtare, Ajeti njeh meritën e *studiesve e albanistë të huaj*, veçanërisht albanistëve të fundit të shek. XIX dhe fillimit të shek. XX, duke radhitur në këtë plejadë: G. Meyer-in, Pedersenin, Joklin. Sipas hulumtimeve të Ajetit “Me punimet e Pedersenit zë të përvijohet një drejtim i ri në studimin e gjuhës shqipe që më vonë ndiqet nga Jokli dhe të tjerë”.²⁵ Këto gjuhëtarë zbatuan parimet e gjuhësisë krahasimtare dhe themeluan gjuhësinë historike për shqipen. E padyshim, një zë origjinal në këtë fushë është Pedersenin i cili²⁶ ishte një linguist komplet që merrej edhe me shqipen, armenishten, me gjuhët balto-sllave, tokarishten, hetitishten, etj..”²⁶ Meritë e padiskutueshme e Pedersenit është përfundimi që arriti se ndikimi i latinishtes në fleksionin e shqipes është baraz me zero. Me rastin

²² “Istoriski razvitak gegijeskog govora Arbanesi kod Zadra”, Sarajevë, 1961

²³ I. Ajeti, “Kontributi i Carlo Tagliavinit në studimet e historisë së gjuhës shqipe”, *Vepra* 5, Prishtinë, 2002, f. 67.

²⁴ I. Ajeti, “Vështrim i shkurtër i punës në studimet etimologjike të gjuhës shqipe”, *Vepra* 3, Prishtinë, 1998, f. 248.

²⁵ I. Ajeti, “Kontributi i Holger Pedersenit në studimin e historisë së gjuhës shqipe”, Seminari VI ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Prishtinë, 1980, f. 154.

²⁶ *Po ai, po aty*.

e botimit të disa prej kontributeve të këtij albanisti në gjuhën shqipe²⁷ Ajeti shkruan: “*Gjeniu i tij u vuri gisht shumë detyrave albanologjike, ndër to origjinës së popullit shqiptar*”.²⁸ Një tjetër kontribut i rëndësishëm i gjuhëtarit danez është ai mbi guturalet.²⁹ Jashtë vëmendjes nuk është lënë as puna e albanologut polak Waclaw Cimochoowski, i cili “ishte dijetar që kishte krijuar një pikëpamje të tërësishme për shqipen si gjuhë e sotme dhe si një nga gjuhët indoeuropiane në zhvillimin e tyre. Në këtë drejtim ai hyn në radhën e albanologëve të shquar të kohës sonë”.³⁰

Sigurisht e gjithë puna shumëvjeçare e akademik Idriz Ajetit në lëmë të historisë së albanologjisë është e vështirë të rroket brenda një punimi, po përmbledhtasi mund të themi se meritë e punës së palodhur të albanistit kosovar është themelimi i një tradite të këtyre studimeve në Kosovë duke u bërë një udhërrëfyes në këtë fushë.

Ashtu siç shprehet prof. Shaban Demiraj: “Puna e frytshme e këtij dijetari të shquar për të ndriçuar sa më mire çështje të rëndësishme të albanologjisë dhe për të ndihmuar për zhvillimin e shpejtë të një shkolle albanologjike shqiptare...e kanë bërë Prof. Idriz Ajetin të zërë një vend nderi krahas gjuhëtarëve më të shquar shqiptarë të shekullit tonë”.³¹ Mund të themi se kjo pasuri shërbeu e po shërben akoma si model dhe si nxitje për breza të tërë albanologësh pasi gjithë kontributet e profesor Idriz Ajetit janë pjesë e rëndësishme e trashëgimisë shkencore albanologjike.

²⁷ Holger Pedersen, *Studime për gjuhën shqipe*, Prishtinë, 2005.

²⁸ I. Ajeti, “Pedersen i flet shqip (1867-1953)”, në rev. *Studime* 11, Prishtinë, 2004, f. 267.

²⁹ H. Pedersen, (1900). Die Gutturale im Albanesischen. *Zeitschrift für vergleichende Sprachforschung auf dem Gebiete der indogermanischen Sprachen*, begründet von A. Kuhn. Berlin und Gütersloh. 36:309-315.

³⁰ I. Ajeti, “Albanologu polak Waclaw Cimochoowski në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës”, në rev. *Studime* 11, Prishtinë, 2004, f. 293-297.

³¹ Sh. Demiraj, “Prof. Idriz Ajeti në 80-vjetorin e lindjes”, në *Gjuha shqipe dhe disa figura të shquara të saj*, Tiranë 2003, f. 274.

Bibliografi

ASHAK: Ajeti, I. *Vepra* 3, Prishtinë, 1998.

ASHAK: Ajeti, I., *Vepra* 5, Prishtinë, 2002.

Ajeti, I., “Pedersenit flet shqip (1867-1953)”, në rev. *Studime* 11, Prishtinë, 2004, f. 267-269.

Ajeti, I., “Albanologu polak Wacław Cimochoński në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës”, në rev. *Studime* 11, Prishtinë, 2004, f. 294-.

Ajeti, I., “Zhvillimi i gjuhësisë shqiptare në Jugosllavi”, Seminari II ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Prishtinë 1976, f. 23.

Ajeti, I., “Kontributi i Holger Pedersenit në studimin e historisë së gjuhës shqipe”, Seminari VI ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Prishtinë, 1980, f. 153-159.

Ajeti, I., “Henrik Bariqi për gjuhën shqipe”, Seminari XIV ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Prishtinë 1989, f. 111-119.

Ajeti, I., “Mendime të studiuesve jugosllavë për shqiptarët dhe gjuhën e tyre”. Seminari XVIII ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Tiranë, 1996, f. 105-112.

Demiraj, Sh., “Prof. Idriz Ajeti në 80-vjetorin e lindjes”, në *Gjuha shqipe dhe disa figura të shquara të saj*, Tiranë 2003, f. 274-283.

Përmbledhje e akteve, “Konferencë shkencore në fushë të filologjisë për nder të Akademik Idriz Ajetit”, Prizren, 15 maji 2014.

“Pesë pyetje Akademik Idriz Ajetit”, në rev. *Gjuha shqipe*, 2004, nr.2, Prishtinë, f. 5-11.

Priku, M., *Carlo Tagliavini dhe studimet albanologjike rreth shqipes*, Camaj-Pipa, Shkodër, 2011.

Revista “Studime”, organ i Akademisë së Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Prishtinë, 2007/14.

Valter MEMISHA, Tiranë

NDIHMESA SHKENCORE E AKADEMIK IDRIZ AJETI NË FAQET E REVISTËS *STUDIME FILOLOGJIKE*

Një anë e spikatur e personalitetit shkencor të akademikut Idriz Ajeti është dhe ndihmesa në studimet albanologjike përmes botimeve në faqet e revistës *Studime filologjike*, organ i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, Tiranë. Bashkëpunimi me revistën ngërthen një shtrirje kohore 32-vjeçare, nga viti 1971 deri në vitin 2002. Akademiku ka botuar gjithsej 8 artikuj, nga të cilët një me bashkautorësi. Në pamje të parë ky numër të duket i vogël, i kufizuar. Por prurjet, veçanërisht në gjuhësi, jo gjithnjë maten me numrin artikujve. Dhe këtë e vërtetojnë më së miri këto botimet në revistë. Ato mishërojnë një punë shkencore serioze, të realizuar, të vlerësuar, përkushtuese dhe referuese. Kjo punë shpërfaqet në disa fusha, në të cilat ai ka ditur ta thotë fjalën e vet me peshë, sidomos për çështje me hapësira debati, si dhe ka sjellë studime që mund të realizoheshin nga personalitete me formim të lartë shkencor si ai i shkencëtarit **fjalëpak e punëshumë**, përdhësues e misionar.

Para se të ndaleshim në konkretësinë e prurjeve, është vendi të theksojmë se botimet shkencore të studiuesve nga Kosova në vitet '70 -'80 të shekullit të kaluar në revistën *Studime filologjike*, organ shkencor i institucionit që varej nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë, ishin një sipërmarrje që u nënshtrohej filtrave të shumtë. Riskimi ishte i shumëfishtë, për studiuesin e për botuesin. Megjithatë në faqet e revistës zunë vend artikuj shkencorë të figurave që fytyrëzonin shkencat albanologjike në Kosovë. Ndaj dhe aty gjen, veç artikujve të akademik I. Ajetit, edhe ata të studiuesve R. Qose, B. Bokshi, A. Hadri, R. Ismajli, H. Agani e të tjerë.

Tematikusht e tipologjikusht artikujt e botuar nga akademiku I. Ajeti në faqet e revistës *Studime filologjike* grupohen:

1. Artikuj për shqipen standarde:

a. Vështrim i përgjithshëm për standardin: I. Ajeti & E. Lafe, *Njëzet e pesë vjet nga Kongresi i Drejtshkrimit (Vlerësime dhe vështrime në të ardhmen)* 1998/1-2.

b. Shqipja standarde dhe Kosova: *Rruga e zhvillimit të gjuhës letrare shqipe në Kosovë*, 1973/1; *Shqipja standarde dhe shoqëria kosovare sot*, 2002/3-4.

2. Artikuj për historinë e gjuhës shqipe:

a. Historia e shqipes përmes marrëdhënieve me gjuhët e tjera: *Për historinë e marrëdhënieve të hershme gjuhësore shqiptare-sllave* 1972/4.

b. Historia e shqipes përmes toponomastikës: *Kontribut për studimin e disa toponimeve të Malit të Zi*, 1984/2.

c. Historia e shqipes përmes onomastikës: *Kontribut për studimin e onomastikës mesjetare në territorin e Malit të Zi, Bosnjës e Hercegovinës dhe të Kosovës*, 1974/3.

d. Historia e shqipes përmes huazimeve: *Për disa huazime shqiptare në të folmet serbo-kroate* 1981/2.

3. Artikuj për studime dialektologjike: *Rreth disa veçorive të të folmeve të shqiptarëve të rrethit të Preshevës dhe të Bujanovcit*, 1971/3.

1. Artikuj për shqipen standarde:

a. Artikulli *Njëzet e pesë vjet nga Kongresi i Drejtshkrimit (Vlerësime dhe vështrime në të ardhmen)* është referati në Konferencën shkencore, Tiranë, 1997, dhe akademiku I. Ajeti është bashkautor me prof. Emil Lafe, të dy pjesëmarrës në Kongres. Në artikull, siç pohohet dhe në titull, i bëhet një vështrim vlerësues procesit të formimit të shqipes standarde, i gjendjes së saj në vitet '90 të shekullit të kaluar, si dhe parashtrohen hapësirat, mundësitë e mjetet për shtrirjen e mëtejshme dhe mirëfunksionimin e saj. Artikulli, vjen edhe si një qëndrim ndaj shumë çështjeve të debatuar fort e që lidheshin drejtpërdrejt me Kongresin e Drejtshkrimit dhe veprën e tij: standardin (gjuhën letrare të njësuar). Artikulli vlerëson se ky kongres "ka hyrë tashmë në histori, po ai nuk është një ngjarje që i takon thjesht

historisë. Veprimi i tij mbi ecurinë e zhvillimit të gjuhës sonë letrare dhe mbi kulturën, arsimin e jetën shoqërore të popullit shqiptar ka qenë dhe është i shënueshëm.”¹

Autorët pohojnë se “Kongresi i Drejtshkrimit u mbajt në një kohë nga e cila populli shqiptar është ndarë vendosmërisht e përfundimisht. Ai nuk mund të vlerësohet nga ngjyra ideologjike e kohës kur u zhvillua, por nga puna që bëri dhe nga frytet e kësaj pune.”²

Duke rimarrë zgjidhjen për standardin e duke dhënë përgjigje për kundërshtarët e kësaj zgjidhjeje, në artikull nënvizohet se “Zgjidhja që gjeti problemi i gjuhës letrare shqipe dhe që u kurorëzua në Kongresin e Drejtshkrimit, nuk ka qenë diçka arbitrare, e diktuar, në kundërshtim me zhvillimin historik të vetë gjuhës letrare dhe me gjendjen reale të saj.”³

Sipas artikullit standardi është rezultat edhe i planifikimit dhe i politikave gjuhësore të kohës kur krijohet. Aty pohohet se “Është i njohur veprimi i faktorëve jashtëgjuhësorë në formimin e një gjuhe të përbashkët, por, kur te ne problemi u shtrua seriozisht për zgjidhje, një peshë përcaktuese në zgjedhjen që duhej bërë, pati faktori gjuhësor, d.m.th. thjeshtësia e strukturës fonetike e gramatikore dhe shkalla më e lartë e përpunimit dhe e njësimimit të normës së koinesë jugore (veçanërisht në gramatikat shkollore e shkencore të Kostaq Cipos), si edhe lëvrimi më i gjerë i saj. Nga ana tjetër gjeografia e pabarabartë e zhvillimit arsimor e kulturor rrethana që Kosova dhe trevat e tjera shqiptare në ish-Mbretërinë Jugosllave deri në shembjen e saj qenë të shkëputura nga ky zhvillim dhe dërgeshin në errësirën e analfabetizmit masiv, ndikuan për një zhvillim) josimetrik të variantit letrar verior dhe për një shkallë më të ulët të njësimimit e të përhapjes së tij në shtypin dhe në botimet e kohës.”⁴

Thukët argumentohet se varianti që kemi sot si standard, ka qenë një proces marrëveshjeje, mbështetur në fakte shkencore. Aty thuhet se “Çdokush që merret sadopak me çështje të gjuhës, e ka të qartë se në një çast të

¹ I. Ajeti, E Lafe, *Njëzet e pesë vjet nga Kongresi i Drejtshkrimit (Vlerësime dhe vështrime në të ardhmen)*, SF, 1998/1-2, f. 6.

² I. Ajeti, E Lafe, *Njëzet e pesë vjet ...*, f. 6

³ I. Ajeti, E Lafe, *Njëzet e pesë vjet ...*, f. 6

⁴ I. Ajeti, E Lafe, *Njëzet e pesë vjet ...*, f. 6-7

caktuar është e nevojshme një marrëveshje shoqërore për të sanksionuar atë që ka arritur në një mënyrë gati të vetvetishme praktika dhe për të zgjedhur në ato raste kur çështja shtrohet sipas formulës *ose...ose*. Në një stad të tillë kishte arritur shkallë - shkallë konvergjenca gjuhësore e dy varianteve normative të shqipes letrare në vitet '60. Për të kaluar në një normë të njësuar, të vetme, duhej zgjedhur.... Pikëpamja se dikur, në një çast të caktuar, edhe këto pak dallime të varianteve normative të shqipes letrare do të njësoheshin vetvetiu pa një ndërhyrje, pa një marrëveshje shoqërore, është jashtë arsyes së shëndoshë dhe jashtë praktikës së vendosjes së gjuhëve letrare edhe te popuj të tjerë. Gjuha letrare kombëtare ose gjuha standarde (me një term të gjuhësisë së sotme) bëhet e nevojshme dhe e mundshme në një shkallë të caktuar të zhvillimit ekonomik e kulturor të kombit. Vonesave të tjera historike ne shqiptarët nuk kishte pse t' u shtonim edhe një vonesë tjetër për çështjen e gjuhës letrare.”⁵

Parë nga një rrugë 25-vjeçare shtrirjeje, zbatimi dhe funksionimi, akademik I. Ajeti dhe prof. E. Lafe, theksojnë se “Gjuha letrare, arritja madhore e Kongresit, qëndron e patundur. Gurët e këndit të kësaj ndërtese janë gdhendur e vendosur nga mjeshtrit më të mëdhenj të fjalës shqipe. Një nga këta gurë këndi është drejtshkrimi. Drejtshkrimi mund të quhet në mënyrë të figurshme edhe *ligji themeltar* ose *kushtetuta* e gjuhës letrare. Kongresi i Drejtshkrimit ishte si një Asamble Kushtetuese që vendosi përfundimisht njësimin e normës drejtshkrimore e me të edhe *njësimin e normës letrare*.”⁶

Artikulli ndalet në dy çaste përcaktuese në rrugën e krijimit të këtij “ligji themeltar”: në *Projektin e drejtshkrimit*, 1967, dhe në *Konsultën e Prishtinës*, 1968, që lidhen pazgjidhshmërisht me vetë Kongresin Drejtshkrimit 1972. Aty theksohet se “Projekti i drejtshkrimit i vitit 1967 ishte një pikë kthese dhe që në shpalljen e tij u konceptua si parathënie e një etape të re, e normës letrare të njësuar. Prandaj ai u prit me interesim të madh nga opinioni shoqëror dhe nga studiuesit e gjuhës, arsimtarët, njerëzit e letrave etj. Në prill 1968 u zhvillua në Prishtinë Konsulta e njohur gjuhësore, vendimet e së cilës përmbliidhen në përcaktimin *një komb - një gjuhë*

⁵ I. Ajeti, E Lafe, *Njëzet e pesë vjet ...*, f. 7

⁶ I. Ajeti, E Lafe, *Njëzet e pesë vjet ...*, f. 12

letrare, një drejtshkrim. Katër vjet e gjysmë që kaluan që nga ajo konsultë deri në mbajtjen e Kongresit të Drejtshkrimit, dëshmuar se edhe në Kosovë, në Maqedoni e në Malin e Zi zbatimi i normës së njësuar letrare nuk kishte ndeshur në probleme të pakapërcyeshme, përkundrazi arritjet ishin të shënueshme.”⁷

Një çështje tjetër në artikull dhe që ka marrë vemëndjen e opinionit gjuhësor është ajo e rivlerësimit të bazës dialektore të standardit, duke kundërshtuar qëndrimet se zgjidhja ka qenë politike, se standardi është thjesht toskërishtja e shpallur si gjuhë letrare e njësuar, duke kundërshtuar qëndrimet për ndryshimin e kësaj baze apo duke qenë kundër për ndërhyrje të thella në strukturën e tij. Aty theksohet dhe argumentohet, duke parashtruar se “R. Ismajli ndër tiparet gjuhësore të shqipes standarde shënon edhe atë që e quan *karakteri artificial*, d.m.th. mospërputhjen e saj me ndonjërin nga idiomat organike: *për shqipen ka rëndësi të theksohet se nuk mund të identifikohet me toskërishten letrare me një sasi, qoftë edhe të madhe, gegizdash, ide që do të ishte shprehje e një konceptioni mekanicist, të gjithë bartësit e shqipes standarde duhet ta nxënë atë, pa marrë parasysh shkallën e përputhjes së saj me idiomën e tyre organik; ajo është vërtet mbidialektore dhe jodialektore*. Prandaj të pohosh sot, pas 25 vjetësh, në një tekst shkollor se më 1972 *toskërishtja letrare u shpall si gjuhë letrare kombëtare ose si gjuhë letrare e njësuar ose më mirë si shqipe standarde* merret vesh qartë se për këtë motivet janë jashtëshkencore. Edhe pohimi se *gjuha e sotme letrare qenka 95 për qind toskërisht dhe vetëm 5 për qind gegërisht* është i pathemeltë, se kështu toskërishtja e gegërishtja dalin si dy gjuhë të veçanta e jo si dy dialekte të së njëjtës gjuhë. Pohime të tilla rrahin t’i vënë përkrah gjuhës letrare një shemër, e cila një ditë do t’ia zinte vendin, duke pasur parasysh rritjen e komponentes gege në kulturën kombëtare. Ky formulim, që e ndan kulturën kombëtare në komponente gege e komponente toske, kur Naim Frashëri një shekull më parë shpjegonte se *Gegë e Toskë janë emëra vëndi e mënyrë të foluri dy vëllezërve*, rreh të hedhë farën e ngatërtimeve *ndër këta vllazën shoq me shoq* - siç do t’i quante edhe Ndre Mjeda toskët e gegët te vjersha e njohur *Gjuha shqipe*.”⁸

⁷ I. Ajeti, E Lafe, *Njëzet e pesë vjet ...*, f. 9-10

⁸ I. Ajeti, E Lafe, *Njëzet e pesë vjet ...*, f. 10-11

Artikulli është shkruar para 20 vjetëve, kur Kosova nuk ishte pavarësuar ende dhe kur shqiptarët ishin shumë më të ndarë e më të copëtuar sesa sot. Dhe ai ndalet enkas te funksioni bashkues e integrues i gjuhës dhe vendi i Kongresit në këtë funksion, duke theksuar se “Gjuha është mjet bashkimi e marrëveshjeje, është gjaku që ushqen vetëdijen tonë kombëtare dhe nuk mund të lejohet që dikush ta përdorë si mjet përçarjeje.”⁹. “Në ditët tona njësia e gjuhës letrare kombëtare ka ndërtuar shtetin e njësishtë kulturor të popullit shqiptar në mbarë hapësirën e tij historike, prandaj Kongresi i Drejtshkrimit është Kongresi i Bashkimit dhe i Mirëkuptimit.”¹⁰

Mbështetur dhe në Rezolutën e Kongresit të Drejtshkrimit se gjuha e njësuar është në zhvillim të përhershëm, në artikull pranohet se në të duhet të bëhen herëpashershëm përmirësimet e nevojshme. Autorët shkruajnë: “Pyetja që shtrohet sot në mënyrë të natyrshme është; ç’mbetet për të bërë më tej në fushën e drejtshkrimit të shqipes? Kjo pyetje nuk mund të ketë një përgjigje mohuese, pra ka ende për të bërë. Por çdo hap i mëtejshëm duhet hedhur me shumë kujdes. Rruga e ndryshimeve dhe e përmirësimeve në drejtshkrim të kalojë përmes diskutimesh të hollësishme me pjesëmarrjen e gjuhëtarëve e të lëvruesve të gjuhës nga të gjitha qendrat e studimeve gjuhësore shqiptare. Gjithçka duhet të vendoset në frymën e mirëkuptimit e të konsensusit mbi bazën e parimeve e të argumenteve shkencore.”¹¹

Artikulli vëren se në gjithë hapësirat shqipfolëse ka rënë ndjeshëm kultura gjuhësore, ndeshen shkelje flagrante të normës. Autorët përsëri pyesin: “Nga se ndodh kjo?” Dhe përgjigjen: “S’ka dyshim se këtu ka ndikuar edhe riplotizimi i çështjes së gjuhës letrare. Por mendojmë se në shumicën dërrmuese të rasteve këto shkelje nuk kanë të bëjnë me ndonjë *qëndrim mohues* ndaj normës, me një mungesë dëshire të shprehur për ta zbatuar atë. Ato mund të vlerësohen thjesht si një *sjellje e pakujdesshme* ndaj saj.”¹² Dhe vazhdohet: “*shtetit shqiptar dhe shoqërisë shqiptare* i ka munguar dukshëm ajo që mund ta quajmë *disiplinën gjuhësore*... Të mos ua vësh veshin fort rregullave të gjuhës, të flasësh e të shkruash në mënyrë të

⁹ I. Ajeti, E Lafe, *Njëzet e pesë vjet ...*, f. 10

¹⁰ I. Ajeti, E Lafe, *Njëzet e pesë vjet ...*, f. 19

¹¹ I. Ajeti, E Lafe, *Njëzet e pesë vjet ...*, f. 10

¹² I. Ajeti, E Lafe, *Njëzet e pesë vjet ...*, f. 14

shkujdesur, pa vetëkontroll, është, për fat të keq, diçka e zakonshme. Norma më së shumti përvetësohet në mënyrë gati të vetvetishme e jo përmes një veprimi të qëllimshëm.”¹³

Në artikull përveçohen dy rreziqe në standard: *hyrja e huazimeve të panevojshme dhe demokratizimi populist i këtij standardi*. Aty pohohet se “Gjuhëtarët dhe opinionin shoqëror janë të shqetësuar për dëmin që po i shkaktohet gjuhës shqipe nga vërshimi i fjalëve dhe i ndërtimeve të huaja. Krahës llojeve të tjera të ndotjes sot mund të flasim edhe për një *ndotje gjuhësore*. Në fushën e fjalorit kjo shfaqet me përdorimin e fjalëve të huaja të panevojshme, e theksojmë: *të panevojshme*; në sintaksë shfaqet me përcudnimin e asaj që quhet *natyrë e gjuhës shqipe*. Rrethanë objektive për këtë *ndotje* është ndikimi i gjuhëve të mëdha ose *imperializmi gjuhësor*, siç e quajnë disa në mënyrë të figurshme... Duke çmuar punën e A. Xhuvanit në këtë fushë, gjuhëtari arbëresh Marko La Piana ka shkruar: *nëse për të gjitha gjuhët çështja e pastërtisë ka rëndësi të madhe, për gjuhën shqipe ajo ka interes jetësor*.”¹⁴

Duke u ndalur edhe te hyrjet e panevojshme nga dialektet a të folmet krahinore në standard, artikulli tërheq vëmendjen se “Ndikimet e të folmeve vendore dhe interferencat e gjuhëve të huaja (këto të kufizuara në leksik e në ndërtimet sintaksore) cilësohen si shmangie nga norma dhe nuk përbëjnë dysorië normativë... Norma letrare e shqipes në të gjithë hapësirën e saj paraqitet pa variante territoriale. Pakujdesia e qortueshme ndaj gjuhës letrare, imitimi i verbër i gjuhëve të huaja çon më fort në bastardim sesa në variantizim të normës.”¹⁵

Së fundi në artikull trajtohet dhe çështja e *politikave gjuhësore shtetërore*, duke e kërkuar se “tashmë është e domosdoshme që pranë Këshillit të Ministrave të ngrihet përsëri një komision, i cili do të kujdeset për mbarrëvajtjen e përdorimit të gjuhës letrare dhe do të ketë kompetencat e nevojshme për të vendosur atë që e quajmë *disiplinë gjuhësore*.”¹⁶

¹³ I. Ajeti, E Lafë, *Njëzet e pesë vjet ...*, f. 14

¹⁴ I. Ajeti, E Lafë, *Njëzet e pesë vjet ...*, f. 17

¹⁵ I. Ajeti, E Lafë, *Njëzet e pesë vjet ...*, f. 17

¹⁶ I. Ajeti, E Lafë, *Njëzet e pesë vjet ...*, f. f.19

b. Në revistën *Studimet filologjike* gjejmë dhe dy artikuj *për shqipen standarde në Kosovë*. Në artikullin ***Rruga e zhvillimit të gjuhës letrare shqipe në Kosovë***, (kumtesë në Kongresin e Drejtshkrimit), sillet thukhtë kjo rrugë. Autori, thekson se “rruga e zhvillimit të gjuhës letrare shqipe ndër shqiptarët që jetojnë në Jugosllavi, ka pasur etapat e saj që janë njëkohësisht etapa historike të popullit shqiptar”¹⁷.

Në vijim artikulli jep një vështrim të zhvillimit të shqipes, duke u ndalur te “Meshari” i Buzikut, me botimin e të cili “gjuha shqipe zë të ngrihet në shkallën e një gjuhe të shkrimit”, mandej te gjuha e Budit, Bogdanit e të tjerëve, gjuha e të cilëve ka karakter të përgjithshëm” që duhet të lidhet me ekzistimin e një tradite shkrimi të gjuhës shqipe, para se të dalë kjo lagje shkrimtarësh”. Aty i mësohet fort faktit se “gjuha e shkrimtarëve gegë të Veriut e të Kosovës të shekujve XVI-XVII, na paraqitet më komplekse, një gegërishte më e përgjithshme, e ngritur në një gjuhë shkrimi mbidialektore. Mirëpo, funksionet shoqërore të asaj gjuhe ishin ngushtësisht të kufizuara.”¹⁸

Artikulli, mandej, ndalet në periudhën e pushtimit osman kur shqipja zhvillohej duke u përdorur në kushte të veçanta, kur pushtuesi “kishte për qëllim nënshtrimin shpirtëror të popujve të Ballkanit, rrafshimin shpirtëror të të gjithë popujve që përfshiheshin në gjirin e Perandorisë, errësimin e shuarjen e elementëve thelbësorë të vetëdijes së kombësisë, sikundër janë gjuha dhe formimi shpirtëror që mbështetet në tradita të vjetra e të thella popullore dhe më në fund asimilimin e plotë të popujve.”¹⁹

Duke ditur rolin e letërsisë në zhvillimin e gjuhës, artikulli ndalet dhe te letërsia që zhvillohej në atë kohë, që “quhej zakonisht letërsi shqipe me shkronja arabo-turke”, një letërsi me përmbajtje fetare, ndaj dhe gjuha e kësaj letërsie “nuk mund të bëhej gjuhë e shkrimit as e shqiptarëve të besimit musliman, sepse me atë gjuhë nuk trajtoheshin punë dhe probleme të mëdha të popullit shqiptar sikundër ishin ato të periudhës së Rilindjes.”²⁰

¹⁷ I. Ajeti, E Lafë, *Rruga e zhvillimit të gjuhës letrare shqipe në Kosovë*, 1973/1, f. 109

¹⁸ I. Ajeti, *Rruga e zhvillimit...*, f. 110

¹⁹ I. Ajeti, *Rruga e zhvillimit...*, f. 110

²⁰ I. Ajeti, *Rruga e zhvillimit...*, f. 110

Pasi thekson rezultatet që u arritën në kohën e Rilindjes në fushën e gjuhës me të gjitha karakteristikat e saj, me priirjen e vazhdueshme konverguese të varianteve letrare shqipe, shton se në vilajetet që pas vitit 1912 u integruan në bashkësinë shtetërore të Jugosllavisë, mungonin kushtet për një krijim e zhvillim të kulturës më elementare në gjuhën shqipe dhe shqiptarët *nuk morën pjesë në punën e konvergencës së përgjithshme gjuhësore*.

Artikulli më tej ndalet në mbledhjet e bëra në Prishtinë për problemin e drejtshkrimit të gjuhës letrare shqipe:

Në mbledhjen e parë të ekspertëve të gjuhës, nëntor 1952, sipas autorit “u trajtuan disa çështje të ortografisë shqipe, për të cilat në praktikën e përditshme të variantit tonë letrar, nuk kishte një mënyrë njësores të shkrimit. Pika kryesore e drejtshkrimit mbi të cilën u këmbyen mendimet, përveç të tjerave ishte përdorimi i gjysmëzanores *ë* në gjuhën letrare shqipe, për shkrimin e së cilës largoheshin pikëpamjet e gjuhëtarëve. Për problemin gjithnjë akut të gjuhës letrare shqipe, thuhej sa vijon: *Me qenëse pakica kombtare shqiptare në RFPJ flet një dialekt të gegnishtes, gjuha e shkrimit për ne nuk mund të jetë veçse gegërishtja.*”²¹

Kurse mbledhja e vitit 1957 “pat për qëllim së pari me thjeshtue sa të jetë e mundun ortografin shqipe, por gjithnji tue u kujdesë që të mos cenohej aspak karakteri shkencor i saj”. Sipas tij, në mbledhje “bien në sy menjëherë dy rryma që ortografinë e gegërishtes letrare e përudhnin në drejtime të ndryshme: njëra përpiquej që ajo të shkonte, duke u përputhur qoftë edhe vetëm në punë të drejtshkrimit, me gjuhën letrare kombëtare, që shtihet në përdorim në të gjitha fushat e veprimtarisë krijuese të shoqërisë socialiste të Shqipërisë së re; ishin ata përkrahës të vetëdijshëm të vijës konverguese të gjuhës letrare shqipe, që nesër do ta kishin të gjithë shqiptarët; lagja tjetër e gjuhëtarëve dhe e punonjësve të tjerë në punë të kulturës nuk shihnin rëndësinë historike të tezës që karakterizohej nga përpjekjet që mbi baza dialektore të ndërtohet një gjuhë njëformëshe letrare shqipe; ata mendonin që gjuha letrare shqipe duhet të ketë një zhvillim të lirë e spontan; një palë tjetër e kësaj teze perspektivat e gjuhës letrare i shihnin në zhvi-

²¹ I. Ajeti, *Rruga e zhvillimit...*, 114-115

llimin e dalluar e të prerë të gegërishtes letrare nga *toskërishtja*, sikundër thoshin ata.”²²

Mbledhja e tretë, janar 1963, që përgatiti *Ortografinë e gjuhës shqipe* (Prishtinë, 1964), “e karakterizojnë rrahja e një kompleksi problemesh nga fusha e drejtshkrimit të gjuhës letrare shqipe dhe nga ana tjetër, orientimi që do të marrin zgjidhjet e çështjeve drejtshkrimore me synime konverguese, që në instancë të fundit favorizojnë zgjidhjen pozitive të gjuhës letrare, duke përfunduar në të ardhmen në një fizionomi njëformëshe.”²³

Kurse Mbledhja e katërt, prill 1968, njihet si Konsulta e Prishtinës, në të cilën në të cilën u aprovua kërkesa që gjuha letrare kombëtare shqipe e kohës sonë të merret e të zbatohet edhe nga shqiptarët në ish-Jugosllavi.²⁴

Artikulli *Shqipja standarde dhe shoqëria kosovare sot*, në pjesën e parë rimerr shkurtazi tezat e trajtuara tek artikulli *Rruga e zhvillimit të gjuhës letrare shqipe në Kosovë*, por duke u ndalur te debatet dhe qëndrimet ndaj bazës dialektore dhe zgjidhjes që i bëri çështjes së standardit Kongresi. Ndër të tjera akademiku thekson se “Duhet të theksojmë edhe këtë herë që zbatimi i gjuhës letrare ishte synimi i të gjitha këshillimeve që nga viti 1952, 1957, 1963, duke përfunduar më 1968 në Konsultën Gjuhësore të Prishtinës, kur u tha edhe se: *Njësimi i gjuhës letrare në të gjitha trojet e shqipes është rezultat i natyrshëm i proceseve të shoqërisë shqiptare veçanërisht nga Rilindja e këndeje*. Konsulta Gjuhësore e Prishtinës, duke u mbështetur në *Rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe*, të botuara si projekt në Tiranë më 1967, vendosi të njohë njëzëri - si gjuhë letrare të shqiptarëve në Jugosllavi - gjuhën letrare të vendit amë. Ky vendim historik e bën Konsultën e Prishtinës një gur shënues me rëndësi të veçantë në rrugën e njësimit gjithëkombëtar të shqipes letrare.”²⁵

Më poshtë autori i artikullit ndalet edhe një herë në argumentin se përse u zgjodh dialeti toskë si bazë dialektore e gjuhës së njësuar: “Nga gjysma e dytë e shekullit XIX gjuha e shkruar shqipe kishte arritur një shkallë të mirë bashkëpunimi me ndërtimin e godinës së madhe gjuhësore

²² I. Ajeti, *Rruga e zhvillimit...*, f. 115

²³ I. Ajeti, *Rruga e zhvillimit...*, f.116

²⁴ Shih më gjerë: I. Ajeti, *Rruga e zhvillimit...*, f. 116-117

²⁵ I. Ajeti, *Shqipja standarde dhe shoqëria kosovare sot* 2002/3-4, f. 24

nëpërmjet elementeve të ndërsjella gegë - toskë: toskërishtja e shkruar me një strukturë të qëndrueshme trajtash, pse ruante një stad më të moçëm e më të drejtë formash, kishte arritur një shkallë të atillë zhvillimi me shfaqje shkrimi *sui generis*: të folmet gege nuk kishin mbërritur në shfaqjen e tyre të shkrimit një afrim që do t' i bashkonte të gjitha ato të folme, ndonëse mendohet, me të drejtë, se dialekti gegë përmban qindra shprehje që toskët i kanë humbur, e që janë xhevahire të vërteta, sepse i kemi trashëguar nga paraardhësit tanë të lartë. Dialekti toskë - thoshte Konica - është *i gjallë, i shkathhtë, i lehtë dhe në një evolucion të vazhdueshëm*.²⁶

Dhe vazhdon “Të gjithë e dimë fort mirë se të folmet toske kishin arritur të afrohen në atë shkallë sa që kishin krijuar një koine të përbashkët: në kohën e Rilindjes toskërishtja e shkruar ishte shtrirë në përmasa të gjera duke e lënë gegërishten e shkruar prapa”²⁷. Në këtë linjë argumentimi thekson se “edhe sikur përpjekjet për të krijuar gjuhën e përbashkët letrare të mos gëzonin mbështetjen e faktorit politik - e pashmangshme në ngritjen e një shoqërie e shteti modern, epërsia e toskërishtes letrare do të çonte me siguri të madhe në vënien e saj në bazë të gjuhës së njësuar letrare shqipe. Shumë shkencëtarë albanologë e joalbanologë gjuhën tonë letrare e gjejnë të drejtë edhe nga pikëpamja teorike dhe praktike. As nga ana racionale nuk e shohin punë të urtë e me mençuri që kjo gjuhë të zëvendësohet me ndonjë tjetër.”²⁸

Më tej artikulli është një debat për pikëpamjet e Këderiçit që polemizon për vendosjen e toskërishtes në themel të gjuhës së përbashkët letrare shqipe, çka sipas tij ka shkaktuar “arbitraritet a majoritet mbi variantin letrar gegë”. Dhe akademiku pyet: “A thua është gjuha e njësuar shkrimore shqipe mjet për të nënshtuar gegët? Ç'kuptim ka ky gjykim i studiuesit gjerman R.Këderiç pse gjuha standarde shqipe nuk qenka gjuha e të gjithë shqiptarëve?!” Mandej ai thekson se procesi i përzgjedhjes së bazës dialektore të standardit ka qenë shkencor, sepse “është vënë në peshore cilësia fonetike e gramatikore e të dyja varianteve letrare shqipe dhe së paku nga ana thjesht gjuhësore, në një anë, dhe, në anë tjetër, nga shkalla më e lartë e

²⁶ I. Ajeti, *Shqipja standarde* ..., f. 25

²⁷ I. Ajeti, *Shqipja standarde* ..., f. 25

²⁸ I. Ajeti, *Shqipja standarde* ..., f. 25

toskërishtes me drejtësinë e formave fonetike, morfologjike shumë më të stabilizuara, - njohësi shqiptar i dialekteve të shqipes s'ka mundur të mos ta gjente më të pranueshme letrarishten jugore shqipe.”²⁹

Artikulli vazhdon me parashtrimet se problemet e ndryshme që dalin për përvetësimin e standardit, shoqërohen edhe me një prirej të rinjve për të folur në dialekt.

2. Artikuj për historinë e shqipes. Kjo është dhe fusha që e identifikon plotësisht personalitetin shkencor të akademikut tonë. Edhe pse janë vetëm 4 artikuj, aty vërehen formimi i tij i plotë shkencor, metodat e sakta të kërkimit dhe të studimit, aftësia paraqitëse, përqaesë, polemizuese e kundërshtuese, sidomos ndaj tezave që vënë në dyshim vazhdimësinë ilire dhe vendësinë e shqiptarëve në trojet e ish-Jugosllavisë. Njohës i shkëlqyer i produktit studimor evropian për shqipen dhe shqiptarët, I. Ajeti mbështetet në autorët më të *pranuar dhe më asnjnës në prurjet e tyre. Dhe vazhdueshëm në referimet argumentuese sidomos në shpjegimet etimologjike i drejtohet akademikut E. Çabej.*

a. Në artikullin *Për historinë e marrëdhënieve të hershme gjuhësore shqiptare-sllave*, profesor I. Ajeti synon të argumentojë se shqiptarët janë trashëgimtarë të pandërmjetshëm të qytetërimit të lashtë ilir, si pohim edhe të rezultateve që janë arritur sipas tij në gjuhësinë albanologjike dhe në linguistikën krahasimtare, duke u ndalur së shumti dhe në *emërtime shqipe në terminologjinë e sferës baritore të të folmeve serbokroate.*

Në pjesën e parë të artikullit theksohet rëndësia e metodave dhe metodologjia e studimit në historinë së gjuhës. Autori thekson se “në punën e hetimit të problemit të burimit të shqipes nga ilirishtja, në punë të birërisë së saj nga kjo, pas rezultateve që janë arritur në këta njëzet vjetët e fundit në gjuhësinë albanologjike dhe në linguistikën krahasimtare, jemi të mendimit se ka ardhur koha që shkenca më shumë t'i silltet metodologjisë së atyre studimeve se sa çështjeve të tjera lidhur me marrëdhënjet e të dyja gjuhëve këtu të përmendura. Profesor Eqrem Çabej është njëri nga të rrallët dijetarë që shkencëtarëve albanistë u tërheq vëmendjen në këtë pikë.”³⁰

²⁹ I. Ajeti, *Shqipja standarde ...*, f. 27

³⁰ I. Ajeti, *Për historinë e marrëdhënieve të hershme gjuhësore shqiptare-sllave*, SF, 1972/4, f. 83

Pasi sjell në vëmendje toponime të vendeve ku gjëllijnë shqiptarët brenda dhe jashtë kufijve politikë të Shqipërisë dhe që pajtojnë me fonetikën historike të shqipes (*Ragusium - Rush; Naissus - Nish; Scardus mons - Shar; Scupi - Shkup; Drivastum - Drisht; Lissus - Lesh, Lezhë; Candavia - Kunavija; Durrachion - Durrës; Issamnus - Ishmi; Thyamis - Çam*), në emra lumenjsh (*Dri nga Drinus, Buen(ë), Bunë nga Barbanna, Mat*), ai i drejtohet dhe terminologjisë detare e peshkatore si dhe huazimeve latine të shqipes, si argument për lashtësinë e shqiptarëve e të gjuhës shqipe³¹.

Në pjesën tjetër të artikullit, autori synon të hedhë pakëz më tepër dritë mbi praninë e shqipes në gjuhët e sllavëve të jugut dhe shkruan se “Dihet me siguri se bazat për një ndikim shumëduarsh të shqipes në gjuhë të tjera të Ballkanit nuk kanë munguar.”³² Por ai vëren me të drejtë se “Në fushën e kërkimeve gjuhësore reciproke shqiptare-sllave shfaqen mospajtime e divergjenca në punën e burimit të fondit të përbashkët leksikor e gjuhësor. Kërkimtarët që hetojnë atë problem nuk gjejnë pajtim në punën se ku do kërkuar burimi i fjalëve, si: vatra, katund sllav. katun, bajgë, balega, Baran, bara, Bar, Baluk, Baljota, bustric, frús, kracun, korda, djalnuti, barla, bera, zalo, urda, hira, zarica, laja, barzast.”³³

Dhe më tej i mëshon faktit se kundër fakteve argumentuese, janë shumë studiues sllavë, të fushave të ndryshme. Akademiku thekson se “Gjykime të rezervuara shfaqin historianët, linguistët e etnografët, etj. kur bëhet fjalë për praninë e elementit shqiptar dhe të gjuhës së tij në toponiminë dhe në ligjërimi të disa zonave ku gjurmët e shqiptarëve konstatohen me lehtësinë më të madhe (Erdeljanoviç, *Stara Crna, Gora, Kuçi, pleme u Crnoj Gori*; Andrija Joviçević, *Zeta i Leškopolje*, Beograd 1926; Stevan Duçiç, *Zhivot i običaji plemena Kuća*, Beograd 1931; Ivan Popoviç, *Zeitschrift für slavische Philologie*, XXVI).”³⁴

Në vazhdim thekson se këto fjalë janë të mbarë gjuhës sonë dhe dalin të përhapura në në familje gjegjëse fjalësh. Nga ana historike burimi shqiptar i tyre përlijet shumë lehtë nga se blegtoria ishte mjeshtria nacio-

³¹ Shih më gjerë, I. Ajeti, *Për historinë e marrëdhënieve...*, f. 84

³² I. Ajeti, *Për historinë e marrëdhënieve...*, f. 85

³³ I. Ajeti, *Për historinë e marrëdhënieve...*, f. 85

³⁴ I. Ajeti, *Për historinë e marrëdhënieve...*, f. 85

nale e shqiptarëve, barinjtë duke shtektuar në kërkim të kullosave më të mira, përhapnin fjalë - terme blegtorale në vise tjera të Ballkanit³⁵.

Akademiku jo vetëm rrëzon shpjegimet etimologjike të gjuhëtarëve nacionalistë sllavë, por në ndonjë fjalë kundërshton dhe etimologjinë e bërë nga prof. E. Çabej., si për *kraçun* “kërshtëndella”, *grëmëratë* f. “kulloshtër”.

Po japim përmblendhtas njërën prej tyre: “**Grëmëratë** f. kulloshtër. Në shqipen fjala del me përdorim të kufizuar, e njohin me sa duket vetëm ligjërimet arbëreshe të Greqisë, prandaj Çabej s’ja ka dalë në krye ta shpjegojë me mjete të gjuhës shqipe, në analizën e së cilës ai arriti në një *grëmë* të pavërtetueshme... Burimi i kësaj fjale do të kërkohet te gjuhët sllave, te shprehja serbokroale *grumen*, nga një trajtë më e mëtejshme *grudmen* ku - *men* do të njehet prapashtesë e vjetër parasllave, që shpejt u zhduk nga sllavishtet, me vështirim: “*toptha të qumështit kur mbështillet, kokrriza qumështi, plis dheu, top dheu, shuk bore; sumbull gjaku*”. Fjala përqaset te gjerm. *gries*; fjala sllave u shtri në shqipen e hershme - *grumen* - që, sipas rregullave në fuqi të shqipes, u zhvillua trajta *grëmëratë*, që më vonë me rregullimin mekanik akcenti u shpërngul në rrokjen e parafundit *grëmëratë* duke pësuar rotacizmin, ndërsa forma e greqishtes së re (*gramenata*) u muar jo me ndërmjetësinë e shqipes, përndryshe po të kishte hyrë ndër-mjetësisht, do të mbetej pa shpjegim mungesa e rotacizmit në formën e fjalës greke *gramenata*; për rrjedhim te *grëmëratë* dhe e rindërtuara *grëmënatë* nuk kemi të bëjmë me zhvillime shumëfish me anë të -*na*, -*ra*.”³⁶

b. Historia e gjuhës shqipe përmes toponomastikës na vjen me artikullin **Kontribut për studimin e disa toponimeve të Malit të Zi**. Autori parashtron se toponimia e Malit të Zi, sidomos ajo e zonave kufitare, ka shpesh emra me origjinë shqipe. Ai sjell shpjegime për emërtimet të mbështetura në ligjet e fonetikës së shqipes: *Brinje* (nuk mund të ndahet nga: *brî, brîni; bri, briri*) *Kunje*: *kunj, Suka*: *Sukë, (Çukë)*. *Fierza*; *Gropa*; *Ša-ljeza*, *Rogame*, *Shestan*, *Štek* etj. Janë me origjinë shqipe edhe *Prentin*, *Buronja*, *Buronjić*, *Zotovina*, *Kumbula*, *Ljug*, *Bridje*, *Bridjaçi*.³⁷

³⁵ Shih më gjerë I. Ajeti, *Për historinë e marrëdhënieve...*, f. 91-92

³⁶ I. Ajeti, *Për historinë e marrëdhënieve...*, f. 91-92

³⁷ Shih më gjerë I. Ajeti, I. Ajeti, *Kontribut për studimin e disa toponimeve të Malit të Zi*, SF, 1984/2, f. 39-44

Në artikull theksohet se shumë interesante janë edhe përkthimet ose kalket nga shqipja, si: *Ljudja od Korita* (Lugjet e Koritave), *Špela Maraševa* (Shpella e Marashit) etj.

Akademiku ndalet dhe në onomastikën me origjinë shqiptare, duke sjellë për ilustrim emra, si *Šoć* (shoq); *Zogović* (zog), *Zotović* (zot); *Zonjići* (zonjë), *Ujkovići*, *Gašići*, *Beriša*: *Voglić*, *Bardonja Burmazi* ose *Burmazović* (burrëmadh), *Barzeta* me *Bardheci*, *Barleti Kokeza*.³⁸

Artikulli mbyllet me pohimin se “Analiza gjuhësore e materialit toponimik të Malit të Zi na lejon të bëjmë një vërejtje të re: shumica e toponimeve është me origjinë shqiptare. Shqyrtime etnologjike që deri tash kanë refuzuar à priori çdo mundësi të origjinës shqiptare, nuk kanë bazë shkencore. Kjo kuptohet mirë kur dihet se autorët e tyre nuk janë specialistë, domethënë linguistë.”³⁹

c. Historia e shqipes përmes onomastikës vjen dhe përmes artikullit ***Kontribut për studimin e onomastikës mesjetare në territorin e Malit të Zi, Bosnjës e Hercegovinës dhe të Kosovës***, përsëri një nga punimet më të mira të autorit dhe me vlerë për studimet historike të gjuhës shqipe dhe jo vetëm. Artikulli referon burime të pasura literature, sjell përqasje, pohon, kundërshton argumenton në të mirë të tezës se në territorin e Malit të Zi, Bosnjës e Hercegovinës gjen shumë toponime e emra vetjakë shqiptarë. Ai vëren se “Në literaturën e pasur që merret me studimin e kushteve të jetesës së barinjve ballkanas, krahas toponimeve dhe antroponimeve vllahe në “katun”-in mesjetar, gjejmë me shumicë emra visesh dhe emra vetjakë me origjinë shqiptare. Gjurmët shqiptare dhe thërmijat gjuhësore me origjinë shqiptare vërtetohen edhe nga burime historike, të cilat dëshmojnë për përkatësinë gjuhësore shqiptare të emrave të disa vllazërive të vjetra të Zetës, siç janë *Mataguzhët* te Podgorica e djeshme (1335), *Mahina* në Primorje (1435), të cilat me emrin e tyre, siç pohon Shuflaj (Arhiv 22), të kujtojnë Maniojë të ilirë (μαρύ), pastaj *Maloshiqët* (Malošili) në luginën e lumit Zeta (Jireček Staat, 2, 34).”⁴⁰

³⁸ Shih më gjerë I. Ajeti, I. Ajeti, *Kontribut për studimin e disa...*, f. 44

³⁹ I. Ajeti, *Kontribut për studimin e disa...*, f. 44

⁴⁰ I. Ajeti, *Kontribut për studimin e onomastikës...*, f. 15

Më tej studimi përmes një lidhjeje të pandashme onomastikë – toponimastikë, ndalet në ato katunde, të cilat me emrin e tyre dhe me atë të barinjve që jetonin aty, vërtetojnë origjinën shqiptare. Përmendim sipas studiuesit: “*Pantalesh, Barzan* (Bardhan), *Bankec, Bytidosi, Lazorci* (1497). Këta katune, si dhe emërtimet e tjera me origjinë shqiptare, kanë marrë prapashtesa të gjuhës serbe: *Leškovići, Lopari, Vjeduši, Bardići, Kući. Lićeni* (liqeni) e *Shpaja* me katunet: *Djonović, Lesković, Murović, Kolemade* (shqip *Golëmadhe* - gojëmadhi). Në nahijet e tjera, në atë të malit të Hotit dhe të Pipërit, gjejmë të dëshmuar katune dhe fshatrat me emra shqiptare që nga fundi i shek. XV: *Keçi, Špihja, Bušat, Rogami, Bukmir* (shqip *Bukëmirë*).⁴¹

*Hapësira e qëmtimit të emërtimeve të vendeve prej emrave të njerëzve është e gjerë. Autori ndalet sidomos në nahijen e Kuçit, duke shkruar se janë me origjinë shqiptare: Pantalesh, Barzanj (Bardhanj), Bankeqi, Butidosi, (Bytidosi). Po kështu, sipas tij, edhe toponimet Rogami, Bušat, Bukmira, Bukumir, nuk mund të shpjegohen me saktësi pa ndihmën e gjuhës shqipe, si dhe disa katune, emrat e të cilëve lidhen me apelativa shqipe, siç janë: Koçe, Fundana, Fundina ose Fundëna, Lis-na, Kishën, Shtiqën.*⁴²

Interesant është zgjerimi i interpretimit dhe i argumentimit shkencor në pjesën tjetër të artikullit ku thuhet se “Toponimia e përzier e këtyre krahinave na nxit të bëjmë kërkime edhe në një fushë tjetër shkencore, në *antroponimi*, që të marrim vesh diçka më shumë mbi përbërjen etnike të banorëve të këtyre krahinave gjatë shk. XV dhe XVI”. Duke kundërshtuar studiuesit serbë, studiuesi ndalet në regjistrat e familjeve të 50 fshatrave të Metohisë, regjistruar te Defteri i Sanxhakut të Shkodrës (1485-1582). Akademiku shkruan se “një numër i mirë fshatrash me emrat e familjeve janë kryesisht me origjinë shqiptare p.sh. në fshatrat *Plakani, Mel, Morina, Dujak, Dolina, Crna, Peronja, Radosh, Dolina, Buxhani, Bozhani, Vuçidol, Berbat, Veliki Dobrosh, Mali Dobrosh, Branković Trnova, Bogova, Kolić, Goraniça, Kolshid, Sismanci, Popovici, Bonisuci, Stubla, Rogami*, mund të themi se gjithë emrat vetiakë janë shqiptarë, si *Gjin, Gjon, Leka,*

⁴¹ I. Ajeti, *Kontribut për studimin e onomastikës...*, f. 17

⁴² Shih më gjerë, I. Ajeti, *Kontribut për studimin e onomastikës...*, f. 17-20

*Kola, Gega, Progon, Tole, Lesh, Pepa, Bardo, Kolsh, Gjec, Tanush, Bushat, Lulo, Mazarak, Pal, Duka etj.*⁴³

Dhe në fund të artikullit akademiku del me përfundime shumë të rëndësishme, ndër të cilat përmendim se “numri i emrave vetiakë karakteristikë shqiptarë në regjistrimin e Sanxhakut të Shkodrës në disa fshatra të nahijes së Dukagjinit është shumë më i madh se sa ai i emrave vetiakë serbë; janë pa bazë edhe pohimet e disa historianëve se prania e shqiptarëve në krahinat e tokave serbe të mesjetës është vërtetuar vetëm te katunet; onomastika me karakteristike të qartë shqiptare, kaq e bollshme në dokumentet serbe të mesjetës, vërteton qartë praninë e shqiptarëve si masa etnike të ngulura në krahinat e lartpërmendura, pra para dyndjes turke; shtimi i madh i elementit shqiptar gjatë shekullit XV e XVI, siç e tregojnë regjistrimet e para turke të banorëve të Dukagjinit dhe të Kosovës, shpjegohet...me rritjen natyrore të shqiptarëve në ato krahina të Dukagjinit dhe të Kosovës si edhe me lëvizjen e banorëve shqiptarë.”⁴⁴

d. Historia e gjuhës shqipe trajtohet dhe tek artikull *Për disa huazime shqiptare në të folmet serbo-kroate*, ku i mëshohet edhe një herë fortazi karakterit dhënës të shqipes. Në artikull merren në vëzhgim “një tubë fjalësh e shprehjesh me gurrë shqiptare në dialekte të truallit jugor e lindor të serbishtes”, hetim që për akademikun kish qenë prej shumë kohësh objekt studimi. Formimi i studuesit ka mundësuar interpretime të sakta në mbështetje për gurrën shqipe të fjalëve të përzgjedhura, duke kundërshtuar origjinën e dhënë për to në fjalorët akademikë serbo-kroatë. *Ai ndalet në fjalë, si shtirkina štirka dhe štirkinja - shqip shterpë*. “Format e shprehjeve shterpë, shter, shterr, shterc (plak i lënë), shtjerra, shqerra, do t'i bashkohen trajtës së foljes *ter = thaj* nga një më e vjetër **tar*, që ruhet si oronim e hidronim këtej e përtej Adriatikut: *Tara, Tarentum, Taranto*, mbase edhe *Tarabosh; shter, shterr* përrenj e lumenj që shterin verës në viset jugore, sidomos nëpër trevat karstike, janë një dukuri e ditur për gjeografin”⁴⁵.

“Tuba e fjalëve” përfshin gjithashtu: *veja* që e lidh me shqipen *e ve, e veja*; *zašātiti, zàšātim* që i lidh me fjalën shqipe *shatë*; *zaprūšiti, zaprūšim*

⁴³ I. Ajeti, *Kontribut për studimin e onomastikës...*, f. 22

⁴⁴ Shih më gjerë, I. Ajeti, *Kontribut për studimin e onomastikës...*, f. 24-25

⁴⁵ I. Ajeti, *Për disa huazime shqiptare në të folmet serbo-kroate*, SF, 1981/2, f. 87-88

që i lidh me fjalën shqipe prush me parashtesën *za*; *dëlāk*, *āka* që i lidh me fjalën shqipe *djalē*, *djel*; *zdeknuti*, *zdeknem* që i lidh me fjalën shqipe *dek* / *vdes*, *aoristi diq*; *zarēpati*, *zārēpām* që i lidh me fjalën shqipe *rrēfej*, *rrē-fehem*; *lākora me lakur*, *šūriti*, *šurim* që e lidh me fjalën shqip *shurrē* etj.⁴⁶

Autori ndalet dhe te huazimi i formantit fjalëformues shqip -*ēz* / -*za*, që del te ndonjë fjalë e serbokroatishtes: *dretēza* me burim shqipe *dredhēz-za*; në antroponimi sllavojugore: *Ivo-Iveza*, *Ivezić (Ivić)*, *Nikeza*, *Nikezići*, prej *Niko*, *Nika*. Gjithashtu ai pranon se në krahinën e Kuçit, Mal i Zi, kemi një shembull kalkimi nga shqipja në serbisht: *tvrdo malo* / *fort pak*⁴⁷.

4. Ndhimesa shkencore në revistë vjen edhe me një studim të mirëfilltë dialektologjik: ***Rreth disa veçorive të të folmeve të shqiptarëve të rrethit të Preshevës dhe të Bujanovcit***, me lëndë, si thotë autori *nga dhjetë a dymbëdhjetë fshatra* dhe që ai "për arësye të kohës së shkurtër ka shënuar vetëm disa nga karakteristikat më kryesore të të folmeve shqiptare të këtyre viseve."⁴⁸

Punimi ndalet në ndarje tipologjike dhe në modele të njohura të punës dialektologjike në terren. Fillimisht jepen dukuri të sistemit *vokalik* të folmeve, duke dalluar disa të tilla si: prania e shtatë vokaleve: *a*, *o*, *u*, *y*, *e*, *i*, *ē* (*ō*); prania e bivolalizmit (vokale orale dhe nazale); prania e kuantitetit të zanoreve; lëvizja e theksit në fjalë (theksi lëviz përbrenda rrokjeve të fjalëve te fjalët e theksuara në rrokjen fundore, sidomos në fjalë me gurrë orientale; një kategori fjalësh të burimit vendës ruajnë theksin në rrokjen e parafundit, fjalë theksi i të cilave në gjuhën e përbashkët letrare shtyhet në silabën fundore: *véri* = *verí*; *njéri* = *njerí*); vokali *y* gjendet si *i*; diftongjet dalin shumë më të qëndrueshëm në gojën e brezit të vjetër (përkundër brezit të ri që ato i gjejmë në një masë të madhe të thjeshtuara)⁴⁹.

Kurse te dukuri të konsonantizmit vëren: *q:ç*; *gj:xh* ruhen mirë (një e folme e rrallë e dialekteve gege që i ruan të paprekura); palatali *nj* është zhdukur në sistemin nominal në pozicionin fundor: *rrāj* (rranjë); *bāj* (banjë)

⁴⁶ I. Ajeti, *Për disa huazime ...*, f. 88-91

⁴⁷ I. Ajeti, *Për disa huazime ...*, f. 91

⁴⁸ I. Ajeti, *Rreth disa veçorive të të folmeve të shqiptarëve të rrethit të Preshevës dhe të Bujanovcit*, SF, 1971/3, f. 65

⁴⁹ Shih më gjerë: I. Ajeti, *Rreth disa veçorive ...*, f. 68-73

etj.; spiranti velar *-h* shfaqet i ndryshueshëm: ka raste që në fjalë zhduket fare në pozicionin e silabës fundore, por është ruajtur sidomos në pozicionin nistor të silabës; konsonanti likuid *-rr* del i qëndrueshëm; kjo vlen edhe për konsonantet *l-ll*: *l*-ja palatale dhe *ll*-ja velare; *th-dh* njihen të qëndrueshëm. Togjet *kl-gl* kanë përfunduar në *k*, *g*; *mb*, *nd* në *m e n*; grupet *tj*, *dj* në palatale eksplozive, vise-vise edhe në afrikate *q*: *gj* (= *c*: *đ*)⁵⁰.

Autori në fund përcakton dhe përkatësinë dialektore të këtyre të folmeve, duke theksuar se "mund të thuhet me siguri se gjithë kjo anë këtu brenda edhe rrethi i Gjilanit, krahina e Preshevës dhe e Bujanovcit, hyjnë në atë grup të të folmeve shqiptare që cilësohen nga një dinamikë komplekse dhe e zhvilluar fonetike; porse vendin qëndror në atë tip dialektor zënë të folmet e Matit, të Mirditës, të Dibrës me viset e tyre brenda shtetit tonë dhe jashtë tij, ligjërime që në mes të tyre kanë konkordanca dhe pika takimi të shumta, pastaj të folmet gege në Maqedoninë Perëndimore si dhe ato të rrethit të Kumanovës. Gjuha e bartësve të këtyre të folmeve progresive e dinamike karakterizohet nga një ndryshim i konsiderueshëm që shfaqet në pasqyrën reale dialektore të kësaj zone - objekt hetimi i këtij studimi, në të cilin konstatohet në një pjesë të madhe një shrrëgullim dhe inovacion edhe në të folmet e tjera të këtij territori e që pajtojnë me idioma malësore të Shqipërisë Veriore."⁵¹

Autori përmes këtij studimi ka dhënë njëherazi ndihmesë të jashtëzakonshme për pikat referuese të Atlasit dialektologjik.

Duke e mbyllur këtë paraqitje, ku më shumë foli akademiku me studimet e tij, shprehim falënderimet dhe mirënjohjen tonë për kontributin e vyer, dhënë në faqet e revistës Studime filologjike, duke sjellë studime që jo vetëm tregojnë punën e tij, rrugën e ngritjes dhe të ecjes në këmbë të sigurt të shkencave gjuhësore në Kosovë, por edhe duke ia ngritur vlerat, cilësinë dhe peshën vetë revistës.

⁵⁰ Shih më gjerë: I. Ajeti, *Rreth disa veçorive ...*, f. 73-79

⁵¹ Shih më gjerë: I. Ajeti, *Rreth disa veçorive ...*, f. 79

Artikujt e akademik I. Ajeti, botuar në revistën "Studime filologjike"

- I. Ajeti, *Rreth disa veçorive të të folmeve të shqiptarëve të rrethit të Preshevës dhe të Bujanovci* [Particularités des parlers des albanais des districts de Presheve et de Bujanovci], 1971/3, f. 65-83.
- I. Ajeti, *Për historinë e marrëdhënieve të hershme gjuhësore shqiptare-sllave* [Pour servir à l'histoire des anciens rapports linguistiques albano-slaves], 1972/4, f. 83-94.
- I. Ajeti, *Rruga e zhvillimit të gjuhës letrare shqipe në Kosovë* [Le chemin du développement de la langue littéraire dans la Kosove], 1973/1, f. 109-117.
- I. Ajeti, *Kontribut për studimin e onomastikës mesjetare në territorin e Malit të Zi, Bosnjës e Hercegovinës dhe të Kosovës* [Contribution à l'étude de l'onomastique médiévale dans les territoires du Monténégro, de la Bosnie et Herzégovine, du Kosovo], 1974/3, f. 15-27.
- I. Ajeti, *Për disa huazime shqiptare në të folmet serbo-kroate* [Sur quelques emprunts albanais dans les parlers serbo-croates], 1981/2, f. 87-92.
- I. Ajeti, *Kontribut për studimin e disa toponimeve të Malit të Zi* [Contribution à l'étude de quelques-unes des toponymes de Monténégro], 1984/2, f. 39-44.
- I. Ajeti & E. Lafë, *Njëzet e pesë vjet nga Kongresi i Drejtshkrimit (Vlerësime dhe vështrime në të ardhmen)* [25 années du Congrès de l'orthographe (Considérations et regards dans l'avenir)], 1998/1-2, f. 5-21.
- I. Ajeti, *Shqipja standarde dhe shoqëria kosovare sot* [L'albanais standard et la société Kosovare d'aujourd'hui], 2002/3-4, f. 23-29.

Mehmet HALIMI, Prishtinë

AKADEMIK IDRIZ AJETI MJESHTËR I MADH I PËRDORIMIT TË FJALËS SHQIPE

“Nuk ka vështirësi më të madhe sesa mjeshtria e fjalës”

Sot kemi një jubilar të dyfishtë: **së pari, po shënojmë 100–Vjetorin e një shekullari – akademik Idriz Ajetit**, i cili ballëllartë e krenar si një rrap shekullor, me veprimtari të pasur shkencore, po qëndron në gjirin tonë shoqëror; **së dyti se sot kemi nderin dhe kënaqësinë, rastin më fatlum që në praninë e tij të flasim për personalitetin e tij dhe të spikasim sukseset e vlerat e veprimtarisë së tij shkencore**. Ky është vërtetë një moment i rrallë në truallin tonë shkencor, që do të mbahet mend e do të kujtohet gjatë ndër breza.

Gjuhëtari ynë i njohur, albanologu e ballkanologu i shquar, studiuesi e kultivuesi i dalluar i gjuhës amtare e mjeshtri i madh i përdorimit të fjalës shqipe, akademik Idriz Ajeti, është njëri ndër dijetarët e rrallë në fushën e shkencave albanologjike, i cili vuri themelet e kësaj dijeje në taban të fortë e të shëndosh shkencor. Ai përvijoi e trasoi hullinë e parë në udhë të mbarë të njësimit të gjuhës shqipe në Kosovë si udhëzues, frymëzues e organizues i Konsultës Gjuhësore të Prishtinës (1968), e cila i parapriu Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe(1972). Si “Dijetar i rysur, kërkues dhe mbrojtës i palodhur e i paepur i së vërtetës shkencore, prijatar në shumë fusha të albanologjisë dhe prind shpirtëror i nxënësve dhe studentëve të tij të shumtë, mik i dashur i zemrës i kolegëve e bashkëpunëtorëve” – thekson E. Lafe¹. Idriz Ajeti është njohësi më i mirë i të folmeve shqipe në Kosovë, i të folmeve të shqiptarëve jashtë shtetit zyrtar të Shqipërisë, në veçanti,

¹ Emil Lafe, *Vepra madhështore e Idriz Ajetit, "Gjuha shqipe", IAP, Prishtinë 2007, f. 11.*

dhe i të folmeve shqipe, në përgjithësi. Ndaj, ai duke i studiuar dialektet dhe të folmet shqipe, për të formuar një unitet kombëtar, angazhohet me mish e shpirt edhe për një gjuhë të njësuar e të standardizuar kombëtare, duke shtruar qartë pyetjen çuditëse, që vetvetiu nënkupton edhe përgjigjen: “Ç” është më e natyrshme se një popull – edhe pse i ndarë në bashkësi të pavarura shtetërore, të ketë një gjuhë të përbashkët letrare ? ! – thekson me të drejtë Idriz Ajeti², i cili çështjen e njësimi të gjuhës e studioi në tre rrafshë: *Në rrafshin kulturor, në rrafshin shkencor dhe në rrafshin kombëtar*³. Fryma e bashkimit kombëtar që, nën udhëheqjen e Idriz Ajetit, mbolli Konsulta Gjuhësore, e krijoi moton moderne shqiptare që tingëllonte dhe tingëllon dhe sot: *Një komb – një gjuhë*⁴, si ide e fuqisë së bashkimit dhe si veçori dalluese nga etnitë tjera në Ballkan.

Idriz Ajeti si mjeshtër i madh i përdorimit të fjalës shqipe, në këtë kuadër të pastërtisë gjuhësore, ai shton se *pa gjuhë të pasur e të pastër, s’ ka as ide e mendime të larta*⁵. Ndaj, në këtë aspekt ai paraqitet edhe si mjeshtër i përdorimit semantik dhe stilistik i fjalës në veprimtarinë e tij shkencore dhe në shkrimet e tija në përgjithësi, kulturore e publicistike. Qysh në vitet e tetëdhjeta të shekullit të kaluar, atë e brengoste dhe shqetësonte mungesa e kultivimit të kulturës gjuhësore, ndaj me të dejtë tërhiqte vërejtjen: “*Me përjashtime të rralla, gjuha e shtypit dhe e publicistikës sonë në Kosovë ende është e varfër, stereotipe, e thatë, e paqartë, e mbytur në skema të modeleve të gjuhëve të huaja. Në veprimtarinë e kulturës së gjuhës nuk mund të ketë sukses po nuk u edukua dashuria për gjuhësinë amtare, ndjenja e përgjegjësisë dhe qëndrimi i ndërgjegjësimi ndaj saj*”⁶. Prandaj, në këtë drejtim ai gjithnjë u përpoq të jap këshilla e sugjerime, shembuj konkretë në përdorimin e drejtë të fjalës shqipe, me pastërti e veçanti gjuhësore si një Aleksandër Xhuvan i ditëve tona, sepse “*fjala ka alkiminë e saj. Ajo ka peshë, ka ngjyrë e shije, ka forcë shndërruese, çudibërëse, misterioze dhe magjike. . .*”⁷

² I. Ajeti, *Studime gjuhësore në fushë të shqipes III*, Prishtinë, 1985, f. 42.

³ Mehmet Çeliku, Konsulta Gjuhësore e Prishtinës dhe shqipja standarde sot (22 prill 1968 – 22 prill 2008), Prishtinë, 2008, f. 167.

⁴ Hysen Matoshi, Konsulta Gjuhësore, (Fjala e hapjes), IAP, Prishtinë, 2008, f. 5.

⁵ Idriz Ajeti, VEPRA 2, ASHAK, Prishtinë, 1998, f. 265.

⁶ Mehmet Halimi, Çështje fjalëformimi në gjuhën shqipe, Prishtinë, 1996, f. 263.

⁷ Avdyl Sula, (“Fjala ka alkiminë e saj. Ajo ka peshë, ka ngjyrë e shije, ka forcë shndë-

Sipas mendimit tim fuqinë dhe mjeshtërinë e përdorimit të fjalës shqipe të Prof. Idriz Ajetit mund ta kuptojmë më hollësisht e më gjerësisht po ta kundrojmë atë në katër rrafshë kuptimore, semantike e stlistike: 1. Në rrafshin e qartësisë : i saktë, i qartë dhe i kuptueshëm; 2. Hulumtues e kërkues i fjalëve popullore dhe përdorimit të tyre me shije logjike e me hije estetike – një Kristoforidh i ditëve tona; 3. Sipas analogjisë semantike, ai e pasuron dhe e zgjeron kuptimin semantik të fjalës së përdorur në tekst;

Idriz Ajeti bëri *vek pa yrrnek*, sepse ai krijoi një stil të vetin të veçantë, që nuk i gjason asnjë stili, një stil origjinal e unikat, si tipar karakteristik vetëm për Idriz Ajetin.

Këtu, në vijim, do të shkoqisim këta katër rrafshë, ku bënë jetë e ku zbatohet mjeshtria e përdorimit të fjalës shqipe të Idriz Ajetit.

1. Sa i përket rrafshit të parë, i cili na shpie në një krahasim analogjik ndërmjet dy profesioneve të ndryshme, por me veprime kujdesi identik e kuptime semantike krahasimi, si një magjatore e mirë dhe e vyer që me mjeshturinë e saj gatuan e mbrumon bukë e trajte të ndryshme të pjekurinave brumore nga mielli i magjes së vet e i grurit të arave tona, gatuan e mbrumon bukë shtëpie, që ka aromë e shije të ushqimit tonë vendor, të tokës sonë truallsore e atërore dardane. Po ashtu edhe Idriz Ajeti hulumton e gjurmon nga pleq e plaka dhe nga fshatarë e zejtarë, fjalë të brumit të shqipes, që përdoren në tërthore të viseve tona, të cilat ai i shtien në përdorim me mjeshtri e saktësi pasente e elokuate dhe me brumin e fjalëve burimore të gurrës shqipe, të mbledhura e të përzgjedhura, ndërton fjali e periudha dhe shkruan vepra shkencore, në të cilat shpreh idetë dhe mendimet e veta në një gjuhë e stil që kanë aromë e shije të gjuhës sonë të bukur amtare shqipe, ku mendohet shqip, ku flitet e frymohet shqip e me një sintaksë të natyrshme shqipe, që ka shije e hijeshi të gjuhës sonë amtare: *të rrjedhshme, të qartë, të saktë e të kuptueshme. Thënë shkurt: Profesor Idriz Ajeti ka aftësinë e mjeshturinë e saktë, që mendimit (ose idesë) të vet si origjinal t' i gjejë modelin (petkun), që shpreh qartë e saktë,*

rruese, çudibërëse, misterioze dhe magjike. Fjala e mirë të ngroh shpirtin, të kthjellon mendjen, të jep zemër e forcë. Fjala e keqe të lëndon të shkurajon. Kësisoj, fjala në kuptime e përdorime të ndryshme, bëhet mjaltë, por edhe helm, bëhet dritë dhe terr, lule e gjemb, plumb e pambuk, zanë mali dhe shtrigë, trëndafil e gjarpër”.).

me nuanca më të holla kjuptimore, me pastërti e veçanti gjuhësore synimin e qëllimin e vet të caktuar në mënyrë të përkryer.

2. *Profesor Idriz Ajeti*, hulumtues e kërkues i fjalëve popullore dhe i përdorimit të tyre – një Kristoforidh i ditëve tona, gjithnjë dëgjon e vëzhgon ligjërimin e të folmeve popullore nga pleq e plaka dhe në momente rasti e çasti i shënon dhe i regjistron këto fjalë dhe i përdorë e i aktivizon në shkrimet e veta, duke u dhënë funksione e kuptime të caktuara në veprat e tij shkencore. Ishin këto fjalë që nuk ishin përdor prej askujt më parë ose ishin përdorë, por jo me kuptime dytësore e tretësore, siç i përdorë dhe u jep jetë Prof. Idriz Ajeti. Po zëmë ngoje këtu një numër të konsideruar fjalësh të këtilla, si: *kaçubet, ledh, mbetëz, m'u la shtëq, në kërthizë të gjuhës, pikatë, spikatë, në krye të herës, në ballë të kohës, ngërthen, u shalakat, rrotull moteve, në rrjedh të kohës, në kapërcyell të shekujve, rrekem, mëtoj, zgrip, pisk, lik, kumt, zhbiroj, bubërroj, furem, m'u furë, kaptoj, këndellem, kërlëshem, mrizoj, mbarështoj, ngurroj, prangoj, shitoj, tufoj, trupoj, vrujon, bunon, e shumë të tjera.*

3. Sipas analogjisë semantike me anë të këtyre fjalëve me kuptim emërtimi parësor, Idriz Ajeti e pasuron dhe e zgjeron kuptimin e tyre me kuptime dytësore e tretësore të fjalës në tekst, si për shembull fjala *kaçubet-i* (makinë që merr veturat, të parkuara në vende të ndaluara, serb. Pa-uk), *rrotull moteve, në rrjedh të kohës, në kapërcyell të shekujve, lik-nerlik (ndërlikoj, i ndërlikuar), ndesh, zgrip, pisk, zhbiroj, gjerb-gjerboj, kaptoj, këndellem, bunon, vrujon, mrizoj, mbarështoj, shitoj, bollëzat e sajit(nga bollë-bolla, gjarpër, me deminutiv) që rrëshqasin në borë si bolla.*

4. *Stili origjinal-unikat i Idriz Ajetit në veprat e tij shkencore*

Idriz Ajeti bëri” *vek pa yrrnek*”, duke krijuar një stil të vetin origjinal – unikat, i cili u bë shkollë dhe model i mënyrës së të shkruarit shqip. Ndonëse nxënësit, pasardhës të tij, u përpoqën ta imitojnë, por deri më sot askush nuk arriti t’ i shëmbllej tekstit semantik e stilistik të Idriz Ajetit që të shkruaj me aq saktësi, qartësi e rrjedhshmëri, me aq pastërti e veçanti gjuhësore tekstet shkencore. Ai kuptimet semantike i ka matematizuar e milimetrizuar në njësi e nuanca tepër të holla gjuhësore, duke ndërtuar një stil të rrjedhshëm shkencor, të saktë e të qartë, ku ideja e mendimi janë shprehur e harmonizuar në shkallën më të lartë shprehimore me fjalën e caktuar e të përzgjedhur si gjedhe apo model i mendimit përkatës, sa që ai që e ka përcjellë me vëmendje e kujdes, pa e parë fare emrin e autorit, do ta

kuptojë se ky stil e kjo veçanti gjuhësore është tipar i veçantë dhe karakteristikë e stilit shkrimor të Idriz Ajetit. Askush, apo rrallëkush mund ta imitojë stilin shkencor të Idriz Ajetit. Sepse stili i tij është origjinal e unikat, i paarritshëm e i papërsëritshëm. Ai është stil në veti. Stili është vetë njeriu dhe njeriu është vetë stili. Secili njeri ka stilin e vet të mënyrës së shprehjes së mendimeve personale në të folur dhe në të shkruar.

Shembuj për të ilustruar konkretisht stilin shkencor të prof. Idriz Ajetit

Duke lexuar veprat shkencore të Idriz Ajetit, kemi vënë re këta shembuj ilustrimi për stilin origjinal shkencor të tij: “*Pedersen arriti që të spikasë tiparet më qenësore fonetike dhe morfologjike të Çamërisë në fjalë*”⁸. Ç’mund t’i shtojmë e ç’mund t’i heqim kësaj fjalie? – asgjë, sepse ajo është ndërtuar me një sintaksë të natyrshme shqipe, semantikisht saktë dhe qartë. Folja *spikasë* është aktivizim dhe zgjerim i emrit **pikë** i foljezuar në **pikatë**, që e ndeshim ndër të folme popullore, por i sforcuar me foljen **spikatë** marrë nga fondi leksikor popullor.

“... por në rastet e zëna ngoje **u-ja** është vokal që në krye të herës në disa të folme shqipe u alternua në **u. .**” (9)⁹. Përdorimi i fjalës të zënë ngoje është përdorë me mjeshtri të madhe dhe ka zënë vendin e vet siç përdoren notat muzikore, duke i dhënë fjalës origjinalitet e muzikalitet, me shije e aromë të stilit popullor shqip.

“Me këtë desha të them se ndërrimi i kuantitetit të vokaleve shpesh bart pas vete edhe ndërrimin e kuptimit të fjalës, kuantiteti i së cilës është shkurtuar”¹⁰.

Autori nuk ka dashur të përsërisë shprehjen të vënë *spikamë*, por në vend të saj ka përdorur shprehjen : *desha të them. . .*

“... Duke gjurmuar trajtën paralele...”¹¹. “Në një artikull mjaft të ndërlikuar të gramatikës shqipe...”¹². “...Po vazhdojmë të nxjerrim në shesh tiparet e konsonantizmit të të folmeve të Briskut e të Shestanit të

⁸ Idriz Ajeti, VEPRA I, ASHAK, Prishtinë, 1997, f. 10.

⁹ Vepra e cituar, f. 10.

¹⁰ Vepra e cituar, f. 68.

¹¹ Idriz Ajeti, Vepra e cituar, f. 72.

¹² Vepra e cituar, f. 74.

Krajës”.¹³ “...Unë kam shetitur kryq e tërthuer Krajën e Malit të Zi, Sheshtanin e Briskun, ku gjëllin popullata shqiptare...”¹⁴, “...Fjalën **theknore** e kam shënuar në kuptimin **kaçamak** me miell thekre nga **thekën** dhe sufiksi –ore për gjininë femërore;”¹⁵ Fjala **roshan** – dash me katër brirë.¹⁶ “Për toskërishten nuk do të sjellim shembuj, sepse atje koniunktivi është në përdorim të **hovshëm** edhe sot dhe është ruajtur i paprekur e në fizionomi të plotë”¹⁷. Kush do t’ishte kujtuar të përdorë këtu fjalën **hovshëm** me aq saktësi e me aq mjeshtri stilistike në vend të fjalëve: rëndom, shpesh, dendur, intensivisht, etj .

“Që në ballë të këtij vështrimi do të themi se titulli i sipërm, sikur ndamë ta quajmë, nuk do të mund t’i kënaq ata që e pandehin atë trajtim të rrasët mbi ligjërimet shqiptare të kësaj treve: një herë, sepse na mungojnë pothuaj kryekëputë të dhëna dialektore të shkoqura, që do të na japin krah e dorë për të bërë një vëzhgim të mirë rreth të folmeve në truallin e Kosovës. Edhe më parë, kushdo që kishte marrë të hetonte ndonjë prej ligjërimeve të këtyre viseve, për mungesë materiali të saktë gjuhësor, pak gjë ka nxjerr në dritë”¹⁸.

“Do të ishte rrugë e mbarë ajo që studimi diakronik i shqipes, që do të thotë dukuritë e saj të kapeshin në vijën e zhvillimit të tyre historik, të ketë pasur një vistër të tërë pune përgatitore në lëmin e filologjisë dhe të dialektologjisë shqiptare. E hetime shkencore të shqipes në qarkun e studimit krahasues të gjuhëve indoeuropiane filluan, mund të themi përafërsisht vetëm këtu e një shekull më parë. Në gjendjen e asaj kohe të dijes, shqipja ndihej fare pak”¹⁹. “Nga burimet e vjetra gjuhësore, të botuara për herë të parë në ligjërime të tyre, me dialektet e shkrimtarëve të Kosovës, ka të bëjë vepra e Pjetër Bogdanit që doli në dritë më 1685 në Padovë të Italisë. Pasi **ngrehu banimin** e vet në Shkodër, Bogdani jetoi atje një kohë të gjatë; por në shkrimet e veta nuk mundi t’i rrinte larg

¹³ Vepra e cituar, f. 76.

¹⁴ Vepra e cituar, f. 80.

¹⁵ Vepra e cituar, f. 94.

¹⁶ Vepra e cituar, f. 95.

¹⁷ Vepra e cituar, f. 98.

¹⁸ Idriz Ajeti, V E P R A 2, ASHAK, Prishtinë, 1998, f. 9.

¹⁹ Vepra e cituar f. 9.

*gjithherë ndikimit të shkodranishtes dhe të të folmeve të tjera të atyre anëve. Për këtë arsye, përse u përket shfaqjeve fonetike, gjuha e Bogdanit, megjithëse ky bir i këtyre tërthoreve, vetëm në rrasa të rralla ruan gjurmë të kosovarishtes së asaj kohe*²⁰.

Shënim:

Po t'i qasemi me kujdes e po të vëmë re stilin e veçantë të Idriz Ajetit, vërtetë shihet qartë se ai dallohet me veçoritë e veta nga çdo stil tjetër, nuk i gjason kurrnjë stili, ai është unikat, siç është i veçantë vetë Idriz Ajeti, si njeri e si shkencëtar. Këtu qëndron mjeshtria e përdorimit të fjalës shqipe dhe madhështia e stilit të Idriz Ajetit, me ind e petk të një teksti shkencor të poetizuar, që lexohet me ëndje e kureshtje të madhe, siç lexohen veprat gjuhësore të klasikëve tanë: Eqrem Çabejt, Selman Rizës, Shaban Demirajt, Mahir Domit, etj.

*“...Meqë. . nuk e merrnin vesh gjuhën e tregimit në fjalë, dorëshkrimi u la në arkivin e Bibliotekës Ambrosiana të Milanos, duke u dergjur dhe duke e ngrënë pluhuri i kohës derisa pas shumë kohësh, linguisti italian Matteo Bartoli e mori dhe e dha të bëhej një fotokopje që e botoi pa farë transkribimi në revistën **Studi albanesi**, T, 1932, f. 7. Pas një kohe të shkur-tër transkribimin e tekstit provoi ta gatitë linguisti shqiptar Mjeda, (Leka, IV, 1932, f. 359-362) me të cilin në shumë pika ne nuk pajtohemi*²¹.

*“Me rasën e vizitës sonë në Krajë i ramë pashë më pashë Shestanit, Briskut e vendeve të tjera të këtyre viseve në të cilat gjëlljnë shqiptarët, por nuk dëgjuam kurrkund tingullin e **L-së** evropiane*²². *“... i cili disa hoveshte nga Amerika e largët u **shalakat** deri në vendlindjen e tij – Shkod-rën me të vetmin objektiv të ngrejë një fushatë kundër gjuhës së sotme letrare*²³. *“...duhej të vihej në kërthizë të gjuhës letrare kombëtare*²⁴ *“...Tash e njëzet vjet pasi u përvetësua nga mbarë bota shqiptare mori, shtat e u zhvillua për mrekulli... ”*²⁵ *“...kurrkush nuk duhet ta flejë mendjen*

²⁰ Vepra e cituar, f. 9.

²¹ I. Ajeti, Djali plëngprishës në të folët shqip të Istrisë, VEPRA 2, ASHAK, Prishtinë, 1998, f. 131.

²² Idriz Ajeti, vepra e cituar, f. 143.

²³ Idriz Ajeti, vepra e cituar, f. 201.

²⁴ Vepra e cituar, f. 201.

²⁵ Vepra e cituar, f. 202.

e të pandeh se problemet e gjuhës shqipe dhe drejtshkrimit të saj janë zgjidhur njëherë e mirë te ne”²⁶. “Për historinë e gjuhës letrare të shqipes” **Meshari**” i Buzukut shënon një kapërcyell me rëndësi të dorës së parë. . .”²⁷. “Vënia e shqipes ballë për ballë me serbokroatishten në një rrafsh tërësor e të kodifikuar leksikor e me stile funksionale të përpunuara, i jep mundësi asaj që të nxjerr në pah të gjitha aftësitë shprehëse dhe zhërvjelltësitë, duke u pasuruar me zhvillime e krijime fjalësh e ngjyrimesh të reja dhe të ngrejë në një shkallë më të lartë stilin e shkrimeve”²⁸... .”që duke ecë në një ravë zhvillimi specifik...”²⁹.

Lidhur me kultivimin e kulturës gjuhësore dhe ndikimin e gjuhëve të huaja dhe depërtimin e kalkeve gjuhësore nga këto gjuhë, Idriz Ajeti thekson: “Sesa është bërë shqipshkruesi rob i logjikës së gjuhës dhe gjykimit të huaj, më së miri e tregon përkthimi fjalë për fjalë i shprehjes serbokroate: **p a u k** –merimangë, marimangë, për makinën që i zhvendos, i largon automjetet prej vendndalimeve që shqip pa e vrarë fare mendjen merret dhe përkthehet fjala e jo vështrimi i saj i vërtetë, apo ideja e veprimi, duke mos sjell në mend ndonjë veprim të ngjashëm bashkë me shprehjen e tij, në botën e shpendive kemi një aktveprim të ngjashëm kur skifteri lëshohet rrëmbyeshëm dhe kap pulën a gjelin duke ia shtënë (futur) kthetrat në trup dhe e ngre përpjetë – shqipfolësit a shqipfolëses të paprekur prej ndikimeve a modeleve të gjuhëve të huaja, do t’i kujtohet mënyra e rrëmbimit të shpendive prej **kaçubetit**. Këtë fjalë **kaçubet** që shpreh aksionin e përmendur e kisha dëgjuar prej një shtëpiakeje katundare që largimin e automjeteve prej vendstrehimeve, vendparkimeve të ndaluara për parkim e pagëzoi: **po vjen e po i kap kerret si kaçubeti**”.³⁰

Po kështu Prof. Idriz Ajeti flet edhe për frazeologjizmat dhe përdorimin e tyre me vend e me shije në gjuhën tonë amtare, por ato nuk lejohet të përkthehen fjalë për fjalë: “Frazelogjizmat janë njëra nga pikat më të dobëta : **flet kodër mbas bregu – flet kot; ka dorë – vjedh; i jap udhë një pune = zgjidh; i bëhet ferra Brahim = trembet kot; bëj pallë – pushoj;**

²⁶ Vepra e cituar, f. 203.

²⁷ Vepra e cituar, f. 209.

²⁸ Vepra e cituar, f. 249.

²⁹ Vepra e cituar, f. 252.

³⁰ Idriz Ajeti, Probleme aktuale të kulturës së gjuhës shqipe, VEPR 2, f. 253.

*heq për hunde = mashtroj*³¹, ndaj I. Ajeti pohon: "Pa gjuhë të pasur e të pastër, s'ka as ide e mendime të larta".³²

Prof. Idriz Ajeti përdorë fjalë të rralla nga të folmet popullore, duke i trupëzuar e stilizuar ato me mjeshtri e veçanti gjuhësore në fjali të caktuara, si për shembull: **ledh-i** (po edhe lufta e Skënderbeut për njëzet e pesë vjet rresht, s' po bëhej veçse për të krijuar **një ledh të gjallë** mbrojtjeje të qytetërimit të kontinentit plak të Evropës dhe të vlerave të larta morale të tij)³³; ose në fjalinë pasuese: " ... dhe për shumë kohë gatuajmë, pothuajse në të njëjtin truall kërkimor shkencor, se si brezit tim e brezit pasues, u është dashur **r r a h u n** ta çelin me pak shokë".³⁴

"...Në atë duken valëvitjet që e rrihnin popullin shqiptar në rrymë të moteve. Shkurt, historia e popullit shqiptar, fund e krye është histori dramatike"³⁵; "...linguistika shqiptare, duke gjuajtur mirë në shenjë, një sasi të mirë e ka nxjerr me prejardhje shqiptare..."³⁶; "Ligjet fonetike dhe kronologjia e tyre **na japin dorë t' u vëmë gisht** toponimeve të lashta, vendbanimeve tona, oronimeve, emrave të maleve, qyteteve të moçme: **Shkupi, Shari, Shtipi, Shkodër, Mat-i, Dri-ni, Lesh – Lezhë, Ishmi, Buenë-Bunë, Durrës, Qafa e Prushit** (Scupi, Scardus mons, Astibos(us), Mathis, Drinus, Lissus, Issamus, Perustae, Pirustae)... e në rrymë të kësaj kohe, me rrugë të caktuar, edhe në lëmin e gjuhës shqipe..."³⁷; "Si kalimthi po i biem disa faktor që tërthorazi ndihmojnë në sqarimin e çështjes kardinale të prejardhjes së shqiptarëve dhe të gjuhës së tyre... Sikur që historia e çdo gjuhe ecën në vijat vetjake, edhe historia e gjuhës shqipe ka **ravën e vet zhvillimore**, rrugët e saj specifike"³⁸.

Kur bënë fjalë për vendin e formimit të shqipes, Idriz Ajeti si bleta që prek lehtë në lule, duke mos e dëmtuar atë, apo sikur kirurgu i kujdesshëm që me sy shqiponje shikon, e me kujdes mamie ta ruaj frytin e porsalindur. Idriz Ajeti ndërton mendimin e vet, duke e ruajtur origjinali-

³¹ Vepra e cituar, f. 262.

³² Vepra e cituar, f. 265.

³³ Idriz Ajeti, VEPRA 3, ASHAK, Prishtinë, 2001, f. 275.

³⁴ Vepra e cituar, f. 279.

³⁵ Idriz Ajeti, VEPRA 4, ASHAK, Prishtinë, 2002, f. 7.

³⁶ Vepra e cituar, f. 11.

³⁷ Vepra e cituar, f. 19.

³⁸ Vepra e cituar, f. 125.

tetin e idesë së tij, përdorë fjalë që shprehin kuptime pasente ashtu siç rrobaqepësi i kujdesshëm i qepë rrobat pasente klientit të tij, duke ia ruajtur vijat trupore në mënyrë harmonike shpreh bukurinë estetike të mjeshtres së vet. Çdo krijim poetik nënkupton edhe krijimin gjuhësor, sepse çdo fjalë e përdorur me vend, saktë e qartë dhe me mjeshtri e veçanti gjuhësore është pjesë thelbësore e artit të fjalës. Në këtë frymë Prof. Idriz Ajeti shpreh: “Një ballafaqim i shqipes me sisteme gjuhësh përreth në një rrafsh tërësor e të kodifikuar me stile funksionale të përpunuara i jep mundësi shqipes letrare të nxjerr në dukje të gjitha aftësitë shprehëse dhe zhdërvjelltësitë në punë të pasurimit me zhvillime e krijime fjalësh e ngjyime të reja dhe të ngrejë në një shkallë më të lartë stilet e shkrimeve.”³⁹ Dhe më tej ai sjell shembuj fjalësh nga të folmet popullore: “Në lavrimin e në studimin e gjuhës shqipe kanë vepruar dy lagje punonjësish, duke u përqëndruar në dy fronte të ndryshme pa ndonjë lidhje të ngushtë ndërmjet tyre”.⁴⁰ Në këtë drejtim ai sjell fjalë të rralla dhe i shpjegon ato, duke i përdorur me mjeshtri e veçanti gjuhësore, ndërton stilin e vet aorigjinal-unikat: “... rrjedhorja **sh-teç** na del me të madhe në të folmet popullore, bie fjala në ligjërimin shqip të shqiptarëve të Jabllanicës, në jug të Serbisë, pastaj në Kosovë e gjetkë”.⁴¹ Dhe në shembujt: “...i integruar e brendathurur... punët organizative i hanin shumë kohë... rrihte të ndiqte fillin e këtij “**demoni**” të brendshëm të shqipes, që i jep asaj shkas e mundësi në pjellorinë e gjuhës sonë... Studimet e këtij lloji janë të thella e të themelta, që mbetën gjedhe si duan trajtuar problemet e tilla të gjuhës”.⁴²

Prof. Idriz Ajeti gjithmonë pati parasysh qëllimin e tij parësor për rolin e tij gjuhësor për fjalët dhe stilin e përdorur në shkrime, ndaj spikat: “Si çdo gjuhë letrare bashkë me drejtshkrimin e saj, edhe kjo jona, është rezultat i natyrshëm i proceseve të zhvilluara, sidomos nga Rilindja e këndej, në krijimin e së cilës shumë breza veprimtarësh specialistë e patriotësh zelltarë, pareshtur, kanë vënë gurë për të ngritur ngrehinën e saj aq të nevojshme për të çuar përpara kulturën e popullit dhe emancipimin e gjithanshëm të tij”.⁴³

Duke qenë i pajisur dhe i përgatitur mirë me dijet filologjike e albanologjike iu rrekë me përkushtim një fushe sa të vështirë, po aq sfiduese, i

³⁹ Vepra e cituar, f. 140.

⁴⁰ Idriz Ajeti, VEPRA 5, ASHAK, Prishtinë, 2002, f. 7.

⁴¹ Vepra e cituar, f. 205.

⁴² Vepra e cituar, f. 260.

⁴³ Idriz Ajeti, VEPRA 4, ASHAK, Prishtinë, 2001, f. 145.

dalë nga mësimet e linguistëve të shquar Karlo Taljavinit, Henrik Bariçit, etj. i thelluar në studime krahasimtare në romanistikë e sllavistikë dhe në studimet e albanologëve me emër, si Holger Pedersenin e Norbert Joklin,⁴⁴ atij i takoi të merret sa me dialektologjinë aktuale historike, po aq edhe me historinë e gjuhës së shkruar, sa me morfologjinë historike dhe me problemet e diskutueshme të saj, po aq edhe me historinë e leksikut, sa me interferencat e dyanshme gjuhësore shqiptaro-sllavojugore, po aq edhe me onomastikën mesjetare, sa me normimin e shqipes, po aq edhe me çështjet e kulturës së gjuhës.⁴⁵ Veprat e Idriz Ajetit janë *vek pa yrrnek* se si duhet të shkruhet shqipja standarde apo shqipja –shqip. Ai e ka shkruar shqipen me fjalë të përzgjedhura, me gramatikë e sintaksë në kuptimin e vërtetë të fjalësit të përdorur që të tërheq ta lexosh çdo vepër të tij. Deri më sot” *askush nuk e ka shkruar shqipen më mirë se Ai*”⁴⁶. Ai si njohës i mirë i dialekteve dhe të folmeve shqipe, të cilat janë si prroska që me prurjet e tyre, derdhen në lumin e madh të gjuhës letrare kombëtare, ndaj gurrën e tyre të pasur, prof. Idriz Ajeti e shfrytëzoi për mrekulli, në pasurimin e gjuhës letrare. Sepse lidhjet e ngushta të gjuhës letrare me të folmet popullore, janë si qumshti e ajka. Sepse nuk mund të ketë ajkë pa qumësht, por edhe qumësht cilësor pa ajkë e vlerë të çmueshme nuk ka.⁴⁷

Ndaj, Prof. Idriz Ajeti, në këtë frymë e rrugëtim, ka luajtur rolin kryesor në kultivimin e kulturës gjuhësore, duke e përdorë fjalën shqipe me mjeshtri e veçanti gjuhësore, me artin e fjalës së tij i ka dhënë shkencës së gjuhësisë sonë dhe gjuhës sonë amtare, në përgjithësi, një vend nderi, sepse e ka ngritur gjuhën tonë letrare kombëtare të standardizuar në shkallë të gjuhëve më të përparuara të botës. Dhe sot, me rastin e 100-vjetorit, të këtij shekullari mund të shprehemi me kënaqësi e respekt të veçantë se te Idriz Ajeti shohim një hulumtues e gjurmues, një lavrues e përpunues të gjuhës shqipe, i cili aq bukur e ka gatuar e hijeshuar gjuhën standarde në shkrimet

⁴⁴ Shefkije Islamaj, Idriz Ajeti dhe gjuha standarde shqipe, Gjuha shqipe, nr. 2, IAP, Prishtinë, 2007, f. 19.

⁴⁵ Bahtijar Kryeziu, Ndiheja e profesor Idriz Ajetit për një shqipe të përbashkët letrare, në Konsulta Gjuhësore e Prishtinës (1968), Prishtinë, 2008, f. 2018.

⁴⁶ Qemal Murati, Idriz Ajeti prijatar për njësimin e gjuhës shqipe, (Veprimtaria shkencore e Idriz Ajetit me rastin e 90 vjetorit të lindjes), IAP, Prishtinë, 24 maj 2007.

⁴⁷ Mehmet Halimi, Gjuha letrare dhe të folmet popullore, rev. “Shkëndija”, nr. 3, 1991, f. 12 dhe në rev. “Gjuha jonë”, nr. 3, 1994. (“Lidhjet e ngushta të gjuhës letrare me të folmet popullore, unë i kam krahasuar si lidhjet e qumshtit me ajkën. Sepse nuk muntë ketë ajkë (mazë) pa qumësht, por edhe qumshti cilësor pa ajkë, nuk ka vlerë të çmueshme”.)

e veta, duke përdorur shprehje me kripë e me shije, në shtegtimet e tij të dijes, ai mendimet dhe idetë e veta i shprehu saktë e qartë, duke e ngritur të vërtetën shkencore në shkallë arti.

Idriz Ajeti është dora e mbarë, e rryer dhe e vyer, mjeshtër që ka mbrumuar e gatuar me aq shije e mjeshtri fjalë me miell brumi të truallit tonë, duke i përdorë ato në kohë të duhur e në vend të duhur, me logjikë e kripë, me rend e me vend, saktë e qartë, rrjedhshëm e këndshëm në shkriimet e veta, ka ngritur lartë kultivimin e kulturës së pastër gjuhësore, krijoi e ndërtoi një stil origjinal e unikat, të paarritshëm e të papërsëritshëm nga të tjerët, por gjithnjë *të çmueshëm e të lakmueshëm nga çdo intelektual e dashamirë dhe* "Të gjithë ata që shqipen e quajn gjuhë të tyre të nënës, të mos heqin dorë nga mbrojtja e saj. . . !"⁴⁸ dhe nga mënyra e të shkruarit, përdorimit të fjalës dhe stilit të Idriz Ajetit, personalitetit me dinjitet e autoritet të çmuar e të nderuar, i cili diti gjithmonë ta drejtojë anijen në limanin e caktuar, ndaj çdo erë i fryni mbarë e çdo nismë e synim qëllim-mirë e kurorëzoi me sukses. Si i këtillë, Idriz Ajeti u bë vlerë kombëtare, sepse puna dhe ndershmëria janë vlerat e tij shkencore, janë zbulurim dhe stolisje i titullit të tij më të lartë *akademik e shkencëtar*, me të cilin ai një popull e një komb e nderon dhe e bën krenar.

Palla e Idriz Ajetit është pena me të cilën ai i shërbeu gjatë gjithë jetës së tij shekullore, me vlerë e nderë, me fisnikëri e dashuri të madhe, popullit e atdheut të vet të shenjtë e të shtrenjtë. Sepse arma më e fuqishme e përparimit dhe diturisë së një populli është *gjuha amtare*. Ndaj është detyrë jona që këtë thesar të çmuar: "Ta ruajmë e ta kultivojmë, ta pasurojmë e ta kristalizojmë aq sa është e mundshme, duke ia përcjellë brezit që vjen pas nesh ashtu siç na e përcollën të tjerët neve sa më të lartësuar, të përpunuar, të normëzuar e të kodifikuar sipas standardeve më të avancuara të gjuhëve më të përkryera botërore".⁴⁹

⁴⁸ Shaban Demiraj, cituar në veprën e Mehmet Halimit: "Çështje fjalëformimi në Gjuhën shqipe", Prishtinë 1996, f. 3.

⁴⁹ Mehmet Halimi, Konsulta Gjuhësore paraprijëse e Kongresit të Drejtshkrimit, në Konsulta Gjuhësore e Prishtinës (1968), Prishtinë, 2008. f. 165.

Berton SULEJMANI, Tetovë

STUDIMET GJUHËSORE TË AKADEMIK IDRIZ AJETIT TË BOTUARA NË SHKUP

Kur flasim për meritat e akad. I. Ajetit, nuk kemi parasysh vetëm gjuhëtarin, profesorin, hartuesin e disa teksteve shkollore, përkthyesin etj., por vështruar më gjerë, flasim për një nga kolosët e albanologjisë sonë të shek. XX – XXI, intelektualin dhe gjuhëtarin shqiptar të dimensioneve ballkanike dhe më gjerë. Është më se e vërtetë se emancipimi ynë kombëtar do t'i detyrohet në një shkallë të ndjeshme dhe rolit e veprës së Ajetit. Ky emancipim do të ketë të bëjë në radhë të parë me gjuhësinë, me fjalën shqipe, po edhe me kulturën, me mendimin shqiptar, me ato ura komunikimi që ai hodhi në mes Kosovës dhe Shqipërisë. Akademik Idriz Ajeti synoi dhe punoi tërë jetën, që atdheu i tij, Kosova duke qenë e ndarë nga kufijtë politikë, të ndihej e të mendonte si Shqipëria për çështjet kyçe të kombit tonë, siç janë: gjuha, flamuri e kombi.

Në studimet dhe vlerësimet e gjertanishme për akademik Idriz Ajetin, në radhë të parë është shquar përkushtimi i tij individual dhe institucional për të përmbyllur misionin e gjithë paraardhësve të tij për gjuhën si shenjë unike kombëtare (ortografike e drejtshkrimore) të popullit shqiptar. Që në fillimet e punës së tij ne gjejmë mesazhet e tij për domosdoshmërinë e njësimin të gjuhës shqipe, si dhe organizimin e institucioneve shkencore për hulumtimin dhe studimin e gjuhës shqipe, si kusht për sendërtimin e idealeve të popullit shqiptar në ish-Jugosllavi. Këtij misioni, me fjalën e arsyes, akademiku ynë i priu në mënyrë të veçantë në vitin 1968, në Konsultën e Prishtinës dhe mori pjesë në kurorëzimin e tij në vitin 1972, në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe. Për këtë edhe do të deklarohet në një rast të veçantë, duke mbrojtur arritjet në një nga polemikat e tij, në përgjigje të publicistikës dhe studiuesve serbë se gjuha standarde ju është

imponuar shqiptarëve në Jugosllavi nga Tirana zyrtare, madje në dëm të dialektit të tyre: —Kontributi i ekspertëve dhe i shumë punonjësve të tjerë të kulturës nga radhët e shqiptarëve në Jugosllavi në ngritjen e kësaj gjuhe është evident, e kjo shihet nga marrëveshjet e shumta të ekspertëve dhe punonjësve të kulturës nga viti 1952, 1957, 1963 dhe 1968 kur pavarësisht, por në mënyrë plebishitare u vendos që gjuhë letrare e shqiptarëve në Jugosllavi të jetë gjuha letrare që sot është në përdorim.¹

Për çështjen standardit gjuhësor të shqipes edhe në vitet e '90 vazhdonte ta mbronte idenë se shqiptarët duhet ta kenë një gjuhë standarde të përbashkët. Madje, Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe e vlerësonte si një nga çështjet më të rëndësishme që kishte kurorëzuar populli shqiptar, së paku që nga libri i parë i Gjon Buzukut “Meshari”, deri në fund të shekullit XX.

Të kthehemi te esenca e këtij punimi. Në Shkup, akad. Idriz Ajeti ka botuar këto studime gjuhësore:

1. **“Kontributi për studimin e marrëdhënieve gjuhësore shqiptaro-serbe”**, JEHONA 5-6, Shkup, 1966, f. 3 - 12;

2. **“Gjendja e studimeve albanologjike – rezultatet dhe detyrat”**, JEHONA 1, Shkup, 1986, f. 3 - 19;

3. **“Eqrem Çabej dhe studimet e gjuhësisë shqiptare”**, JEHONA 10, Shkup, 1987, f. 10 - 28;

4. **“Ndihmesa e Çabejt në studimet etimologjike të gjuhës shqipe”**, JEHONA 1, Shkup, 1990, f. 3 – 6.

5. **Ai ka shkruar edhe një recension, gjegjësisht parathënien e librit “Kontaktet gjuhësore në hapësirat ballkanike” të ballkanologes Olivera Jashar-Nasteva, Logos-A, Shkup, 1998.**

Këto punime kanë luajtur një rol shumë të madh për ngritjen e nivelit të studimeve gjuhësore të shqipes në Maqedoni. Nëpërmjet kësaj reviste studiuesit e intelektualët shqiptarë kanë pasur mundësinë që të jenë në hap me rrjedhat e gjuhësisë shqiptare të asaj periudhe kryesisht nëpërmjet puni-

¹ Bahtijar Kryeziu – Begzat Balii, *Rrapi shekullor - Akademik Idriz Ajeti*, f. 22, botues, Era, Prishtinë, 2017.

meve të kolosëve të gjuhësisë shqiptare, si: E. Çabejt, I. Ajetit, Sh. Demirat, R. Ismajlit e shumë të tjerëve.

Në punimin e tij shkencor të botuar në vitin 1966 në Shkup në revistën për çështje shkencore, politike, letrare dhe kulturore “**Jehona**” me titull *Kontributi për studimin e marrëdhënieve gjuhësore shqiptaro-serbe* që e kishte lexuar në Kongresin Ballkanologjik në Bullgari që ishte mbajtur po të njëjtin vit, Idriz Ajeti do të paraqesë gjendjen e atëhershme të studimeve ballkanologjike. Do të propozojë dhe në këtë punim do të paraqesë një sintezë të vogël të elementeve shqiptare në gjuhët ballkanike e sidomos në të folmet e serbokroatishtes.

Akademik Ajeti do të paraqesë edhe studiuesit e huaj e shqiptarë që gjer atëherë kishin botuar studime e vepra rreth gjuhëve ballkanike e në veçanti atyre sllave dhe gjuhës shqipe, si Miklosiçi (1970), Selishçevi (1930), Sandfeldi (1931), Majeri, Pedersen, Jokli, Bariqi, Skoku, Tagliavani, Çabej e Cimohovski duke konstatuar se në veprat e studimet e tyre dhe të shumë albanologëve të tjerë janë vërtetuar shumë shprehje të thesarit gjuhësor shqiptar, që kanë hyrë në gjuhët e popujve ballkanikë.

Idesë së dikurshme se është e pamundur të vërtetohet ndonjë huazim me origjinë shqiptare në gjuhët ballkanike, për akad. Idriz Ajetin ishte e paqëndrueshme. Këtë më së miri e shpjegon me fjalën, përkatësisht ballkanizmin *katun* nga shqipja *katund* (krah. tund, perkund, shkund) për të cilën sllavisti Brückmer (Brykmer) kishte mendimin se nuk mund të jetë e shqipes. Ajeti do të shprehet se ky studiues albanologjinë, gjegjësisht ballkanistikën e ka pasur në periferi të interesimit shkencor.²

Duke qenë i bindur se s’ekziston kurrfarë dyshimi se një numër huazimesh me origjinë nga serbokroatishtja në gjuhën shqipe kanë hyrë me anë të të folmeve të kësaj gjuhe. Po kështu s’ekziston kurrfarë dyshimi se në të kaluarën në mes këtyre popujve ka ekzistuar një bazë solide si për ndikime reciproke, ashtu edhe për marrëdhënie reciproke.

Shqiptarët me siguri e kanë ruajtur më mirë se çdo popull tjetër ballkanik kulturën e vjetër ballkanike si në mënyrën e të jetuarit ashtu edhe

² Dr. Idriz Ajeti “*Kontributi për studimin e marrëdhënieve gjuhësore shqiptaro-serbe*”, JEHONA 5-6, Shkup, 1966, f. 4.

të zakoneve. Këtë kulturë gjatë koekzistencës së përbashkët, madje edhe në simbiozë e kanë mbartë në sferat përkatëse të popujve fqinjë si: të serbëve, maqedonasve, bullgarëve, rumunëve, grekëve e të tjerë, shkruan akad. Ajeti. Madje, aty jep edhe numrin e huazimeve shqiptare në të folmet serbe, gjegjësisht maqedonase, në vitet e '60 (të shek. XX) që arrinte në 700, gjegjësisht 800. Me origjinë të hershme, pa kurrfarë dyshimi, janë këtë huazime: *balega*, rum. *baligă*, shqip *balëgë*, *balgë*, *bajgë*, *bagël*; vatra rum. *vatră*, shqip *vatër*, *votër*; struga, maqed. *stroga*, *straga*, shqip *shtrungë*; *magare*, *magarac*, shqip *magar*, *gare*, *gaç*, *agër*; *kaçula*, shqip *kësulë*; maqed. *para*, shqip *farë*, *fara*; *korda*, shqip *gardh*; *zarepati se* (Mali i Zi) është huazim nga shqipja *rrëfëj*; *umjek* shqip *mjekoj*, *mjekue*.

Këto fjalë dhe shprehje (origjina e të cilave me siguri është nga shqipja), sipas akad. Idriz Ajetit, i gjejmë dhe përdoren në disa të folme serbe, veçanërisht në ato që kanë kontakte të përhershme me shqiptarët (në zonat kufitare të Malit të Zi, mandej të Kosovës, në të folmet maqedonase të Maqedonisë Perëndimore e të tjera). Shumë shprehje shqipe, akad. Ajeti i hasë të kalkuara në gjuhët sllave, si: *da uçini kushtrim* e përbërë në bazë të shqipes *me ba kushtrim*, *me qitë kushtrimin*. Në të folmen e malazezëve të Kuçit ka vërejtur kalket: *konjunaci*, *konjunak* që përputhen plotësisht me shprehjen shqipe *kushtrim* (*kush* + *trim* = *ko* + *junak*).

Uzela ga na oči; *uze mi dijeta na oči* (Plavë e Guci), përputhet plotësisht me sintagmën shqipe: *me marrë mësysh*, *ma mori djalin mësysh*; *konjski kamen* përkthim tipik i shqipes, më mirë të themi i fjalës së gegërishtes veriore *gurkali* që në serbokroatisht thuhet *plavi kamen*;

nijesam tjesan za to krahas shprehjes *nijesam ngušt za to*, *nije na gušt za to* në vend të *nije mi shalo do toga*, *ne marim za to*, *ne mari on za to*. Akademiki ynë mbështetet edhe në fjalorët e Vukut e Elezoviqit rreth shpjegimit të fjalës *tijesan* të Malit të Zi dhe vjen në përfundim se këto kuptime përputhen plotësisht me ato që ka fjala e gjuhës shqipe *ngushtë*: 1) *kam ra ngushtë*; 2) *S'jam ngushtë për te*;

pejše kraste të cilën Ajeti e ka hasur që përdoret në të folmet e malazezëve të Plavës e Gucisë duhet të ketë marrëdhënie tepër të ngushta dhe përkon me shprehjen shqipe *lia e qenit*. Shprehjen *pajše kraste* nuk e hasim në të folmet tjera serbokroate, por *odrje kraste*, *obrje boginje*, ndërsa

lia e qenit në të folmet shqipe të atyre krahinave kufitare si dhe në të folmet e gegërishtes në përgjithësi është term popullor standard i fushës së medicinës, krah. Fjalori i gjuhës shqipe, Tiranë 1954;

šarati drva që përdoret në të folmet e malazezëve të Plavës e Gucisë, është marrë nga e folmja e shqiptarëve që jetojnë afër këtyre vendeve. Kjo shprehje hyn në fondin leksik të gjuhës shqipe dhe është huazim nga latinishtja: *serr* = *sharrë, sharroj*, shkruan Ajeti.

Një gjë tjetër që paraqet në këtë punim akad. I. Ajeti janë fjalët *burnija* dhe *nerzija* që i ka vërejtur në të folmet malazeze të Plavës e Gucisë kryesisht te njerëzit më në moshë. Fjala e dytë dëgjohet edhe në të folmet serbe të Kosovës: *ti da imaš nerziju, tako ne bi činijo; nikakvu nerziju nema* (G. Elezovič, Rečnik). Kjo fjalë në të folmet që përmendëm pa dyshim ka hy nga të folmet shqipe.

Në fund të këtij punimi, akad. I. Ajeti shkruan se në këto të folme malazeze, në të cilat ka edhe shumë huazime të tjera leksikore me origjinë nga shqipja, domosdo kanë pësuar ndikime të dukshme edhe në fushë të sintaksës që do të thotë se ndikimi i shqipes ka depërtuar edhe në sintaksën e këtyre të folmeve. Edhe në territorin e Kosovës, në bazë të materialit të Elezoviqit, profesor Ajeti shpreson se të folmet serbe ka rreth 300 fjalë dhe shprehje të shqipes.

Punimin e tij të dytë e ka botuar në vitin 1986 në po të njëjtën revistë. Këtë punim ia kushton gjendjes së studimeve albanologjike të asaj kohe (rezultatet dhe detyrat). Punimi gjithsej ka 16 faqe. Albanologjia si fushë e shkencës që merret me studimin e historisë së shqiptarëve, të gjuhës shqipe dhe letërsisë e të kulturës shqiptare – edhe pse me rezultate të mira, sipas Ajetit nuk ka ndonjë traditë të pasur d.m.th., trashëgimi i studimeve më të mira në fushë të shkencave albanologjike nuk është i madh. Historiografia shqiptare zë fill në shekullin XV me humanistët Marin Barleti dhe Marin Beçikemi, pastaj me veprat e Frang Bardhit dhe Pjetër Bogdanit. Ndërsa në burim të gjuhësisë shqiptare, sikur është thënë shpeshherë, qëndron fjalori latinisht-shqip i Frang Bardhit (1635). Pas kësaj periudhe vetëm nga gjysma e dytë e shekullit XIX zunë të gjallërohen studimet e veprimtarëve të Rilindjes, që nisin me Kristoforidhin, S.

Frashërin, De Radën, Kamardën etj., veprat e të cilëve u vunë në themelet e gjuhësisë shqiptare.

Veç albanologëve shqiptarë, në ballë të lagjes së albanologjisë së huaj qëndronte linguisti gjerman Franc Bopp, i cili e inauguroi gjuhësinë historike krahasuese dhe hodhi themelet e studimit të mirëfilltë shkencor të shqipes si gjuhë indoevropiane. Ishte fat i madh që studimet e gjuhës shqipe i vazhduan linguistët, si Meyer – Pedersen – Jokl.

Një e metë e madhe e albanistikës së huaj, shton më tej Prof. Ajeti, në periudhën para se të dilnin në skenën shkencore albanistike, Pedersen – Jokl, qëndronte në vetë programin e saj: që kërkonte të zbulonte se ç’ bashkonte shqipen me gjuhë të tjera indoevropiane dhe ç’ dallonte prej tyre. Andaj në studimet e tyre të asaj periudhe u mëshohej kryesisht çështjeve të jashtme të gjuhës shqipe dhe liheshin jashtë faktorët brendagjuhësorë të saj – studiohej historia e jashtme e kërkimet e strukturës së vetë shqipes së asaj kohe, ndërsa të historisë së hershme të saj zinin një vend fare të vogël. Vetëm me punimet e Holger Pedersenit, zë të përvijohet një drejtim i ri, një rrugë e re duke u përqendruar në gjurmimin kryesisht të strukturës së shqipes dhe duke kundruar problemet e kësaj gjuhe të brendshme, - një rrugë që më vonë do të ndiqet nga Jokli e të tjerë.

Që në vitin 1829, J. Kopitari shfaq interes të veçantë për probleme nga disiplina të ndryshme të ballkanistikës, e nxënësi i tij me origjinë sllavene Franz Miklosiçi (*“Kërkime të gjuhës shqipe”* 1870 – 1871), qoftë si linguist, qoftë si folklorist e vuri ballkanologjinë në baza shkencore, meqë e shtrin spektrin e studimeve të të gjitha gjuhëve e popujve të Ballkanit – duke hedhur edhe themelet e studimeve albanologjike: *“Elementet sllave të gjuhës shqipe”*; *“Elementet romane të shqipes”*; *“Trajtat e foljeve të hua-zuara të gjuhës shqipe dhe të gjuhëve të tjera”*. Pra, është meritë e Miklosiçit që i studioi shtjellueshëm lidhjet e gjuhëve të Ballkanit në dritën e teorisë së substratit trako-ilir, duke theksuar rëndësinë e posaçme të shqipes si e vetmja gjuhë që trashëgon drejtpërsëdrejti strukturën e asaj gjuhe të lashtë elementet e së cilës pasqyrohen në disa gjuhë ballkanike.

Albanologjia zuri të gjallërohet që para Luftës së Parë Botërore dhe gjatë saj (Instituti Ballkanologjik i Sarajevës) e me hov të madh sidomos pas saj, saktësisht 1922/23 në kuadrin e Degës studimore të gjuhëve

indoevropiane që e drejtonte profesori i gjuhësisë indoevropiane Henrik Bariçi, në Beograd u hap Seminari i Gjuhës shqipe, që zgjeroi veprimtarinë shkencore dhe nxori revistën e parë dhe të vetme albanologjike – Arhiv za arbanasku starinu, jezik i etnologiju (1923 – 1928).

Ndërsa pas periudhës së Luftës së Dytë Botërore, më saktësisht gjatë viteve '60 ë shek. XX janë të një rëndësie të madhe kur zë të shtohet numri i institucioneve kërkimore e shkencore: hapet institucioni i parë i studimit të lartë – Fakulteti i Filozofisë (1960), pastaj vazhdojnë të hapen me radhë fakultetet e tjera. Njëri nga treguesit e shumtë të ngritjes së përgjithshme të Kosovës, është padyshim hapja e Universitetit të Prishtinës (i Kosovës) që shënoi një kthesë të rëndësishme në çeljen e shtigjeve të reja për ngritjen e kuadrove dhe të punëtorëve shkencorë – edhe të shkencave albanologjike. U themeluan edhe Instituti Albanologjik, Enti i Historisë së Kosovës etj.

Detyrat që e presin albanologjinë në të ardhmen, sipas akad. I. Ajetit, veç tjerash është mungesa e kuadrit të specializuar që do të merrej me kulturën e popullsisë paleoballkanike, por nga na tjetër, dardanët, një degë e fiseve të shumta ilire, - këtu te ne kanë gjetur studiuesin e tyre të mirëfilltë, i cili me punimet e tij analitike ka qitur dritë në shumë vise të historisë së kësaj etnie të Ballkanit të lashtë. Po kështu qëndron (në të mirë) puna me popullsinë e vjetër të Ballkanit – me ilirët. Interesi për këtë etni të lashtë ballkanase, pas luftës dukshëm është shtuar. Njohësi më i mirë i problemit ilir ndër ne është, pa farë dyshimi, profesor Aleksandër Stipçeviçi, i cili lidhur me çështje të shumta problemore të ilirëve, thotë: *“Të studiosh sot historinë popujve të Ballkanit e mos ta njohësh substratin kulturor ilir, është një gjë e pamundur”*.

Në fund të këtij punimi, Prof. Ajeti, para studiuesve albanologë sot shtron detyra të mëdha. Por, njëherazi porositë albanologët që me punën e tyre të shquhen edhe në të ardhmen për hetimin e çështjeve në frymë objektive ashtu si iu ka hije shkencëtarëve të mirëfilltë, duke u shmangur nga pikëpamjet dogmatike, të dhëna apriori.

Dy studimet tjera që i ka botuar në revistën “Jehona” ia kushton figurës kryesore në fushën e gjuhësisë shqiptare, Eqrem Çabejt. Punimi i parë titullohet *“Eqrem Çabej dhe studimet e gjuhësisë shqiptare”* (1987) që përfshin 18 faqe të revistës. Studimet e Çabejt, akad. Idriz Ajeti i çmon

shumë. Theksin kryesor në këtë punim, Ajeti e fokuson në kontributin kolosal që Çabej e kishte marrë si obligim që ta studiojë/ta rishikojë edhe një herë punën e kryer të albanistikës së jashtme me gjitha shtigjet e hapura me probleme të shtruara e në raste të shumta me zgjidhje të drejta, që kanë zënë vend të qëndrueshëm në trashëgiminë e studimeve të historisë së gjuhës shqipe, por që aty-këtu vuan nga dobësi e të meta jo të pakta.

As linguisti shqiptar Eqrem Çabej s'kishte mbetur i kënaqur me mënyrën dhe rrugët që ishin rrahur në punën e zgjidhjes së shumë problemeve nga fusha e fonetikës historike të gjuhës shqipe. Nga zgjidhja e ligjeve fonetike, që sundonin, ishte bërë e pamundur t'u gjendej filli një morie etimologjish të gjuhës shqipe, prandaj linguisti E. Çabej me një shqyrtim të ri të materialit dhe me një rrokje më të rreptë të ligjeve të brendshme të gjuhës shqipe u përpoq t'u afrohej zgjidhjeve të tyre. Nga mangësitë njohëse e ligjeve të brendshme fonetike dhe të strukturës morfologjike të shqipes, me të cilat operonin albanologët e huaj me dekada të tëra, ishte bërë punë e vështirë të konstatohet burimi i shumë fjalëve dhe të diktohet origjina e tyre (sidomos trinomi Meyer-Pedersen-Jokl).

Çabej rroku një rrugë tjetër për të shpjeguar p.sh. gurrën e fjalës *vise* mbi të cilën Majeri e mbështeste doktrinën e tij dhe Pedersenin, duke mos qenë në gjendje ta përfshijë në rregullën e teorisë së tij, praktikisht e pranoi refleksin *s*, nga palatalja *k* indoevropiane. Duke depërtuar në thellësinë e problematikës, në thellësinë e fonetikës dhe të morfologjisë historike të gjuhës së tij amtare, në shpjegimin e kësaj fjale (*vise*) Çabej rrahu një rrugë që atij i dha dorë ta nxjerrë nga burimi i shqipe, të krijuar relativisht vonë në këtë gjuhë. Fjala *vise* për Çabejn është një shumës i fjalës *vend*. Ndërrim të tillë e gjejmë edhe te *shpend*, sh. *shpesë*; *shpes*! Ose kompozitat: amvisë, mjedis; te Buzuku *vjedmis*, një trajtë metalike e *mjedvis*; fjala ka një përhapje të përgjithshme në shqipen, është e mbarë shqipes, d.m.th. ka një denduri përdorimi sidomos të shkrimtarët e vjetër gegë e toskë, por vetëm si shumës, thotë Ajeti. Sikundër po shihet, fjala jonë *vise* nuk ka lidhje me latinishten *vicus*, as me të sllavishtes *vese*, dhe se *s-ja* e saj nuk mund të jetë refleks i palatales *k* indoevropiane. Nga kjo mund të vijmë në përfundim se teoria e Meyerit që mbështetej mbi këtë fjalë dhe mbi ndonjë tjetër, si *sulem*, e cila nuk mund të veçohet prej *sjell*, meqë qëndron në këmbë të qelqta, u shemb me të parën gogotje, me ç'gjë mendimi i

Pedersenit mori një mbështetje më të qëndrueshme me argumente të palëkundshme falë shtjellimit gjuhësor të gjuhëtarit shqiptar Eqrem Çabej.

Edhe pse studimet e dijetarit shqiptar E. Çabej, shton më tej Ajeti, rrokin, pothuajse të gjitha disiplinat kërkimore të albanistikës, trualli studimor i tij ishte historia e gjuhës shqipe – e atje hetimi i etimologjisë së leksikut të saj. Mu për këtë arsye, punimin e dytë që e boton me rastin e dhjetëvjetorit të vdekjes së Çabejt, e titullon “*Ndihmesa e Çabejt në studimet etimologjike të gjuhës shqipe*” (1990). Në këtë punim ai shkruan pak edhe për ngritjen dhe formimin e Çabejt në qendrën universitare të Vjenës ku njohu dhe thithi kulturën dhe arritjet e linguistikës së kohës me rryma e lëvizje që sundonin në atë fushë studimesh. Prandaj, Prof. I. Ajeti është i bindur se vetëm me Çabejn nisin studimet etimologjike të mirëfillta shkencore, të lëvruara prej vetë shqiptarëve.

Me zhdukjen tragjike të Joklit, njohësit më të mirë të çështjeve gjuhësore të shqipes, përgatitjet e një fjalori etimologjik të gjuhës sonë, u tretën si kripa në ujë, shkruan Ajeti, dhe vetëm Çabej mund ta merrte një punë të tillë dhe me dorë të sigurt ta përfundonte fjalorin etimologjik të gjuhës shqipe.

Përfitoi nga rrethana se me vite kishte qëndruar në Romë ku ka mundur të gjurmojë dokumentet e rralla në arkivat e Romës, si ky i Mesharit të Gjon Buzukut. Duke u njohur edhe me veprat e tjera të letërsisë së vjetër shqipe, si të Budit, Bardhit, Bogdanit, Kazazit dhe me literaturën arbëreshe, Çabej pasuroi shumëfish skedarin e fondit leksikor me fjalë të panjohura deri atëherë.

Që nga numri i katërt i revistës shkencore *Buletin i Universitetit Shtetëror* dhe *Studimet filologjike*, Çabej zuri të botojë një version seleksionues të fjalorit etimologjik në të cilin përpunoi afër 1000 njësi leksikore, ndërsa në vitin 1976, në botim të Akademisë së Shkencave, doli në dritë vëllimi II i fjalorit të tij etimologjik (“*Studime etimologjike në fushë të shqipes*”). Në këtë vëllim Çabej trajtoi dy shkronja (A – B) të alfabetit të shqipe me afro njëmijë fjalë, shton më tej Ajeti.

Në vëllimin III të *Studimeve etimologjike në fushë të shqipes*, 1987, (C, Ç, D), Çabej ka shoshitur më se njëmijë fjalë nga pikëpamja

etimologjike. Ajo çka ka vërejtur akad. I. Ajeti në këtë vepër – zbërthimi i çdo lekseme të shqipes paraqet një studim të thukët më vete.

Në vëllimin e parë (1982) të veprës madhore të tij, *Studimeve etimologjike në fushë të shqipes*, Çabejn dhe shumë studiues të leksikut historik të shqipes e intereson raporti i pjesës së huazuar me atë të pjesës burimore të fondit leksikor të shqipes. Në emërtimet e konfiguracionit të terrenit, shton më tej Ajeti për Çabejn, në emrat e botës bimore, të dukurive atmosferike, në emërtimet e produkteve bujqësore e në prodhimet e qumështit, në emërtimet e trupit të njeriut dhe të funksioneve të tij, - në të gjitha sferat e përmendura mundësitë shprehëse të trashëgimisë indoevropiane janë më të mëdha në raport me ato të huazuara: në tërësinë leksikore prej afro 564 fjalësh, raporti është 342 me burim vendi ndaj 222 huazimeve.

Akad. I. Ajeti, e përmbyll këtë punim duke thënë se Çabej zbatoi metodën intensive të studimit të çështjeve gjuhësore duke ecur në vazhden e mësuesve të tij të mëdhenj, para se gjithash ravën e Norbert Joklit – mësuesit të drejtpërdrejtë të tij.

Siç përmendëm më lart, akad. Idriz Ajeti, në Shkup ka botuar edhe një recension për librin e ballkanologes Olivera Jashar-Nastevës me titull *”Kontaktet gjuhësore në hapësirat ballkanike”*. Librin në fjalë, Prof. I. Ajeti e kishte në fazën e para botimit, pra e kishte dorëshkrimin. Pasi u hodhi sy titujve të temave të studimeve, bile edhe të veprave që përmbante dorëshkrimi, del qartë qëllimi i autores, e cila nëpërmjet këtij projekti të hartuar parasheh të bëjë kërkime e studime të ndërsjella gjuhësore maqedono-albano-turke. Pra hulumtimet dhe studimet e planifikuara, në rend të parë i mëshohet ndikimit të gjuhës maqedonase mbi të folmet shqipe dhe turke në Maqedoni, zhvillimit të leksikut dialektor në kushtet e interferencës gjuhësore, vendit të gjuhës maqedonase në Bashkësinë Gjuhësore Ballkanike, paraqitjes së diglosisë dhe të bilinguizmit në Maqedoni, kontaktet të të folmeve maqedonase me të folmet shqipe, gjuhës maqedonase dhe të gjuhëve të tjera.

Edhe pse përpjekjet për kërkime e gjurmime të tilla në Maqedoni ka pasur edhe më parë (por rrallë), si: studimi i P. Skokut *”Lingvistička proučavanja neslovenskog stanovništva skopske kotline”* (1941). Sipas Ajetit, dijetarja Jashar-Nasteva është ajo punonjëse shkencore në atë lagje gjur-

muesish dhe hulumtuesish në Maqedoninë e pasluftës e cila në punë të këtij lloji studimi nga aspekti ballkanologjik në Maqedoni, mbante një barrë të konsiderueshme. Te *“Ndikimi i gjuhës maqedonase në të folmet shqipe dhe turke në Maqedoni”*, dijetares i interesojnë ato fjalë, të cilat nga gjuha maqedonase kanë hyrë në të folmen e shqiptarëve dhe turqve, që jetojnë brenda kufijve të Maqedonisë në kohën më të re, pas çlirimit. Huazimet i ka marrë nga gjuha e gjallë popullore e jo nga gjuha e shkruar shqipe e turke, sepse ato në shkrim nuk mund të hasen, shkruan Ajeti. Madje sipas tij (I. A.), ballkanologia nuk i ka marrë parasysh të gjitha rrethanat e përdorimit të një numri aq të madh termash nga sfera kryesisht administrative, me fjalë të tjera, kjo sasi aq e madhe e huazimeve të regjistruara në shtresën e paarsimuar të popullsisë, të cilat, në anë tjetër, nuk i gjejmë gjëkund në lagjen jo të vogël të inteligjencies kulturore, shkencore, në tekstet shkollore në përdorim të një armate shkollarësh.

Në fund të këtij recension-i-parathënie, akademiku ynë udhëzon autoren se nga pikëpamja metodologjike, do të ishte gabim huazimet, qoftë edhe nga një shtresë e vetme e popullsisë, të merren e të shpallen huazime të përgjithësuara të një gjuhe tjetër! Kështu bënte, shpesh, edhe prof. P. Skoku, shkruan Ajeti, kur nga qëndrimi i tij kërkimor në një areal dialektor shqiptar, bie fjala në Ulqin, çdo sllavizëm të atij dialekti shqiptar ta merrte për huazim në mbarë shqipen.

Po e përmbyll këtë punim duke qenë i ndërgjegjshëm se studimet gjuhësore të Akademik I. Ajetit që i ka botuar në Shkup paraqesin një pjesë të vogël të veprimtarisë së tij shkencore e cila është shumë e gjerë, por në të njëjtën kohë jam i bindur se kam sjellë një kontribut, të paktën për njohjen sa më të plotë të veprimtarisë së tij shkencore dhe njëherazi ndihmesa e kësaj veprimtarie për gjuhëtarët, kryesisht tanë të këtyre trevave etnike shqiptare kanë qenë dhe do të jenë të një rëndësie të madhe.

Bibliografi

- Ajeti, Idriz, “Kontributi për studimin e marrëdhënieve gjuhësore shqiptaro-serbe”, JEHONA 5-6, Shkup, 1966, f. 3 - 12;
- Ajeti, Idriz, “Gjendja e studimeve albanologjike – rezultatet dhe detyrat”, JEHONA 1, Shkup, 1986, f. 3 - 19;
- Ajeti, Idriz, “Eqrem Çabej dhe studimet e gjuhësisë shqiptare”, JEHONA 10, Shkup, 1987, f. 10 - 28;
- Ajeti, Idriz, “Ndihmesa e Çabejt në studimet etimologjike të gjuhës shqipe”, JEHONA 1, Shkup, 1990, f. 3 – 6.
- Ajeti, Idriz, “Studime për gjuhën shqipe”, vepra të zgjedhura, zgjodhi dhe përgatiti akademik Rexhep Ismajli, ASHAK, Prishtinë, 2017.
- Kryeziu Bahtijar – Baliu Begzat, “Rrapi shekullor - Akademik Idriz Ajeti”, Era, Prishtinë, 2017.
- Jashar-Nasteva Olivera, “Kontaktet gjuhësore në hapësirat ballkanike”, Logos-A, Shkup, 1998.

Shkumbin MUNISHI, Prishtinë

KONTRIBUTI I IDRIZ AJETIT PËR STANDARDIZIMIN E GJUHËS SHQIPE

Abstrakt

Në këtë punim trajtohet kontributi i Idriz Ajetit për standardizimin e gjuhës shqipe, sidomos për normimin e saj në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare të ish-Jugosllavisë. Kontributi i Ajetit ka qenë domethënës gjatë tërë procesit të planifikimit të korpusit të shqipes pas Luftës së Dytë Botërore, në veçanti në Kosovë. Po ashtu, roli i tij ka qenë i jashtëzakonshëm edhe për vendimin që mori Konsulta Gjuhësore e Prishtinës për ta pranuar Projektin e Rregullave të Drejtshkrimit të Botuar në Tiranë më 1967 dhe për miratimin e shqipes standarde në Kongresin e Drejtshkrimit më 1972.

Fjalët çelës: planifikim (gjuhësor, i korpusit), standardizim, gjuhë shqipe (standarde), normë, gegërishte, toskërishte.

Kontributi i Ajetit për normimin e shqipes në Kosovë

Në rrjedhat e planifikimit të shqipes, periudha pas Luftës së Dytë Botërore ka qenë padyshim vendimtare për fatet e shqipes standarde. Procesi i planifikimit, që kishte filluar me Kongresin e Manastirit (1908), në të cilin qe normuar sistemi fonematik i përbashkët për të dy dialektet e shqipes, dhe që kishte marrë hov me Komisinë Letrare në Shkodër (1916-1918), mori hov e intensifikua pas përfundimit të LDB-së. Nëse veprimtaritë e para në fushën e planifikimit të shqipes para LDB-së kishin ndodhur vetëm brenda kufijve të Shqipërisë, pas kësaj periudhe këto veprimtari u zhvilluan paralelisht në Shqipëri dhe në trevat shqiptare në ish-Jugosllavi.

Pa dashur të ndalemi më gjatë për t'i trajtuar zhvillimet në planifikimin e korpusit të shqipes në Shqipëri për të cilat kemi bërë fjalë në raste të tjera (Munishi 2002, 2006, 2016), do të ndalemi në veprimtaritë standardizuese që janë zhvilluar në ish-Jugosllavi pas vitit 1945 në të cilat një rol të veçantë ka luajtur gjuhëtari ynë i shquar Idriz Ajeti.

Aktivitetet për standardizimin e shqipes në Kosovë pas LDB-së, të cilat janë trajtuar në mënyrë të shteruar nga Raka (1997) dhe sidomos Ismajli (1998), kanë filluar në nëntor të vitit 1952 kur u mbajt mbledhja e parë që kishte për qëllim t'i trajtonte çështjet e drejtshkrimit të shqipes në Kosovë. Në këtë mbledhje referatin e mbi gjuhën letrare dhe çështjet e tjera që kanë të bëjnë me drejtshkrimin e kishte lexuar Idriz Ajeti. Përveç këtij referati, Raka (1997) thekson se në mbledhje ishte lexuar edhe një referat i dytë nga Selman Riza, por Ismajli nuk e nxjerr krejtësisht të faktuar një konstatim të tillë (Ismajli 1998: 123-124). Megjithatë, pavarësisht se a ka pasur apo jo një referat të dytë të lexuar nga Riza, duket se ndikimi i pikëpamjeve të tij nuk mund të mohohet në përfundimet e mbledhjes dhe në vendimet që janë marrë në çështje të gjuhës letrare në atë rast. Në përcaktimin e etapave të standardizimit të gjuhëve Einar Haugen (1966) ka identifikuar përzgjedhjen e normës, pra përzgjedhjen e bazës dialektore, si hapin e parë dhe mbase më vendimtar në standardizimin e gjuhëve. Kur flet për përzgjedhjen e kodit në atë mbledhje, Ismajli citon shkrimin e atëhershëm të Rilindjes të botuar në faqen 5, në të cilin thuhej: "Përsa i përket përdorimit të gegënishtes si gjuhë shkrimi në Mbledhje nuk pati asnjë ndryshim pikëpamjesh dhe njizanit u caktue kriteri i njajtësismit të gjuhës simbas të cilit kriter duhet ndjekë nga përdorimi të gjitha **evolutat partikulariste** (nënvizimi sh.m.) të nëndialekteve gegënishte" (f. 123). Vite më parë, kur kishte folur për formimin e shqipes standarde, Riza kishte theksuar se: "Do të njajtësojmë gegënishten letrare me toskënishten letrare tue mënjane evolutat partikulariste" (Riza 1944: 112-113). Neve na duket që pikërisht ky term "evoluta partikulariste" që u referohet zhvillimeve variacionale të gegërishte është sajuar për herë të parë nga Riza dhe në mbledhjen e vitit 1952 është marrë si një mekanizëm udhëzues që kishte për qëllim që nëpërmjet reduktimit të zhvillimeve të posaçme në varietetet e gegërishtes ta reduktonte variacionin në gegërishten letrare. Prandaj, mendojmë se sugjerimet e Rizës kanë qenë domethënëse për përfundimet e

mbledhjes dhe kjo mund të vërehet edhe në disa elemente të tjera. Për një rol domethënës të Rizës në diskutimet dhe në Rezolutën e Mbledhjes së vitit 1952, flet në mënyrë të argumentuar edhe Ismajli (1998: 134-135). Sa i përket karakterit të diskutimeve në atë mbledhje, më vonë Ajeti (1973) kishte thekuar se vërehej se në atë mbledhje dalin në pah dy rryma: njëra synonte që së paku në drejtshkrim t'i ruante, sa të ishte e mundur format e përbashkëta gjuhësore të të dy varianteve letrare të shqipes, ndërsa tjetra synonte që edhe më tej t'i mbante të qarta dallimet në mes të varianteve letrare të gjuhës shqipe (Ajeti 1973; Raka 1997: 202), ndonëse nuk përmenden se cilët ishin protagonistët që u përkitnin këtyre dy rrymave, ndërsa Ismajli në këtë klasifikim të Ajetit sheh në të vërtetë tri rryma (Ismajli 1998: 130). Prandaj, në bazë të dokumenteve që sjell Ismajli dhe dëshmime të tjera të tërthorta, duket që Ajeti dhe Riza si dy autoritete kryesore të kohës në fushën e gjuhësisë, në atë ngjarje luajtën rol vendimtar për ta futur në binarë standardizimin e shqipes në Kosovë mbi bazat e një gegërishteje mbidialektore.

Mbledhja tjetër që kishte për qëllim t'i trajtonte çështjet e drejtshkrimit u mbajt më 30-31 maj 1957 në Prishtinë. Kjo mbledhje, në trajtimet kryesore në fushën e standardizimit të shqipes (Raka 1997; Ismajli 1998) është cilësuar si një prapakthim në procesin e standardizimit të shqipes dhe se përfundimet e saj kishin për qëllim normimin e shqipes në Kosovë mbi baza të ngushta dialektore. Në këtë pikë, Raka dhe Ismajli kanë theksuar me të drejtë reagimin pozitiv të Ajetit, i cili nuk pajtohej me përzgjedhjen e kodit mbi baza të ngushta regjionale, por as edhe me çështje të caktuara të drejtshkrimit që ishin vendosur aty pa u bazuar në studime shkencore para-prake. Është krejtësisht e qartë se, siç duket, Ajeti kërkonte që normimi i shqipes në Kosovë në atë kohë, nëse jo të njëjtësohej, atëherë së paku të përafrohej me procesin e normimit të shqipes që po ndiqej në Shqipëri, sepse siç shprehet Ismajli, me vendimet e Mbledhjes së vitit 1957 "po shtyhej përpara ajo që kuptohej me gjuhë letrare të veçantë për shqiptarët e Jugosllavisë, apo gegërishte vetëm për shqiptarët e RFPJ-së (Ismajli f. 163).

Mbledhja e tretë u mbajt më 14-16 janar 1963 në të cilën u diskutua një raport i një komisioni që ishte themeluar më 1961 për ta rishikuar drejtshkrimin në përbërje: Idriz Ajeti, Hasan Vokshi, Sulejman Drini, Mehdi Bardhi dhe Latif Mulaku. Ortografia e hartuar nga ky grup studiue-

sish u diskutua gjerësisht dhe në bazë të saj më 1964 u botua Ortografia e vitit 1964, e cila do të jetë ortografia e fundit e bazuar në një gegërishte letrare mbidialektore, e cila do të botohej në Kosovë.

Dy ngjarjet e radhës, në të cilat do të jetë përsëri protagonist Idriza Ajeti do t'i japin një kah krejtësisht tjetër standardizimit të shqipes në Kosovë. Së pari, Konsulta Gjuhësore e Prishtinës e mbajtur më 27-28 prill 1968 do të jetë një ngjarje kthesë në procesin e standardizimit të shqipes në Kosovë dhe në trevat e tjera shqiptare në ish-Jugosllavi. Në këtë ngjarje, në të cilën fjalën e hapjes e kishte mbajtur Fehmi Agani, referatin kryesor e kishte lexuar përsëri Idriz Ajeti, i cili foli për rrugën që ishte ndjekur për njësimin e gjuhës letrare dhe për hartimin e ortografisë. Referati i tij jepte indikacione të qarta se Konsulta Gjuhësore do t'i jepte mbështetje Projektit të Rregullave të Drejtshkrimit që ishte botuar më 1967 në Tiranë. Ky do të ishte momenti më vendimtar në procesin e standardizimit të shqipes në Kosovë, me ç'rast do të braktisej rruga e normimin të shqipes mbi bazën e gegërishtes, e cila kishte filluar pas LDB-së, dhe do të fillonte një proces i ri i futjes në përdorimit të shqipes standarde të normuar në Shqipëri mbi bazën e një varieteti tjetër gjuhësor ose më saktë mbi bazën e toksërishtes. Synimi kryesor i kësaj politike gjuhësore që tani e tutje do të ndiqej në Kosovë bazohej në motive kombëtare (Byron 1979) dhe synonte në instancë të fundit homogjenizimin gjuhësor mbarëshqiptar.

Ngjarja tjetër përfundimtare ishte Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe që u mbajt më 20-25 nëntor 1972 në Tiranë, në të cilin u miratua përfundimisht Drejtshkrimi i Gjuhës Shqipe i bazuar në Projektin e vitit 1967. Edhe në këtë ngjarje Idriz Ajeti kishte lexuar referatin për rrugën që ishte ndjekur për standardizimin e gjuhës shqipe në Kosovë.

Duke përmbledhur veprimtarinë e Ajetit për standardizimin e gjuhës shqipe, mund të konstatohet se në dekadën e parë që nga fillimi i viteve '50 të shekullit 20 dhe zgjatë deri më 1968, ai kishte dhënë një kontribut domethënës për standardizimin e shqipes në trevat shqiptare në ish-Jugosllavi duke u bazuar në një gegërishte mbidialektore dhe duke synuar që standardizimi i shqipes të mos mbështetej vetëm në një variant lokal krejtësisht lokal të gegërishtes që do të rezultonte me formimin e një shqipeje letrare në ish-Jugosllavi krejtësisht të dallueshme nga shqipja letrare e

cila po standardizohej në Shqipëri pas viteve '50 të shekullit XX. Në këtë frymë ishte edhe reagimi i tij më 1957. Me fjalë të tjera, gjatë gjithë aktivitetit të tij në fushën e planifikimit të shqipes vërehet herë haptas, herë jo krejtësisht drejtpërdrejt, qëndrimi i Ajetit që aktivitetet për standardizimin e shqipes në Kosovë të mos bëheshin në mënyrë të ndarë dhe të pavarur nga konteksti gjithshqiptar. Këto qëndrime të tij kulmojnë në vitin 1968, në Konsultën Gjuhësore të Prishtinës, kur qëndrimet dhe pikëpamjet e Ajetit për shqipen standarde bëhen krejtësisht konformiste me qëndrimet e politikës gjuhësore që po ndiqej në Shqipëri në atë kohë. Një qasje e tillë jo vetëm e Ajetit, por edhe e autorëve të tjerë të asaj kohe në mesin e shqiptarëve të ish-Jugosllavisë, i hapi rrugë mbajtjes së Kongresit të Drejtshkrimit dhe miratimit të shqipes standarde në përputhje me vendimet që ishin marrë në Shqipëri për përzgjedhjen e kodit dhe për kodifikimin e normës.

Pikëpamjet e Ajeti për shqipen standarde dhe bazën e saj dialtore

Sa i përket shqipes standard edhe bazës dialektore të saj, pikëpamjet dhe diskutimet për bazën dialektore zënë fill krahas me shfaqjen e ideve nismëtare për formimin e gjuhës standarde shqipe. Në këtë kuadër, para LDB-së mund të përmendim pikëpamjet krejtësisht të përgjithshme të Konicës, të shfaqura në revistën "Albania" (1897), pikëpamjet shumë më konkrete të Aleksandër Xhuvanit (Xhuvani, 1905, 1908), pikëpamjet e shprehura nga anëtarët e Komisionit Letrar Shqipe të Shkodrës (1916-1918), pikëpamjet e Namik Resulit dhe pikëpamjet e Selman Rizës (Riza, 1944). Diskutimet kryesore të asaj periudhe përqendroheshin në atë se a do të duhej që për bazë të gjuhës standarde të përbashkët të merrej toskërishtja, gegërishtja apo ndonjë variant i përzier.

Pas Luftës së Dytë Botërore dhe pas ndryshimeve politike që ndodhën në Shqipëri, formimi i gjuhës standarde shikohej me interes edhe nga klasa politike, edhe nga klasa shkencore e kulturore e kohës Pushteti i ri në fushën e gjuhës i ndërmori disa veprime vendimtare që përcaktuan fatin e gjuhës standarde shqipe për të cilat bëjnë fjalë A. Haxhi (Haxhi, 1993: 67-71), O. Myderrizi (Myderrizi, 1952: 95) dhe B. Beci (Beci, 1993: 6). Me këto veprime praktikisht u përcaktua baza dialektore e gjuhës standarde shqipe.

Baza dialektore dhe formimi i gjuhës standarde shqipe ishin tema bosht edhe në sesionet gjuhësore të vitit 1952 (Për diskutimet në sesionet e vitit 1952 shih: Buletin për Shkencat Shoqërore IV, Tiranë, 1952; Rexhep Ismajli 1988). Sesionet e vitit 1952 nuk kishin arritur ta jepnin argumentimin shkencor që për bazë dialektore të gjuhës standarde do të duhej të merrej toskërishtja, veprim ky që, siç u tha më lart, ishte bërë me vendime administrative shtetërore menjëherë pas vitit 1945.

Pas sesioneve të vitit 1952, gjuha letrare i ofrohej publikut, jo më si toskërishte e ngritur në normë, por si një koine letrare që rezultonte nga bashkëveprimi dialektor.

Duke filluar nga vitet '60 rolin kryesor në procesin e standardizimit të shqipes e mori Androkli Kostallari, i cili pothuajse ruante të drejtën ekskluzive të merrej me interpretimin e çështjeve që kishin të bënin me gjuhën standarde. Në këtë kuadër, Kostallari, në shkrimet e tij, është marrë shumë edhe me qëndrimet lidhur me bazën dialektore të shqipes standarde dhe duhet thënë që tërë interpretimet e tij për bazën dialektore të shqipes standarde sillleshin rreth konstatimit se shqipja letrare nuk është toskërishtja e ngritur në normë, por është rezultat i bashkëveprimit, i konvergjencës, së dialekteve të shqipes (Kostallari, 1970:41). Për t'i përmbledhur qëndrimet e Kostallarit për bazën dialektore të shqipes standarde po e japim edhe këtë pohim të tij: "prerja horizontale e strukturës së gjuhës sonë letrare të sotme dëshmon se kjo nuk është ndërtuar mbi një bazë të ngushtë njëdialektore. Ndër të tjera, ajo tregon se mendimi i shfaqur më parë se gjuha letrare e sotme është toskërishtja letrare, e ngritur drejtpërdrejt në shkallën kombëtare, nuk i përgjigjet së vërtetës shkencore. Nën sistemet e gjuhës letrare, të para në tërësinë e tyre komplekse, na lejojnë të arrijmë në përfundimin se gjuha letrare kombëtare shqipe është formuar e po përfundon kristalizimin e saj si **një koine letrare sui generis**" (Kostallari, 1972: 41-42). Kostallari vinte në këto përfundime pasi kishte analizuar sistemin fonologjik-fonetik dhe sistemin morfo-sintaksor të gjuhës letrare (Kostallari, 1970, 1972, 1975). Këto qëndrime të Androkli Kostallarit për gjuhën standarde shqipe dhe për bazën dialektore të saj, u bënë qëndrimet zyrtare në gjuhësinë shqiptare në Shqipëri deri në rënien e sistemit komunist. Në Shqipëri nuk pati pothuajse asnjë gjuhëtar që t'i kundërshtonte këto qëndrime, apo edhe të shprehte ndonjë mendim alternativ, aq më pak të kundërt.

Sa u përket qëndrimeve për gjuhën standarde dhe për bazën dialektore të saj, siç jemi shprehur edhe më parë (Munishi 2007), edhe në këtë pikë Ajeti mbështeste interpretimet që ishin bërë në Shqipërinë e asaj kohe, sidomos nga Kostallari. Ajeti, sikur edhe Kostallari, e sheh formimin e shqipes letrare si rezultat i konvergjencës dialektore që kishte filluar qysh nga Rilindja Kombëtare (Ajeti, 1973). Në shpjegimin e tij teorik për bazën dialektore të shqipes standarde, Ajeti është i mendimit se, “baza dialektore e gjuhës letrare shqipe është përcaktuar në mënyrë të logjikshme duke ndjekur rrugën e konvergjencës, d.m.th. të afrimit të dy kryedialekteve letrare, një rrugë kjo në të cilën po ecet që këtu e njëqind vjet më parë” (Ajeti, 1980: 13). Është e qartë që qëndrimi i Ajetit është pothuajse plotësisht i njëjtë me pikëpamjet e Kostallarit për bazën dialektore të standardit gjuhësor. Këtë qëndrim Ajeti e ka mbrojtur në vazhdimësi, duke kundërshtuar tezat e Bahri Becit, Arshi Pipës e të tjerëve, që gjuhën standarde e shohin si “toskërishte të ngritur në gjuhë letrare kombëtare”, apo që “gjuha letrare është 95 % toskërishte dhe vetëm 5 % gegërishte” (Ajeti-Lafe, 1988: 10).

Sa u përket pikëpamjeve të Ajetit për shqipen standard edhe bazën e saj dialektore, në një rast tjetër kemi theksuar se këto pohime mund të kuptohen dhe të arsyetohen vetëm në kuadër të kontekstit historik dhe politik në të cilin janë bërë, por për hir të saktësisë shkencore duhet theksuar që baza dialektore e gjuhës standard shqipe, në elementet kryesore të saj, i takon varietetit të toskërishtes.

Përfundime

Pikëpamjet e Idriz Ajetit dhe kontributi i tij për standardizimin e shqipes nuk mund të shihen ndryshe përveç se si angazhim i bazuar në motive kombëtare që për qëllim kryesor kanë ruajtjen dhe kultivimin e identitetit kombëtar dhe kulturor të shqiptarëve në Ballkan. Këto motive shpeshherë kanë drejtuar edhe pikëpamjet e tij shkencore, sidomos në interpretimet që ai ia bën gjuhës standarde dhe bazës së saj dialektore. Edhe në këtë pikë, sikurse edhe në qëndrimet e tij për procesin e normimit të shqipes në Kosovë, Ajeti shfaq pikëpamje konformiste me ato që zhvilloheshin në Shqipëri për shqipen standarde. Por, duhet pasur parasysh

që përtej akribisë shkencore, pesha e kësaj qasjeje kombëtare të Ajetit bëhet edhe më e rëndësishme kur merren parasysh rrethanat politike e kulturore në të cilat ka vepruar ai e të cilat në mjaft raste nuk kanë qenë aspak favorizuese për gjuhën dhe për kulturën shqiptare. Për këtë arsye, veprimtaria e Idriz Ajetit për standardizimin e shqipes mund të quhet një kontribut me vlera të theksuara kombëtare.

Bibliografi

- Ajeti, Idriz (1973), *Rruga e zhvillimit të gjuhës letrare shqipe në Kosovë*, Studime filologjike, Tiranë.
- Ajeti, Idriz (1980), *Probleme aktuale të kulturës së gjuhës*, Probleme aktuale të kulturës së gjuhës shqipe, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1983.
- Ajeti, Idriz-Lafe, Emil (1998), *Njëzet e pesë vjet nga Kongresi i Drejtshkrimit (Vlerësime dhe vështrimen në të ardhmen)*, Studime filologjike 1-2, Tiranë.
- Beci, Bahri (1993), “Probleme të formimit të gjuhës letrare standarde shqipe”, Studime filologjike 1-4, Tiranë, f. 5 -11
- Buletin për Shkencat Shqiptore IV, Tiranë, 1952.*
- Byron, Janet L., (1976) *Selection among alternates in language standardization : The case of Albanian*, Mouton The Hague, Paris.
- Haugen, Einar (1966), *Dialect, language, nation, Sociolinguistics – Selected readings*, Editors: J.B. Pride and Janet Holmes, Penguin books, Ringwood, Victoria, Australia, 1972.
- Haxhi, Artan (1993), “Çështje të gjuhës letrare kombëtare”, *Hylli i Dritës* 2-3, Tiranë, f. 67-71.
- Ismajli, Rexhep (1979) *Mbi normën gjuhësore*, Përparimi.
- Ismajli, Rexhep (1998), “Në gjuhë” dhe “për gjuhë”, *Dukagjini*, Pejë.
- Ismajli, Rexhep (1991), *Gjuhë dhe etni*, Rilindja, Prishtinë.
- Kostallari, Androkli (1970), *Mbi disa veçori strukturore e funksionale të gjuhës letrare shqipe të kohës sonë*, Studime filologjike 2, Tiranë.
- Kostallari, Androkli (1972), *Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj*, (referat kryesor i lexuar në Kongresin e Drejtshkrimit më 1972), Tiranë 1973, f. 41-42.
- Kostallari, Androkli (1975), *Etapat kryesore të procesit të formimit të gjuhës letrare kombëtare shqipe dhe veçoritë e saj strukturore të sotme në Formimi i gjuhës letrare kombëtare shqipe dhe veçoritë themelore të normës së sotme gjuhësore I (Mbledhur e përgatitur nga Miço Samara)*, Tiranë, f 45.
- Lajmet e Komisës Letrare Shqipe në Shkodër, Numër I, Kallënduer 1918.*
- Munishi, Shkumbin (2002). *Pikëpamjet e Androkli Kostallarit për gjuhën standarde shqipe*. ZeroPrint. Prishtinë. 2013
- Munishi, Shkumbin (2006), *Probleme të shqipes standarde në Kosovë*. ZeroPrint. Prishtinë. 2013.
- Munishi, Shkumbin (2007). *Pikëpamjet e Idriz Ajetit për bazën dialektore të gjuhës standarde shqipe*. Studime 14. ASHAK. Prishtinë.
- Munishi, Shkumbin (2016). *Vështrime sociolinguistike për shqipen standarde*. ZeroPrint. Prishtinë.

- Myderrizi, Osman (1952), “Probleme të gjuhës letrare të përbashkët”, Buletin për Shkencat Shoqërore IV, Tiranë, f. 95.
- Pipa, Arshi (1989), *The politics of language in socialist Albania*, Columbia University Press, New York.
- Raka, Fadil (1997), *Historia e gjuhës letrare shqipe*, Prishtinë.
- Riza, Selman (1944). *Tri monografia albanologjike. Vepra 1. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. Prishtinë. 1996.*
- Xhuvani, Aleksandër (1905), *Për themelimin e një gjuhe letrare*, Vepra I, Tiranë, f. 3, 1980.
- Xhuvani, Aleksandër (1906), *Përmi themelim të një gjuhe letrare shqipe*”, Vepra I, Tiranë, 1980, f. 8.

Begzad BALIU, Prishtinë

RAPORTET E PROFESOR AJETIT ME PROFESOR ÇABEJN

Abstrakt

Objekt i kërkimeve tona mbi raportet kolegiale dhe shkencore ndërmjet profesor Idriz Ajetit dhe profesor Eqrem Çabejt janë kërkimet e mia në arkivat e këtyre dy bardëve të albanologjisë dhe leximet në veprat e botuara a në dorëshkrim të tyre. Prej gjetjeve dokumentare mund të themi se raportet e tyre janë modeste, krahasuar me referimin dhe vlerësimin shkencor reciprok të njërit apo të tjetrit. Në të vërtetë, komunikimi modest jashtëshkencor i Profesor Çabejt me Profesor Ajetin ndërlihet me priren e vakët të komunikimit të Profesor Ajetit me gjithë lagjen e albanologëve të kohës së tij, por që përplotësohet shumëfish me shumësinë e shkrimeve dhe referimeve për veprën dhe në veprën e tij. Në studimet e tij Profesor Çabej (përfshijë studimet etimologjike), veprën e Profesor Ajetit nuk e ka trajtuar shumë, sepse edhe nuk ishte në natyrën e tij që të shquante studiuesit bashkëkohës të tij, por e ka trajtuar në disa momente dhe në disa projekte të një rëndësie të veçantë. Në veprën e tij, ndërkaq, Profesor Ajeti, Profesor Çabejn e ka bërë objekt studimi me karakter monografik, recensues, sintetik, referues dhe përgjithësues. Për këtë arsye dhe anëve të tjera të raporteve të tyre, diskutimi i këtyre marrëdhënieve të ndërsjella bëhet me qëllim të krijimit të një pamjeje sa më të plotë të dy bardëve të albanologjisë në Prishtinë dhe në Tiranë.

Fjalët çelës: Idriz Ajeti, Eqrem Çabej, albanologjia, raportet, vlerësimet

Kujtesa e profesor Idriz Ajetit

“Me Profesor Çabejn jam takuar shumë herë dhe do të duhej të ruaja shumë kujtime, por mosha dhe vitet e largëta shumë prej tyre i kanë zbehur. Tani ruaj vetëm disa nga ato më të veçantat, që i kam ruajtur me mendje dhe me zemër”. Kështu i fillonte kujtimet e tij Profesor Ajeti gjatë

një bashkëbisedimi për Profesor Çabejn, në qershor të vitit 2016, tekstin e së cilës po e risjell të përmbledhur për herë të parë:

“Sa më kujtohet tani me Profesor Çabejn jam takuar për herë të parë në Konferencën Ndërkombëtare të Studimeve të Europës Juglindore në Sofje¹. Vite më parë kisha shkruar për disa kontribute të tij te revista “Gjurmime albanologjike”². Mezi prisja ta takoja, prandaj që ditën e parë u interesova ta gjej dhe të bisedoj me të. Por, u zhgënjeva shpejt! E takova dy a tri herë me radhë mes studiuesish dhe ai ma jepte dorën duke shikuar sa në të majtë, sa në të djathtë, mos e shihte kush. E kuptova shqetësimin e tij. Marrëdhëniet ndërmjet Jugosllavisë dhe Shqipërisë nuk ishin të mira, prandaj me gjasë studiuesit nga Shqipëria ishin porositur të mos komunikonin as me ne nga Kosova. Megjithëse ka kaluar shumë kohë dhe ne pastaj jemi takuar edhe shumë herë të tjera, nuk me hiqej nga mendja ai takim i parë.

Në vitet ’70 marrëdhëniet ndërmjet ish-Jugosllavisë dhe Shqipërisë ishin normalizuar, prandaj u bë e mundur që në Prishtinë të vinin shumë profesorë universitarë. Të gjithë u pritën shumë mirë, por ardhja e Profesor Çabejt ishte një ngjarje e madhe. Ai ishte një përfaqësues i dijes shqiptare dhe në Prishtinë pritej jo vetëm si Profesor e Shkencëtar, po si një Burrë i Madh.

Takimet e mia me Profesor Çabejn ishin të shumta dhe të ndryshme. E para, gjatë kësaj kohe unë isha në krye të disa institucioneve universitare e shkencore në Prishtinë dhe takimet me të ishin sa zyrtare aq edhe personale. E dyta, gjatë kësaj kohe u përgatit dhe u botua kompleti i veprave të tij, ku mua m’u kërkua të shkruaj *Parathënie*³. Prandaj patëm mjaft takime dhe diskutime për disa aspekte të botimit të studimeve dhe veprave veç e veç. E treta, ai ligjëronte në studimet e magjistraturës, prandaj ndihmoi mjaft në ngritjen e kuadrove shkencore në Prishtinë. E vërteta, shumë studentë tanë që mbrojtën temat e magjistraturës dhe të doktoratës në albanologji gjatë viteve ’70 dhe ’80, ato i kishin filluar dhe diskutuar shu-

¹ Kongresi i II-të i Shoqatës Ndërkombëtare të Studimeve të Evropës Juglindore (A I E S E E), Sofje, 1966.

² Shih, Recensionin e Profesor Idriz Ajetit në “Gjurmime albanologjike, nr.1, pp. 283-286, Prishtinë, 1962.

³ Idriz Ajeti, *Dy fjalë për opusin e E. Çabejt, në "Studime gjuhësore"* (Études linguistiques). I. Studime etimologjike në fushë të shqipes. A-O. Rilindja. Redaksia e botimeve, Prishtinë, 1976, pp. VII-XXII.

më herë me profesorët nga Tirana, Profesor Mahir Domin, Dhimitër S. Shuteriqin, Androkli Kostallarin, e sidomos Profesor Eqrem Çabejn.

Me Profesor Eqrem Çabejn kemi diskutuar shpesh për çështje të leksikut të trevave të Ballkanit. Megjithëse unë u mora më shumë me marrëdhëniet e shqipes me gjuhës sllave, në formim jam romanist. Edhe ai merrej me indoevropianistikë e gjuhësi shqiptare, por romanistikën e kishte në krah të parë. Veprën e tij e nderoja dhe për të kam shkruar gjatë gjithë jetës sime.

Njëherë unë kisha një mendim tjetër rreth etimologjisë së toponimit *Ombra* dhe këtë e shfaqta publikisht në fjalën time, pasi që ai tashmë e kishte botuar mendimin e tij⁴. Kolegët më thanë se Profesor Çabej do të inatoset, por përkundrazi, ai ishte një Burrë i Madh, që i pranonte mendimet shkencore të tjetrit. Sigurisht unë isha i bindur në mendimin tim, por me vinte keq t'i kundërvihesha Profesor Çabejt sepse ai më parë kishte shkruar mirë për mua. Kur u takuam, ai ma rrahu krahun dhe më tha: “Ke të drejtë”! Nuk e di nëse këtë e ka tumirë edhe me shkrim, por mendimin tim pastaj e kanë përkrahur mjaft studiues të studimeve ballkanike dhe unë e ribotove atë edhe në gjuhë të tjera⁵.

Me Profesor Eqrem Çabejn ishim dhe mbetëm miq! – përfundonte Profesor Ajeti në qershor të vitit 2016, në 99 vjetorin e lindjes së tij”.

Por le t'i shohim me radhë këto marrëdhënie në dritën e dokumenteve dhe të teksteve shkencore gjatë një periudhe prej tri dekadash.

Vlerësimet e profesor Çabejt

Në arkivin personal të Profesor Çabejt, të pasur me shumë letra dhe kartolina të studiuesve e krijuesve nga Kosova, nuk gjendet ndonjë letër a kartolinë e profesor Idriz Ajetit, ndërsa në arkivin personal të Profesor Ajetit gjendet një letër-ftesë dërguar Profesor Çabejt më 1979, për të marrë pjesë në Seminarin Ndërkombëtar të Gjuhës, Letërsisë dhe Kulturës Shqiptare, që do të organizohej në korrik të vitit 1980, e cila në arkivin e

⁴ *Dy fjalë për opusin e E. Çabejt*, në Dr. Eqrem Çabej, “Studime gjuhësore”, I. (Studime etimologjike në fushë të shqipes. A-O), “Rilindja”, Prishtinë, 1976, pp. XXII-XXIII.

⁵ Idriz Ajeti, *Eqrem Çabej et les études de la linguistique albanaise*, “Gjurime albanologjike – seria e shkencave filologjike”, nr. 17, Prishtinë, 1987. Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1988, pp. 31-32.

Çabejt mungon, për arsye se nuk është karakterizuar si letër personale për arkivin e tij, por si komunikim zyrtar, prandaj sigurisht gjendet në *Arkivin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë*.

Në kërkimet shkencore të tij Profesor Çabej, vepra e Profesor Ajetit është bërë objekt studimi për herë të parë gjatë një diskutimi në Konferencën e Dytë të Studimeve Albanologjike në Tiranë, të vitit 1968, kur Profesor Çabej diskutoi mbi një kumtesë të Profesor Ajetit rreth pranisë së shqipes ndër dialekte të popullsisë sllave të Gadishullit Ballkanik në dritën e gjuhës dhe të toponimisë së tyre⁶, duke ua kujtuar të pranishmëve se Profesor Ajeti me këtë kumtesë interesante po e vazhonte rrugën e kërkimeve të sllavistit norvegjez Olaf Broch, të nisur duku në fillim të shekullit XX. Në të vërtetë sikur e theksonte Profesor Çabej kontributi i Profesor Ajetit shkonte përtej, tek disa struktura jo vetëm të karakterit leksikor po edhe fonetik, morfologjik e etimologjik, përmes të cilave shqipja e krahasuar me gjuhë të tjera fqinje mund të rindërtonte disa faza të moçme të saj, të cilat për shkaqe të caktuara historike, i ka humbur, por që ruhen në ato gjuhë.

Diskutimi i dytë i Profesor Çabejt për kumtesat e Profesor Ajetit është ai i vitit 1972 në Kuvendin e I të Studimeve Ilire në Tiranë⁷, në të cilin që në fillim dalin në pah raportet miqësore të dy bardëve të albanologjisë, jo vetëm pse Profesor Çabej (i shtyrë në moshë një dekadë para tij) i drejtohej me cilësorin Profesor, por pse që në fillim të fjalës së tij reflektonte për kontributin e Profesor Ajetit në fushë të marrëdhënieve leksikore shqiptaro-sllave, po edhe për dijeninë që kishte rreth perspektivës së këtyre

⁶ *Diskutim rreth kumtesës së I. Ajetit "Prania e shqipes ndër dialekte të popullsisë sllave të Gadishullit Ballkanik në dritën e gjuhës dhe të toponimisë së tyre* (Discussion sur la communication de I. Ajeti), po aty, p. 339, në Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 12-18 janar 1968. Tiranë, 1969 (1970), vëllimi III, pp. 329-330. Universiteti i Shtetëror i Tiranës – Instituti i Historisë dhe Gjuhësisë, referuar nga "Studime gjuhësore" (Études linguistiques). V. Gjuhë, folklore, letërsi, diskutime, "Rilindja", Redaksia e botimeve, Prishtinë, 1975. U shtyp në shtator të vitit 1977, p. 249.

⁷ *Diskutim mbi kumtesat e C. De Simones, V. Georgievit, I. Ajetit, E. Lafes, A. Katiçit, P. Visanit, G. Bonfantes* (Discussion), në "Kuvendi I i Studimeve Ilire", 15-20 shtator 1972, Tiranë, 1974, vëll. II, pp. 324-329, referuar nga *Diskutim rreth kumtesave të C. De Simones, V. Georgievit, I. Ajetit, E. Lafes, A. Katiçit, V. Visanit, G. Bonfantes* (241-246), në "Studime gjuhësore", (Études linguistiques). V. Vep., e cit., pp. 241-246.

kërkimeve, duke i quajtur ato me interes jo vetëm për albanologjinë po edhe për ballkanologjinë përgjithësisht. Më tej ky diskutim, do shquar jo vetëm për faktin se Profesor Çabej mbrojti etimologjinë shqipe të dy fjalëve (njërës rumune *crâciun* dhe tjetrës greke: *gramenata*), të cilat Profesor Ajeti i konsideronte sllave, por pse duke diskutuar para se gjithash për këtë të dytën Profesor Çabej ia kujtonte Profesor Ajetit një parim shumë të rëndësishëm në studimet etimologjike: “që, kur një fjalë gjen interpretim të kënaqshëm me mjetet e brendshme të gjuhës, mos të kalohet në shpjegim me mjete të gjuhëve të tjera.”⁸

Po këtë vit, në Paris botohet edhe një recension i gjerë i Profesor Çabejt për revistën e Prishtinës “Gjurmime albanologjike”, për vëllimet e dala gjatë viteve 1962, 1965, 1966 dhe 1968⁹. Nëse për Profesor Ajetin mund të thuhet se gjatë më shumë se katër dekadave të kërkimeve albanologjike të tij, veprën e Profesor Çabejt e ka bërë shumë herë objekt studimi, gjë që nuk mund të thuhet për anën tjetër, vlerësimet e Çabejt në këtë rast sikur përplotësojnë karakterin sasior të tij. Në një tekst prej 16 faqesh të *Buletinit shkencor gjuhësor të Parisit* ai, veç tjerash merret gjerësisht me katër studime monografike të Profesor Ajetit, që njëkohësisht, janë katër studimet më të rëndësishme të periudhës së parë të kërkimeve shkencore të tij, përjashtojë tezën e doktoratës “Zhvillimi historik i së folmes gege të arbëneshëve të Zarës”¹⁰ që u botua si vëllim më vete në Sarajevë. Në këtë rast, që në hyrje të tij theksohet fakti se kjo revistë drejtohet nga Profesor Idriz Ajeti – kryeredaktor.

Prej vëllimit të parë të revistës “Gjurmime albanologjike”, edituar nga Fakulteti Filozofik i Universitetit të Prishtinës Profesor Çabej vë në

⁸ Po aty, p. 243.

⁹ *Gjurmime albanologjike* (Recherches albanologiques), Revue scientifique de l’Institut Albanologique de Prishtina, 1 (1962), 2 (1965), 3 (1966), VII (II) 1 et 2 (1968), “Bulletin de la Société de Linguistique de Paris LXVII, fasc. 2, pp. 211-227. Paris 1972. Éditions Klincksieck. (Recension. Compte rendu); sipas *Eqrem Çabej, në “Bulletin de la société de linguistique de Paris”, Tome 67, 1972, fascicule 2, f. 211-227: GJA, revistë shkencore e Institutit Albanologjik të Prishtinës, 1 (1962), 2 (1965), 3, (1966), VII (II) 1 e 2 (1968) (260-270); në “Studime gjuhësore” (Études linguistiques). V. Vep. e cit., pp. 260-270. Përkthyer në gjuhën shqipe nga Rexhep Ismajli.*

¹⁰ *Istorijski razvitak gegijskog govora arbanasa kod Zadra*, Balkanološki institut Naučnog društva Bosnije i Hercegovine, Sarajevo 1961, p. 164.

diskutim studimin e botuar, përkatësisht ribotuar¹¹ të Profesor Ajetit “Dokumenti më i vjetër shqip i Kosovës me alfabetin arab”¹². Duke e vlerësuar këtë sintezë monografike si një qasje të një interesi të veçantë, Profesor Çabej çmonte faktin se me këtë studim Profesor Ajeti ka paraqitur një pasqyrë mjaft interesante të sistemit fonetik të të folmeve shqipe të zonës së Kosovës, duke vijuar pastaj me shqyrtimin e disa çështjeve të morfologjisë historike dhe të formimit të fjalëve¹³. Në këtë proces kërkimi, rindërtimi e krahasimi për Profesor Çabejn me interes janë krahasimet ndërdialektore. Por jo vetëm kaq, për Profesor Çabejn në këtë proces hulumtimi mbeten edhe disa “çështje që duan ndriçim të mëtutjeshëm: “përcaktimi më i saktë i disa fenomeneve, si afrikatet, gjeneza e admirativit, kronologjia e rënies së *e-së* atone, zhvillimi i guturaleve palatale në afrikate dhe reduktimi i grupeve *kl, gl* në guturale të llojeve të ndryshme”¹⁴.

Duke shkruar për studimet e botuara në vëllimin e dytë të “Gjurmime albanologjike”, Profesor Çabej vë theksin edhe te studimi i Profesor Ajetit mbi raportet gjuhësore midis shqipes e serbokratishtes¹⁵. Fjala është për njërin prej studimeve orientuese të Profesor Ajetit, mbi marrëdhëniet e shqipes dhe serbokratishtes, që në të vërtetë thelbsisht kanë të bëjnë me praninë e leksikut të shqipes në korpusin e përgjithshëm të serbishtes, me theks të veçantë të folmet serbe të Kosovës dhe Serbisë Jugore. Profesor Çabej në vlerësimin e tij për revistën e Parisit përkujton se tashmë nuk është fjala madje as vetëm për njësitë leksikore të kësaj provincie, por edhe për disa struktura të karakterit morfologjik e sintaksor. Pasi ndalet tek disa shembuj të karakterit leksikor, si format *tunâj, kuventa, koka* etj., dhe i sheh ato edhe në raport me maqedonishten e greqishten, Profesor Çabej vjen në një përfundim gjithëpërfshirës, se “ky studim përveç raporteve shqiptaro-sllave, ka rëndësi edhe për historinë e shqipes dhe për rindërtimin e brendshëm të disa tipareve të sistemit të saj”¹⁶.

¹¹ Për herë të parë ky dokument u bë i njohur në studimin *Dokumenti më i vjetër i shqipes së Kosovës, shkruar me alfabetin arab*, “Rilindja” më 1, 2 e 3 janar 1960, p. 15.

¹² *Najstariji dokument kosovskog arbanaškog govora na arapskom pismu*, “Gjurmime albanologjike”, Prishtinë, 1962, nr. 1, pp. 9-73.

¹³ *Studime gjuhësore*, (Études linguistiques). V. Vep., e cit., p. 260.

¹⁴ Po aty, p. 260.

¹⁵ *Prilog proučavanju medjusobnih šiptarsko-srpskih jezičkih odnosa*, “Gjurmime albanologjike”, Prishtinë, 1965, nr. 2, pp. 35-56.

¹⁶ Vep., e cit. p. 263.

Edhe në vëllimin e tretë të revistës “Gjurmime albanologjike”, Profesor Ajeti kishte vazhduar botimin e temave me karakter dialektor, të cilën e kishte filluar me tekstin e Tahir Boshnjakut në gjuhën arabe. Këtu ai boton një përmbledhje lirike të Sheh Maliqit, të shkruar në gjuhën arabe. Duke vlerësuar me interes këtë tekst, Profesor Çabej kujton se si në tekstin e parë të Tahir Boshnjakut ashtu edhe në tekstin e dytë të Sheh Maliqit, paraqitja e sistemit fonetik ruan parimet e përbashkëta, por në këtë studim janë me rëndësi daljet në dritë të strukturave morfologjike e sintaksore të shqipes së dialektit veri-lindor, sikur janë: sistemi i rasave, nyja dhe historia e saj, disa aspekte të sistemit foljor etj.¹⁷

Në vëllimin 2/1968 të revistës “Gjurmime albanologjike” është botuar një studim tjetër i Idriz Ajetit mbi marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-sllave¹⁸, tek i cili Profesor Çabej ndalet në mënyrë të veçantë për disa arsye. Studimi i Profesor Ajetit tashmë merr në shqyrtim jo vetëm ndikimin e shqipes në të folmet serbe në Serbinë Jugore dhe në Kosovë, po edhe në të folmet serbe në Mal të Zi, dhe për më tej rrafshi i kërkimeve nuk janë vetëm njësitë leksikore dhe kur e kur ndonjë veçori morfologjike, por edhe njësitë onomastike, frazeologjike dhe të kalkeve gjuhësore. Tek vlerësimi i tij Profesor Çabej thekson me kënaqësi se tashmë Profesor Ajeti jo vetëm kishte arritur të zgjidhte disa etimologji të shqipes në pajtim me pikëpamjet e tij të mëhershme, por ato i kishte zgjeruar e konkretizuar edhe me shembuj të tjerë të fushës së leksikografisë dhe të onomastikës. Megjithëse edhe në këtë studim Profesor Ajeti, mbajti qëndrim në lidhje me origjinën shqipe të sllavishtes *kračun*, Profesor Çabej, në këtë vështrim ia kujtonte Profesor Ajetit se nuk e ndihmonin aspak vërejtjet dhe plotësimet. Po këtu është mjaft me interes një vërejtje e përgjithshme e Profesor Çabejt në lidhje me huazimet dhe relacionet e veshjeve ndërmjet popujve, e kjo do të thoshte edhe ndërmjet popullit shqiptar dhe atij malazez. “Pjesërisht është fjala për mbeturina, elemente shqiptare të ruajtura te një popullsi dikur shqiptare, pas procesit të sllavizimit”¹⁹.

Raportet kolegjiale të tyre Profesor Çabej do t’i kurorëzoj me vlerësimin që i bënte Profesor Ajetit në *Hyrje të Studimeve etimologjike në*

¹⁷ Shih, po aty, p. 265.

¹⁸ *Studime leksikore shqiptaro-sllave*, Gjurmime albanologjike, Prishtinë 1968, 2, 35-50.

¹⁹ Vep., e cit., p. 270.

fushë të shqipes (I), në fillim të viteve '70²⁰. Duke sjellë një kronologji të studimeve etimologjike në fushë të shqipes, nga radhët e studiuesve të huaj dhe vendorë, në lidhje me marrëdhëniet shqiptaro-sllave, Profesor Çabej pa shkuar në tërthore emrash a temash, me një fjali përmbledh konceptet e tij: “Në fushën e marrëdhënieve shqiptaro – sllave, meritë ka I. Ajeti”²¹.

Vlerësimet e profesor Idriz Ajetit

Kronologjia e vlerësimeve

Në bibliografinë e studimeve të profesor Idriz Ajeti, për veprën jetësore dhe shkencore të profesor Eqrem Çabejt ka një shtrirje prej katër dekadash. Ajo përfshinë studime dhe sinteza me synim përgjithësues për jetën dhe sidomos veprën e tij, recensione për vepra të caktuara, parathënie veprash të botuara në Prishtinë, kapituj të veçantë studimorë dhe madje mjaft përgjithësues për tema dhe fusha të rëndësishme të albanologjisë, referenca të zgjeruara dhe mbështetje të caktuara në tekstet problematizuese dhe polemizuese të Profesor Ajetit me studiues shqiptarë dhe të huaj. Vlerësimet e tij për vepra të caktuara të Profesor Çabejt fillojnë në vitin 1962 me një recension për studimin monografik “Über einige mit z-analytische Wörter der Albanischen”, për të vazhduar me një recension tjetër mjaft të zgjeruar (1967) për monografinë sintetike *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe*, me një parathënie ribotimit të librit *Për gjenezën e literaturës shqipe* (1972), për të realizuar sintezën më të plotë me studimin *Dy fjalë për opusin e E. Çabejt*, botuar në *Hyrje të veprave të plota të Profesor Eqrem Çabejt në Prishtinë* (1976). Studimet, vlerësimet dhe nderimet për jetën dhe veprën e tij Profesor Ajeti i vazhdon me një tekst nderimi e vlerësimi me rastin e vdekjes së Profesor Çabejt (1980); me, sikur shprehej Profesor Ajeti *dy fjalë kujtimi për Eqrem Çabejn* me rastin e përvjetorit të vdekjes së tij (1981); për të kulmuar me një studim tjetër po kaq përgjithësues e sintetik për Eqrem Çabejn dhe studimet e gjuhësisë shqiptare (1998), një sintezë kjo e botuar jo njëherë dhe me plotësime nga njëri rast në tjetrin. Si në periudhën e parë ashtu edhe në vitet në vazhdim, përveç studimeve me karakter të veçantë apo përgjithësues profesor Idriz

²⁰ Megjithëse u shkruar pjesërisht në vitet '60 e '70, për shkaqe ekstrashkencore kjo vepër u botua nga Akademia e Shkencave e RPSH të Shqipërisë - Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, në Tiranë, vetëm në vitin 1982.

²¹ Po aty, p. 32.

Ajeti veprën e Profesor Çabejt dhe problemet e caktuara që ka trajtuar ai, i ka bërë objekt studimi në disa dhjetëra tekste të tij.

Studimet e me karakter sintetik

Në studimet gjuhësore të tij krahas fushave të veçanta të albanologjisë, si dialektologjia, shqipja standarde, marrëdhëniet e shqipes me sllavishten, etimologjia, onomastika etj., profesor Idriz Ajeti është kujdesur të shkruaj dhe të kujtohet për disa nga studiuesit më të shquar të lagjes së albanologjisë, të romanistikës, të sllavistikës, të ballkanologjisë e të indoeuropianistikës. Tekstet, kryesisht përgjithësuese për jetën dhe veprën e tyre, Profesor Ajeti i ka shkruar në rastet më të shpeshta për përvjetorët e tyre, prandaj brenda tyre ka sjellë edhe sinteza me interes jo vetëm për albanologjinë po edhe për dijet e tjera rreth saj.

Në bibliografinë e pasur të këtij korpusi gjuhëtarësh përjashtim bën Eqrem Çabej, për jetën dhe veprën e të cilit ka shkruar atëherë kur ai ishte në kulmin e sintezave të mëdha, me rastin e vdekjes dhe pas vdekjes së tij. Duke shkruar, kështu në situata të ndryshme, jetën dhe veprën e Profesor Çabejt e ka parë me kujdes, në tekste të vëllimshme dhe gjithanshëm, jetën dhe sidomos veprën e tij, si dhe i ka diskutuar gjithashtu disa çështje gjuhësore në mënyrë përimtuese, analitike dhe sintetike njëkohësisht. Duke shkruar *in memoriam* e parë në emër të institucioneve shkencore e arsimore të Kosovës ai gjithashtu ka shprehur gjithë pikëllimin e qytetarëve të Kosovës, ku Profesor Çabej, më shumë se një albanolog, ishte një kult njëkohësisht²². Në të vërtetë, duke shkruar edhe pas vdekjes së tij, ai ka mundur të shkruaj sintezën e madhe të albanologjisë së tij, që më parë se gjuhë dhe histori e saj, në jetën arsimore e shkencore të shqiptarëve në Kosovë, perceptohej si dije për qytetërimin shqiptar²³.

²² *Albanologut më të madh të ditëve tona*. (Me rastin e vdekjes së profesor Eqrem Çabejt), Rilindja, Prishtinë, 23 gusht 1980, f. 12-13; *In memoriam*, Vepra 5, ASHAK, Prishtinë, 2002, f. 117; *Eqrem Çabej (1908-1980)*, (*In memoriam*), Studime gjuhësore në fushë të shqipes, III, Rilindja Prishtinë, 1985; *Kolos me kompetenca të gjithanshme shkencore*, Rilindja, 23. 8. 1980, Prishtinë, pp. 12-13.

²³ *Dy fjalë kujtimi me rastin e përvjetorit të vdekjes së Eqrem Çabejt*, Vepra, 5, ASHAK, Prishtinë, 2002, pp. 127; *Eqrem Çabej dhe studimet e gjuhësisë shqiptare*, Studime gjuhësore në fushë të shqipes, IV, Rilindja, Prishtinë, 1989, pp. 75-85; Eqrem Çabej et les etudes de la linguistique albanaise. *Gja-sshf*, nr. 17, Prishtinë, 1987. IAO, Prishtinë,

Sinteza e parë e studimeve të tij që porositur nga Redaksia e Rilindjes në vjeshtë të vitit 1971, në fillim të përgatitjeve të saj për të botuar vepërën e plotë të Profesor Çabejt në gjashtë vëllime, vëllimi i parë i të cilave dali nga shtypi në vitin 1976, me parathënie të Profesor Ajetit, me titull “Dy fjalë për opusin e E. Çabejt.”²⁴ Pas një studimi gjithpërfshirës, shterues e sintetizues në sjelljen e të dhënave biografike e shkencore, të profesor Jup Kastratit²⁵, të cilit do t’i pasvjen më vonë edhe një bibliografi²⁶ unike në dijen albanologjike të kësaj kohe, studimi i profesor Idriz Ajetit mbetet teksti më sintetik, i shkruar për Profesor Çabejn, deri në vitet ’80, kur profesor Shaban Demiraj boton monografinë më të plotë deri më sot për dijen Çabejane²⁷.

Pasi paraqet arsyetimin e projektit për botimin e veprave të plota të Profesor Çabejt formimin arsimor dhe shkencore të tij e projekton në linjën e dy perspektivave: atë kohore, në të cilën u formua dhe punoi, e kjo do të thotë në perspektivën europiane të albanologjisë dhe në varësi të rrethave të brendshme të cilave ju takoi dhe brenda të cilave punoi. Në këtë rrjedhë ai ka përvijuar edhe formimin e tij arsimor e shkencor në Vjenë, duke i identifikuar edhe shkollat, rrymat, metodat dhe nocionet e kësaj shkolle me traditë, që ka përdorur në studimet e tij shkencor, në interes të arritjeve të tij shkencore dhe në interes të dijes së albanologjisë vendëse. Duke i identifikuar emrat e shkencëtarëve prej të cilëve e mori formimin shkencor të tij është e kuptueshme që të kujtonte edhe profesorët e tij

1988, pp.31-32; *Ndihmesa e Eqrem Çabejt në studimet etimologjike të shqipes*, Fjala, 10, Prishtinë, 1990, p. 3.

²⁴ *Dy fjalë për opusin e E. Çabejt, në Studime gjuhësore (Études linguistiques). I. Studime etimologjike në fushë të shqipes*. A-O.Rilindja.Redaksia e botimeve, Prishtinë, 1976, pp. VII-XXII. Në botimet dhe ribotimet e më vonshme ka dalë me titull *Veprimtaria shkencore e Prof. Eqrem Çabejt*. Shih, veç tjerash ribotimin e parëtë po atij viti: *Veprimtaria shkencore e prof. Çabejt*, Gjurmime albanologjike – Seria e shkencave filologjike V – 1975, Prishtinë 1976, pp. 7-25 dhe brenda përmbledhjes me studime *Kërkime gjuhësore*, Rilindja, Prishtinë, 1978, pp. 304-338.

²⁵ *Veprat albanologjike të prof. Eqrem Çabejt*, Buletin shkencor i Institutit të Lartë Pedagogjik të Shkodrës, viti II, nr. 3, pp. 97-167.

²⁶ *Bibliografia e punimeve të prof. Eqrem Çabejt (1929-1981)*, (Bibliographie des travaux du prof. Eqrem Çabej), Studime filologjike, 1/1981, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 1981, p. 219.

²⁷ Shih, *Eqrem Çabej – Një jetë kushtuar shkencës*, Tiranë 1990.

(Joklin, Pach-in e të tjerë), si dhe bashkëkohësit e tij me ndikim në studimet albanologjike, ballkanologjike dhe indoeuropiane të kohës.

Pasi ka sjellë një panoramë më vete për dijen e shkollave europiane Profesor Ajeti ka identifikuar edhe bardët e këtyre studimeve nga radhët e albanologëve të lagjes shqiptare të dy shekujve të fundit. Në të vërtetë, pasi ka sjellë një pasqyrë të dyanëshme të dy faqeve të albanologjisë vendore dhe ndërkombëtare, Profesor Ajeti e ka parë jetën dhe veprën e tij të ndarë në dy periudha pothuajse shtampa në të gjitha studimet me karakter historik: nga viti 1934-1945 dhe nga viti 1945-1975, sado, po të shihet biografia e tij në rrjedha të kohës dhe të zhvillimit të saj, ajo do të mund të përkufizohej mbi disa parime të tjera, e ato nuk do të ishin historike, por bibliografike.

Bosht i studimit të kontributeve të Çabejt gjatë periudhës së parë janë bërë dy veprat themelore të tij “Gjeneza...” (1939), për të cilën kishte shkruar gjerësisht edhe disa vite më parë, si dhe krestomacia “Elemente të gjuhësisë...” (1936). Brenda kërkimeve të tij të kësaj periudhe nuk lë pa përmendur edhe studimet e tij të botuara, madje kryesisht në shtypin ballkanik dhe atë gjermanofolës, por duke u marrë me disa probleme të gjuhësisë dhe të letërsisë së kësaj periudhe, Profesor Ajeti ka identifikuar disa arritje të Profesor Ajetit në këtë periudhë, në ato përmasa të cilat nuk janë bërë pothuajse as atëherë as më vonë. Le të theksojmë këtu vetëm disa aspekte të këtyre shembujve ku ka vënë theksin Profesor Ajeti. Diskutimi i etnonimit *alb/arbër* dhe toponimin *Arbëri*, këtu merr përmasa të gjera vlerësuese e krahasuese, sa ta shohim këtë tekst, si një përplotësim të kësaj dijeje edhe një gjysmë shekulli më vonë.

Në vazhdim Profesor Ajeti përvijon situatat politike, arsimore dhe shkencore pas Luftës së Dytë Botërore si dhe angazhimin e Profesor Çabejt në këto zhvillime, ndërsa brenda tyre edhe orientimet arsimore e shkencore duke i dhënë hapësirë interesimit të tij në studimin e strukturës gjuhësore të “Mesharit” të Buzukut, njërit prej projekteve të tij më të rëndësishëm, të cilin e kishte filluar së punuari gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore në Itali. Sigurisht ky projekt, i cili do të kulmoj në vitin 1968 me botimin në dy vëllime të “Mesharit”, do të mbetet njëra prej veprave më të rëndësishme në gjithë korpusin e tij shkencor.

Në rrjedha të përimtimit historik të një dore leksikore me karakter lashtësisht historik, Profesor Ajeti ndalet edhe te një listë studimesh të kësaj periudhe me interes për autoktoninë e popullit shqiptar e të gjuhës shqipe, duke u marrë gjerësisht jo vetëm me probleme të natyrës së shqipes apo te dijes albanologjike të kohës, po duke e hapë atë edhe për disa shekuj më tej. Megjithëse Profesor Ajeti temën e diskutimit e hapë shumanshëm dhe pavarësisht se sjell një sintezë mjaft të kompletuar, në tërësinë e këtyre diskutimeve mbetet në rrafshin antologjik. Duke ju rikthyer kur më shumë e kur më pak monografisë për fonetikën historike të Buzukut apo disa prej studimeve të tij të veçanta, Profesor Ajeti në fund sjell edhe një sintezë të arritjeve të Çabejt në korpusin e përgjithshëm të fonetikës historike të shqipes, brenda të cilit gjejnë shpjegime sisteme të tëra të familjeve të fjalëve e toponimeve historike të shqipes. Nuk është e rastit që disa dukuri dhe fenomene të fonetikës historike tëshqipes të përcaktuara në këto studime të gjejnë zbatim edhe sot në fushë të leksikologjisë dhe onomastikës historike të shqipes. Në këtë rrjedhë ai merret në mënyra mjaft të përkushtuar edhe me dy monografi të papërsëritshme të morfologjisë së shqipes, *Parashtesat e gjuhës shqipe*²⁸ dhe *Prapashtesat e gjuhës shqipes*²⁹, të cilat i kanë përgatitur profesor Aleksandër Xhuvani dhe Profesor Çabej në vitet '50-'60.

Në këtë studim mjaft gjithëpërfshirës Profesor Ajeti gjerësisht do të merret me dy vëllimet e *Studimeve etimologjike të shqipes*, duke filluar nga shkolla gjuhësore në të cilën është formuar deri te metoda gjuhësore e shkollës gjermane "Fjalët dhe sendet", të cilat Profesor Çabej i ka funksionalizuar me sukses në dy vëllimet e studimeve etimologjike të tij. Ndryshe nga qasja leksiko-semantike dhe strukturore e njësive gjuhësore, te studimet e fazës së parë, korpusit të studimeve etimologjike i qaset nga rrafshi historiko-kulturor e etno-psikologjike, duke i parë shtresat gjuhësore të shqipes në raport me zhvillimin dhe qytetërimin e popullit shqiptar e autoktoninë e tij në këto tërthore të Ballkanit Perëndimor. Duke i parë fjalët, përkatësisht njësitë leksikore si objekt studimi brenda këtyre dy

²⁸ *Parashtesat e gjuhës shqipe* (Lex préfixes de la langue albanaise), nga Prof. Dr. Aleksandër Xhuvani), Buletini Shoqëror i Shkencave, nr. 4, pp. 66-103, Tiranë, 1956.

²⁹ *Prapashtesat e gjuhës shqipe* (Les suffixes de la langue albanaise) nga Prof. Dr. Aleksandër Xhuvani dhe Prof. Eqrem Çabej, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe Gjuhësisë, Tiranë, p. 112.

vëllimeve Profesor Ajeti reflekton në trashëgiminë etno-historike dhe kulturore të popullit shqiptar. “Mbi bazën e metodës shkencore, shkenca etimologjike është në gjendje të bëj dallimin midis elementeve të huaja nga fondi autokton. Në këtë mënyrë provohet gjithherë që historia e gjuhës është njëkohësisht histori e kulturës së popullit që atë e flet. Fjalët *hardhi*, *rrush*, *vjel*, *venë*, *verë*, *vreshtë*, *vneshtë*, nga fondi trashëgues në gjuhën shqipe e nga sfera e punimit të vreshtarisë janë dëshmi e pakontestueshme që të parët e shqiptarëve jetnonin në zona mesdhetare dhe kultivonin hardhinë duke nxjerrë nga rrushi verë”³⁰.

Në mbyllje të këtij studimi Profesor Ajeti merret me disa tekste, që në të vërtetë përfaqësojnë sinteza gjuhësore përmbi disa zhvillime të brendshme dhe të jashtme të shqipes. Në kuadër të studimeve të tij përmbi disa zhvillime të jashtme të shqipes, Profesor Ajeti merret kur më pak e kur më shumë dhe kur më përkushtueshëm e kur më përgjithsueshëm me disa eufemizma të shqipes, me tekstin bazik, sikur shprehej Profesor Çabej, të një monografie në proces, përmbi disa fjalë të shqipes që nisin me Z-dhe sidomos me disa etimologji të Kristoforidhit. Duke u marrë me disa kërkime të thelluara të kësaj natyre dhe me interes për fonetikën, morfologjinë historike të shqipes e sidomos të etimologjisë, Profesor Ajeti kishte arritur të nxjerr edhe disa konkluzione me interes që kishin të bëjnë me disa rregulla të fonetikës historike të shqipes dhe më tej me disa çështje të historisë së gjuhës shqipe, e madje me vetë problemin e autoktonisë së shqiptarëve në dritën e emrave të vendeve, apo me sinteza më të mëdha, sikur ishte vendbanimi i hershëm i shqiptarëve në Gadishullin Ballkanik në dritën e gjuhës e të emrave të vendeve. Në dritën e këtyre sintezave, në dukje të parë të natyrës brenda gjuhësore, sikur e thekson edhe Profesor Ajeti, Profesor Çabej arrinte të disa probleme themelore të historisë së vjetër të gjuhës shqipe, në të vërtetë të vetë problemi i burimit të gjuhës shqipe, të historia e strukturës dialektore të saj dhe të burimet e përbashkëta të ilirishtes e të shqipes, një synim ky i lakmuar i të gjithë albanologëve.

Pasi ka diskutuar disa nga dukuritë dhe fenomenet nga historia e jashtme e gjuhës shqipe, Profesor Ajeti i ka bërë objekt vlerësimi disa

³⁰ *Veprimtaria shkencore e profesor Eqrem Çabejt*, në **VEPRA 5**: ASHAK, Botime të veçanta XXIII. Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, libri 12. Redaksia: R. Ismajli, B. Bokshi, E. Gjerqeku. Prishtinë, 1997, p. 111.

dukuri jo të pakta dhe jo më pak të rëndësishme nga historia e brendshme e gjuhës shqipe, të cilat Profesor Çabej i ka marrë në shqyrtim për disa dekada me radhë, por që tani i ka përfshirë në gjysmën e dytë të vëllimit të katër, me rastin e botimit të kompletit të veprave të tij në Prishtinë. Fillimisht merret me diskutimin e njërës prej njësive etimologjike Rum. Crăciun “kërshëndella”, për të cilën kanë fërkuar mendimet jo njëherë dhe jo vetëm kalimthi, për të vazhduar diskutimet gjerësisht dhe sistematikisht edhe me tekste të tjera të kësaj natyre, disa prej të cilave sinteza të pakalueshme edhe sot, sikur janë: kërkimet e tij mbi disa mendime rreth marrëdhënieve gjuhësore rumuno-shqiptare, karakteristikat e huazimeve latine të gjuhës shqipe, elementet latine të gjuhës shqipe, mbi një saktësim në lidhje me një etimologji të shqipes të diskutuar nga gjuhëtari amerikan Eric Hamp etj. Kërkime më vete paraqesin vlerësimet e Profesor Ajetit për kontributin e Profesor Çabejt në lidhje me marrëdhëniet e shqipes me gjuhët fqinje dhe rrafshet historike të reflektimeve të saj, apo mbi disa faza më të mëdha të shqipes në dritën e gjuhëve fqinje, mbi shqipen dhe gjuhët fqinje, mbi kontributin e shqipes në formimin e lidhjes gjuhësore ballkanike etj. Cikël më vete studimesh me interes për të dy bardët e historisë së gjuhës e në veçanti etimologjive të saj, paraqesin studimet e Çabejt mbi disa raporte të shqipes me gjuhët sllave, mbi disa izoglosa kelto-shqiptare, të ndërlidhura madje edhe me emrin e Dardanisë, si dhe mbi disa rrethana të lidhjes së iberoromanishtese të shqipes dhe izoglosat e tyre latine. Në këtë mënyrë a një tjetër, mund të thuhet se studimi hyrës i Profesor Ajetit në këtë vëllim bëhet një parathënie e tërësisë së veprave të Profesor Çabejt të botuara në gjashtë vëllime në Prishtinë.

Pas tekstit të botuar në vend të *parathënies* me titull *Dy fjalë për opusin e E. Çabejt*, në vëllimin e parë “Studimet gjuhësore”, profesor Idriz Ajeti ka botuar edhe tekste të tjera, por studimi *Eqrem Çabej dhe studimet e gjuhësisë shqiptare*, është teksti më i plotë, jo vetëm për mënyrën se si e ka përvijuar veprën e tij, por edhe në kontekstin historik të paraqitjes së pamjes së saj. Në fillim është sjellë një pamje mjaft e plotë e zhvillimit të gjuhësisë shqiptare që nga fillimet e saj, duke nisur me Naum Veqilharxhin, Konstantin Kristoforidhin, Sami Frashërin, Jani Vreton, Naim Frashërin, Pashko Vassen, Thimi Mitkon, Zef Jubanin, Koto Hoxhin, Hasan Tahsinin etj, duke parë te kontributet e tyre misionin e tyre të shumëfishtë, gjuhësor, kulturor, kombëtar, identitar e institucional; në të vërtetë, duke

vlerësuar tek ata misionarët, leksikografët, enciklopedistët, neologjistët, terminologët, mbledhësit e folklorit e të gjuhës popullore, dialektologët, gramatikologët, etimologët dhe sidomos formësuesit e teorisë së prejardhjes historike të popullit shqiptar e të gjuhës shqipe etj. Në rrjedhë të këtyre vlerësimeve të kontributit të rilindësve tanë, Profesor Ajeti përvijon e vlerëson edhe arritjet më të mira të Profesor Çabejt si një pasardhës i denjë i tyre. Po kështu mund të thuhet për mënyrën se si i ka diskutuar teoritë gjuhësore dhe konceptet e disa prej albanologëve, ballkanologëve e indeuropianistëve për probleme të mëdha, sikur është problemi i origjinës së gjuhës shqipe e të popullit shqiptar dhe për probleme më të vogla, sikur janë etimologjitë e disa prej njësive leksikore, sado në tërësinë e tyre ato përfaqësojnë trashëgiminë kulturore e historike të popullit shqiptar.

Nëse traditën albanologjike të Rilindjes Kombëtar Profesor Ajeti e diskuton përgjithësisht në tërësinë e kontributeve të gjithë rilindësve shqiptarë, traditën europiane të albanologjisë e koncepton në trinomin e madh të kësaj tërësie: Meyer-Pedersen-Jokli. Nëse te veprae Meyerit, përkatësisht te *Fjalori* i tij shihte njësi etimologjike “në disa vise të vjetruara”, te vepra e Pedersenit shihte shumë vlera cilësore në çështje të metodës, por autorin “shumë herët të larguar” nga studimet albanologjike; ndërsa te autori i tretë i këtij trinomi Norbert Jokli, Profesor Çabej gjeti mësuesin e tij jetësor dhe shkencor, mentorin e tij të përjetshëm.

Sintezën shkencore të tij për raportet e Profesor Çabejt me trashëgiminë gjuhësore kombëtare dhe trashëgiminë europiane të albanologëve, e fillon me një konstatim modest, por themeltar: “Ne nuk do të thoshim asgjë të re, pos një përsëritje, po të vinim re se është mendja sistematike e albanologut Gustav Meyer ajo që ndërtoi sistemin e tingujve dhe strukturën morfologjike, me çka u përcaktua karakteri i veçantë i gjuhës shqipe si dhe vendi i saj në rrethin e ligjërimeve të tjera indoevropiane”³¹. Besoj se edhe ne, në rrjedhë të mendimit të Profesor Ajetit, nuk do të thoshim asgjë të re, as nuk do të sillnim një sintezë të re, po të theksonim se, mbi themelet e këtij konstatimi të Ajetit për Majerin, mund të themi se: është mendja sistematike dhe gjeniale e Holger Pedersenit ajo e cila krijoi sistemin e guturaleve të shqipes, mbi të cilën Profesor Çabej ndërtoi sistemin e plotë

³¹ Vep. e cit. p. 133.

të fonetikës historike të shqipes; është mendja gjeniale e Joklit ajo, e cila krijoi sintezën e madhe të strukturës fjalëformuese të fjalësit të shqipes, mbi të cilën Profesor Çabej ndërtoi sintezën e madhe të studimeve etimologjike në fushë të shqipes. Kjo ndërkaq nuk e pengoi Profesor Çabejn që ato të mos i përplotësonte në shumë anë dhe në shumë rrafsh, jo vetëm në fushë të fonetikës po edhe në atë të morfologjisë, të semantikës e të etimologjisë.

Reflektimin e tij për veprën e Profesor Çabejt në fushë të shqipes, si një pasardhës i denjë i trinit Meyer-Pedersen-Jokli, Profesor Ajeti e fillon me sintezën e madhe kritike, që Profesor Çabej e pati sjellë në lidhje me përqindjen e etimologjive të leksikut të shqipes në *Fjalorin etimologjik të shqipes*, si dhe qëndrimin që mbante ai. Në këtë kontekst Profesor Ajeti mban edhe qëndrimet e tij ndaj këtyre arritjeve, duke theksuar rëndësinë e këtyre rezultateve nga pasqyrimi që sjellin ato për historinë e origjinës së tyre e të gjuhës shqipe përgjithësisht, deri te ndikimi që kanë ato në stabilizimin e formës letrare të tyre në kohën tonë. Në këtë mënyrë, Profesor Ajeti, vazhdimësinë e kontributeve të Profesor Çabejt e konsideron si një vazhdim të natyrshëm të ndërtimit të ngrehinës së Norbert Joklit në studimet albanologjike, duke filluar me veprën monument për Gjon Buzukun deri te projekti i madh i studimeve etimologjike në fushë të shqipes. Këtë tekst sintetik për Profesor Çabejn dhe gjuhësinë shqiptare Profesor Ajeti e përmbyll me një vështrim të gjerë të karakterit historik e sintetik për vëllimet *Studime etimologjike në fushë të shqipes*. Në të vërtetë, fjala është për një rikthim në njërin prej problemeve shumë të diskutuara, për burimin indoeuropian, autokton apo të huazuar të leksikut të shqipes, për të cilin ai sjell jo vetëm vlerësimet e të tjerëve po edhe vlerësimet e tij, njëri prej të cilëve besoj mjaft esencial, sipas të cilit, statistika e këtyre raporteve duhet të bëhet “jo në mbështetje të raporteve numerike të visarit leksikor burimor ndaj atij të huazuar, por në mbështetje të cilësisë të vetë leksemave, sipas asaj se në ç’denduri paraqiten në tekstin e dhënë. Do të thotë, është e nevojshme të shikohet se në cilat kategori leksikore të pasurisë gjuhësore është përdorur fjala burimore dhe me çfarë frekuence, në njërin anë, dhe të vërtetohet dinamika e një fjale të huazuar në tekstin e dhënë, në anën tjetër; edhe nëse ekzistojnë statistika të tilla, ato janë shumë të rralla”³².

³² Vep. e cit. p. 141.

Me rastin e vdekjes së Eqrem Çabejt, në vitin 1980, Profesor Ajeti shkroi një tekst të zgjeruar dhe jo shumë të zakonshëm për raste të tilla³³. Një tekst që fillonte me një diskurs dhembjeje e nostalgjie për mikun por hapej në gjithë dijen albanologjike, duke shtrirë kontributin e tij si një linjë të përhershme të kësaj dijeje. “Kumti i zi mbi vdekjen e Prof. Çabejt jehoi thekshëm duke pikëlluar flakshëm inteligjencien shqiptare të mbarë Kosovës”³⁴. Kështu e fillonte fjalën e tij të dhimbjes e të nderimit Profesor Ajeti, për të vazhduar vlerësimin e tij, që në të vërtetë është një sintezë e karakterit enciklopedik për Profesor Çabejn dhe veprimtarinë e tij shkencore. Megjithatë nuk mund të thuhet se ky tekst kujtimi e nderimi ka sjellë ndonjë vlerësim të ri, të cilin nuk e kishte shprehur në tekstet e mëparshme ndonjëherë, sot mund të themi se tekste të kësaj natyre nuk ishin shkruar jo vetëm deri atëherë, përjashtoj studimin e Profesor Jup Kastratit³⁵, por nuk janë shkruar as deri më sot, duke përfshirë edhe zërin enciklopedik në *Fjalorin enciklopedik shqiptar* apo në ndonjë fjalor të kësaj natyre me karakter enciklopedik të përmasave të përbotshme, sikur është enciklopedia *Encyclopedia of Language and Linguistics*³⁶, ku është përfshirë edhe zëri për Eqrem Çabejn.

Në këtë tekst sintetik, sikur është bërë përmbledhja e plotë kronologjike dhe e analizuar e veprave dhe studimeve të Eqrem Çabejt, nga njëri vit në tjetrin dhe nga njëri studim në tjetrin, duke sjellë kur e kur edhe konstatime të tjera për probleme të origjinës së gjuhës shqipe, të fenomeneve apo dukurive të fonetikes historike, të strukturave të morfologjisë historike të shqipes, të disa etimologjive të diskutueshme dhe metodologjisë së kërkimeve të tyre etj. Ky *in memoriam* përmbyllet me njërin prej teksteve më të referuara të tij në shumë artikuj shkencor dhe publicistik: “Te Eqrem

³³ Shih botimet dhe ribotimet e këtij teksti: *Albanologut më të madh të ditëve tona* (Me rastin e vdekjes së profesor Eqrem Çabejt), Rilindja, Prishtinë, 23 gusht 1980, f. 12-13; *In memoriam - Vepra 5*, ASHAK, Prishtinë, 2002, p. 117; *Eqrem Çabej (1908-1980)*, *In memoriam*, - *Studime gjuhësore në fushë të shqipes*, III, Rilindja Prishtinë, 1985; *Kolos me kompetenca të gjithanshme shkencore*, Rilindja, 23. 8. 1980, Prishtinë, pp. 12-13.

³⁴ *In memoriam*, *Studime gjuhësore në fushë të shqipes*, III, Rilindja, Prishtinë, 1985, p. 117.

³⁵ *Veprat albanologjike të prof. Eqrem Çabejt* në Buletinin shkencor, Institutit të Lartë Pedagogjik të Shkodrës, viti II, nr. 3, pp. 97-167.

³⁶ Shih, *Encyclopedia of Language and Linguistics*, volume 2, Edition 2; Publisher Elsevier, 2006, p. 174.

Çabej kemi bjerrë patriarkun e gjuhës sonë, të lidhur ngushtë për truallin, popullin shqiptar dhe gjuhën e tij, vepra e të cilit do të mbetet e gjallë ndër ne sot si dhe në ditët që do të vijjnë³⁷.

Megjithëse Profesor Ajeti me një fjalë rasti të shkurtër e pati kujtuar Profesor Çabejn edhe me rastin e përvjetorit të tretë të vdekjes³⁸, ky përfundim i tekstit të shkruar me rastin e vdekjes së tij do të mbetet një prej artikulimeve më emblematike në gjithë krijimtarinë e tij të gjerë e të shumanshme të teksteve albanologjike.

Përfundim

E parë në kontekstin e kohës, raportet e profesor Idriz Ajetit me profesor Eqrem Çabejn, sigurisht edhe për shkaqe pozitash në jetën arsimore, shkencore e institucionale, kanë qenë raporte pak a shumë zyrtare; por të para këto raporte në kontekst të vlerësimit kolegjial e profesional ato janë raporte miqësie, nderimi e vlerësimi të lartë e të përhershëm. Nëse komunikimi i tyre personal sigurisht kushtëzohej para se gjithash edhe prej situatave politike në rajon dhe sidomos të marrëdhënieve jugosllavo-shqiptare, nderimi dhe vlerësimi i veprës shkencore ishte i përhershëm dhe i kushtëzuar prej arritjeve të dyanshmë shkencore në fushë të albanologjisë. Këtë e dëshmojnë dy përbërës themelor: vlerësimi i profesor Eqrem Çabejt për disa nga studimet e Profesor Ajetit që në vitet '60 dhe referencat e përhershme të profesor Idriz Ajetit në veprën albanologjike të Çabejt një jetë të tërë.

³⁷ Vep. e cit., p. 126

³⁸ *Dy fjalë kujtimi me rastin e përvjetorit të vdekjes së Eqrem Çabejt*, Vepra, 5, ASHAK, Prishtinë, 2002, p. 127.

Abdullah HAMITI, Prishtinë

KONTRIBUTI I IDRIZ AJETIT NË STUDIMIN E TEKSTEVE SHQIPE ME ALFABET ARAB

Abstrakt

Në këtë shkrim tonin, me rastin e 100-vjetorit të lindjes së akademik Idriz Ajetit, do të trajtojmë kontributin e tij në studimin e teksteve shqipe me alfabet arab. Siç dihet ai kishte studiuar gjuhën e veprës Vehbije të T. Boshnjakut dhe gjuhën e Divanit të Sheh Maliqit dhe kështu ai që i pari që këtyre veprave u kushtoi qasje të mirëfilltë shkencorre filologjike. Përqëndrimi ynë kryesisht ka të bëjë me problemet e transkriptimit të këtyre dy vepra nga proesor Ajeti.

Fjalët çelës: Ajeti, grafia arabe, transkriptimi, Vehbije, Divani, vokalet

Interesimi për të studiuar, hulumtuar literaturën shqipe me alfabet arab në Shqipëri fillon më herët menjëherë pas krijimit të shtetit shqiptar. Sidomos kontribuojnë revistat *Diturija*¹, *Zani i Naltë*² etj. Ndërkaq në Kosovë hulumtimi i trashëgimisë letrare shqipe me alfabet arab fillon pas viteve të pesëdhjeta të shek. 20, me ç'rast janë arritur rezultate në zbulimin dhe grumbullimin e materialit, pastaj studimin e saj dhe në identifikimin e autorëve të saj. Këto materiale, pjesa dërmuese janë të evidentuara nëpër arkiva, biblioteka e prona private. Janë bërë edhe studime gjuhësore dialektologjike³ mbi baza të disa veprave shqipe me alfabet arab. Kurse duhet

¹ Lumo Skendo, *Për shkrime të haruarë e të paditurë*, në **Diturija**, Volumi i dytë, 1 Nantor 1926, numur 1, f. 1-6; (Lumo Skendo) *Disa dorshkrime shqip me germa tyrqishte*, **Diturija**, nr. 8, Volumi i dytë, 1 Qershor, Tiranë, 1927, f. 288-299.

² *Veteranët e Klerit Musliman*, **Zani i Naltë**, viti XII, Nandor 1937, nr. 11, Shkodër, f. 329-368, etj.

³ Dr. Idriz Ajeti, “*Pamje historike e ligjërimit shqip të Gjakovës në fillim të shekullit 19*”, dhe “*Gjuha e ‘Divanit’ të Sheh Maliqit*”, në: **Studime gjuhësore në fushë të shqipes**

veçuar punën e palodhshme të hulumtuesve e studiuesve të kësaj trashëgimie, në radhë të parë të O. Myderrizit, H. Kaleshit, M. Pirrakut, M. Hysa, etj.

Se kjo literaturë e shkruar me alfabet arab nuk është trajtuar drejtë e se ka nevojë të shtrohet pa paragjykime e kanë theksuar edhe studiuesit e saj. Kështu, O. Myderrizi si studiuesi i praë profesional i alhamiados shqiptare, i cili i vuri bazat e studimit shkencor të kësaj trashëgimie letrare kulturore shqiptare të proviniençës silame, qysh në vitin 1965 e vëren qartë rëndësinë e këtyre teksteve për studime letrare e gjuhësore shkruante se "Pavarësisht nga shkronjat e nga fjalët e huaja të kulturës tekstet shqip me alfabet arab janë tekste të vjetra shqip. Pa njohur e pa studiuar mirë këto tekste as historia e letërsisë shqipe nuk mund të shkruhet, as historia e zhvillimit të gjuhës së shkruar nuk mund të kuptohet".⁴

Akademik Idriz Ajeti, gjithashtu, që në hyrje të një studimi të tij, e thekson rëndësinë e dokumenteve të shkruara për të bërë një vëzhgim të mirë rreth të folmeve në truallin e Kosovës dhe shprehet "Edhe më parë, kushdo që kishte marrë të hetonte ndonjë prej ligjërimeve të këtyre viseve, për mungesë materiali të saktë gjuhësor, pak gjë ka nxjerrë në dritë. Njohja jonë e dokumenteve të vjetra gjuhësore, rezultatet e të cilave kanë rëndësi të dorës së parë, është tepër e kufizuar".⁵

Edhe përsa i takon teksteve shqipe me grafi arabe të shkruara në Kosovë profesor Ajeti jep një njoftim të shkurtë duke e dalluar ntayrisht veprën Vehbije të Tahir Efendi Boshnjakut të cilën e karakterizon si dokumenti më i vjetër i shqipes së Kosovës i shkruar me alfabet arabo-turk, për

II, Rilindja, Prishtinë, 1985; Abdullah Hamiti, *Gjuha e veprës 'Akaidul islam' të Tahir Llukës* (punim magjistrature) i mbrojtur në Fakultetin e Filologjisë në Prishtinë, më 199 (dorëshkrim, f. 168); Mr. Abdullah Hamiti, *Veçoritë gjuhësore të fjalorëve shqipturqisht e turqisht –shqip të Hafiz Ali Ulqinakut*, (disertacion i doktoratës) i mbrojtur në Fakultetin e Filologjisë, Prishtinë, 1998 (dorëshkrim, f. 404); Abdullah Hamiti, *Mbi gjuhën e mevludit të Hafiz Ali Riza Ulqinakut*, në: **Gjurmime Albanologjike, Seria e shkencave filologjike**, nr. 28-29, Prishtinë, 2002, f. 85-98.

⁴ Osman Myderrizi, *Tekstet e vjetra shqip me alfabetin arab*, në: **Konferenca e parë e studimeve albanologjike**, Tiranë, 1965, f. 289.

⁵ Dr. Idriz Ajeti, *Pamjehistorike e ligjërimit shqip të Gajkovës në fillim të shekullit XIX, Kërkime gjuhësore*, Prishtinë, 1978, f. 37.

të përmendur pastaj Mevludin e Tahir Efendi Popovës dhe në fund edhe krijimtarinë e Sheh Maliqit nga Rahoveci. Por me rëndësi është qëndrimi i Idriz Ajetit për peshën dhe rëndësinë e këtyre dorëshkrimeve përkundër problemeve që paraqet grafia arabe për pasqyrimin e të gjithë tingujve të shqipes. Kështu, ai shprehet se “Kundrejt kësaj trashëgimie gjuhëtarët shqiptarë e të huaj, pas mendimit tonë, kanë mbajtur qëndrim, në mos përbuzës, indiferent po sigurisht. Dikur nga të dhëna asisoj të dala prej librash fetare e të shkruara prej hoxhallarësh e myderrizash të pajisur shpeshherë me kulturë të gjerë teologjike dhe me njohje të thellë të gjuhës shqipe, mund të ndriçoheshin shumë çështje të errëta në historinë e shqipes, sikur edhe mbi bazën e dokumenteve të shkruara në ndonjë prej gjuhëve indoevropiane. Është e vërtetë se një dokument gjuhësor, i shkruar me alfabetin arab, për mungesë shenjash grafike, që të pasqyrohen të gjithë tingujt e shqipes, nuk lejon të nxirren përfundime e përmbyllje të hollësishme në fushën e fonetikës si një dialekt, mirëpo as një dokument tjetër i paraqitur me alfabetin e ndonjë gjuhe të Evropës, në lidhje me shfaqje të ndryshme gjuhësore përgjithësisht, nuk do të mundet të na kënaqë kërshërinë tonë mbi këtë çështje filologjike a linguistike.”⁶

Këto konstatime të profesor Ajetit tregojnë qasjen dhe interesimin e tij për t’u marrë me studime gjuhësore duke marrë për bazë tekstet e caktuara shqipe të shkruar me grafi arabe. Ai ka bërë një studim të titulluar *Pamje historike e ligjërimit shqip të Gjakovës në fillim të shekullit XIX* mbi bazë të veprës *Vehbije* të Tahir Efendi Boshnjakut dhe studimin tjetër *Gjuha e “Divanit” të Sheh Maliqit*⁷. Ne me këtë rast do të përqëndrohemi kryesisht tek studimi i tij i parë që ka të bëjë me veprën *Vehbije* të Tahir Efendi Boshnjakut e cila është shkruar në vitin 1835, dhe ate veçanërisht në çështjet e transkriptimit, që është shumë e rëndësishme, sepse duke u mbështetur në te nxirren edhe konstatime të analizës gjuhësore.

Vehbija e Tahir Boshnjakut është e shkruar me alfabetin arab me modifikimet që i kishin bërë persët e osmanët, e kështu kishin vepruar edhe

⁶ Dr. Idriz Ajeti, *Pamjehistorike e ligjërimit shqip të Gjakovës në fillim të shekullit XIX, Kërkime gjuhësore*, Prishtinë, 1978, f. 43.

⁷ Dr. Idriz Ajeti, *Kërkime gjuhësore*, Rilindja, Prishtinë, 1978. Këta punime janë botuar edhe në botimet tjera të professor Ajetit,

krijuesit tjerë të fazës së hershme të kësaj pjese të letërsisë shqipe. Ndërsa krijuesit e mëvonshëm të çerekut të fundit të shekullit 19 dhe të fillimit të shekullit 20, pra në kohën e Rilindjes kombëtare, kur aktualizohet mirë çështja e alfabetit, të cilët shkruajnë edhe abetare shqipe me alfabet arab, janë më të vetëdijshëm për problemet që paraqet për mbulimin e tingujve të gjuhës shqipe, veçmas për sistemin vokalik mjaft të zhvilluar të gjuhës shqipe u munduan të bëjnë modifikime duke u shtuar germave arabe shenja diakritike për t'ia përshtatur sistemit tingullor të shqipes siç vepruan H. Ali Ulqinaku, Tahir Lluca, Rexhep Voka e ndonjë tjetër⁸

Duke qenë se transkriptimi i këtyre dy veprave nga Idriz Ajeti është bërë shumë herët, atëhere kur po fillonte hulumtimi dhe studimi i teksteve shqipe me grafi arabe dhe, deri tash është punuar pandërpre në këtë drejtim dhe është krijuar një përvojë dhe traditë më e madhe, e kemi më lehtë edhe të bëjmë ndonjë vërejtje eventuale rreth leximit sepse janë punuar tekste të shumë autorëve dhe janë bërë analiza të shumta rreth grafisë. Prandaj në këtë kontekst kemi marrë guximin të shprehim dyshimet për disa çështje rreth transkriptimit në këto studime të I. Ajetit.

Profesor Ajeti fillimisht e vëren mirë gabimin në transliterimin e Vehbijes të vitit 1907 që u botua në Sofje kur konstaton se dy okluzivet palatale *q* dhe *gj* ishin afrikatizuar në *ç* e *xh*, ndonëse siç mund të shihet nga teksti origjinal autori ka përdorur grafema të veçanta për këto katër tinguj e këtë e ka konstatuar edhe prof Ajeti.⁹

Pastaj ai shtron problemin e paraqitjes së sistemit të zanoreve të shqipes me alfabetin arab për faktin se sistemi vokalik i arabishtes është tepër i varfër për të mbuluar tingujt vokalik të shqipes. Megjithate, Ajeti përsa i përket sistemit të zanoreve në gjuhën e tekstit që e studion duke ilustruar me shembuj të bollshëm nga teksti ia del të konstatoj se teksti të cilin e studion njeh tri shkallë gjatësish të vokaleve të theksuara: shkurtësinë, gjatësinë e ndërmjetme dhe gjatësinë e plotë të vokaleve, por duke

⁸ Abdullah Hamiti, *Vështirësitë e leximit të teksteve shqipe me grafi arabe*, në: **Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare**, 19, Prishtinë, 2001, f. 143-157;

⁹ I. Ajeti, *Pamjehistorike e ligjërimit shqip të Gajkovës në fillim të shekullit XIX, Kërkime gjuhësore*, Prishtinë, 1978;

vërejtur “ndonëse nga teksti që kemi në duar, për mungesë shenjash grafike të alfabetit me të cilin ishte shkruar dorëshkrimi, ka qenë vështirë të veçohet kuantiteti i zanoreve të theksuara”.¹⁰

Te autorët shqiptarë që krijuan me alfabet arab, normalisht jo te të gjithë, problem më vete është edhe riprodhimi i zanoreve të gjata të gjuhës shqipe. Ka autorë që ato i kanë dalluar grafikisht siç kishin vepruar H. Ali Ulqinaku, Tahir Lluca e R. Voka të cilët zanoret e gjata i dallojnë qartë me shenjë të veçantë diakritike med (˘)¹¹ e cila në gjuhën arabe jep a-në e gjatë, por ka edhe të atillë që nuk i kanë dalluar grafikisht e të këtillë ishin edhe Tahir Boshnjaku edhe Sheh Maliqi.

Në mbështetje të teksteve origjinale, sa i përket gjatësisë së zanoreve, te Vehbije e T. Boshnjaku dhe te Divani i Sh. Maliqit do të themi si vijon: Tahir Boshnjaku në Vehbijen e tij nuk i dallonte grafikisht zanoret e theksuara të gjata, ndërsa profesor Ajeti kur flet për praninë e zanoreve të gjata në atë tekst¹² mbështetët pjesërisht në grafinë e pjesërisht në orientimin global që ka bazë njohjen e mirë të të folmeve të shqipes përgjithësisht, e të folmeve të gegërishtes posaçërisht. Kurse Sheh Maliqi, siç konstaton I. Ajeti, kishte shprehë grafikisht zanoret e gjata duke futur në përdorim shenjat kompensatore të alfabetit arab që shërbejnë për të shprehur kuantitetin e vokaleve, si (َ) për a-në e gjatë, vavi (و) për u-në e gjatë dhe je (ی) për i-në e gjatë.¹³ si: اودhtar: صوندمتار sundimtar. Por të shtojmë se, si shumë autorë shqiptarë që kanë shkruar shqip me grafi arabe, edhe Sheh Maliqi këto kombinime, në radhë të parë, i ka përdorur për shënimin e zanoreve të shkurta.

Në këtë studim të prof. Ajetit tërheq vëmendjen konstatimi i ekzistimit të nazalitetit në të folmen e Gjakovës në një fazë të hershme, për

¹⁰ I. Ajeti, *Pamjehistorike e ligjërimit shqip të Gjakovës në fillim të shekullit XIX, Kërkime gjuhësore*, Prishtinë, 1978, f. 51.

¹¹ Abdullah Hamiti, *Vështirësitë e leximit të teksteve shqipe me grafi arabe*, në: **Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare**, 19, Prishtinë, 2001, f. 143-157;

¹² Dr. I. Ajeti, *Pamje historike ...*, në: *Studime gjuhësore në fushë të shqipes*, Prishtinë, 1985, f.172.

¹³ Dr. I. Ajeti, *Gjuha e “Divanit” të Sheh Maliqit*, në: *Studime gjuhësore në fushë të shqipes*, Prishtinë, 1985, f.222.

faktin se siç shprehet ai “njëherë sepse grafia e tekstit nuk lejonte të formonim kurrfar bindjeje mbi praninë e vokaleve hundore të këtij ligjërimi. Shenjë grafike për të paraqitur hundorësinë në këtë vepër autori nuk kishte rezervuar. Grafema e rezervuar për të paraqitur vokalet o, u, y, i shërbente autorit edhe për â hundore.¹⁴ Dhe vazhdon shpjegimin duke thënë: “Vendosëm të lexojmë â e jo o sa herë që ndeshëm në shenjën grafike و (elif-vav), duke u mbështetur edhe në një rrethanë tjetër kur në tekstin tonë nuk hasëm kund në ndonjë rast të velarizimit të a-së, që do të thotë në këmbimin e fonemës a me gjatësi të madhe në fonemën o.¹⁵ Kjo do të thotë se ai për ta riprodhuar a-në nazale nga kjo shenjë grafike arabe më tepër është mbështetur në njohurinë e tij të mirë të zhvillimit historik të sistemit vokalik të shqipes. Prandaj, siç vëren edhe H. Agani: “Ne në transkriptimin që i bëri Ajeti vetë Vehbijes â-në nazale e shenoi rregullisht si të tillë, jo të labializuar.¹⁶ Ndërkaq në transkriptimin që u bëri Kaleshi disa fragmenteve të shkurtëra të Vehbijes, në të cilat mbështetet edhe Agani, lexojmë: Niri shka i bon veti, nuk i bon qetri; po i bje komët me ja gjeshë; hor bohet ja kaur; Niri shka e çon me veti osht i veti etj.”¹⁷ Por, të dy këta studiues theksojnë vështirësitë objektive për një transkriptim preciz, të tekstit me alfabet arab, kurse prof. Ajeti shkruan: “Ta themi të saktë në qoftëse jemi pajtuar që shenjën grafike të alfabetit arabo-turk ta lexojmë si a hundore dhe si o gojore atëherë në shumë raste do të detyrohemi që grafemën vav ta riprodhojmë, herë a hundore, herë o orale”.¹⁸

Sikundër shohim edhe Tahir Boshnjaku edhe Sheh Maliqi me anë të vavit (و) kanë shprehur o,u,y dhe â. Prandaj, kur kihen parasysh këto mundësi të leximit të vavit në tri a katër mënyra, me të drejtë Prof. Ajeti thotë: “Mjafton të themi që shenja grafike vav (و) e alfabetit arab përdorej për të shprehur këto zanore të shqipes: a,o,u,y si dhe â - në hundore për të

¹⁴ I. Ajeti, *Pamjehistorike e ligjëritimit shqip të Gajkovës në fillim të shekullit XIX, Kërkime gjuhësore*, Prishtinë, 1978, f. 60.

¹⁵ I. Ajeti, *Pamjehistorike e ligjëritimit shqip të Gajkovës në fillim të shekullit XIX, Kërkime gjuhësore*, Prishtinë, 1978, f.62.

¹⁶ Dr. Hilmi Agani, *Fjalori i Lubomir Kujunxhiçit*, Prishtinë, 1981, f. 69.

¹⁷ Hasan Kaleshi, *Prilog poznavanja arbanaške knjizevnosti iz vremena preporoda*, “Godišnjak I Balkanološkog Instituta”, Knjiga 1, Sarajevo, 1957.

¹⁸ I. Ajeti, *Mbi gjuhën e “Divanit” ...*, *Kërkime gjuhësore*, Prishtinë, 1978, f. 123.

parë se me sa kujdes do të veprohet kur merret të transkriptohej një tekst shqip i shkruar me alfabetin arabo - turk”.¹⁹

Këtu më duhet të theksoj se ekziston një mospërputhje mes Ajetit dhe Aganit sa i përket tekstit origjinal të Sheh Maliqit. Shembujt e paktë që i sjell Prof. Ajeti janë të pavokalizuar (është fjala për ato shenja diakritike që në arabishten nuk shënohen, por kur shënohen velen mbi ose nën konsonanten gjegjëse) si: د هت وهتن مه لون duhet vehten me lân; بو هت bâhet, حيلنا ز مر ن çilna zemrën etj. Kurse të Agani i gjejmë të vokalizuar: دريتا نيا drita një, ماسى قا با masi ka bâ, مهُو نَعْرُ me honger; ني نى suret o; يِلْ ا حُونْ dill e hon etj., e kështu të vokalizuar i gjejmë në tërë tekstin e Vehbijes dhe të Divanit.

Nga këta pak shembuj që i sollëm nga studimet e Ajetit e Aganit shihet se të dy tekstin e Sheh maliqit e lexojnë ndryshe. Ajeti konsonantin e pasuar me vav, si: بو هت e lexon bâhet, ndërsa Agani në raste të tilla lexon: مهُو نَعْرُ me honger. Ai shpjegon se “në të gjitha rastet në të cilat a-në e dikurshme nazale Maliqi e shënoi me vav dhe me damma vokalin e shënuar në e lexuam o (ô) kurse shënimin alternativ e kuptuam si shkallë labializimi të a-së nazale”.²⁰ Unë mendoj se Agani është përcaktuar ta lexojë drejtë, sepse vështirë është të pranohet që ky kombinim grafik arab të jap mundësinë e leximit me â, pos me o. Për ta lexuar me a në arabishte përdoret elifi (ا), siç ka vepruar edhe Sheh Maliqi: دريتا نيا drita një, ماسى قا masi kâ bâ.

Ne pa dashur që ta zgjasim më shumë themi se mbase këtu mund të ketë raste që do të na detyronin të mendojmë se me grafemën و vav disa raste kanë mundur të lexohen me o e jo me a. Kjo grafemë me funksionin ndihmës për zanore në osmanishte jep o, ö, u, ü por jo as a-në nazale as a-në e gjatë. Kështu në bejtin vijues:

Shtatdhjet her zjarmi i xhehnemit biro,

A'sht ma i nxet se zjarmi i dynjas â.²¹

¹⁹ Dr. I Ajeti, *Gjuha e "Divanit" të Sheh Maliqit*, Studime gjuhësore në fushë të shqipes, II, Prishtinë, 1985, f.219.

²⁰ Dr. Hilmi Agani, *Fjalori i Lubomir Kujunxhiçit*, Rilindja, Prishtinë, 1981, f.72.

²¹ Dr. Idriz Ajeti, *Kërkime gjuhësore*, Rilindja, Prishtinë, 1978, f. 97.

Mendojmë se këtu vargu i dytë do të përfundoj me o e jo me â, sepse këta dy vargje duhet të përfundojnë me rimë të njëjtë. Kjo poemë didaktike e T. Boshnjakut është shkruar në formën poetike Mesnevi ku çdo bejt ka rimë më vete.

Ose bejti tjetër:

Ma me hata: kush s'a: / se ai qi vehten e dō.²²

Edhe këtu rima e kërkon që edhe vargu i parë të lexohet s'o, siç përfundon vargu i dytë me e dō. Sepse grafia e jep këtë mundësi pasi dy vargjet përfundojnë me grafemën vav.

Edhe përsa i përket nyjes, profesor Ajeti thotë se teksti që e studion ai nuk jep kurrfar shkasi për ta hetuar këtë çështje. Prandaj shkruan “Në lidhje me atë kategori emrash që mbarojnë me velaret *k*, *g*, ne nuk kemi mundur t'i binim në fije nyjes së prapavendosur, a duhet të lexohet *-i* apo *-u*. E nuk kemi mundur t'i binim në të sepse fjalët e tekstit të shkruar me alfabetin arabo-turk, nuk janë vokalizuar qysh praktikohet zakonisht, prandaj, ta zëmë fjalën *horllëk* nuk dinim si ta lexonim: *horllëkin* apo *horllëkun*; *hallkit* apo *hallkut*; *xhahilleki* apo *xhailleku*.”²³ Por ne duke e verifikuar tekstin në origjinal, mbështetur në disa shembuj që gjetëm, mendojmë se ajo nyje duhet lexuar *-i* për faktin se përfundi bashkëtingëllores *k* kemi shenjë diakritike kesra e cila siç dihet në arabishte shenon vokalin e shkurtër *i*, ndërsa në osmanishte vokalin *i* dhe *ë* e këtë vlerë e ka pas edhe në shqipe. Kështu në transkriptimin e Ajetit lexojmë: Hallku lakmi per me pas (f. 98), duhet Hallki خالقى; Hak(i, u?) i hajvanit (f. 100), duhet Haki حاق; Duhet ti ūnek(i, u)n ... (f. 99) duhet lexuar: yrnekin أورناڤن; Emni ūt e petk(i, u?) ūt nuk bân dobî (f. 99) – petki yt پاتق dhe te shembulli: La dekën belqi horllekun (96) ne e lexojmë: Le dekën belqi horllukinë حورلوقنة sepse në fund pas germës *n* ka një *he* që në fund të fjalës duhet lexuar *ë*. Gjithashut te faqe 97, 99 e gjejmë të lexuar dy herë hallkut. Këtu fjala hallkut mendoj se duhet lexuar hallkit - خلقت sepse grafia jep këtë variantë leximi meqë mbas kafit nuk kemi vav për ta lexuar hallkut, por përfundi kafit kemi kesran që lexohet *i*.

²² Dr. Idriz Ajeti, Kërkime gjuhësore, Rilindja, Prishtinë, 1978, f. 99.

²³ I. Ajeti, Pamjehistorike e ligjërimit shqip të Gajkovës në fillim të shekullit XIX, Kërkime gjuhësore, Prishtinë, 1978, f. 79.

Gjithashtu edhe te leximi i disa fjalëve arabe që mbarojnë me bashkëtingëlloren *b* kemi luhatje në lexim. Më shumë lexohen me *b* e rrallë edhe me *p*. Do theksuar se në osmanishte fjalët arabe janë shkruar me formën e tyre siç shkruhen në arabishte por, ato në osmanishte lexohen të përshtatura sipas sistemit tingullor të turqishtes dhe, ato fjalë arabe që mbarojnë me *b* në osmanishte shkruhen me *b* por lexohen me *p*, sepse bashkëtingëllorja *b* në gjuhën turke mund të gjendet në pozicion në fillim të fjalës dhe në pozicion në mes të fjalës, por jo edhe në pozicion fundor.²⁴ Dhe sigurisht që edhe në shqipe kanë depërtuar si turqizma pra, edhe pse shkruhen me *b* lexohen me *p*. Kështu në faqe 99 kemi bejtin:

Kshtu batil shum fja:l kan pa hesab

Gjithcili kan për batil t'vet xhev:p.

Të dy këto fjalë në fund të vargjeve janë shkruar me *b*, andaj nuk ka arsye që njëra të lexohet me *b* e tjetra me *p*, sepse në këtë rast do të prishej edhe rima. Po ashtu këto fjalë edhe në raste tjera i gjejmë të lexuara hesa:b dhe xheva:b, e që edhe pse të dyja janë shkruar me *b*, konsideroj për arsyen që e dhamë sipër, duhen lexuar me *p*. Sikundër që edhe fjalët garib (96), sevab (104), qitab (106) duhen lexuar garip, sevap, qitap edhe pse në fund të fjalës janë shkruar me grafemën *b*.

Gjithashtu, për habi, nuk dimë pse, Ajeti lidhur me bashkëtingëlloret *dh* e *th* shprehet se autori i Divanit nuk kishte rezervuar shenja të veçanta grafike për t'i shprehur ato.²⁵

Na duhet të theksojmë se alfabeti arabi ka këto dy bashkëtingëllore dhe autori idivanit i ka përdorur ato ku kishte nevojë. Pra autori i divanit nuk kishte nevojë të rezervonte shenja të veçanta grafike, duke qenë se bashkëtingëllorja *د* (*dh*) e *ث* (*th*) të arabishtes janë ekuivalente dhe përputhen fonetikisht me *dh*-në dhe *th*-në e shqipes.

Përkundër adaptimeve e modifikimeve që kanë bërë apo nuk i kanë bërë grafisë arabe shkrimtarët shqiptarë, studiuesit e këtyre veprave duhet maksimalisht të jenë të kujdesshëm gjatë transkriptimit të veprave shqipe

²⁴ M. Ergin, **Türk Dil Bilgisi**, (7 baski), Istanbul, 1982, s. 62

²⁵ I. Ajeti, *Mbi gjuhën e "Divanit" të Sheh Maliqit*, **Kërkime gjuhësore**, Prishtinë, 1978, f. 134 – 135.

të shkruara me alfabet arab si dhe të kenë përkatitje të duhur filologjike dhe krahas gjuhës e alfabetit arab t'i njohin edhe gjuhën e vjetër turke dhe ate persiane dhe modifikimet që këta për nevoja të tyre i kanë bërë grafisë arabe.

Kështu, përderisa marrim guxim të themi se disa nga këta krijues nuk u munduan sa duhet të bëjnë modifikime e adaptime në alfabetin arab për sistemin fone(ma)tik të shqipes, ose që nuk mundën, po ashtu duhet të themi se disa nga studiuesit tanë të kësaj krijimtari nuk ishin aq sa duhet të kujdesshëm në transkriptimin e kësaj pasurie tonë kulturore, letrare e sidomos gjuhësore – dialektologjike.

Duke e përfunduar, po shtojmë se vërejtje mund t'i bëhen edhe Ajetit, Aganit e Kaleshit sa i përket transkriptimit të veprës “ Emni Vehbije” të Tahir Boshnjakut e ” Divanit ” të Sheh Maliqit, por nuk po e zgjasim dhe po mjaftohemi me konstatimin se mjafton të thuhet se që të tre këta studiues i bëjnë vërejtje njëri tjetrit, për transkriptim jokorrekt.

Dhe në fund do të themi: Mesa pamë qëndrimi i akademik Idriz Ajetit për peshën dhe rëndësinë e këtyre dorëshkrimeve, përkundër problemeve që paraqet grafia arabe për pasqyrimin e të gjithë tingujve të shqipes, ishte shumë konstruktiv. Ai me njohuritë e tij të thella të gjuhës shqipe në njërën anë dhe, me njohuritë e tij mbi alfabetin arab në anën tjetër, duke e marrë për bazë tekstin e Vehbijes së Tahir Boshnjakut mundohet të ndriçojë shumë çështje të errëta në historinë e shqipes. Gjithashtu i heton mirë vështirësitë që paraqet grafia arabe që të pasqyrohen të gjithë tingujt e shqipes, por ndonëse dikund me dilema, ai ia del të nxjerr përfundime të hollësishme në fushën e fonetikës, por edhe në lidhje me çështje të ndryshme gjuhësore përgjithësisht.

Naser PAJAZITI, Prishtinë

PROFESOR IDRIZ AJETI PËR GJUHËN E “DIVANIT TË SHEH MALIQIT¹

Sheh Maliqi, me prejardhje nga katundet Anadrinit, si hoxhë e myfti kishte shërbyer në Rahovec në vitet tetëdhjeta të shekullit XIX. Gjatë shërbimit të tij dyzetvjeçar la një varg veprash origjinale dhe të përkthyer me përmbajtje fetare, të shkruara me alfabetin arabo-turk, ndër të cilat edhe një Divan me 77 këngë, ku paraqitet gjendja gjuhësore e periudhës së shekullit XIX në trevën e Anadrinit.

Meqenëse shkrimet shqipe të botuara në Kosovë në shekujt e kaluar ishin të pakta, ose thënë shkurt mund të numëroheshin në gishta dhe duke parë rëndësinë që kanë këto shkrime për historinë e gjuhës dhe për dialektologjinë shqiptare, profesor Idriz Ajeti bëri një studim për gjuhën e Divanit të Sheh Maliqit, në të cilin janë trajtuar një varg tiparesh gjuhësore që e karakterizojnë këtë shkrim, duke i vënë në spikamë kryesisht veçoritë fonetike dhe morfologjike të veprës në fjalë.

Kështu, bie fjala, në fushën e fonetikës dallohen zanoret hundore. Sikundër dihet, alfabeti arabo-turk nuk i ka të gjitha zanoret që i ka gjuha shqipe, hetimi i hundorësisë në këtë të folme paraqiste vështirësi. Megjithatë, profesor Idriz Ajeti ka vërejtur se në Divanin e Sheh Maliqit janë ruajtur mjaft mirë zanoret hundore dhe se gjuha e Divanit është e pasur me vokale nazale. P.sh

¹ Hilmi Maliqi i nohur si Sheh Maliqi nga Rethi i Rahovecit në vitet tetëdhjetë të shekullit të kaluar la një varg veprash origjinale në shqip të shkruara me alfabetin arabo-turk 16 tregime: *Mularri i zemrës*, *Sofra e Aliut*, *Kopshti dashnisë*, *Loçka e zemrës* me përmbajtje fetare. “Divani” i Sheh Maliqit ka 77 këngë.

*kush t'i gjan,
duhet vehten me lan, tuj than,
me ngran,
e kan banun² etj.*

Kjo vlen për zanoren hundore **a**, ndërsa sa u përket zanoreve të tjera, sipas Ajetit, autori nuk kishte përdorur shenjë të veçantë grafike, ndërsa për ta shprehur kuantitetin e vokaleve Sheh Maliqi kishte përdorur tinguj kompensatorë me anë të të cilëve pasqyrohej kuantiteti i vokaleve.

Duke u mbështetur në gjendjen fonetike të diftongjeve të Divanit të Sheh Maliqit është i drejtë konstatimi prof. Idriz Ajetit se diftongjet nuk na dalin arkaike, ashtu sikundër ngjet me dukuritë e tjera gjuhësore, sepse diftongjet dhe grupet e zanoreve i gjejmë të mbledhura në monoftongje: p.sh *me punu, me msu, me shku, me knu, me fitu, tokë e qill* etj

Vlen të theksohet sidomos ruajtja e grupeve konsonantike **nd**, **mb** të plota në gjuhën e Tivanit të Sheh Maliqit, si p.sh.: *ndihmoj, sundon, mundet, gjindet, tandin, menden, mbet, mbajt* etj.: grupe të cilat sot nuk i hasim në trevën e Anadrinit³, por as në shumicën e të folmeve të Kosovës (grupi **nd** ruhet në të folmen e Opojës). Po kështu, është ruajtur mjaft mirë edhe grupi **ng**: *ngrohet, ngraon* etj.

Një dukuri tjetër gjuhësore që ndeshet në Divanin e Sheh Maliqit dhe e cila si tillë ka zgjuar kureshtjen e profesor Idriz Ajetit është, pa dyshim, edhe ruajtja e okluziveve palatale **q** dhe **gj**, për të cilën dukuri thekson: “Edhe vetë nuk kujtonim se në ndonjë prej të të folmeve tona në Kosovës nga fundi i shekullit të kaluar (është fjala për shekullin XIX) dhe në fillim të këtij tonit (është fjala për shekullin XX) dalloheshin tipat e okluzive palatale **q-ç, gj-xh**” Për shembull: *Gjith prej qille, shoq, zemra digjet, gjimon* etj. Ndërsa, në bazë të hulumtimeve tona në terren, në asnjë rast, nuk kemi vërejtur që në trevën e Anadrinit të ruhen këto bashkëtingëllore, madje as që kemi gjurmë sado të vogla të ruajtjes së tyre. Mirëpo, me të drejtë thekson Idriz Ajeti, se këto grupe nuk janë ruajtur as edhe në të folmet e tjera të Kosovës, nga të cilat bëjnë përjashtime të

² Idriz Ajeti, *Gjuha e “Diavnit” të Sheh Maliqit, Vepra 2, Prishtinë, 1998, f.*

³ Naser Pajaziti, *Grupet bashkëtingëllore në të folmen e Anadrinisë, Studime 5,6,7, Prishtinë, 2001, f. 382-383*

folmet skajore të Kosovës, si, bie fjala, në të folmen e Preshevës e të Bujanovcit me rrethinë, në të folmen Tetovës, në të folmen e Gostivarit⁴.

Në fushën e bashkëtingëlloreve nuk duhet lënë pa përmendur edhe ruajtjen e spirantit **h**, e cila, sipas Ajetit, në gjuhën e Divanit del mjaft e qëndrueshme, si p. sh. te fjalët *shohim, bahet, çohet, shahadet, Allahi, vehten*.

Karakteristikë tjetër në gjuhën e Divanit është edhe mospërdorimi i shenjave dalluese për dy tipat e sonanteve **l, ll** dhe **r, rr**, p.sh.:

alemi prej vori çohet
N'ahret mos t'qorohet
me kalx,
aty gjendet sultani etj.
Tokë e qil
*Me sy t'balit*⁵

Sipas mendimit tonë nuk ka dyshim se edhe në kohën kur është shkruar Divani i Sheh Maliqit në të folmen e Anadrinit mjaft qartë janë diferencuar këto çifte bashkëtingëlloresh. Ndërsa, kur është fjala për mospërdorimin e tyre në Divanin e Sheh Maliqit, konstatojmë arsyet mund të jenë të ndryshme.

Aspektit morfologjik i kushtohet më pak hapësirë në studimin për Divanin e Sheh Maliqit.

Në fushën e morfologjisë do të veçonim:

Tek emrat e gjinisë mashkullore që mbarojnë me bashkëtingëllore grykore **k** dhe **g** herë del mbaresa nominale **i** herë **u** p.sh.: *hallki, ashiku, rahatllakun, madnillakun, çarki* etj., po kështu ngjet edhe me disa emra që mbarojnë me fërkimoren **h**.

Përemrat pronorë **i jem e jemi** që përdoren sot në trevën Anadrinit me nyjën e përparme **i** dhe **e** në gjuhën e Divanit të Sheh Maliqit përdoren pa nyjën e përparme, e cila sipas profesor Idriz Ajetit është trajtë e kryehershme, arkaike p.sh. *shtati em, ahti yt*.

⁴ Ajeti, *vep. cit.*, 72

⁵ Ajeti, *vep. cit.*, f. 74

Një kategori foljesh në vetën e parë të së tashmes së dëftores në Divanin e Sheh Maliqit del me mbaresën *i*: *lypi, çeli, fali, shkelietj*. Po me këtë mbaresë këto folje i hasim edhe sot në të folmen e Anadrinit dhe në ato të rrethinës së Prizrenit. Në shqipen e sotme standarde këto folje në këtë vetë dalin me mbarsë zero⁶.

Në gjuhën e Divanit forma e participit del me **un** p.sh. *falun, dalun, amun, pasun, ranun, dalldisun, hapun* etj.

Në vargun e tipareve dalluese, sipas Ajetit, në Divanin e Sheh Maliqit është pa dyshim edhe përdorimi alternativ i foljeve ndihmëse **kam dhe jam**, kur zgjedhohen si folje jokolimtare p.sh.:

ku jem kan, erdhem apet;

me kan me dal;

*ku jem kan*⁷ etj

Një dukuri tjetër, që mjaft mirë është hetuar nga profesor Idriz Ajeti, e që haset edhe sot në trevën e Anadrinit, por edhe në rrethinën e Prizrenit, është zëvendësimi i së tashmes së dëftores me format e lidhore p.sh.:

Gjith ça shohish;

*n'ter jesish, pa dritë*⁸; etj.

Studimi për gjuhën e Divanit të Sheh Maliqit është hartuar me një akribi të rreptë shkencore, dukuritë gjuhësore janë shpjeguar me një gjuhë të qartë dhe janë shprehur me mendime të rrjedhshme. Ashtu si edhe studimet e tjera, të punuara nga dora e profesor Ajetit, edhe studimin për gjuhën e Sheh Maliqit e dallon thellësia e mendimit dhe qartësia e kuptimit, ndërsa fenomenet gjuhësore autori nuk i sheh të shkëputura, por në lidhje, ndaj shpeshherë edhe i krahason me të folmet e tjera të shqipes dhe, në mënyrë të veçantë, u referohet shkrimeve të vjetra të shqipes.

Për fund mund të themi se studimi për Divanin e Sheh Maliqit përbën një kontribut me vlerë të lartë shkencore dhe, si i tillë, ka rëndësi të dorës së parë, jo vetëm për zhvillimin historik të të folmeve të Kosovës dhe për dialektologjinë shqiptare, por edhe për mbarë historinë e gjuhës shqipe.

⁶ Shih Grup autorësh, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë 2006

⁷ Ajeti, *vep. cit* f 93

⁸ Ajeti, *vep. cit.* f. 92

Fridrik DULAJ, Gjakovë

NDIHMESA E IDRIZ AJETIT RRETH TË FOLMES SË RAHOVECIT SIPAS DESHIFRIMIT TË DIVANIT TË SHEH MALIQIT

Kontributi i prof. Idriz Ajetit në shkencat albanologjike krah për krah me kontributin e E. Çabejt e Sh. Demiraj që është çmuar nga studiuesit që janë marrë me studimin e veprave të tyre është mendim i qëndrueshëm. Në këtë kumtesë unë kam zgjedhur të flas për ndihmesën e prof. Idriz Ajetit në fushën e dialektologjisë. Në mesin e punimeve të shumta në fushë të shqipes të prof. Ajetit, është edhe studimi i tij “Mbi gjuhën e Divanit” të Sheh Maliqit. Kjo vepër paraqet dokumentin më të plotë të shqipes së shkruar në Rahovec e rrethinë. Sheh Maliqi duhet ta ketë shkruar Divanin, përafërsisht, në fillim të shek. XX. Ky mendim gjen mbështetje në këngën e katërt të Divanit, në të cilën autori ndër të tjera shkruan: *erdh kolera Serbija, naj hoq hakku shejtnia*. Kjo dëshmon se kënga (apo Ilahia siç dëgjohet sot nga ata që këndojnë Divanin) është shkruar, ose është marrë në dorë, pas pushtimit të Kosovës nga Serbia në vitet 1912/13.

Sheh Hilmi Maliqi (1865-1928), ka kryer dymbëdhjetë vjet shkollim në medresenë e Prizrenit. Ai ka njohur turqishten, arabishten, persishten dhe boshnjakishten. Është marrë me shkrime. Ka lënë në dorëshkrim Divanin, i cili ka gjithsej 77 këngë në gjuhën shqipe, gjashtë këngë janë në gjuhën turke, ndërsa prej tyre dy këngë - në gjuhën boshnjake. Sheh Maliqi ka bërë edhe përkthime nga gjuhët orientale. Ka lënë në dorëshkrim edhe Elifin (alfabetaren), e cila i ka 29 shkronja, Risalet, që përbëhet prej 16 tregimesh me përmbajtje historike¹.

¹ Jahja Hondozi, *Trajtimi filozofik i Divanit të Sheh Hilmi Maliqit* (punim i masterit), Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë 2010.

Idriz Ajeti, me të drejtë veprën “Divani” të Sheh Maliqit e rendit në frymën e veprave të shkrimtarëve bejtexhinj dhe rrënjët e saj, sipas tij, duhen kërkuar në ideologjinë e kulturën e pushtetit oriental².

Që në fillim të studimit të tij mbi gjuhën e Divanit, Ajeti flet për vështirësitë e shumta që i shfaqen gjatë deshifrimit të gjuhës së Divanit, për shkak të varfërisë së sistemit vokal që ka arabishtja³. Konstatimi i tij se Sheh Maliqi kishte përdorur shenja grafike, siç ishte و (vav) e alfabetit arab për të shënuar zanoret: a, o, u, y, grafemë kjo që i nxori punë studiuesit të zellshëm, i cili ishte i vendosur që punën e nisur do ta çonte deri në fund. Kjo shenjë, و (vav), i ka shkaktuar autorit të studimit mjaft shumë vështirësi në pasqyrimin e zanores hundore â të gegërishtes në të folmen e Rahovecit dhe fshatrave rreth tij. Më tej prof. I. Ajeti konkludon se gjuha e “Divanit” ishte e pajisur edhe me vokalin nazal, prandaj ne e kemi riprodhuar atë duke u mbështetur edhe në grafemat, sa herë që hundorësia përsëritej historikisht⁴.

Dilemat e ngritura nga Ajeti për sistemin vokal të shqipes së Rahovecit, duke iu referuar gjuhës së Divanit të Sheh Maliqit më kanë shtyrë që edhe unë të merrem me këtë problematikë tejte të ndërlikuar. Me qëllim të studimit të hollësishëm e të plotë të të folmes së Rahovecit me rrethinë dhe veçanërisht për ta parë sistemi e vokaleve në aspektin diakronik të zhvillimit e të evoluimit që ka pasur, kemi marrë në shqyrtim Divanin. Për të ndriçuar sa më shumë këtë çështje, kemi konsultuar edhe njohës të alfabetit arab, të cilët kanë saktësuar apo vërtetuar konstatimet e prof. Idriz Ajetit se Sheh Maliqi i ka shkruar zanoret e gjata me grafemat të cilat shprehin dyfishim në alfabetin arab, siç është **elif** dhe **vav** si p.sh: *zjarmi*., *na:li*, *flu:tren*, *mera:k*, *bo:n*, *dri:ta*, *Kadri*., *Selami*., etj., “*tash nuk di: se çka: u ba:*”, “*me ashk tandi:n,neje (neve) zemran me na zdri:t*”, “*me ashk t’zemres me ndigu:e*” etj. Po ashtu studiuesi i ri, Jahja Hondozi, nga Rahoveci, i cili i bëri një trajtim filozofik kësaj vepre, po jo dhe gjuhësor, dëshmon se në Divanin e Sheh Maliqit është ruajtur gjatësia e zanoreve, prandaj thotë: “gja-

² Idriz Ajeti, Studime gjuhësore në fushëtë shqipes, Rilindja, Prishtinë 1985, f. 217.

³ I. Ajeti, vep. cit. f. 218.

⁴ I. Ajeti, vep. cit. f. 219.

tësinë e zanoreve, Sheh Maliqi e ka shprehur me shenjat grafike të alfabetit arab: zanoren e gjatë **a** me ' (elif), i-në me **ﺀ** (j) dhe u-në me **ﻭ** (vav)⁵.

Duke u bazuar në ndihmesën që ka dhënë profesor Ajeti dhe bashkëpunëtorët tanë (Jahja Hondozi e Kadri Durguti), në deshifrimin e shkronjave të Divanit, mendojmë se gjatësia e zanorëve të Divanit lidhet, apo ngjason, shumë me zanoret e gjata që dëgjohen sot në Rahovec dhe Krushës të Madhe. Kjo na jep të drejtë të mendojmë se kjo dukuri e zgjatimit të zanoreve ishte e gjithë trevës së Rahovecit, e cila më vonë ka ndryshuar në arealin e Ratkocit, por jo edhe në Rahovec dhe Krushë të Madhe në të cilën dëgjohen të gjata edhe sot e kësaj dite. Për ta krijuar përshtypjen e sistemit të zanorëve në të folmen e Rahovecit po i referohemi hartave 1.a, 1.b, 1.c, 1.ç, 1.d, 1.dh, të ADGJSH⁶, në të cilët është pasqyruar gjatësia e zanoreve dhe kundërvënia e tyre në fjalët: *plāk-pla:k* dhe *plakë*, *vësh* dhe *ve:sh*, *dīt* dhe *di:të*, *byk* dhe *by:k*, *py:k* dhe *pykë*, *lūg* dhe *lu:g*. Për të gjitha këto fjalë të dhënat e ADGJSH për pikën 35. na japin kundërvënien e zanorëve të gjata dhe të shkurta. Por nga ajo që ne kemi hulumtuar në terren mund të themi se pika 35 e ADGJSH mund të mbulojë vetëm arealin e Rahovecit dhe të Ratkocit në të cilat kundërvënia ekziston⁷. Ndërsa në arealin Krushës e Madhe nuk ka kundërvënie të zanoreve, në këtë areal fjalë dëgjohen me hipërgjatësi, si p.sh: *pla::k*, *ve::sh*, *di::t*, *by::k*, *py:k*, *lu::g*⁸.

Sa i përket diftongjeve, prof. Idriz Ajeti thekson se diftongjet dhe bashkëlidhjet e zanoreve të gjuhës së "Divanit" i gjejmë të mbledhura në monoftongje p.sh: *me na pshtu*, *qysh me shku*, *me punu: etj*. Ç'është e drejta, në gjithë tekstin e Divanit gjetëm vetëm disa shembuj në të cilët ruhet ende diftongu **ue** i paredaktuar, si p.sh.: *digom ti mue*, *jam hutue*, *kam fitue* etj., thekson I.Ajeti⁹.

Në hartat e ADGJSH në pikën 35, pika më të afërt nga qendra e Rahovecit, që është fshati Xërxë, çështja e diftongjeve nuk është paraqitur e qartë sa duhet. Kështu, p.sh. sa i përket togut zanor **ue** në hartat 51.a,

⁵ J. Hondozi, *vep. cit.*, f. 20.

⁶ ADGJSH, ASHSH, Napoli 2007, f.69-73.

⁷ Fridrik Dulaj, *E folmja e Rahovecit me rrethinë*, IAP, Prishtinë 2016, f. 69-71.

⁸ F. Dulaj, *vep. cit.*, f. 71-74.

⁹ *Vep.cit.* f. 223.

51.b, 51.c, dhe 52, ai na paraqitet i qëndrueshëm, pra i plotë, mirëpo togzanori në fjalë kam vënë re se nuk ruhet njësoj në gjithë zonën¹⁰. Ndërkaq, hartat 53.a, 53.b, 53.c, ku pasqyrohet gjendja e togut zanor **ye**, na paraqitet një mbledhje e qartë e këtij togu zanor në zanoren e parë **y**¹¹.

Lidhur me këtë çështje ne do të theksonim se edhe sot në pjesoret, të cilat i thekson prof. I. Ajeti, por edhe në shumë sosh, në një areal më të gjerë të Rahovecit, i përbërë nga disa fshatra që lidhen gjeografikisht me këtë qytezë, siç janë fshatrat: Pataqan i Poshtëm, Sopniq, Vrajakë, Bratatin, dëgjohen rregullisht diftongu **ue** dhe **ye** në pjesoren e foljes: *punue, shkue, këue*, përkatësisht: *thye, shkye, lye* etj¹². Prandaj duke pasur parasysh heterogjenitetin e kësaj treve në aspektin fonetik, mendojmë se pika 35 e ADGJSH, nuk mund të mbulojë gjithë trevën e Rahovecit me rrethina.

Në sistemin e bashkëtingëlloreve Ajeti, konstaton se gjuha e Divanit e ka ruajtur grykoren **h**, prandaj shprehet kështu “shqiptimi i spirantit **h** del mjaft i qëndrueshëm në gjithë tekstin e Divanit, qoftë në fjalët e huazuara orientale, qoftë të shprehjet me burim të vendit”, si p.sh: *Na shohim, Bim shehadet, Guha ... ban rahmet*.

Në tri veprat e autorëve rahovecas, Divani i Sheh Maliqit¹³, Fjalori i Kujunxhiçit dhe Flamurtari i Kosovës-Isa Boletini S. Haxhia, na paraqesin kalimin e **h** në **f** te disa fjalë: *me njofto, i njoftun, i ftoft*; ose te vepra e S. Haxhisë: *A po i shef e a po i njef, Të cilit janë e kush janë, Unë po i shof dhe po i njof*¹⁴. Duke ju referuar hartave 57.a, 57.b, 57.c, 57.ç, të ADGJSH, për fjalët: *leh, shoh, njoh, ftoh, ndihmë, lahem*¹⁵, na duhet të theksojmë se në pikën 35., grykorja **h** na paraqitet e ruajtur në të gjitha pozicionet. Por sipas hulumtimeve të bëra në terren na rezulton se pika 35. e ADGJSH-s, nuk e pasqyron qartë gjendjen e grykores **h** në gjithë këtë zonë. Foljet *shoh* e *njoh* në të gjithë trevën e Rahovecit në mënyrë sporadike bashkëtingëllozja **h** ka kaluar në **f** siç është dhënë për pika fqinje 31., 31.a, 34., 37. në ADGJSH, si p.sh.: *njof* dhe *shof*.

¹⁰ ADGJSH, ASHSH, Napoli 2007, f. 68-71

¹¹ ADGJSH, ASHSH, Napoli 2007, f. 72-74

¹² F. Dulaj, *vep. cit.* f. 100.

¹³ I. Ajeti, *vep. cit.* f. 228

¹⁴ S. Haxhija, *vep. cit.* f. 119.

¹⁵ ADGJSH, ASHSH, Napoli 2007, f. 182-185.

Ruajtjen e spirantit **h** e vërteton edhe studiuesi i Fjalorit të Lubomir Kujunxhiçit, Hilmi Agani¹⁶. Qëndrueshmëria e kësaj bashkëtingëlloreje vazhdon edhe sot në të gjitha fshatrat e Rahovecit ashtu siç e gjejmë në shumë monografi për të folme të ndryshme të shqipes. Për dallim nga fshatrat e kësaj qyteze, në Rahovec qëndrueshmëria e bashkëtingëllores **h** është lëkundur dukshëm, gjë që kjo mendoj se është rrjedhojë e bilinguizmit që përdoret në këtë areal, prandaj kemi emrat pa **h**, si: *Asan, Isen, Aki*, ose edhe në trup të fjalës: *Ravec, gua* (Rahovec, gjuha). Mendimi i Idriz Ajetit për qëndrueshmërinë e bashkëtingëllores **h** dhe Hilmi Aganit për ruajtjen e **h**-së në të gjitha pozicionet e fjalës, na forcon bindjen se qëndrueshmëria e kësaj bashkëtingëlloreje u lëkund nga ndikimi i bilinguizmit, e cila ka rënë në të folmen e këtij areali pas botimit të këtyre dy veprave. Pra, sipas mendimit tonë rahoveciançja u krijua si një kod gjuhësor me një leksik të përzier në gjysmën e parë të shekullit të XX. Siç na dëshmon prof. I. Ajeti, sonantet **l**, **ll**, **r**, **rr** autori i Divanit nuk bëri përpjekje t'i dallonte. Ai nuk e përdori **teshtidin** e alfabetit arab, i cili do t'i mundësonte të bënte dallimin e sonateve *l-ll* dhe *r-rr*. Kur e kemi fjalën te kjo çështje, është mirë te theksojmë se, sot, sonatet **r** dhe **rr** në të folmen e qytetit të Rahovecit përdoren këmbyerazi, si p.sh: *po e prej aren, po e livroj arren*. Ndërsa lëngëzorja e dyfishtë **ll** shpeshherë, e ndikuar nga situata bilinguistike dhe vendi i afërt i nyjetimit, ka zëvendësuar **dh**, si p.sh.: *po m'llem llami (po m'dhem dhami)*¹⁷.

Çështje tjetër, e cila mendoj se ka rëndësi të trajtohet në këtë kumesë është konstatimi i Idriz Ajetit se gjuha e Divanit të Sheh Maliqit ka ruajtur grupet e bashkëtingëlloreve **mb**, **nd** dhe **ng**, të cilat duke iu referuar edhe shumë monografive për të folmet e gegërishten verilindore, por edhe të dhënave të ADGJSH, me përjashtim në anën veriperëndimore të të folmes së Pejës me rrethina, janë reduktuar në bashkëtingëlloren e parë. Ruajtjen e këtyre gupeve bashkëtingëllore në gjuhën e Divanit të Sheh Maliqit e vërteton edhe punimi i Jajah Hundozit, si p.sh.: *S'na bjene ne mend per ahiret; sevdan tonde kur kom hi; dertin tond kush se e kish; ne gjerdan kuj do ja mbrri; mbrenda qe ka shpend të gjallnis; ma ngat se ato*

¹⁶ Agani, Hilmi, *Fjalorii Lubomir Kujunxhiçit*, Prishtinë 1981, f.143.

¹⁷ F. Dulaj, *vep. cit.* f. 134.

nuk kom; Qo i ngrat mos rri n'gaflet; ngo Hilmi mos rri gafil. Lidhur me këtë çështje, prof. Ajeti shprehet kështu: “E shohim të arsyeshme të vëmë në dukje që në gjuhën e Divanit ruhen të paprekura toget bashkëtingëllore **mb** dhe **nd**, të cilat në të folmet shqipe të truallit të Kosovës sot i gjejmë të asimiluara në **n**, **m**¹⁸”.

Ruajtja e grupit konsonant **mb** mund të dëshmojë për një gjendje më të vjetër të shqipes, krahasuar me përdorimin e rahovecjançes, siç e kemi sqaruar më lart, ose thënë më saktë rahovecasit në të kaluarën flisnin shqip e jo sllavisht. Të gjitha rastet e shqiptimit të grupit **mb** rahovecasit i shqiptojnë të plotë: puna *mbar*, *nimbllet*, *shtambllet*, *Katërqindmij pejgamber qi erdhenn'dynja*, etj. Përderisa në fshatra ky grup është mbledhur në bashkëtingëlloren e parë p.sh.: puna e *mar*, *nimdhet Pejgamerin* etj.

Në një veprën tjetër, më të vonë se Divani, Flamurtari i Kosovës-Isa Buletini, në zonën e Rahovecit, në vend të grupit bashkëtingëllor **mb** në foljen mbes del forma me **j**, si: *jes*, *jet*, *jesim*, *jisni*, *jesin* (mbes, mbet, mbesim mbetem), si p.sh.: *Vriten në luftë po po dhe desin*, *Nuset e reja pa burrra jesin*, *Jesin(mbesin) të veja si qyqe në shpi*, *I lanë shpit e kthejnë në gjini*¹⁹.

Në disa raste të veçanta, siç e kishte shkruar edhe autori i Divanit, Hilmi Maliqi deshifruar nga prof. Ajeti, grupin **mb** e hasim të bashkëshkrirë në **p** p.sh: *mbram-pram*, *humb-hup*²⁰. Ndërkaq, në veprën e S. Haxhiajt, grupi **mb** e gjejmë me shurdhimin e **b**-së në **p**, pra: **mp**, p.sh.:... *Shqipnin në dorë qi mos t'ia lshojmë*, *Me armë n'dorë do ta mprojmë*²¹.

Nga ç'u tha më sipër në lidhje me këtë grup konsonantik, duke iu referuar veprës Divani të Sheh Maliqit, veprës së S. Haxhisë dhe hulumtimeve në terren, mund të përfundojmë se grupi bashkëtingëllor **mb** sipas të dhënave të ADGJSH të paraqitura në hartën 16, ku pasqyrohet gjendja e grupit bashkëtingëllor **mb**, si në mbarë gegërishten edhe e folmja e zonës në shqyrtim është përfshirë në reduktimin e grupit **mb** edhe pika 35, që është brenda të folmes së Rahovecit do t'i mbulojë fshatrat Ratkoc dhe

¹⁸ I. Ajeti, *vep. cit.* f.312.

¹⁹ S. Haxhiaj, *Flamurtari i Kosovës-Isa Boletini*, Munchen 1967, f. 89.

²⁰ I. Ajeti, *vep. cit.* f. 229

²¹ S. Haxhiaj, *vep. cit.* f. 66.

Krushë, por jo edhe qytetin e Rahovecit, ku grupi bashkëtingëllor **mb** ruhet në të gjitha pozicionet: *mbiell grurin, krastit kumbullen, thumb, përmbi etj.*

Edhe grupi **nd**, ashtu sikurse edhe grupi **mb**, sipas të dhënave të studimit të prof. Idriz Ajetit, në gjuhën e Divanit është i qëndrueshëm²². Mirëpo, shikuar më për së afërmi, grupi bashkëtingëllor **nd** në të folmen e kësaj zone ka ndjekur dy rrugë: brenda në qytetin e Rahovecit ky grup ruhet i plotë, ndërsa në të gjitha fshatrat rreth tij është reduktuar në **ñ**.

Edhe H. Agani, duke iu referuar Fjalorit të Kujunxhiçit, për grupin **nd** mendon se dëgjohet në mënyrë sporadike në disa fshatrat të Rahovecit si në: Sopniq, Zaçisht, Zatriç, Apterushë, si p.sh.: *nder, katundar, e ki mundu, mbas shpinde etj.*²³.

Grupi bashkëtingëllor **nd**, sipas të dhënave të ADGJSH, në harta 15.b dhe 17., na paraqitet i reduktuar në bashkëtingëlloren e parë, duke ruajtur elemente të bashkëtingëllores së dytë **ñ**.

Po të krahasohet gjendja e sotme e grupit të bashkëtingëllor **nd**, ashtu si na shfaqen në të folmen e qytezës së Rahovecit në krahasim me të folmen e Llapushës, e cila i përket komunës së Malishevës dhe që gjeografikisht lidhet me fshatrat e Rahovecit, mund të themi se në të folmen e Llapushës ky grup është reduktuar plotësisht qysh moti. Në të folmen e Llapushës grupi bashkëtingëllor **nd** ka ndjekur një rrugë më ndryshe nga të folmet e arealeve të Krushës dhe Ratkocit. Në Llapushë grupi **nd** është reduktuar plotësisht në bashkëtingëlloren e parë, pa ruajtur elemente të bashkëtingëllores së dytë **d**, d.m.th në **n** të pastër, p.sh.: *po knon knusi*. Kurse në të folmen e dy arealeve, Ratkocit dhe Krushës, grupi **nd** ka dhënë **ñ**, si p.sh.: *po kñon kñusi*. Ndërsa në Rahovec: *kendon kendusi*.

Në lidhje me grupin bashkëtingëllor **nd**, sipas hulumtimeve të bëra në të terren, për vite të tëra, mund të përfundojmë me përgjegjësi të plotë se edhe ky grup konsonantik, ashtu sikurse edhe grupi **mb**, ka ndjekur dy rrugë. Në të gjitha fshatrat e Rahovecit është reduktuar **ñ**, siç dhe është paraqitur në hartën e ADGJSH, ndërsa në qytetin e Rahovecit ka mbetur i qëndrueshëm, d.m.th ruhet edhe sot e kësaj dite, siç e gjen edhe prof. I.

²² I. Ajeti, *vep. cit.*, f. 229

²³ H. Agani, *vep. cit.* f. 141.

Ajeti në veprën “Divani” të Sheh Maliqit: *edhe njonda osht marifet, apet ndermend nuk na ra, zembren bone paq perëndia na tha*. Dhe siç e vërteton më vonë H. Agani në “Fjalorin e Kujunxhiçit”, apo edhe siç e gjejmë në veprën e S. Haxhisë “Flamurtari i Kosovës- Isa Boletini”: *tue i këndue në vesh kurkush pa ndi*.

Ashtu si grupet **mb** dhe **nd** edhe grupi **ng**, sipas të dhënave që na sjell prof. I. Ajeti nga Divani i Sheh Maliqit na paraqitet i qëndrueshëm deri në fillim të shekullit XX²⁴, si p.sh.: *ket Hilmijen e pe ngon (K49), as me pi as me ngorn K51, hiqnaj perdet ngat me kon K5*. Edhe në veprën e S. Haxhisë “... të gjithve Isa ja ka me n’a pre, Me na pre me n’a cungue. Mund të theksojmë se këto grupe janë edhe sot e kësaj dite të gjalla në qytetin e Rahovecit, p.sh: *me hanger, ngat, ngusht, kungull* etj.

Në dy arealet e tjera, jashtë Rahovecit, pra në fshatrat Ratkoc dhe Krushë edhe grupi bashkëtingëllor **ng** është reduktuar në fonemën **ŋ**, e cila ka përdorim të gjerë, p.sh.: *kânj* (këngë), *hinjirizet* (qeshet me zë të lartë), *hinjllima* e kalit, *kuŋull* (*kungull*), *buŋ* (*bung*), *guŋaq* (*gungaq*) etj., *ia la ŋrehtdoren, ju ŋri xhaki, etj*.

E shohim të udhës që edhe për çështjen e bashkëshkrirjes së këtij grupi koinsonantik t’i referohemi hartës 18. të ADGJSH-së, përkatësisht pikës 35²⁵, ku grupi bashkëtingëllor **ng** është paraqitur i reduktuar në të gjitha kushtet fonetike për të folmen që po e shqyrtojmë, dhe kjo gjendje përkon me arealet e Ratkocit dhe të Krushës p.sh: *ŋusht, kuŋull, truŋ, cuŋ, ŋat*, por jo edhe me qytezën e Rahovecit. Prandaj, duke u mbështetur në të dhënat që na japin “Divani”, “Fjalori i Kujunxhiçit” dhe vepra “Flamurtari i Kosovës-Isa Boletini”, si dhe në të dhënat që na dalin në terren, mund të themi se të dhënat e ADGJSH nuk janë në përputhshmëri me gjetjet faktike në këtë të folme. Prandaj mund të saktësojmë se folësit e të tri grupmoshave në qytetin e Rahovecit e ruajnë grupet bashkëtingëllore **mb**, **nd** dhe **ng** në të gjitha pozicionet, p.sh.: *mbiell, kumbullen, thumb, përmbi; njonda, ndermend, katundar, mundu, kendon kendusi; ngusht, kungull, trung, cung, ngan, ngat* etj.

²⁴ I. Ajeti, *vep. cit*, f. 231.

²⁵ ADGJSH, ASHSH, Napoli 2007, f. 101.

Dihet tashmë se ndryshimet në mes të folmeve të dialekteve të shqipërisë dalin kryesisht në sistemin fonetik. Megjithatë, po sjellim edhe disa ndryshime dialektore që na dalin në sistemin gramatikor të kësaj të folmeje, të cilat mendoj se janë me interes të shihen në këndvështrimin dialektal. Në fushë të morfologjisë, sipas të dhënave që sjell prof. I. Ajeti nga gjuha e Divanit, sistemi i rasave ka ndjekur të njëjtën rrugë të zhvillimit si kurse në të folmet e tjera të Kosovës. Emrat e lakimit të dytë, të cilët përfundojnë me bashkëtingëlloret grykore **k, g, h** në gjuhën e Divanit, kryesisht, dalin me nyjën **i**, por në mënyrë sporadike del edhe nyja **u**, si p.sh.: *ashki, hakit, tarikatin, hallki, ashikin, çarki, ahi, plehi*, ose me **u**: *teriku, ashiku* etj.²⁶ Nisur nga të dhënat e Divanit dhe nga kërkimet e bëra në terren, duhet të pohojmë se në të folmen e Rahovecit, kalimi i nyjës **u** nuk ka përfunduar krejtësisht në **i**. Edhe sot e kësaj dite në mënyrë sporadike dëgjojmë forma të shquarsisë së emrave të lakimit të dytë me nyjën shquese **u**, si p.sh.: *thi bir thi, krah i djatht* etj. Edhe sa i përket çështjes së pronorëve, I. Ajeti vëren se në gjuhën e Divanit, pronorët *jem, jon, yt* etj., përdoren pa nyje të përparme. Theksojmë me këtë rast se pronorët nuk janë nyjësuar as sot e kësaj dite në të folmen e Rahovecit. Gjinia e pronorëve *ynë* dhe *jonë*, në arealin e Krushës së Madhe është ruajtur, ashtu siç e ka vënë re prof. Ajeti në Divanin e Sheh Maliqit, si p.sh.: *hoxha yn, vllavi yn, mali yn*, ose *kodra jon, fusha jon, ara jon*. Sa i përket çështjes së leksikut duhet të theksojmë do të theksonim se konkludimin e prof. I. Ajetit se në gjuhën e Divanit ai nuk gjeti më shumë se gjashtë fjalë sllavisht.

Duke e përfunduar kumtesën time, më duhet të theksoj ndihmesën e çmuar të prof. Ajetit që bëri rreth të folmes së Rahovecit duke pasur për objekt shtjellimi gjuhën e Divanit të Sheh Maliqit. Ai, ndonëse nuk kishte për qëllim të kryente një hetim dialektologjik në Trevën e Rahovecit, megjithatë preki çështjet kryesore të kësaj të folmeje, si në fushën e fonetikës, morfologjisë, leksikut dhe la shtegun të hapur edhe për studiues të tjerë që të shtjellonin këtë të folme edhe nga fushat e tjera të reja siç janë: sociolinguistika, psikolinguistika, apo edhe në këndvështrimin lingistik e plurilinguistik.

²⁶ I. Ajeti, *vep. cit.*, f. 236.

INDEKSI

- Adelung, 142, 166
Agalliu, 116, 123
Agani, 13, 52, 209, 256, 286, 287,
290, 299, 301, 302
Agolli, 119
Ajeti, 5, 9, 11, 12, 13, 14, 15, 17, 18,
19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27,
29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37,
38, 39, 41, 44, 46, 47, 48, 49, 50,
51, 52, 53, 55, 56, 57, 59, 82, 87,
91, 93, 94, 95, 96, 97, 98, 99, 100,
101, 102, 103, 110, 113, 114, 125,
133, 138, 146, 147, 148, 149, 159,
160, 161, 162, 164, 169, 175, 176,
177, 178, 180, 181, 183, 184, 185,
186, 187, 188, 189, 190, 191, 192,
193, 194, 195, 196, 197, 199, 200,
201, 202, 203, 204, 205, 206, 207,
209, 210, 211, 212, 213, 214, 215,
216, 217, 218, 219, 220, 221, 222,
223, 224, 225, 226, 227, 228, 229,
230, 231, 232, 233, 234, 235, 236,
237, 238, 239, 240, 241, 242, 243,
244, 245, 246, 247, 248, 249, 250,
251, 252, 253, 254, 255, 256, 259,
261, 263, 264, 265, 266, 267, 268,
269, 270, 271, 272, 273, 274, 275,
276, 277, 278, 279, 280, 281, 282,
283, 284, 285, 286, 287, 288, 289,
291, 292, 293, 294, 296, 297, 298,
299, 300, 301, 302, 303
Almagià, 134
Altimari, 9, 117, 123, 133, 156
Arkhangelskij, 116, 123
Auvera, 121, 123
Bacaj, 60, 61, 70
Badallaj, 175
Bageri, 196
Bagerit, 191, 192
Baliu, 263
Bardhi, 30, 116, 177, 245, 249, 255
Barić, 17, 20, 35, 72, 73, 203, 204
Bariç, 25, 45, 50, 102, 200, 204, 247
Bariqi, 201, 202, 207, 243
Barjaktarević, 60, 61
Barleti, 223, 245
Bartoli, 133, 134, 135, 144, 147, 148,
149, 150, 151, 169, 201, 235
Beci, 87, 91, 123, 160, 162, 164, 257,
259, 261
Beçikemi, 245
Biondelli, 135, 140, 144, 147
Blaku, 45, 186, 196, 197
Bogdani, 25, 49, 116, 168, 177, 216,
234, 235, 245, 249,
Bokshi, 116, 123, 209, 275
Bonfantes, 91, 266
Bopp, 92, 176, 177, 246
Boshnjaku, 18, 47, 269, 281, 282,
283, 285, 286, 288, 290
Brückmer, 243
Buchholtz, 116
Buchholz, 28, 123
Budi, 116, 177, 216, 249
Budimir, 102, 204
Buzoliç, 50, 51
Buzuku, 25, 49, 109, 116, 114, 164,
177, 181, 216, 236, 242, 248, 249,
273, 274, 278
Bybee, 121, 122, 123
Byron, 256, 261
Camaj, 24, 123, 176, 200, 201, 203,
207
Cimochowski, 18, 20, 206, 207
Cimohovski, 243
Cipos, 211
Condillac, 142
Constantinescu, 77, 79
Cordignano, 60
Corinaldi, 136, 144, 145, 147, 148,
149, 150, 151
Çabej, 12, 20, 22, 24, 27, 30, 34, 35,
36, 48, 49, 87, 91, 95, 100, 102,
109, 114, 176, 177, 178, 194, 195,
197, 200, 201, 220, 222, 235, 242,
243, 247, 248, 249, 250, 252, 263,
264, 265, 266, 267, 268, 269, 270,
271, 272, 273, 274, 275, 276, 277,
278, 279, 280
Çeta, 13

- Çetta, 30
 Dançetoviçin, 30
 Daničić, 65, 74, 78
 De Mauro, 134, 169
 De Rada, 134
 De Simones, 266
 Dema, 9
 Demiraj, 24, 35, 49, 53, 87, 88, 92,
 114, 206, 207, 235, 240, 272, 295
 Dervishi, 121
 Desnickaja, 20, 35, 38, 87, 88, 91,
 102, 204
 Desnickajes, 204
 Desnitskaja, 160
 Devoto, 134
 Dobrić, 137, 139, 151, 165, 169
 Domi, 19, 22, 24, 29, 30, 35, 114,
 235, 265
 Dozoni, 51, 178
 Drançolli, 72
 Drini, 255
 Dulaj, 295, 297, 298, 299
 Dušana, 74
 Elezović, 188, 189, 196, 197
 Elezović, 245
 Elezović, 189, 196, 204
 Elezović, 244, 245
 Erber, 50
 Erdeljanović, 221
 Ergin, 289
 Fallmerari, 99
 Fidler, 27
 Fiedler, 9, 19, 116, 123
 Flaubert, 120
 Fontanot, 137
 Frashëri, 25, 213, 246, 276
 Friedman, 9, 41, 42, 44
 Gamba, 139, 140
 Gashi, 59
 Gazullin, 25
 Georgiev, 102, 266
 Ghisalberti, 134, 169
 Giannini, 134
 Gołąb, 42, 44
 Gosturani, 123
 Gjeçovi, 25, 188, 191, 197
 Gjinari, 87, 88, 89, 91, 114
 Hadri, 13, 209
 Hadžibegić, 80
 Haebler, 25, 176
 Hahn, 59, 60, 61, 62, 87, 88, 98, 99
 Halimi, 229, 230, 239, 240
 Hamiti, 281, 282, 284, 285
 Hampit, 35
 Handžić, 80
 Haugen, 254, 261
 Haxhi, 257, 261, 298, 300, 302
 Hondozi, 295, 297
 Hoxhin, 276
 Hubbard, 123
 Humboldt, 17
 Hysa, 282
 Illiç-Svityč, 42, 44
 Imami, 139, 146, 147, 169
 Islamaj, 239
 Islami, 9, 11, 12, 15
 Ismajli, 11, 17, 29, 31, 33, 34, 91,
 123, 184, 185, 189, 194, 196, 197,
 209, 213, 243, 252, 254, 255, 258,
 261, 267, 275
 Jakobson, 128, 129, 131
 Janković, 142
 Janura, 30
 Jašar-Nasteva, 41, 44
 Jashar-Nasteva, 30, 242, 250, 252
 Jireček, 35, 36, 65, 67, 77, 79, 97, 223
 Jokl, 20, 46, 48, 87, 72, 82, 87, 92,
 102, 176, 201, 202, 204, 205, 239,
 243, 246, 248, 249, 250, 273, 277,
 278
 Jorgji, 123, 160, 161, 169
 Jubanin, 276
 Juras, 136
 Kadare, 119, 121, 186
 Kaleshi, 282, 286, 290
 Karaxhiqit, 187, 196
 Karpikova, 115
 Katičić, 35, 36
 Katiçiq, 266
 Katiqic, 102
 Kazazi, 49, 116, 249
 Koneskin, 25
 Kopitar, 94, 204, 246
 Korkuti, 9, 11, 12, 15
 Kostallari, 258, 259, 261, 265
 Kovačev, 77
 Kovačević, 73, 80, 82
 Krahe, 102

- Krasniqi, 13
 Kreqmeri, 98
 Kristoforidhi, 245, 276
 Kryeziu, 27, 30, 197, 239, 242, 252
 Kuhn, 51, 206
 Kujunxhiç, 52, 286, 287, 298, 299, 301, 302
 Kushi, 192, 197
 La Piana, 22, 114, 215
 Lafe, 210, 211, 212, 213, 214, 215, 216, 228, 229, 259, 261, 266
 Lamberci, 28, 46, 48
 Lewin, 28
 Likaj, 103
 Ljubiç, 69
 Locke, 142
 Loma, 78
 Lushaj, 59, 70, 71
 Lluka, 284, 285
 Majer, 51, 98, 178, 243, 248
 Mala-Imami, 139, 169
 Maliqi, 18, 47, 48, 176, 269, 281, 283, 285, 286, 287, 289, 290, 291, 292, 293, 294, 295, 296, 298, 299, 300, 302, 303
 Malte-Brun, 168
 Mansaku, 33, 117, 123
 Maria Monti, 134
 Maslova, 119
 Matoshi, 9, 230
 Matzinger, 116, 123
 Mayer, 71, 202
 Meillet, 39
 Meje, 102
 Mekuli, 13
 Memisha, 209
 Meyer, 20, 87, 88, 91, 200, 202, 203, 204, 205, 246, 248, 277, 278
 Meyer-Lübke, 204
 Miklosich, 35, 65, 81
 Miklošičit, 201, 203
 Miklošič, 200, 202, 203, 243, 246
 Mikloshic, 204
 Mikloshic, 50, 51, 94, 102
 Milani, 60
 Miletiçin, 178
 Milojeviç, 66
 Minxhozi, 9
 Mitkon, 276
 Mjeda, 213, 235
 Mjedja, 133, 144, 145, 148, 149, 150, 151, 154, 159, 169
 Mladenovi, 46, 48
 Morozova, 123
 Mulaku, 93, 255
 Munishi, 253, 254, 259, 261
 Murati, 239
 Mustafa, 11, 12, 15
 Myderrizi, 257, 262, 282
 Nahtigal, 25, 204
 Newmark, 116, 123
 Neziri, 190, 197
 Nolin, 25
 Novaković, 82, 84
 Omari, 189, 197
 Osmani, 64
 Oshtir, 204
 Pagliuca, 123
 Pajaziti, 291, 292
 Pallas, 142
 Panduro, 142
 Paravia, 136, 140
 Pedersen, 20, 51, 114, 178, 179, 180, 200, 201, 202, 205, 206, 207, 233, 239, 243, 246, 248, 249, 277, 278
 Pedesenit, 205
 Pekmezi, 51, 176, 178
 Perkins, 123
 Pešikan, 69, 72
 Petar Strčić, 136, 169
 Pipa, 60, 203, 207, 259, 262
 Pirrakut, 282
 Plungian, 121, 123
 Pillana, 30
 Pompa, 136
 Popovës, 283
 Popović, 81
 Popoviç, 97, 102, 221
 Popviç, 51
 Prifti, 123
 Priku, 199, 203, 207
 Prishtina, 9, 12, 21, 31, 44, 267, 275
 Pulaha, 63, 64, 69
 Qose, 209
 Radossi, 137
 Raka, 254, 255, 262
 Resuli, 24, 257

- Riza, 20, 22, 24, 114, 235, 254, 257, 262, 282
Rosetti, 75
Rozhaja, 13
Rusakov, 115, 123
Rrota, 199
Šafarik, 67, 74
Salvioni, 138, 140, 141, 148, 169
Sandfeldi, 243
Sapir, 114
Sarro, 145, 146, 164, 169
Sawicka, 125, 128, 129, 130, 132
Schmitt, 66
Schubert, 28
Schumacher, 116, 123
Selishçevi, 243
Simovski, 41, 44
Sinani, 183, 197
Skendo, 281
Skok, 20, 25, 35, 45, 46, 74, 75, 102, 191, 197, 204, 243, 250, 251
Skoku, 46, 243, 251
Sokoli, 28
Stadtmüller, 38
Stancovich, 135, 136, 137, 138, 139, 140, 141, 142, 143, 144, 146, 147, 148, 149, 150, 151, 161, 162, 164, 165, 166, 168, 169, 170
Stanković, 136, 169
Stipčević, 99
Šufflay, 59, 65, 66, 81
Sula, 230
Sulejmani, 241
Sheperin, 176
Shklifov, 42, 44
Shkurtaj, 91, 123, 164, 169, 181, 192, 197
Shuteriqi, 145, 148, 169, 265
Tagliavani, 243
Tagliavin, 18, 25, 91, 134, 200, 201, 202, 203, 204, 205, 207
Tahsini, 276
Taliavini, 45, 46, 87, 205
Tajjavini, 48, 50, 205
Timberlake, 42, 44
Topalli, 23, 180
Treimer, 204
Trompetti, 204
Thaçi, 14
Thunmann, 35
Uhlisch, 28
Ulqinaku, 284, 285
Vajgand, 50, 51, 100
Vasen, 276
Veçilharxhin, 276
Vidoeski, 30, 42, 44
Vidossich, 140, 141, 148, 169
Visanit, 266
Vllahiu, 9
Voka, 284, 285
Vokshi, 255
Vreton, 276
Weigand, 176
Weigandi, 18
Wijk, 75, 81
Xhuvani, 22, 30, 215, 257, 262, 274
Zaimov, 78, 79
Zajmi, 13, 21
Zojzi, 88
Дмитренко, 123
Заика, 123
Маслова, 123
Плунгян, 119, 123
Топоров, 127, 129, 131
Трубецкой, 129
Храковский, 123
Якобсон, 128, 129, 131

NË 100-VJETORIN E AKADEMIK IDRIZ AJETIT
Materialet e Konferencës jubilarë-shkencore të mbajtur në Prishtinë
me rastin e 100-vjetorit të lindjes së Akademik Idriz Ajetit (ASHAK)
më 27 janar 2017

Përgatiti: Akademik Rexhep Ismajli

2018

Botues:

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Redaktor teknik:

ASHAK

Madhësia: 19.50 tabakë shtypi

Tirazhi: 200 copë

Formati: 16x24 cm

Shtypi:

Focus Print

Shkup

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

008(496.51)“2017”(063)

811.18(496.51)“2017”(063)

929(496.51) Ajeti, Idriz

Në 100-vjetorin e Akademik Idriz Ajetit: materialet e Konferencës jubilarë-shkencore të mbajtur në Prishtinë me rastin e 100-vjetorit të lindjes së Akademik Idriz Ajetit (ASHAK) më 27 janar 2017 / përgatiti Rexhep Ismajli. - Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2018. - 308 f.: ilustr. me ngjyra; 24 cm. - (ASHAK: Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë).

Titulli paralel në gjuhën shqipe dhe angleze.

1. Ismajli, Rexhep

ISBN 978-9951-615-93-8